



Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Drag
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës
në Dragash



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 - 2023

PJESA I: KAPITUJT 1 - 4

Michael Voit
Maria Elena Zuniga Barrientos – Menaxhere e projektit

Me kontributin e:

Dorothea Roßner – Planere, Crystal Whitaker – Arkitekte, Florian Bemmerlein-Lux – Biolog, Peter Bank – Biolog, Ergin Hajredini – Ekspert i Pylltarisë dhe GIS, Dr. Halil Ibrahim – Ekolog, Todd Wassel – Specialist i Turizmit, Cristian Angelescu – Inxhinier Sanitar, Shpresa Kastrati – Inxhinierë për Sanitari, Ekkehart Naumann – Ekspert i energjetikës, Maliq Pireci – Ekspert i energjetikës, Rreze Duli, Specialiste për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale, Kaltrina Salihu – Zyrtare për komunitet, Ismail Gagica, ekspert i GIS, Bashkim Susuri – Gazetar dhe Bashkëpunëtor i Projektit, Ajhan Hadzija – Koordinator i Turizmit, Abdullah Kryeziu – Përkthyes, UNICEF Kosovë, dhe nga Grupi Komunal Punues (GKP) i Komunës së Dragashit: Avni Nebiu – Koordinator, Hajri Ramadani – Drejtor i Arsimit, Ramadan Jashari – Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ahmet Bahtijari – Drejtor për Ekonomi dhe Financa, Bajram Hoxha – Drejtor i Zhvillimit Bujqësor dhe Inspeksionit, Bean Hadziasan – Drejtor i Urbanizmit dhe Kadastrit, Uzair Hamza – Zyrtar për komunitete, Tafil Krasniqi- Drejtor për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, Kamber Kamberi – Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Lindita Piraj – Zyrtare komunale për barazi gjinore, bazuar në vlerësimin paraprak të UN-HABITAT.

Dragash, Kosovë qershor 2013

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| LISTË E FIGURAVE | 3 |
| LISTË E TABELAVE | 4 |
| 1. HYRJA..... | 5 |
| 1.1 HISTORIKU | 5 |
| 1.2 QËLLIMI I PZHK | 6 |
| 1.3 PARIMET PLANIFIKUESE | 6 |
| 1.4 KËSHILLIMI PUBLIK | 7 |
| 2. KONTEKSTI KOMBËTAR DHE REGJIONAL I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR..... | 9 |
| 2.1 KORNIZA LIGJORE | 9 |
| 2.2 STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMBËTARE | 10 |
| 2.3 KONCEPTI KOMBËTAR I ZHVILLIMIT HAPËSINOR | 14 |
| 3. PROFILI I KOMUNËS SË DRAGASHIT..... | 18 |
| 3.1 PËRSHKIRMI I KOMUNËS..... | 18 |
| 3.1.1 Vendndodhja dhe gjeografia | 18 |
| 3.1.2 Topografia | 18 |
| 3.1.3 Klima | 21 |
| 3.1.4 Popullsia..... | 25 |
| 3.1.5 Administrimi komunal..... | 44 |
| 3.1.6 Sfondi kulturor dhe historik..... | 49 |
| 3.1.7 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese | 50 |
| 3.2 VENDBANIMET..... | 51 |
| 3.2.1 Fondi i njësive banesore dhe kushtet e jetesës | 51 |
| 3.2.2 Krahasimi i fshatrave | 54 |
| 3.2.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të vendbanimeve..... | 72 |
| 3.2.4 VENDBANIMET JOFORMALE | 73 |
| 3.3 SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE DHERAT | 76 |
| 3.3.1 Shkëmbijtë, Minerale dhe Dherat..... | 76 |
| 3.3.2 Shfrytëzimi i tokës..... | 78 |
| 3.3.3 Rreziqet natyrore | 79 |
| Vërshimet, rrëshqitjet e dheut dhe shembja e shkëmbinjve | 81 |
| 3.3.4 Burimet e ujit | 82 |
| 3.3.5 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të zhfrytëzimit të tokës dhe dheu | 84 |
| 3.4 ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE | 84 |
| 3.4.1 Arsimi | 84 |
| 3.4.2 Shëndetësia..... | 93 |
| 3.4.3 Mirëqenia Sociale | 97 |
| 3.4.4 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese në arsim, shëndetësi dhe mirëqenia sociale | 100 |
| 3.5 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI | 101 |
| 3.5.1 Zhvillimi Ekonomik | 101 |
| 3.5.2 Punësimi..... | 109 |
| 3.5.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese ekonomike..... | 110 |
| 3.6 PYLLTARIA DHE BUJQËSIA | 111 |
| 3.6.1 Pylltaria & dhe zonat gjysmë natyrore | 111 |
| 3.6.2 Bujqësia dhe shfrytëzimi i posaçëm i tokës..... | 114 |
| 3.6.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të pyjeve dhe të bujqësisë | 115 |

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

| | | |
|-----------|--|------------|
| 3.7 | BIODIVERSITETI DHE MBROJTJA E NATYRËS | 115 |
| 3.7.1 | <i>Flora dhe fauna</i> | 115 |
| 3.7.2 | <i>Parku Nacional i Sharrit</i> | 116 |
| 3.7.3 | <i>Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të biodiversitetit</i> | 118 |
| 3.8. | TURIZMI DHE KULTURA..... | 119 |
| 3.8.1 | <i>Kultura</i> | 119 |
| 3.8.2 | <i>Trashëgimia kulturore dhe natyrore</i> | 121 |
| 3.8.3 | <i>Turizmi</i> | 123 |
| 3.8.4 | <i>Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të turizmit dhe kulturës</i> | 126 |
| 3.9 | RRJETI RRUGOR DHE TRANSPORTI | 127 |
| 3.9.1 | <i>Rrjeti rrugor</i> | 127 |
| 3.9.2 | <i>Transporti</i> | 127 |
| 3.9.3 | <i>Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të rrugëve dhe transportit</i> | 128 |
| 3.10 | MENAXHIMI I MBETURINAVE TË NGURTA..... | 130 |
| 3.10.1 | <i>Pasqyrim i përgjithshëm</i> | 130 |
| 3.10.2 | <i>Mbeturinat dhe riciklimi</i> | 131 |
| 3.10.3 | <i>Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave të ngurta</i> | 134 |
| 3.11 | INFRASTRUKTURA DHE SHERBIMET KOMUNALE | 135 |
| 3.11.1 | <i>Furnizimi me ujë</i> | 135 |
| 3.11.2 | <i>Ujërat e zeza</i> | 136 |
| 3.11.3 | <i>Menaxhimi i ujërave të zeza</i> | 137 |
| 3.11.4 | <i>Rrjeti i energjisë elektrike</i> | 137 |
| 3.11.5 | <i>Rrjetet e telekomunikacionit</i> | 142 |
| 3.11.6 | <i>Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të infrastrukturës teknike</i> | 143 |
| 3.12 | <i>Vlerësimi i kapaciteteve të investimit</i> | 143 |
| 4. | SWOT ANALIZA | 145 |
| 4.1 | FUQITË | 145 |
| 4.2 | DOBËSITË | 147 |
| 4.3 | MUNDËSITË | 149 |
| 4.4 | KËRCËNIMET | 150 |
| 4.5 | PËRMBLEDHJA..... | 152 |

Listë e Figurave

| | |
|---|-----|
| GRAFIKU 1: STRUKTURA DHE RRJETI I VENDBANIMEVE. BURIMI: PHK 2010-2020, F. 126 | 15 |
| GRAFIKU 2: STRATEGJIA ZHVILLIMORE HAPËSINORE-ZONA E PORTOKALLTË (KOPSHTET E KOSOVËS), BURIMI: PHK 2010-2020, F. 145 | 17 |
| GRAFIKU 3: SHKALLA E LARTËSISË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DRAGASHIT | 20 |
| GRAFIKU 4: PROFILI I LARTËSISË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DRAGASHIT | 21 |
| GRAFIKU 5: DIAGRAMI I KLIMËS PËR KOMUNËN E DRAGASHIT | 22 |
| GRAFIKU 6: POPULLSIA GJATË KOHËS NË KOMUNËN E DRAGASHIT 1921-2011 | 28 |
| GRAFIKU 7: PIRAMIDA E POPULLSISË NË 1991 DHE 2009..... | 31 |
| GRAFIKU 8: PIRAMIDA E POPULLSISË PËR KOMUNËN E DRAGASHIT (TË DHËNAT NGA REGJISTRIMI NË KOSOVË 2011 | 32 |
| GRAFIKU 9: POPULLSIA E DRAGASHIT SIPAS GJINISË DHE GRUPIMIT MOSHOR 5 VJEÇAR..... | 33 |
| GRAFIKU 10: POPULLSIA SIPAS SFONDIT ETNIK/KULTUROR PËR [A] KOSOVË, DHE [B] KOMUNËN E DRAGASHIT | 37 |
| GRAFIKU 11: POPULLSIA E DRAGASHIT SIPAS RELIGIONI | 39 |
| GRAFIKU 12: PROPORCIONI I POPULLATËS SË DRAGASHIT SIPAS GJINISË DHE NIVELIT MË TË LARTË TË ARRITUR ARSIMOR | 40 |
| GRAFIKU 13: SKEMA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS KOMUNALE DRAGASH | 46 |
| GRAFIKU 14: BURIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE TË HAPËSIRËS SIPAS PËRDORIMIT NË PËRQINDJE | 52 |
| GRAFIKU 15: ENERGJIA E FATURUAR PËR SEKTORË TË NDRYSHËM PËR VITIN 2010 (%)..... | 53 |
| GRAFIKU 16: ENERGJIA ELEKTRIKE E FATURUAR NË FSHATRA TË KOMUNËS DRAGASH (2010)..... | 54 |
| FOTOGRAFIA 17: FOTOGRAFI NGA AJRI E BRESANËS | 57 |
| FOTOGRAFIA 18: FOTOGRAFI NGA AJRI E RESTELICËS | 59 |
| FOTOGRAFIA 19: FOTOGRAFI NGA AJRI I BREZNËS/BREZNA..... | 60 |
| FOTOGRAFI 20: FOTOGRAFI NGA AJRI E BRODIT..... | 63 |
| FIGURE 21: FOTOGRAFI AJRORE TË BUZEZIT | 67 |
| GRAFIKU 22: FOTOGRAFI NGA AJRI E RADESHËS | 70 |
| GRAFIKU 23: FOTOGRAFI NGA AJRI E ZLIPOTOKUT..... | 72 |
| GRAFIKU 24: KLASAT E GURËVE NË DRAGASH | 77 |
| GRAFIKU 25: KLASAT E DHEUT NË DRAGASH | 78 |
| GRAFIKU 26: ORTOFOTOGRAFI E RESTELICËS ME TREGUES TË QENDRËS HISTORIKE DHE PËRHAPJES SË VENDBANIMIT GJATË DEKADËS SË FUNDIT. SHIGJETA E KUQE TREGON RRUGËN E ORTEKUT, RRETHI I ZEZË I TREGON SHITËPITË E PREKURA..... | 80 |
| FIGURA 27: BIZNESET E REGJISTRUARA NË DRAGASH SIPAS SEKTORIT..... | 102 |
| FIGURA 28: NUMRI I BIZNESEVE DHE PUNËTORËVE (ME PËRJASHTIM TË PRONARËVE) NË DRAGASH SIPAS VENDBANIMEVE | 104 |
| FIGURA 29: VLERËSIMI I RELEVANCËS SË FAKTORËVE TË NDRYSHËM PËR SUKSESIN APO DËSHTIMIN E NVM-VE ⁹⁰ | 106 |
| FIGURA 30: SITUATA PRONËSORE NË PYJET E DRAGASHIT (NË HA)..... | 113 |
| FIGURA 31: MOSHA E KLASAVE NË PYJET E DRAGASHIT (NË HA)..... | 113 |

Listë e Tabelave

| | |
|---|-----|
| TABELA 1: TEMPERATURA MESATARE STINORE NË DRAGASH..... | 23 |
| TABELA 2: RESHJET DHE TEMPERATURA MESATARE GJATË PERIUdhËS SË VEGJETACIONIT | 23 |
| TABELA 3: TË DHËNAT PËR ENERGIJË DIELLORE PËR DRAGASHIN PËR SIPËRFAQEN HORIZONTALE..... | 24 |
| TABELA 4: TË DHËNAT PËR ENERGI DIELLORE NË KËNDIN OPTIMAL PËR DRAGASHIN | 25 |
| TABELA 5: POPULLSIA E FSHATRAVE TË KOMUNËS DRAGASH 1921 – 2008/2010 | 27 |
| TABELA 8: ÇMIMI I DRURIT PËR ZJARR SIPAS BURIMIT | 53 |
| TABELA 9: NUMRI DHE DENDËSIA E POPULLSISË SIPAS VENDBANIMEVE - 2008 [RENDITUR SIPAS DENDËSISË MË TË ULËT E TUTJE] | 55 |
| TABELA 10: DENDËSIA DHE DISTANCA MESATARE E VENDBANIMEVE TË KOMUNËS | 55 |
| TABELA 11: TË RESHURAT VJETORE NË M ³ PËR PELLGUN UJËMBLEDHËS..... | 82 |
| TABELA 12: PËRMBLEDHJE E SHKOLLAVE TË ARSIMIT SIPAS FSHATRAVE NË KOMUNËN E DRAGASHIT..... | 88 |
| TABELA 13: PËRMBLEDHJE E ZONAVE QË KANË OBJEKTE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË DRAGASH | 94 |
| TABELA 14: KRAHASIMI I VIZITAVE NË OBJEKTET SHËNDETËSORE TË DRAGASHIT ME MESATAREN E VENDIT | 95 |
| TABELA 15: LISTA E STAFIT MJEKËSOR NË KOMUNËN E DRAGASHIT (2012) | 96 |
| TABELA 16: MIRËQENIA SOCIALE E OFRUAR NË VITIN 2011 SIPAS MUAJVE | 98 |
| TABELA 17: MIRËQENIA SOCIALE E OFRUAR NË VITIN 2011 SIPAS KATEGORISË | 99 |
| TABELA 18: OFRIMI I SHËRBIMEVE..... | 100 |
| TABELA 19: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DHE PUNËTORËVE NË DRAGASH SIPAS FSHATRAVE | 103 |
| TABELA 20: DEGËT E NVM-VE NË DRAGASH (2011) ⁸⁸ | 105 |
| TABELA 21: NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS DEGËS NË NVM ⁸⁹ | 106 |
| TABELA 22: NUMRI I PUNËTORËVE NË SEKTORIN PUBLIK NË KOMUNËN E DRAGASHIT..... | 109 |
| TABELA 23: LLOJET E TOKAVE TË SHFRYTËZUARA NË KOMUNË TË DRAGASHIT NË HA DHE PËRQINDJE..... | 111 |
| TABELA 24: TË HYRAT NGA VJELJET NË PYJE NË TË DY SEKTORËT PUBLIK/PRIVAT..... | 113 |
| TABELA 25: LISTA E MONUMENTEVE TË MBROJTURA, JUGOSLLAVIA 1967..... | 122 |
| TABELA 26: SASIA E MBETURINAVE TË MBLEDHURA NË VITIN 2008 (TONELATA) | 133 |
| TABELA 27: FURNIZIMI ME UJË NË FSHATRAT E KOMUNËS SË DRAGASHIT..... | 135 |
| TABELA 28: SHPENZIMI I ENERGISË ELEKTRIKE SIPAS BURIMIT TË ENERGISË NË KOMUNËN E DRAGASHIT DHE PËRQINDJA E SHPENZIMIT..... | 138 |
| TABELA 29: SHPENZIMI MUJOR I ENERGISË NË KOMUNËN E DRAGASHIT | 139 |
| TABELA 30: NDËRTESAT PUBLIKE NË KOMUNË, GJENDJA EKZISTUESE | 141 |
| TABELA 31: KUSHTET EKZISTUESE NË NDËRTESA INDIVIDUALE (PËR BANIM) NË KOMUNËN E DRAGASHIT | 141 |
| TABELA 32: BUXHETI I KOMUNËS SË DRAGASHIT 2007-2011..... | 144 |

1. Hyrja

1.1 HISTORIKU

Historiku i projektit: Përgatitja e Planit Zhvillimor Komunal (PZHk) është bërë si pjesë e ruajtjes së biodiversitetit të Menaxhimit të projektit të Qëndrueshmërisë së Shfrytëzimit të Tokës (MQSHT), i cili e përfshinë tërë komunën e Dragashit. MQSHT është program trevjeçar që ka filluar në nëntor të vitit 2010, që financohet nga Qeveritë e Finlandës dhe menaxhohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor (MAPH) është institucioni kryesor kombëtar përgjegjës për ruajtjen e biodiversitetin, planifikimin hapësinor dhe për shumicën e aspekteve të mbirjes mjedisore. Prandaj është njëri nga pjesëmarrësit kryesor kombëtar për projektin MQSHT me komunën e Dragashit si pjesëmarrëse kyçe vendore administrative.

UNDP aktualisht i ndihmon institucionet kombëtare dhe lokale në Kosovë për t'i arritur synimet e Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit (QZHM). Duke e bërë këtë projekti MQSHT do të promovonte QSHM-në e tetë për të "siguruar qëndrueshmërinë mjedisore". Si pjesë e kësaj pune, një komponentë kryesore e punës së UNDP-së në Dragash është për të zhvilluar kapacitetin për t'i adresuar çështjet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të jetesës së përmirësuar, sidomos në nivelin lokal.

Kushtet e Referencës (KER) për MQSHT janë paraqitur në Dokumentin e Projektit të UNDP-së: Ruajtja e Biodiversiteti dhe Menaxhimi i Qëndrueshmërisë së Shfrytëzimit të Tokës në Dragash (Shtator 2010), Rezultatit 1 dhe 2 i këtij programi thotë që do të arrihet si vijon:

Planet dhe politikat në vend adekuat për ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të përdorimit të tokës.

Planet dhe kapacitet e zhvilluara për përmirësimin e jetesës.

Përgatitja e PZHk-së bie, në pjesën më të madhe, brenda këtij rezultati të programit.

Puna e kaluar relevante: Ka pasur një numër studimesh të ndërmarra nga komuna e Dragashit brenda pesë viteve të fundit, të cilat janë relevante për PZHk-në. Të rëndësishme kyçe janë dokumentet në vijim:

- *Agjenda zhvillimore komunale 2004-2006. E përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa:* Kjo ka siguruar një analizë situatë të komunës së Dragashit, kryesisht i ka përfshirë vitet 1999-2003, dhe i ka paraqitur disa qëllime strategjike me veprime të sugjeruara implementimi.
- *Komuna e Dragashit – Analiza hapësinore (tetor 2006).* E përgatitur nga Instituti për planifikim hapësinor dhe komuna e Dragashit për Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky ishte një vlerësim i shfrytëzimit të tokës ekzistuese dhe i situatës hapësinore në komunë deri në vitin 2006.
- *Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal (2007-2011).* E përgatitur nga DELTA III Projekti për Komunën e Dragashit (Nëntor 2007). LEDES e Përckatoi një vizion, qëllimet dhe projektet për hapësirën e komunës deri në fund të vit 2011.
- *Studimi preliminar në pah të konsultimit lidhur me elaborimin e Planit Zhvillimor Komunal (Korrik 2010).* Përgatitur nga UNHABITAT. Kjo jep një pasqyrë të shkurtë të profilit komunal, e harton një vizion, kornizën hapësinore dhe strategjinë implementuese për Dragashin.

- Strategia zhvillimore regjionale për regjionin ekonomik jug (2010-2013). E përgatitur nga agjencia regjionale zhvillimore jug (rda). Kjo paraqet vlerat ekonomike dhe mundësitë e regjionit të jugut të Kosovës dhe e shpalosë një strategji dhe e formulon një strategji zhvillimi dhe disa masa paraprake.
- *Udhëzimet e Komunës së Dragashit (për bashkëpunim ndërkombëtar) (2011-2013).E përgatitur nga UNDP.* Kjo ka raportuar për punën pjesëmarrëse të planifikuar për pesë fshatrat në Dragash. Gjithashtu i pasqyroj edhe çështjet kyçe që nevojitet të shqyrtoheshin për punën pasuese në PZHk.

1.2 QËLLIMI I PZHk

Plani Zhvillimor Komuna, sipas definicionit në Ligjin për Planifikim Hapësinor është një “plan shumë sektorial që i përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor”. E përfshinë tërë territorin e komunës.

PZHk për Dragashin është përgatitur për të mbuluar një periudhë kohore 10 vjeçare prej vitit 2013 deri në 2023. Gjatë kësaj periudhe, qëllim kryesor i PZHk-së do të jetë të veprojë si dokument strategjik planifikimi për komunën. Me këtë do t'i përmbushë këto funksione kyçe:

- Të sigurojë një analizë të azhurnuar të situatës ekzistuese për zonën e komunës;
- Të pasqyrojë plane strategjike dhe veprimtaritë për periudhën dhjetë vjeçare;
- Të sigurojë një kornizë për planifikimi të detajua hapësinor (si Planet Zhvillimore Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane) në rajonin e komunës;
- Të përkrah lehtësimin e varfërisë dhe të zhvillimeve socio-ekonomike për Dragashin dhe, me të bërë këtë, të përkrahë përfshirjen sociale dhe mundësit e barabarta për grupet e varfra;
- Të përkrahë qëndrueshmëria mjedisore dhe ruajtja e ndarës si dimension kyç për zhvillim të qëndrueshëm në këtë rajon rural.

1.3 PARIMET PLANIFIKUESE

Procesi përgatitor dhe përmbajtja e Planit Zhvillimor Komunal i përmbahen parimeve vijuese planifikuese:

Hierarkia e planifikimit: PZHk i konsideron kontekstin më të gjere hapësinor dhe planet relevante dhe rregullat e përcaktuara në nivelin kombëtar; udhëzimet e dhëna nga PZHk përputhet me kornizën kombëtare (kapitulli 2), përqendrohet në nivelin lokal dhe strategjike specifike dhe qëllimet për veprime të mëtejme në nivelin komunal.

Planifikimi i integruar: PZHk ofron një konspekt ndër-sektorial për zhvillimin hapësinor të komunës, duke i integruar elementet e të gjitha sektorëve relevant si ato ekonomik, shoqëror, të infrastrukturës dhe të zhvillimi të mjedisit.

Planifikimi shumë disiplinor: Përgatitja e planeve është bërë nga ekipi shumë disiplinor nën përgjegjësinë e UNDP-së, në të cilin planifikuesit, ekonomistët, inxhinierët ndërtimor, ekologët dhe të tjerët kanë bashkëpunuar më shumë. Ekipi përbëhet nga profesionistët kombëtar dhe këshilltarët ndërkombëtarë, që kanë bashkëpunuar intensivisht me administratën lokale dhe qytetarët.

Planifikim përsëritës: Procesi i ndoqi rregullat e themelore të planifikimi të përsëritur. Filloi me një analizë intensive të situatës ekzistuese ku shumë të dhëna u mbledhën, që nuk kanë qenë në dispozicion më parë. Analiza përfundoi me vlerësimin e fuqisë –dobësisë-mundësive dhe kërcënimeve (SWOT). Bazuar në rezultatet dhe analizat, në hapin e dytë vizionet dhe qëllimet janë krijuar. Këto e formonin Projekti i UNDP: Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës në Dragash

bazën për hapin e tretë: elaborimi i kornizës së zhvillimit strategjik. Si hap i katërt, strategjitë zbatuese u definuan.

Planifikimi transparent dhe publik: një proces intensiv bashkëpunimi mes ekipit të UNDP-së, komunës lokale, Ministrisë për Ambient dhe Planifikimi Hapësinor dhe format e ndryshme të pjesëmarrjes, u ndërmorën për të përfshirë këshillimin publik në vendimmarrje gjatë përgatitjes së PZHk-së ër të arritur një shkallë të fuqishme konsensusi në përmbajtjen e saj.

Qëndrueshmëria si asket kyç planifikimi: Sipas karakteristikave specifike të Dragashit, një komunë me popullatë të shpërndarë që shtrihet në vargmalet e larta të maleve të Sharrit me biodiversitet të madh dhe perspektivë të parkut nacional në të, aspektet mjedisore janë të rëndësishme qendrore. Andaj ishte e nevojshme të përfshihej komponenti në procesin e planifikimit, që ofroi informata të detajuara për situatën ekologjike dhe e lehtësoi planifikimin hapësinor me vlerësimin dhe udhëzimet e mëtejshme. Prandaj një "Atlas i Zhvillimit të Qëndrueshëm" (AZHQ) për Dragashin është përpunuar, i përfshirë në projektin e UNDP-së "Ruajtja e Biodiversiteti dhe Menaxhimi i Qëndrueshmërisë së Shfrytëzimit të Tokës në Dragash". Hartat bazike, Harta e Vlerësimit dhe Hartat Udhëzuese të AZHQ-së e formojnë një burim relevant informatash për PZHk-në, andaj shumë nga ato informata paraqiten në dokument e PZHk-së. Në anën tjetër, rezultatet planifikuese të PZHk-së krijuan burime të rëndësishme për punën e AZHQ-së.

1.4 KËSHILLIMI PUBLIK

Procesi përgatitor i PZHk-së e ka inkorporuar këshillimin publik në nivele të ndryshme. Është shumë me rëndësi që sektorët e ndryshëm të komunitetit në Dragash të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të marrin pjesë në përmbajtjen e planit. Rëndësi të njëjtë ka që përmbajtja e PZHk-së të inkorporojë një shkallë të fuqishme të konsensusit publik dhe që në mënyrë efektive t'i integrojë pikëpamjet e komuniteteve. Kjo është bërë si pjesë e shkallës së hershme të përgatitjes së PZHk-së, përfshirë gjatë AZHQ-së, procesin e mbledhjes së informatave. Grupet e ndryshme punuese morën pjesë në procesin e planifikimit.

Grupi punues komunal: Grupi Punues Komunal (GPK) është një forum pjesëmarrës, këshillues, i krijuar nën udhëheqjen e arriteve lokale. GPK e ka shoqëruar dhe përkrahur tërë procesin e PZHk-së. Anëtarët janë përfaqësues të qeverisë komunale (sipas sektorit), përfaqësues të sektori të biznesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Grupet punuese të fshatrave: Pos kësaj, grupet e fshatrave janë konsultuar për pikëpamjet e tyre lidhur me nevojat planifikuese në fillim të vitit 2011 (ref. Udhëzimet e Komunës së Dragashit Për Bashkëpunim Ndërkombëtar) (2011-2013). Pesë grupet e para punuese të fshatrave (jane themeluar ne vitin 2010-2012) i kanë përfshirë Bellobradin, Blaçin, Brodin, Brrutin dhe Restelicën. Edhe pesë grupet të tjera punuese të fshatrave janë themeluar në vitin 2012 në fshatrat Bresanë, Kuk, Shajne, Rapcë dhe Zlipotok.

Ushtrimi i këshillimi publik për PZHk përfshiu me Punëtori Vizionare katër ditore në fillim të shtatorit 2011. Kishte rreth 45 pjesëmarrës nga sektorët e ndryshëm të popullatës lokale (banorë të fshatrave, organizata joqeveritare, përfaqësues të sektorit privat dhe zyrtarët komunal) të cilët kontribuan në çështjet kyçe që duhej adresuar nga PZHk, si dhe elementet më të rëndësishme të vizionit të planit. Punëtorja është përshkruar në më shumë detaje në Pjesën 5.1.

Procesi formal i përgatitjes së PZHk ka evoluar gjatë periudhës në një proces bashkëveprues ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë: ekspertët, ekipit planifikues nga komuna, Grupi Punues Komunal,

Projekti i UNDP: Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës në Dragash

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZHk

anëtarët e Kuvendit Komunal, shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e grupit të punës dhe institucionet publike në Dragash.

Në korrik të viti 2012, Opsionet Strategjike Zhvillimore iu prezantuan Grupit Punues Komunal, Këshilltareve të Kuvendit Komunal përfshirë edhe një grupi pjesëmarrësish nga sektorët e ndryshëm të komunitetit në mënyrë që të përcaktohen pikëpamjet e tyre dhe preferencat. Mendimet e këtyre pjesëmarrësve kontribuuan në formulimin e Opsionet të Preferuar Strategjik Zhvillimor i cili është përdorur si bazë për definimin e veprimeve të mëvonshme dhe propozimeve për PZHk. Diskutimi dhe konsensusi mbi opsionet strategjike të zhvillimit kanë evoluar gjatë një periudhe prej 3 muaj të e një pune të vazhdueshme ndërmjet ekspertëve të ndryshëm dhe aktorëve vendor dhe versionet përfundimtare janë shqyrtuar në punëtorinë e mbajtur në 2 tetor 2012.

Ligji i Republikës së Kosovës për Planifikimin Hapësinor (Ligji nr. 2003/14) kërkon që Drafti Final i PZHk-së të jetë në dispozicion për shqyrtim dhe komente nga publiku dhe agjencitë qeveritare gjatë periudhës këshilluese 60 ditore. Procesi i konsultimit publik u mbajt në Dragash - pas vendimit nga ana e Kuvendit Komunal të 26 mars 2013 – nga 4 prill e deri me 4 qershor të vitit 2013. Procesi përfshiu një debat publik i cili u zhvillua në Komunën e Dragashit në 8 maj. Komentet e marra nga ky aktivitet janë përfshirë në verzionin final të PZHk. Ky PZHk është përfunduar pas këshillimit publik ku u shqyrtua Drafti Final të PZHk-së. Komentet e publikut ose do të inkorporohen në plani përfundimtar ose, përgjigjet në to do të dokumentohen në Aneksin I.

Ne procesin përfundimtar dhe sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr.03 / L -230, është bërë vlerësimi strategjik mjedisor i PZHk-së. Procesi ka ndjekur kërkesat sipas ligjit, sipas të cilit procesi i konsultimit publik dhe një debat publik u zhvilluan. VSM e Komunes së Dragashit për PZHk-së është miratuar nga autoriteti përkatës i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 7 Gusht, Plotësuar procesin përfundimtar, dhe sipas procedurës përcaktuara në Ligjin Nr.03 / L -230, ka bërë një vlerësim strategjik mjedisor të PZHk-së. Procesi sipas ndjekur kërkesat e ligjit, sipas të cilit procesi i konsultimit publik dhe një debat publik u zhvillua. SEA për PZHk-së së Dragashit është miratuar nga autoriteti përkatës i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në gusht 7, 2013 (e dokumentuar në Shtojcën 2). 2013 (e dokumentuar në Shtojcën 2).

2. Konteksti Kombëtar dhe Regjional i Planifikimit Hapësinor

Kapitulli vijues e përshkruan kornizën ligjore për Planin Zhvillimor Komunal, kontekstin e planifikimit hapësinor në nivelin kombëtar në Kosovë, rregullat relevante në nivelin kombëtar dhe specifikimet, që rezultojnë nga planifikimi në nivelin kombëtar të PZHk.

2.1 KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për planifikimin hapësinor përfshinë Ligjin për Planifikim Hapësinor, Amendamentet e tij dhe Udhëzimet Administrative mbi implementimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor. Gjithashtu relevante është edhe Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit.

Ligi mbi Planifikimin Hapësinor (Ligji Nr. 2003/14) e rregullon planifikimin hapësinor në tërë territorin e Kosovës. Ligji përcakton që niveli kombëtar i planifikimit hapësinor në Kosovë përbëhet nga Planifikimi Hapësinor i Kosovës dhe Planet Hapësinore të Zonave të Veçanta. Plani Hapësinor i Kosovës është koncepti bazë për zhvillimin hapësinor në Kosovë. Ai përmban profilin dhe analizën hapësinore të tërë territorit, vizionet, parimet dhe qëllimet për të ardhmen e Kosovës dhe kornizat e strukturës hapësinore të zhvillimit. Strategjia e saj dhe veprimet implementuese në nivelin kombëtar dhe i përvijon aktivitetet dhe projektet për t'i arritur këto objektiva.

Në nivelin komunal Plani Zhvillimor Komunal (PZHk), planet zhvillimore urbane dhe planet rregulluese urbane do ta rregullojë zhvillimin hapësinor.¹ *PZHk është një plan shumë- sektorial, që e mbulon tërë territorin e komunës, i cili i përcakton qëllimet afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor për një periudhë prej së paku pesë vitesh. PZHk do të përfshijë një plan për zhvillimin e zonave urbane dhe fshatrat brenda në komunë. PZHk përfshinë një përmbledhje të shkurtë të ndikimeve shoqërore-ekonomike dhe mjedisore që rezultojnë nga implementimi i planit.* Publikut dhe agjencive të tjera qeveritare do t'u jepet rasti për ta shqyrtuar dhe për të dhënë komente në draftin e PZHk-së. Para miratimit përfundimtar të PZHk-së, Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor (MAPH) e verifikon përputhshmërinë me Planin Hapësinor të Kosovës.²

Amendamenti i Ligjit për Planifikim Hapësinor (Ligji Nr. 03/L-106) e specifikon PZHk-në si Plan Hapësinor për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës, i cili i përcakton afatet dhe i përfshinë projektimet reale investuese.³

Udhëzimet administrative (Udhëzimi Nr. 33, Pro. Nr. 29/03) për implementimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor e përcakton përmbajtjen e PZHk-së. Këto përmbajnë komponentë tekstual dhe grafik. Komponenti tekstual përfshinë *Profilin e Zhvillimit Hapësinor dhe analizën situatës; Vizionin, Parimet dhe Qëllimet; Kornizën e Zhvillimit Hapësinor; Strategjitë e Implementimit dhe Veprimet, si edhe Dispozitat Implementuese.* Komponenti grafik përfshinë të dhënat hartografike dhe anekse të tjera grafike që e portretizojnë situatën dhe intervenimet në hapësirë. PZHk përfshinë elementet hapësinore

¹ Ligji Nr. 2003/14, Neni 10.

² Ligji Nr. 2003/14, Neni 13.

³ Ligji Nr. 03/L-106, Neni 2.

të transportit, të zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe rregullat e tjera strategjike për komunën. I paraprinë zhvillimit strategjik në territor të komunës, përqendrohet në çështjet lokale dhe i merr në konsideratë aspektet e barazisë dhe të ndjeshmërisë gjinore. PZHk duhet të shprehet në një formë që e lehtëson monitorimin dhe shqyrtimin.⁴

Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (Ligji Nr. 03/L-230) i rregullon planet e vlerësimit dhe programet për siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje të ambientit dhe të shëndetit të njerëzve. Ligji përcakton kushtet, formën dhe procedurën e vlerësimit të efekteve mjedisore të planeve të caktuara dhe programeve nëpërmjet integritimit në parimet mjedisore në përgatitje sipër, miratim dhe realizim të planeve dhe programeve.⁵ Autoriteti përgjegjës vendos nëse plani apo programi ka gjasa të ketë efekt të rëndësishëm mjedisor apo jo. Planet dhe programet nuk do t'i dërgohen procedurës legjislative për miratim derisa të mos zbatohet vlerësim strategjik i mjedisit (VSM), raporti i VSM-së është marrë parasysh dhe Ministria e autorizuar miratimin.⁶

Përgjegjësitë: Sipas Ligjit për Planifikimin Hapësinor Neni 13, çdo komunë është përgjegjëse për përgatitjen e Plani Zhvillimor Komunal. Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor (MAPH) është përgjegjëse për këshillim dhe ndihmë komunave në përpilimin e PZHk të tyre.⁷ Instituti për Planifikim Hapësinor, si sektor i Ministrisë, merret me përpilimin e dokumenteve planifikuese, hulumtimet për zhvillimin hapësinor dhe krijimin e të dhënave bazë hapësinore.⁸ MAPH është përgjegjëse për përgatitjen e Planit Hapësinor të Kosovës (PHK).⁹

2.2 Strategjia Zhvillimore Kombëtare

Meqë çdo PZHk duhet të jetë në përputhje me PHK ashtu edhe objektivat e tij, vizionet, parimet, etj., relevante për Dragashin, do të paraqitin në vijim.

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) 2010-2020 i **përcakton qëllimit zhvillimore hapësinore** dhe objektivat për tërë territorin e Kosovës:¹⁰

- Veni i integruar në Bashkimin Europian,
- Arritja e një zhvillimi të baraspeshuar shoqëror me qasje të njëjtë në shërbimet për tërë banorët e Kosovës,
- Zhvillim i qëndrueshëm dhe i baraspeshuar hapësinore, mbrojtje dhe respektim i burimeve – trashëgimia kulturore dhe natyrore të territorit të saj dhe të atyre (territoreve) fqinje,
- Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i baraspeshuar në bazë të standardeve natyrore, burimore, të teknologjisë modern, të tregut konkurrent dhe të implementimit të standardeve mjedisore,
- Transporti dhe infrastruktura e integruar dhe komunikimi, duke i respektuar standardet mjedisore.

⁴ Udhëzimi Nr. 33, Pro. Nr. 29/03, Neni 1.

⁵ Ligji Nr. 03/L-230, Neni 1

⁶ Në të njëjtin vend Neni. 3-5.

⁷ Ligji Nr. 2003/14, Neni. 5.

⁸ PHK 2010-2020.

⁹ PHK 2010-2020, Art. 10.

¹⁰ PHK 2010-2020, f. 118 dhe vijuese

Strategjia dhe veprimet implementuese të PHK-së 2010-2020, detyrojnë zhvillim shoqëror dhe ekonomik, ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore si edhe zhvillimin e infrastrukturës dhe komunikimit.¹¹

Veprimet, aktivitetet për arritjen e qëllimeve të **zhvillimit shoqëror** janë në pah të arritjes së objektivave kryesisht të ndërlidhur me zhvillimin e arsimit, shëndetësisë dhe përmirësimin e cilësisë së banimit. Pasojat në lidhjen logjike për të arritur arsimim cilësor janë:¹²

- Arsimimi në distancë më të shkurtë, për t'u përputhur me nevojat shoqërore, fizike dhe emocionale
- Ndërtimi objekteve të reja arsimore
- Trajnimi i stafit të mësimdhënësve në implementimin e metodave moderne të procesit mësimor
- Sigurimi i transportit për vendet e largëta

Aktivitet kryesor për ti përmirësuar kushtet e përgjithshme të **kujdesit shëndetësor** në koherencën hapësinore janë:

- Përmirësimi i njerëzve (stafi mjekësor), ndërtesat dhe pajisjet
- Përmirësimi i financimit për shëndetësi, decentralizimi i financimit për shëndetësinë primare në Komuna

Për të përmirësuar kushtet e **banimit**, dispozita duhet të përqendrohet në lokacionet me infrastrukturë, duke e përkrahur qëndrueshmërinë zhvillimore dhe shfrytëzimin më të mirë të tokës urbane. Dizajni i ri banesor duhet të jetë modern dhe të mundësojë rigjenerimin urban të vendbanimeve të degraduara dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Veprimet e nevojshme në koherencën hapësinore janë:¹³

- Krijimi i mjedisit banesor të qëndrueshëm
- Shfrytëzimi më i mirë i tokës
- Lidhja e zhvillimit me transportin publik
- Ri-përcaktimi i biznesit dhe i funksioneve të tjera në shtëpi
- Përkrahja e zhvillimit me përdorim të kombinuar
- Gjelbërim nëpër vendbanime
- Dizajni cilësor

Sfidat e **zhvillimit ekonomik** në Kosovë lidhen me çështjet specifike ose problemet si papunësia e lartë, shkalla e lartë e varfërisë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, cilësia e zhvillimit në vendet urbane, vendbanimi me zhvillim të pamjaftueshëm, energji, vendbanimi joformal, humbja e tokës bujqësore, rritja e numrit të gjedhëve, zhvillimi i vreshtarisë dhe shpopullzimi i vendbanimeve.

PHK paraqet aktivitetet në koherencën hapësinore:¹⁴

- Autoritetet qeveritare dhe komunale duhet të hartojnë strategji punësimi, gjithashtu në fokus të grupeve specifike (gratë, rinia, etj.)

¹¹ Po aty f. 157.

¹² Po aty, f. 157 dhe vijuse

¹³ Po aty, f. 159

¹⁴ Po aty., f. 160-168.

- Zhvillimi i politikave të përshtatshme sidomos në bujqësi, krijimi i kushteve të favorshme në vendet rurale, rigjenerimi i kapaciteteve industriale
- Fokusimi në vendet që kanë me zhvillim ekonomik si Sharri (Dragashi)
- Prioritet në investimet qeveritare për krijimin e një infrastrukture të re shoqërore dhe riaktivizimi teknik dhe ekonomik i kapacitete ekzistuese
- Të stimulohet bujqësia dhe blegtoria për t'u ulur shkalla e migrimit nga fshatrat në qytete
- Të shqyrtohen politika ekzistuese dhe të miratohen masat nismëtare për përkrahjen e efikasitet energjetik të sektorit të burimeve përtëritëse energjetike
- Zhvillimi dhe fuqizimi i masave stimuluese fiskale për përkrahjen e efikasitetit të energjisë dhe teknologjitë përtëritëse të energjisë
- Arritja e një marrëveshje të gjerë politike dhe miratimi i ligjeve për adresimin e ndërtimeve të kundërligjshme
- Komisioni i Bashkëpunimit të Tokës Administrative përgatit udhëzime politike për menaxhimin bujqësor të tokës, ujitje dhe drenimin, prodhimtarinë bujqësore dhe blegtorale, pylltarinë dhe pjesëmarrjen në aktiviteti e mbrojtjes së tokës bujqësore kundër ndotësve të çdo lloji
- Zhvillimi i infrastrukturës fizike
 - Përmirësimi i infrastrukturës fizike (rrugës, kanalizimit, ujësjellësit, telekomunikimit, etj.), kryesisht në vendet rurale
 - Asfaltimi i rrugës dhe rrejt funksional hekurudhor do të ndikojë në fuqizimin dhe shkurtimin e largësive mes vendbanimeve, që do të mundë[sojë qarkullim më të madh të mallrave dhe njerëzve në mënyrë indirekte dhe do të ketë ndikim në uljen e migrimit në drejtim të zonave të zhvilluara
- Zhvillimi teknik i infrastrukturës
 - Përqendrimi në zhvillimin e teknologjisë informative dhe komunikuese, modernizimin e shërbimeve telefonike, përhapja e rrjetit dhe ofrimi i shërbimeve më të mira të internetit, etj. për t'iu afruar shumëllojshmërisë dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të telekomunikimit
 - Ofrimi i furnizimit të pandërprerë me rrymë elektrike
 - Ndërtimi i akumulimeve të reja ujore për të mundësuar furnizimi të mirë me ujë të vendeve urbane
 - Identifikimi dhe vlerësimi e hidro- potencialeve më të vogla ekzistuese në Kosovë dhe ofrimi me koncesion për investuesit privat për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla
- Politikat e vendbanimeve dhe zhvillimi
 - Vlerësimi i situatës ekzistuese të vendbanimeve joformale në qytetet e Kosovës
 - Parandalimi i zhvillimit të menjëhershëm të vendbanimeve joformale dhe ndërtimi i egër
 - Parandalimi i ndërtimi në tokë të kategorisë I-IV
 - Rregullimi i vendbanimeve joformale përmes sigurimit të infrastrukturës teknike dhe shoqërore, zgjidhja e çështjeve pronësore dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në qeverisje
 - Përpilimi i raporteve lidhur me kushtet e ndërtesave pa leje
- Mbrojtja e tokës cilësor bujqësore dhe zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme
 - Në harmoni me Ligjin për tokën bujqësore, tokat e kategorive I, II, III dhe IV janë nën mbrojtje (shfrytëzimi i tokës së atillë bëhet vetëm për prodhimtari bujqësore)

- Themelimi i një fondi për ripërtëritjen e tokës bujqësore, për të rritur sipërfaqen e tokës bujqësore për kokë banori

Grupimi i ngastrave të shpërndara në një zonë më të madhe me konsolidimin e tokës (matjet e reja të tokës, formësimi i ri i ngastrave në forma të rregullta gjeometrike, rregullimi i ri i marrëdhënieve pronësore-juridike, Kadastra e ri e Tokës)

- Të iniciohet shfrytëzimi më i mirë i mekanizmave bujqësore, qasja në rrugë dhe rudimenti i shtuar i produktivitetit bujqësor për njësi sipërfaqësore
- Urbanizimi i fshatrave me tërë infrastrukturën shoqëruese

Objektivat e PHK-së lidhur me **mjedisin, burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore** janë ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe degradimi, ruajtja, mbrojtja dhe eksploatimi racional i burimeve natyrore dhe ruajtja dhe mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. Aktivitetet e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave në koherencë hapësinore janë:¹⁵

- Reduktimi i ndotjes mjedisore
 - Pengimi i eksploatimit të materialit inert nëpër shtretërit e lumenjve nga shfrytëzuesit pa leje, të dredhjes së mbeturinave nëpër shtretër të lumenjve dhe të çdo aktiviteti mekanik në shtretërit e lumenjve
 - Përdorimi i plehrave artificial dhe pesticideve duhet të bëhet në përputhej me standarde për minimizimin e ndotjes së ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor
 - Standardizimi i deponive të mbeturinave për të siguruar mbrojtje më efikase të deponive të mbeturinave të rrezikshme, eliminimi i deponive ilegale
 - Të bëhet pastrimi kimik dhe biologjik i ujit nga çdo stabiliment industrial apo aktivitet, minierë e hapur, etj.
 - Impiante për trajtimin e ujërave të zezë për pastrimin e ujërave nga sistemet e kanalizimeve të vendbanimeve
- Mbrojtja e florës dhe faunës
 - Shfrytëzimi racional i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe i vlerave natyrore
 - Mbrojtja dhe ruajtja e pyjeve dhe të integritetit të vlerave pyjore
 - Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe i vlerave pyjore, parandalimi i prerjeve ilegale dhe i shkatërrimit të pyjeve
 - Zgjerimi i territorit të Parkut Nacional “Mali Sharr” në drejtim të komunës së Dragashit
 - Mbrojtja e llojeve relikte dhe endemike të florës dhe faunës
 - Kujdesi për mjedisin nga ndërtimi dhe zhvillimi i zonave rekreative-turistike
- Parandalimi nga përmytjet dhe erozioni
 - Minimizimi i përmytjeve ose minimizimi i pasojave (të dhënat bazë, shënimi i zonave të rrezikuara, sistemet paralajmëruese të përmytjes, matjet teknike dhe ndërtimi i objekteve mbrojtëse)
 - Ndalimi i shfrytëzimit të tokës bujqësore përgjatë brigjeve të lumenjve të cilat mund të ndikojnë në rreziqet nga përmytjet

¹⁵ Po aty, f. 168-177.

- Ndalimi i të gjitha aktiviteteve ndërtuese në afërsi të brigjeve të lumenjve, pos objekte të karakterit ekonomik (urat, digat, kanalet kulluese, etj) të cilat nuk i rrezikojnë rrjedhat e ujit me përmbajtje
- Të ndërmerren veprime kundër erozionit (ndërtimi i tarracave, pendëve dhe digave, mirëmbajtja e tokës bujqësore, parandalimi i kullotjes në zonat me mungesë flore, mbjellja e pyllit)
- Mbrojtja e peizazhit natyror
 - Aplikimi i thënies: „një dru i rënë (i prerë) të zëvendësohet me dy bimë të tjera”
 - Parandalimi i shkatërrimit të florës përgjatë brigjeve të lumenjve, mbjellja me drurë përgjatë brigjeve të lumenjve (gjithashtu parandalimi i erozionit) dhe ofrimi i peizazheve natyrale
 - Krijimi i zonave e rripave të gjelbër rreth zonave me ndikimi negativ mjedisor (gjithashtu mbrojtja e florës dhe faunës)
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore
 - Mbrojtja e vazhdueshme nga degradimi i trashëgimisë kulturore me inventarë ndërtesash dhe të vendeve sipas kriterëve të MCYS, definicioni i zonave të trashëgimisë kulturore dhe përkrahja dhe informimi për rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore
 - Përfshirja funksionale e trashëgimisë kulturore në turizmin kulturor duke mundësuar qasje të lirë ndaj vizitorëve, përmirësimi i infrastrukturës (restorantet, etj.) dhe ofrimi i punëtorive, muzeve, galerive, ekspozitave, etj.

Aktivitet për ta zhvilluar infrastrukturën dhe komunikimin janë përmendur me aktivitetet e lartpërmendura. Zhvillimi i planifikuar kombëtar i infrastrukturës në Dragash identifikon rrugët e caktuara që duhet të asfaltohen. Pos kësaj ekziston plani për shtrirjen e një kabloje optike në qytetin e Dragashit. Sipas konceptit kryesor të zhvillimit hapësinor, nuk ka më projekte të mëdha të infrastrukturës të planifikuara në Dragash.

2.3 KONCEPTI KOMBËTAR I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Plani hapësinor i Kosovës ofron një **koncept të zhvillimit hapësinor** të Kosovës, nga e cila dalin specifikimet relevante për zhvillimin hapësinor në Dragash.

Definicioni i rëndësisë qendrore të qendrave:

PHK përfshin definicionin e përgjegjësisë dhe rëndësisë së vendbanimeve brenda rrjetit të vendbanimeve. Sipas kësaj, Prizreni konsiderohet si qendër e madhe, Dragashi si qendër e vogël.

Qendrat e mëdha më tej do ta forcojnë pozitën si qendra regjionale, duke u shërbyer qendrave që i rrethojnë ato dhe duke i përfunduar shërbimet dhe duke i plotësuar shërbimet në raport me kryeqytetin. Këto qendra duhet të jenë bartës të zhvillimit. Qendra regjionale është vendin për përtëritje dhe adaptim të zonave industriale për kërkesat e reja të prodhimtarisë dhe të zhvillimi dhe për parqet e biznesit si palë e ardhme integrale e tërë qendrës. Struktura efikase rrugore e lidhë qendrën regjionale me qendrat e tjera (regjione dhe më të vogla).


Qendrat më të vogla do të kenë një rol aktiv në zhvillimin e ardhshëm hapësinor në aspektet e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve dhe efikasitetit.

- në forcimin lidhjeve me fshatrave përreth dhe
- në përpjekjet që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të paracaktuar zhvillimore¹⁶.

Definicioni i zonave regjionale të zhvillimit hapësinor:

Sipas karakteristikave gjeografike, zhvillimit potencial dhe aktivitete ekonomike, Kosova është e ndarë në këtë koncept në katër fusha: ¹⁷

- “Limani i Kosovës” në Prishtinë dhe rrethina e saj është një qendër administrative dhe një qendër shërbimi, tregtie, industrie bujqësore dhe turizmi.
- “Thesari i Kosovës” në Veri karakterizohet me industri, shërbime dhe tregti.
- “Ura e Kosovës” në jugperëndim dhe lindje funksionojnë si nyje të lidhjeve tregtare me vendet fqinje.
- Në “Kopshtet e Kosovës (Zona e portokalltë)” në veriperëndim dhe jug, përqendrimi kryesor është në kulturë, turizëm, shërbime, tregti dhe industri bujqësore.



Grafiku 1: Struktura dhe rrjeti i vendbanimeve. Burimi: PHK 2010-2020, f. 126

Dragashi është pjesë e zonës jugore të portokalltë të quajtur “Kopshtet e Kosovës”, e cila përbëhet nga tre komunitet: Suhareka, Dragashi dhe Prizreni si qendër regjionale.

¹⁶ Po aty, f. 126.

¹⁷ PHK 2010-2020, f. 121.

Kullosat në Dragash dhe në Pakun Nacional të Malit të Sharrit konsiderohen si Zona të Interesit Special Hapësinor.

Vizioni për zonën e portokalltë në jug është:

Zonë e zhvilluar e turizmi kulturor, vend bujqësor-industrial dhe ekonomik në Prizren ku ndodhen rrënjët e traditës së lashtë, si qendër moderne ekonomike me qeveri vendore përgjegjëse, veprimtari të biznesit privat dhe zhvillimi ekonomik lokal përmes shfrytëzimit të burime natyrore dhe njerëzore.

Krijimi i mjedisit atraktiv për zhvillimin e veprimtarive të biznesit privat dhe inkurajimi për shfrytëzim më të mirë të mundësive lokale ekonomike dhe të burimeve natyrore dhe njerëzore, sidomos në turizëm dhe bujqësi.

Qëllimet **kryesore** për Kopshtet jugore të Kosovës janë¹⁸


- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike
- Zhvillimi i një rrejtjei atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje të shërbimeve publike në favor të qytetarëve, me cilësi të rritur të jetës së qytetarëve, punësim dhe barazi sociale
- Zhvillimi i bujqësisë
- Programi ZHEL (Zhvillimi Ekonomik Lokal) përmes përkrahjes së NMV-e(Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla)
- Zhvillimi i infrastrukturës regjionale
- Zhvillimi i turizmit malor dhe kulturor, mbrojtja e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike

Në kontekst të skenari të zhvillimit të Dragashit **konflikte të caktuara duhet të vërehen** si zgjerimi i vendbanimeve në tokën bujqësore, zgjerimi horizontal i vendbanimeve duke rënë në konflikt me shfrytëzimin racional të hapësirës dhe degradimi i trashëgimisë kulturore-historike që bie ndesh me zhvillimin e turizmit. Andaj PZHK duhet të rregullojë shfrytëzimin racional të hapësirës, ndërtimin e infrastrukturës rrugore në bashkëveprim me zhvillimin bujqësor, ndërtimin e rrugëve transitore rreth qytetit për ta shkarkuar trafikun urban, mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe investimet në Malet e Sharrit në bashkëveprim me zhvillimin e turizmit.¹⁹

¹⁸ Po aty f. 147.

¹⁹ Po aty]

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZHk



Grafiku 2: Strategjia zhvillimore hapësinore-Zona e Portokalltë (Kopshtet e Kosovës), Burimi: PHK 2010-2020, f. 145

Plani i **Strategjisë Zhvillimore Hapësinore** i Zonës së Portokalltë përmban:

Qyteti i Dragashit është shënuar si një qendër e vogël me zonë ekonomike, e lidhur me atë në Prizren, qendrën regjionale.

Rrjetet rrugore dhe hekurudhore: aksi Prizren-Durrës është pjesë e një korridori të rëndësishëm ndërkombëtar të trafikut Serbi-Kosovë-Shqipëri, që i lidhë Merdaren, Prishtinën, Prizrenin dhe Durrësin. Autostrada europiane E 851 përgjatë këtij aksi është në ndërtim e sipër. Sipas planit, rruga ekzistuese gjithashtu është propozuar të zgjerohet dhe është propozuar të ndërtohet një hekurudhë e re. Dragashi lidhet me aksin dhe me Prizrenin përmes rrugës regjionale Dragash –Zhur. Në plan është propozimi për ndërtimin e një rruge ndërkombëtare lidhëse me IRJ të Maqedonisë, e cila do të nisej nga qyteti i Dragashit në jug dhe do të kalonte nëpër malet e Sharrit.

3. PROFILI I KOMUNËS SË DRAGASHIT

3.1 PËRSHKIRMI I KOMUNËS

3.1.1 Vendndodhja dhe gjeografia

Dragashi është komuna më jugore e Kosovës, e cila kufizohet me vendet fqinje të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJ e Maqedonisë) në lindje dhe jug, dhe Shqipërisë në perëndim. Koordinatat e komunës janë 41 50' 58" - 42 09' 03" në gjerësinë gjeografike veriore dhe 20 35' 39" - 20 48' 26" gjatësinë. Në veri, Dragashi kufizohet me Komunën e Prizrenit që është qendra e rajonit jugor të Kosovës në kuadër të së cilës është dhe Dragashi. Qyteti i Dragashit është 37km larg nga qyteti i Prizrenit.

Komuna përfshin një sipërfaqe prej 435.8km², afërsisht 4% e tërë territorit të Kosovës dhe është e teta për nga madhësia në mesin e tridhjetë komunave të Kosovës. Komuna e Dragashit përfshin 36 vendbanime, me qytetin e vogël të Dragashit si qendër e komunës.²⁰ Komuna kufizohet në skaje nga Malet e Sharrit në anët jugore dhe lindore, që vazhdojnë shtrirjen në IRJ të Maqedonisë dhe Shqipëri. Ky varg malor shtrihet në verilindje-jugperëndim afërsisht 70 km në gjatësi dhe 30km në gjerësi, me një sipërfaqe totale rreth 1600km². 900km² (56.25%) e kësaj sipërfaqeje shtrihet në IRJM, 690 km² (43.12%) në Kosovë dhe 10 km² (0.63%) në Shqipëri. Karakteristikë specifike e Dragashit janë hapësirat e gjëra të kullotave që e ka bërë këtë zonë të përshtatshme për blegtori, bujqësi dhe produkte bujqësore.

Vargu i Mali i Sharrit në Kosovë ndahet në tre rajone që përfshijnë zonën turistike dhe të sportit dimëror të Lubotenit/Brezovicës, zonën qendrore të Prizrenit dhe pjesën e Dragashit që përfshinë Gorën dhe Opojën. 18.5% e këtij vargmali është 2000m mbi lartësinë detare. Mali më i lartë i tërë zonës së Sharrit është Mali Korab (2764m), ndërsa maja më e lartë është Maja e Titos me 2747m. Në Dragash majat më të rëndësishme janë: Koritniku në veriperëndim në kufi me Shqipërinë (2262m), Kodra e Karanikolles në veriperëndim (2409m), Maje në lindje (2493m), "Kryet e Kagit" në veri të Brodit (2207m), Vraca e Madhe në juglindje (2536m, maja më e lartë) dhe Kësula e Priftit në jugperëndim (2075m).

3.1.2 Topografia

Në aspektin topografik, Dragashi mund të ndahet në nën-pellgjet lumore të tija kryesore: me Lumin Restelicë, lumin Plavë (në rajonin e Opojës, duke përfshirë pjesët lindore të zonës së Malit të Sharrit në zonën e Dragashit), dhe të pellgut ujqor të Lepencit (në pjesën jugore të komunës). Një sistem i katërt shtrihet rreth Breznës, ku zona rrjedh përmes një strukture nëntokësore karstike në zonën e Prizrenit.

²⁰ Në disa shënime komunale, numri i vendbanimeve mund të ndryshojë nga 36. Llogaritja e 36 vendbanimeve, në të gjitha hulumtimet e UNDP-së, është e bazar në faktin se ekzistojnë 36 zona kadastrale në Dragash, në kuadër të së cilës një numër i zonave të vendbanimeve më të vogla mund të jenë të regjistruara (siç është Radesha e Epërme dhe Radesha e Poshtme). Numri i 36 vendbanimeve përputhet me Agjendën e Kaluar për Zhvillim Komunal 2004-2006 dhe me Studimin Preliminar për PZhK për Dragashin të bërë nga UN-Habitat (2010). Pasi që PZhK është një plan hapësinor për tërë komunën e jo një plan urbanistik, klasifikimet e tija bazohen në nivele më të larta territoriale.

Dy nga këto rrjedha kryesore të ujit i përkasin pellgut të madh të Drinit të Bardhë që përmes Shqipërisë derdhet në Detin Adriatik: Lumi Plavë me degët e tij në veri, dhe lumi Restelicë që i bashkohet apo derdhet në lumin Plavë. Sistemi i tretë kryesor ujqor – pellgu i lumit Lepenc – shtrihet në jug dhe kryesisht derdhet nga IRJ të Maqedonisë në Detin Egje.²¹

Megjithatë, territori më shpesh identifikohet si i tillë që përfshin dy zona, atë të Opojës në veri dhe të Gorës në jug. Gjeografia kodrinore-malore ka ndikuar në zhvillimin e vendbanimeve të koncentruara e të vogla malore përgjatë tre luginave kryesore, por është gjithashtu edhe arsye e izolimit të komunës si dhe e problemeve aktuale infrastrukturore dhe të tjera. Sipas profilit të pjerrtësisë, 55% e territorit është klasifikuar si i pjerrët ose shumë i pjerrët, dhe ofron qasje të kufizuar përkatësisht nuk lejon qasje për automjete/makina²². Kjo i kufizon mundësitë për bujqësinë si dhe për zgjerimin e rrugëve dhe të vendbanimeve

Lartësia e komunës ndryshon nga 750 e deri 2550 metra mbi nivelin e detit, me një mesatare në 1620m. Pjesa më e madhe - 40.3% e territorit - është e klasifikuar si Male të Larta, me lartësi mbidetare nga 1450m dhe 2050m. Vargu malor në veri të komunës arrin lartësi ndërmjet 1100m dhe 2200m. 30.4% e hapësirës shtrihet në rajonin Malor (1050 - 1350 metra lartësi mbidetare), me 20.3% të hapësirës totale në lartësi dukshëm më të lartë nga 2050 deri në 2550 metra, niveli ku nuk rriten drunjtë (kufiri drunor). Vetëm 6% e territorit është Nën-malore (2600ha në lartësi 750 – 1050 metra mbi nivelin e detit), që ndodhet në veri rreth luginës së Pllavës dhe pjesët e poshtme të luginave lumore të Brodit dhe Restelicës²³. Kjo tregon që, në përgjithësi, komuna është e vendosur në lartësi të madhe dhe strukturë malore, posaçërisht kur krahasohet me lartësinë mesatare për të gjithë territorin në Kosovë që është 800m lartësi mbidetare²⁴. Komuna fqinje e Prizrenit është e vendosur në lartësi mesatare prej 400-500 metrash mbi nivelin e detit.


²¹ Atllasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëllim 2 (Draft) *Bazat*, UNDP, qershor 2012

²² Po aty

²³ Po aty

²⁴ Të dhënat e siguruara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë


Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 3: Shkalla e lartësisë në territorin e Komunës së Dragashit ²⁵

²⁵ Përveç nëse nuk theksohet ndryshe, të gjithë grafikët, tabelat/diagramet dhe hartat janë nga Atlasi për Zhvillim të Qëndrueshëm: Vëllimi 2 (Draft) *Bazat*, UNDP, tetor 2012

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 4: Profili i lartësisë në territorin e Komunës së Dragashit


3.1.3 Klima

Komuna e Dragashit ka klimë subalpine me temperaturë mesatare vjetore prej 8.6° Celsius. Verat janë të shkurta dhe të freskëta me temperaturë mesatare prej 18.1° C, me dimra të gjatë dhe relativisht të ftohtë (temperaturë mesatare -0.4°C). Temperatura më të larta përjetohen në lugina, ku është afërsisht 10°C më nxehtë se sa në majat malore, dhe pikërisht në këto zona gjenden edhe shumica e vendbanimeve apo fshatrave. Temperatura mesatare gjatë periudhës së vegjetacionit nga prilli-shtator është 15°C²⁶. Temperaturat maksimale të regjistruara janë 36.5° C në korrik dhe -21.5° C në janar.²⁷

²⁶ Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëllimi 2 (Draft) *Bazat*, UNDP, qershor 2012

²⁷ Nga Agjenda e Zhvillimit Komunal 2004 – 2006, Komuna Dragash (Agjendën Zhvillimore Të Komunës Së Dragashit Për Periudhën 2004 – 2006)

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 5: Diagrami i klimës për Komunën e Dragashit

Malet e larta që e rrethojnë komunën i mbrojnë vendbanimet/fshatrat nga kushtet ekstreme klimatike dhe krijojnë mikroklima të buta. Është relativisht e strehuar nga erërat e forta, me afërsisht 18.1% të ditëve në vit pa erë. Përgjithësisht erërat fryjnë nga verilindja dhe jugperëndimi.²⁸

Nuk ka të dhëna të besueshme të erërave në rajonin e Dragashit. Ende është në proces një vlerësim profesional i erërave. Pika më e afërt, që është shfrytëzuar në të kaluarën për të matur shpejtësinë e erës, në mënyrë që të vlerësohet energjia e saj potenciale, është afër fshatit Zym/Zjum. Kjo pikë është rreth 16 km larg nga kufiri i komunës Dragash, dhe rreth 25km nga qyteti Dragash dhe konsiderohet të jetë shumë larg për të ofruar të dhëna relevante për komunën.

Reshjet

Lagështia vjetore relative e ajrit është 76%, që arrin kulmin më të lartë në nëntor me 83.15% dhe më të ulët në gusht 67.6%.²⁹

Dragashi përjeton nivel të lartë të reshjeve të shiut dhe të borës, të shpërndara njëtrajtshëm përgjatë hapësirës së komunës. Reshjet më të mëdha të shiut ndodhin në muajin qershor me pak mbi 100mm reshje, si dhe pikat që pasojnë në shtator dhe nëntor. Muajt në të thatë janë janari dhe marsi, si dhe gushti. Afërsisht 50% e totalit të reshjeve vjetore bie nga muaji prill deri në shtator. Sasia mesatare vjetore e të reshurave është 807mm. Më shumë reshje bie në majat në veriperëndim (Koritnik) dhe juglindje (Shutman) të komunës.³⁰ Mesatarja e të reshurave të shiut në lartësi më të vogla është 800 mm, me mbulim bore 120 ditë gjatë vitit, ndërsa reshjet e shiut me mesatare prej 1370 mm. Në zona më të larta bora qëndron afërsisht 280 ditë gjatë vitit.³¹

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëllimi 2 (Draft) Bazat, UNDP, qershor 2012

³¹ Raport i UNDP: Vlerësimi i Sektorit të Ujit në Komunën Dragash, Markaj, T., mars 2010.

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 1: Temperatura mesatare stinore në Dragash

| Temperatura mesatare në | Dimër | Pranverë | Verë | Vjeshtë | Periudha e vegetacionit |
|-------------------------|-------|----------|------|---------|-------------------------|
| Dragash °C | -0.4 | 7.9 | 18.1 | 10.2 | 15.0 |

Tabela 2: Reshjet dhe temperatura mesatare gjatë periudhës së vegetacionit

| Reshjet dhe temperatura mesatare gjatë periudhës së vegetacionit | Prill deri Shtator | | | Tetor deri Mars | | | Vjetore | | |
|--|--------------------|------|----------|-----------------|------|----------|---------|-----|----------|
| | mm | % | Temp. °C | mm | % | Temp. °C | mm | % | Temp. °C |
| Sharr/ Dragash | 413 | 51.1 | 15.0 | 394 | 48.9 | 3.3 | 807 | 100 | 8.3 |

Rrezatimi diellor

Nuk ekzistojnë të dhëna specifike dhe të hollësishme për shpeshësinë e rrezatimit diellor për Komunën Dragash, ndonëse ka disa informacione për qytetin e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës që mund të shfrytëzohen si bazë për të bërë krahasimin. Megjithatë, këto ende nuk janë dëshmuar si të besueshme.³²

³² Tahirsylaj S.: Disa veçori të rrezatimit të diellit dhe shpejtësisë së erës në Kosovë – potencial energjetik natyror”. Marrë nga Raporti i UNDP për Vlerësimin e Energjisë për Komunën Dragash, Pireci, M., mars 2012

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 3: Të dhënat për energjinë diellore për Dragashin për sipërfaqen horizontale.³³

| Vendndodhja | Komuna | Dragash |
|--|----------|-------------|
| E llogaritur për vendndodhje | Gjerësia | N 42°3'41" |
| | Gjatësia | E 20°39'20" |
| | Lartësia | 1054m |
| Rrezatimi diellor mujor dhe vjetor në pllakë horizontale (kWh/m ²) | I | 48.1 |
| | II | 64.96 |
| | III | 110.9 |
| | IV | 144.3 |
| | V | 177.3 |
| | VI | 198.6 |
| | VII | 217.9 |
| | VIII | 187.6 |
| | IX | 121.5 |
| | X | 92.7 |
| | XI | 56.7 |
| | XII | 40.9 |
| | Vjetor | 1461.5 |

³³ Tabelat 3 & 4 sipas shifrave nga baza e të dhënave e Komisionit Evropian (<http://re.jrc.ec.europa.eu/pvgis/apps4/pvest.php#>. Qasur më 12.06.12). Marrë nga Naumann, E. and Pireci, M. *Identifikimi i potencialit për aplikimin e teknologjisë së energjisë diellore në Komunë e Dragashit*, Drafti i parë 2012

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 4: Të dhënat për energji diellore në këndin optimal për Dragashin

| Vendndodhja | Komuna | Dragash |
|---|----------|-------------|
| E llogaritur për vendndodhje | Gjerësia | N 42°3'41" |
| | Gjatësia | E 20°39'20" |
| | Lartësia | 1054m |
| Rrezatimi mujor dhe vjetor në pllakë me kënd optimal me orientim nga jugu (kWh/m ²) | I | 68.8 |
| | II | 81.5 |
| | III | 132.1 |
| | IV | 155.4 |
| | V | 176.4 |
| | VI | 189.3 |
| | VII | 213.4 |
| | VIII | 199.6 |
| | IX | 142.8 |
| | X | 125.2 |
| | XI | 83.1 |
| | XII | 57.9 |
| Vjetor | 1625.5 | |

3.1.4 Popullsia

Ka pasur disa vështirësi për sigurimin e numrave të sakta të popullsisë në Kosovë s tërësi dhe për Komunën e Dragashit posaçërisht. Krahasimi i të dhënave nga dekadat e kaluara është problematik meqë shumë të dhëna janë shkatërruar në vitin 1998-1999 dhe vareshin nga procesi i grumbullimit dhe regjistrimit të informacioneve me dorë, që edhe këto ditë përbën kufizim përkundër përparimeve të arritura në burimet elektronike dhe të centralizuara. Për më tepër, pjesa dërmuese e popullatës shqiptare të Kosovës e patën bojkotuar regjistrimin e popullsisë në Kosovë të vitit 1991. Kështu, regjistrimi i popullsisë i vitit 1981 shpesh merret si bazë nga koha para konfliktit. Pas kësaj kohe nuk u patën bërë më regjistrime, ndonëse UNMIK-u dhe OSBE-ja kanë kryer anketime për t'i siguruar numrat e përafërt të popullsisë për vitin 2006 dhe 2008.

Vlerësimet nga Agjencia Kosovare e Statistikave për shifrat e popullsisë në vitin 2008 japin një numër të popullsisë prej 42,171 banorë në komunën e Dragashit. Ka dyshime të mëdha nëse këto janë shifra të besueshme, meqë tregojnë për një rritje të vazhdueshme të popullsisë – dhe në disa vendbanime, një rritje dramatike të popullsisë, ndonëse në realitet emigrimi nga Dragashi në vende tjera të Kosovës, vende të ish Jugosllavisë, apo në Evropë pasur ndikim të madh në popullsinë e përhershme që është regjistruar. Kjo ka mundur të vie nga një metodë e parregullt e raportimit apo numërimit gjatë ushtrimeve të ndryshme të grumbullimit të të dhënave. Pjesa dërmuese e vendbanimeve shfaqin një trend ngritës të shtimit të vazhdueshëm të popullsisë nga 1921, me një kulmim më të theksuar nga

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

2008-2010 (ku ka shënime në dispozicion), e përcjellë me një rënie signifikante në popullsi të regjistruar në vitin 2011 në një nivel të ngjajshëm me shënimet për vitin 1991.

Vendbanimet që shfaqin një trend drejt shtimit të popullsisë në vitin 2011 janë Restelica, Radesha, Krusheva, Gllloboçica, Brodi, Zlipotoku dhe Zymi.

Për rajonin e Gorës, të dhënat mbi popullsinë janë siguruar nga Koordinatori Komunal për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë dhe Integrim, dhe është bazuar në shënime të mbajtura nga Bashkësia Islame në 2007 dhe 2009.³⁴ Në vitin 2007, të dhënat tregojnë se 11,007 banorë banonin në mënyrë të përhershme në rajonin e Gorës, ndërsa 17,019 kishin emigruar. Në vitin 2009 numri i banorëve të përhershëm kishte rënë në 10,684. Është me gjasë se në disa raste, pjesëtarët e popullsisë që jetojnë jashtë vendit gjatë pjesës më të madhe të vitit, janë regjistruar si banorë të përhershëm në shënimet komunale të Dragashit (e jo si banorë të përkohshëm – në qoftë se është bërë fare ndonjë dallim), prandaj ka mundësi të ketë anomali në ndryshimet e popullsisë. Këta banorë të përkohshëm nuk janë numëruar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë të vitit 2011.

Të dhënat e fundit në dispozicion për popullsinë dalin nga regjistrimi i përgjithshëm i 2011. Regjistrimi i 2011³⁵ është bojkotuar nga disa familje joshumicë nëpër Kosovë (duke përfshirë komunat veriore të Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit, dhe një pjesë të veriut të Mitrovicës), prandaj rezultatet nacionale mund të mos jenë të plota, edhe pse thuhet se pjesëmarrja në Dragash ka qenë e lartë. Të dhënat nga Regjistrimi i 2011 sugjerojnë që në Dragash jetojnë rreth 33, 997 persona si banorë të përhershëm.³⁶

Mund të bëhet një përmbledhje se informatat mbi popullsinë ndërmjet 1991 dhe 2010 janë grumbulluar nga copëza me mundësi të pjesëmarrjes së pjesëshme, duke shfrytëzuar metodologji inkonsistente dhe definicione bazike dhe për këtë arsye mund të konsiderohen si të pabesueshme. Për qëllim të këtij profili komunal, rezultatet zyrtare të *Regjistrimit të Popullsisë dhe Amvisnive në Kosovë 2011* është shfrytëzuar si bazë kryesore e informatave.

³⁴ Të dhënat për 2007 dhe 2009 nga Koordinatori Komunal për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë dhe Integrim, Z. Uzair Hamza.

³⁵ Të dhënat kryesore për nivelin komunal dhe nacional të siguruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Amvisnive 2011: Rezultatet Finale: të Dhënat Kryesore*, http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results_ENG.pdf [shikuar më 29 January 2013]. Të dhënat në nivel fshati janë siguruar në Janar 2013 Kryetari I Komunës së Dragashit (Z. Salim Jenuzi), nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, të cilët ndanë këto informata me UNDP. Kjo ka përfshirë një ndarje të popullsisë sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, nivelit arsimor, amvisnive dhe banimit të shtëpive.


³⁶ *Popullsia* është definuar në dokumentin *Rezultatet nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Amvisnive 2011: Rezultatet Finale: Të Dhënat Kryesore* pasi që “të gjithë persona që zakonisht kanë banuar në Kosovë për së paku 12 muaj në kohën e regjistrimit, apo kanë pasur për qëllim të banojnë në Kosovë për së paku 12 muaj gjatë asaj kohe” (përfshijon personat me status diplomatik, personelin e huaj ushtarak dhe personat që banimin e tyre të zakonshëm e kanë jashtë Kosovës). Për këtë arsye personat që vijnë çdo vit për disa muaj në Dragash si banorë të përkohshëm apo vizitorë sezonal nuk është dashur të llogariten në regjistrim.

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

| Fshati | Popullsia (të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës; llogaritjet për 2008) | | | | | | | | Regjistrimi zyrtar |
|---------------|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-----------------------|
| | 1921 | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991 | 2008 | 2011 |
| Baçkë | 167 | 222 | 249 | 259 | 311 | 381 | 215 | 44 | 52 |
| Bellobrad | 232 | 415 | 345 | 385 | 568 | 808 | 998 | 1780 | 948 |
| Blaç | 360 | 474 | 503 | 594 | 797 | 1123 | 1415 | 2150 | 1,455 |
| Brezne | 590 | 908 | 871 | 946 | 1410 | 1971 | 2465 | 4103 | 1,990 |
| Brod | 1863 | 2248 | 2229 | 1604 | 1485 | 1685 | 1741 | 1200 | 1,544 |
| Bresanë | 844 | 1219 | 1229 | 1353 | 1861 | 2498 | 2999 | 4500 | 2,839 |
| Brrut | 450 | 596 | 584 | 575 | 798 | 1097 | 1319 | 1800 | 1,164 |
| Buçe | 269 | 398 | 400 | 437 | 574 | 766 | 913 | 1005 | 645 |
| Buzez | 74 | 102 | 102 | 127 | 191 | 240 | 366 | 380 | 320 |
| Dikanc | 162 | 318 | 320 | 349 | 392 | 282 | 257 | 133 | 124 |
| Dragash | 172 | 408 | 480 | 612 | 694 | 1114 | 1532 | 1893 | 1,098 |
| Gllloboçicë | 391 | 648 | 683 | 757 | 813 | 1002 | 968 | 630 | 960 |
| Kapre | 154 | 214 | 255 | 265 | 354 | 496 | 582 | 503 | 452 |
| Kosavë | 300 | 488 | 486 | 525 | 720 | 912 | 1033 | 1200 | 905 |
| Kërstec | 299 | 465 | 440 | 475 | 562 | 798 | 837 | 272 | 420 |
| Krushevë | 126 | 281 | 319 | 377 | 513 | 645 | 738 | 625 | 857 |
| Kuk | 433 | 640 | 655 | 669 | 985 | 1335 | 1619 | 2550 | 1,658 |
| Kuklibeg | 234 | 408 | 383 | 409 | 516 | 658 | 916 | 1100 | 852 |
| Kukulanë | 361 | 543 | 551 | 482 | 605 | 777 | 621 | 290 | 235 |
| Leshtan | | 537 | 493 | 513 | 658 | 758 | 679 | 197 | 783 |
| Lubovishtë | 211 | 344 | 352 | 384 | 541 | 690 | 799 | 360 | 773 |
| Mlikë | 260 | 461 | 428 | 428 | 455 | 506 | 335 | 114 | 92 |
| Orçushë | | 415 | 370 | 396 | 431 | 427 | 221 | 57 | 60 |
| Pllavë | | 462 | 449 | 493 | 690 | 972 | 1125 | 420 | 1,000 |
| Pllajnik | | 322 | 321 | 365 | 485 | 549 | 576 | 1200 | 405 |
| Radeshë | 440 | 753 | 794 | 837 | 884 | 1279 | 1226 | 953 | 1,224 |
| Rapçë | 622 | 889 | 877 | 885 | 1125 | 1647 | 1781 | 863 | 853 |
| Restelicë | 745 | 1393 | 1471 | 1772 | 2576 | 3476 | 4274 | 4200 | 4,698 |
| Rrenc | 127 | 188 | 177 | 202 | 292 | 473 | 685 | 700 | 581 |
| Shajne | 440 | 626 | 639 | 705 | 921 | 1253 | 1415 | 1950 | 1,069 |
| Vranisht | | 755 | 771 | 815 | 884 | 926 | 731 | 297 | 352 |
| Xërxe | 90 | 215 | 202 | 205 | 269 | 335 | 373 | 250 | 236 |
| Zaplluxhe | 470 | 667 | 663 | 666 | 967 | 1275 | 1504 | 2250 | 1,273 |
| Zgatar | 435 | 435 | 401 | 415 | 640 | 818 | 985 | 1400 | 885 |
| Zlipotok | | 486 | 488 | 532 | 568 | 625 | 619 | 322 | 610 |
| Zym | 139 | 197 | 167 | 215 | 315 | 457 | 573 | 480 | 585 |
| Komuna | 11460 | 20140 | 20147 | 21028 | 26850 | 35054 | 39435 | 42171 | 33997 |

Tabela 5: Popullsia e fshatrave të Komunës Dragash 1921 – 2011³⁷

³⁷ Të dhëna nga Zyra e Statistikave e Kosovës (2008). Siç citohet në Atlasin për Zhvillim të Qëndrueshëm: Vëllim 2 (Draft) *Bazat*, UNDP, qershor2012



Grafiku 6: Popullsia gjatë kohës në komunën e Dragashit 1921-2011

Tabela dhe grafiku më lartë tregojnë zhvillimet e popullsisë kryesisht gjatë shekullit 20 në 36 fshatrat që e përbëjnë komunën Dragashit. Ndërmjet vitit 1921 dhe 1981 popullsia në komunë u shtua për gati 300%. Deri në vitin 1981 mund të shihet që popullsia në gati të gjitha fshatrat kishte rritje të sigurt përveç në Brod (që në përgjithësi ka pasur një trajektore në rënie të popullsisë, me ngritje dhe ulje të vogla). Megjithatë, nga vitin 1981, rritja e popullsisë është raportuar kryesisht në pjesën veriore të komunës (Opojë), derisa fshatrat në rajonin e Gorës (jug) kanë përjetuar një ulje, në disa raste dramatike, të numrit të popullsisë. Ka ekzistuar një ulje e përgjithshme në popullsinë e Dragashit që nga viti 1981 përkundër llogaritjeve më të larta të popullsisë të siguruara për vitin 2008.

Ndërmjet viteve 1981 dhe 2011, 11 vendbanime kanë përjetuar një ngritje të përgjithshme në popullsi. Kjo kryesisht ka ndodhur në një grupim në verilindje të rajonit të Opojës në fshatrat që janë mirë të lidhura me njëra tjetrën dhe në rrugët kryesore që çojnë në nënqendrat lokale, në qytetin e Dragashit dhe në Prizren. Këto vendbanime janë Bellobradi, Blaçi, Bresana, Buzezi, Kuklibegu, Kuki, Rrenci dhe Zymi. Në rajonin e Gorës, vendbanimet me një popullsi në rritje janë Restelica, Krusheva dhe Lubevishta. I fundit duket se është duke u zgjeruar për shkak të afërsisë së tij me qendrën komunale, ndërsa Restelica më tepër është një anomali në komunë, pasi që ka shfaqur një rritje të vazhdueshme si vendbanim që nga 1921 përkundër pozitës së izoluar dhe të largët; është e mundur që rritja e Restelicës, gjithashtu e ka stimuluar edhe rritjen e Krushevës fqinje.

Një rënie të përgjithshme kanë përjetuar 12 vendbanime ndërmjet viteve 1981 dhe 2011. Ato me një ulje relativisht të vogël janë fshatrat Buçe, Shajne dhe Xërxe. Ato vendbanime që kanë përjetuar rënie të madhe dhe të rëndësishme të popullsisë kryesisht gjenden në zona kodrinore të pjesës qendrore të komunës, në rrënjë të masivit të Sharrit dhe të Koritnikut: Rapça, Mlikë, Baçkë, Kukulane, Kërstec, Orçushë, Vranishtë, Dikancë dhe Pllajnik. Është me gjasë se terrenet më të rrëpirëta e vështirësojnë qasjen, bujqësinë produktive dhe bizneset tjera, duke rezultuar me një emigrim ekonomik.

Projekti i UNDP: Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës në Dragash

Janë 13 fshatra që mendohet se janë stabile me popullsinë e tyre, që kanë pasur një rritje apo ulje të vogël rreth +/- 10% të popullsisë së tyre ndërmjet viteve 1981 dhe 2011. Ato janë Zaplluxhja, Zgatari, Pllava, Kosava, Kapra, qyteti i Dragashit, Breznja, Brruti, Brodi, Zlipotoku, Radesha, Leshtani dhe Glloboçica. Pesë të fundit gjenden në rajonin e Gorës. Radesha dhe Leshtani mund të shfaqin një popullsi stabile për shkak të afërsisë së tyre me qytetin e Dragashit që mund t'i sigurojë nevojat për shumicën e banorëve, duke zvogëluar kështu nevojën për t'u zhvendosur për shkak të qasjes së vështirë, lëvizshmërisë dhe mungesës së mundësive. Glloboçica mund të shfaqë një popullsi stabile për shkak të vendndodhjes së vetë si një pikë në gjysmë të rrugës ndërmjet qendrës komunale dhe vendbanimit të madh të Restelicës, si dhe afër vendbanimit të Krushevës që është duke u rritur. Gjithashtu, Brodi dhe Zlipotoku kanë mundur të mbeten stabile me të dhënat e tyre mbi popullsinë, për shkak të largësisë së tyre nga qyteti i Dragashit, duke formuar një grupim të izoluar por të qëndrueshëm të zhvillimit në jug të komunës dhe duke vepruar si një nyje për fshatrat përreth. Struktura e popullsisë së këtyre dy vendbanimeve është gjithashtu më e gjerë në grupet e moshës së mesme, duke sugjeruar se popullsia e përgjithshme është më e vjetër dhe për këtë arsye mund të jetë më e paiterësuar dhe pa gjasa që do të shpërngulet për punësim apo arsim. Vendbanimet stabile në rajonin e Opojës janë gjenden afër dy rrugëve që çojnë për në Prizren (nëpërmes Zaplluxhes dhe anës Breznes), me qasje të lehtë në fshatrat fqinje dhe me nënqendrat për t'i siguruar pjesën më të madhe të nevojave. Zona gjithashtu është më e rrafshët, që mundëson bujqësi më të lehtë, lëvizshmëri, ndërtim dhe zgjerim, si dhe zhvillim të biznesit.

Dy të tretat – 24 – vendbanime të Dragashit janë shumë të vogla, të cilat përbëjnë më pak se 1000 banorë. Kjo është e shpërndarë në mënyrë mjaft të barabartë nëpër komunë, me këto 13 fshatra që gjenden në rajonin qendror dhe jugor, dhe 11 janë në rajonin verior dhe lindor. 11 vendbanime të madhësisë së mesme, me numër të banorëve ndërmjet 1000 dhe 3500 kryesisht gjenden në Opojë dhe janë mirë të lidhura me rrugët kryesore apo me vendbanime tjera të mëdha apo me nënqendra. Në mënyrë të pazakontë, qendra kryesore komunale duket të mos ketë numrin më të madh individual të banorëve në komunë. Derisa qyteti i Dragashit vetë ka më pak banorë se p.sh. Restelica, gjendet në një zonë ku qasja dhe lëvizshmëria është shumë më e lehtë, me zgjerim urban të tipit “periferi” që paraqitet drejt Lubovishtës dhe Shajnes që e rritin popullsinë e përgjithshme të zonës, si dhe lidhjet e mira me Prizrenin. Kjo nënkupton se popullsia ka më shumë gjasa të jetë më e lëvizshme dhe të ketë qasje në mundësi më të mëdha për punësim. Restelica ka përjetuar një rritje të qëndrueshme qysh se shënimet e popullsisë kanë filluar dhe sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011, është vendbanimi me popullsinë më të madhe në komunë, me 4698 banorë. Kjo është edhe përkundër largësisë së madhe nga qendrat tjera kryesore, mungesës së vendkalimit kufitar, lidhjeve rrugore dhe karakterit të saj izolues dhe rural që e bënë qasjen më të vështirë në kullosa, shërbime dhe në vendbanimet tjera, posaçërisht gjatë dimrit.

Regjistrimi i Kosovës i vitit 2011 tregon se komuna përbën afërsisht 1.95% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës³⁸. Nga kjo, shumica e popullsisë (36%) jeton në familje me 2-4 persona; 33% jetojnë në familje me 5-6 persona dhe një pjesë relativisht e madhe e popullsisë (26%) jeton në familje me 7 apo më shumë anëtarë. Mesatarisht, familjet në Dragash i bie të kenë nga 5.5 persona³⁹, që krahasohet edhe me mesataren nacionale të Kosovës që është 5.9 dhe atë Evropiane që është 2.4⁴⁰. Kjo tregon se ka një

³⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultati i Regjistrimit i Popullsisë dhe i Amvisive në Kosovë 2011, Rezultatet finale: Të dhënat kryesore, http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results_ENG.pdf [shikuar më 29 janar 2013]. Popullsia e përgjithshme e Kosovës në vitin 2011 është dhënë si 1,739,825 persona (duke përfshirë tri komunat e veriut të Kosovës që e kanë bojkotuar regjistrimin).

³⁹ Op. cit, Regjistrimi 2011, Tabelat 2.1 dhe 5.18

⁴⁰ Burimi: Eurostat (http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_lvph01&lang=en). Qasur më 14.03.2012

mesatare pak më të ulët të anëtarëve për familje në Dragash në krahasim me mesataren e përgjithshme të Kosovës, por megjithatë është mbi dyfishin e mesatares Evropiane për familje.

Shifrat nga viti 2010 regjistrojnë 721 lindje⁴¹ dhe 245 vdekje⁴² në komunë. Nataliteti nëpër komunë është afërsisht 1.7%, ndërsa shkalla e mortalitetit është 0.58%. Bazuar në këto të dhëna, duket se rritja e natyrshme e popullsisë është afërsisht 1.12%. Përkitazi me ndryshimet natyrore të popullsisë, supozohet që Dragashi do të përjetojë një ulje të lehtë në shtimin e natyrshëm të popullsisë për shkak të ndikimit të migrimit jashtë vendit dhe në qendra më të mëdha urbane brenda Kosovës (si në Prizren dhe Prishtinë) që ofrojnë mundësi më të mëdha ekonomike dhe arsimore, si dhe premtimin e standardit më të lartë të jetesës.⁴³

Dendësia mesatare e Komunës së Dragashit sipas Regjistrimit të Kosovës 2011 rezulton të jetë 7.8 persona për km², e pesta komunë me dendësi më të vogël në Kosovë pas komunave Novobërdë, Partesh, Ranillug dhe Shtërpçë⁴⁴, ku të gjitha janë kryesisht rurale dhe kanë një popullsi shumicë të serbëve të Kosovës. Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë 2011 thuhet se rreth 62% e popullsisë së Kosovës është rurale.⁴⁵

Struktura sipas moshës

Ndryshimet e rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas vitit 1990 kanë pasur efekt në zhvillimin e përgjithshëm të demografisë të komunës dhe në strukturën e popullsisë sipas moshës. Gjatë pjesës së dytë të shekullit 20, piramida e popullsisë e Komunës së Dragashit kishte një bazë të zgjeruar ku grupmosha dominuese ishte ajo 0-4 vjeç. Kjo strukturë moshe dhe gjinie është paraqitur në një analizë të dhënave nga viti 1991. Ndryshimet në shkallën e shtimit natyror të popullsisë pas vitit 2000 ka ndikuar në formën e piramidës së popullsisë: ka pasur një ulje në numrin e popullsisë nën moshën 14 vjeç, derisa grupi me moshë mesatare është shtuar pak. Shumë informata të reja janë siguruar nga Regjistrimi i Kosovës 2011, por qëndron një mungesë e të dhënave krahasuese sipas grupmoshave për vitet paraprake.⁴⁶

⁴¹ ZSK, statistikë e lindjeve në Kosovë 2010.

⁴² ZSK, statistikë e lindjeve në Kosovë 2010.


⁴³ Raport i UNDP mbi Projektionet e Popullsisë për Dragash, Besim Gollopeni, qershor 2012.

⁴⁴ Publikuar në REKOS Regjistrimi Preliminar 2011 rezultatet. Ky kategorizim nuk është përfshirë në rezultatet finale të publikuara të Regjistrimit në Kosovë 2011

⁴⁵ Në raportin e Bankës Botërore 2011, bazuar në Anketat e Familjeve (ekonomive shtëpiake) Bujqësore kryer nga ZSK

⁴⁶ Raporti i UNDP mbi Projektionin e Popullsisë për Dragashin, Besim Gollopeni, qershor 2012.


Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
 2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 7: Piramida e popullsisë në 1991⁴⁷ dhe 2009⁴⁸

⁴⁷ Të dhëna nga regjistrimi, familjet dhe banesat për vitin 1991

⁴⁸ Anketë/Hulumtim Demografik mbi shëndetin social dhe riprodhues në Kosovë, nëntor 2009, f. 10



Grafiku 8: Piramida e popullsisë për komunën e Dragashit (të dhënat nga Regjistrimi në Kosovë 2011)

Në përgjithësi gjatë 20 viteve të fundit, grup-mosha e të rinjve (0-19 vjeç) ka qenë dominuese në kuadër të popullsisë së përgjithshme të komunës. Një trend i ngjajshëm është vërejtur gjithashtu në rezultatet e Regjistrimit në Kosovë 2011 (shih grafikun 8), ku grupet më të populluara janë ndërmjet 10 dhe 19 vjeç, duke indikuar se në vitet e ardhshme me gjasë do të jetë një shkallë e lartë natyrale e lindjeve, për shkak të plleshmërisë së kësaj grupmoshe. Gjithashtu, 52% e grave në komunë në vitin 2011 ishin të moshës për të lindur⁴⁹. Sidoqoftë, duket se ka pasur një rritje në grupet e moshës së mesme (35-49 vjeç) që nga studimet e kaluara, të cilat mund të tregojnë se shkallë natyrale e lindjeve është duke u ngadalësuar. Nëse trendet krahasuese të paraqitura gjerësisht në Evropë indikojnë ndryshime në të ardhmen, shkalla e lindjeve mund të ngadalësohet edhe më tej, nivelet më të larta të arsimit dhe punësimi (posaçërisht i femrave) mund të vështrohet, dhe emigrimi për punësim dhe arsimim mund të rritet. Kjo do të ketë pasojë në përbërjen e moshës të banorëve të përhershëm dhe për popullimin e vendbanimeve (të përhershme apo të përkohshme).

Rreth 57% e popullsisë është nën 34 vjeç, prej të cilëve 34% janë nën moshën 19 vjeç. 65% të popullsisë së përhershme të Dragashit konsiderohen të moshës së punës.⁵⁰ (15-59 për gratë dhe 15-65 për burrat)

⁴⁹ Ndërkombëtarisht e definuar si moshë ndërmjet 15 dhe 49 vjeç.

⁵⁰ "Moshë e punës", si një definicion ndërkombëtar përfshinë si femrat ashtu edhe meshkujt e kësaj grupmoshe që janë potencialisht të aftë për punë. Ndërsa kjo e dhënë përjashton personat që *nuk priten* të punojnë (nxënësit në shkollim të detyrueshëm; pensionistët, etj.). Kjo përfshinë personat që mund të jenë të *paaftë* për punë, për shembull, për shkak të paaftësisë pasi që këto të dhëna dhëna të pagrumbulluara nuk janë në dispozicion. Përveç kësaj dhe për dallim prej metodologjisë së Regjistrimit, kjo *përfshinë* gratë që mund të jenë "gra të shtëpisë" (amvise, nëna dhe gra që nuk punojnë por

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

me rreth 9% mbi 65 vjeç. Rezultatet e Regjistrimit në Kosovë 2011 tregojnë se ekziston një raport i vartësisë prej 53.1 (që është e përafërt me mesataren kombëtare)⁵¹, por kjo ka rënë në mënyrë të rëndësishme që nga 1961-1981 kur raporti i vartësisë ishte rreth 80.⁵²

Struktura sipas gjinisë

Sipas rezultateve të Regjistrimit të popullsisë në Kosovë 2011, popullsia e Dragashit është e balancuar mes gjinisë mashkullore dhe femërore (50.11% me 49.89% respektivisht), dhe përkon afërsisht me mesataren nacionale të Kosovës (50.3% meshkuj, 49.7% femra).

Në përgjithësi, në 20 nga 36 vendbanimet e Dragashit ka më shumë femra sesa meshkujt, të shpërndarë në mënyrë të barabartë nëpër komunë. Megjithatë, ka më shumë meshkuj sesa femra nën moshën 35 vjeç nëpër komunë si tërësi; nga grupmosha e 35-39 dhe mbi, në përgjithësi ka më shumë femra sesa meshkuj, me një zbrazëtim në rritje rreth moshës 60 vjeç. Emigrimi i të zotëve të familjes meshkuj pas moshës 35 vjeç për qëllime ekonomike mund të merret parasysh këtu, edhe pse nuk e ka çekuilibruar në mënyrë të padrejtë raportin gjinor në komunë.

| Mosha | 0-4 | 5-9 | 10-14 | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-49 | 50-54 | 55-59 | 60-64 | 65-69 | 70-74 | 75-79 | 80+ | TOTAL |
|---------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-----|--------|
| Meshkuj | 1,436 | 1,471 | 1,564 | 1,571 | 1,475 | 1,292 | 1,226 | 1,262 | 1,098 | 1,072 | 878 | 760 | 510 | 468 | 439 | 280 | 233 | 17,035 |
| Femra | 1,343 | 1,384 | 1,460 | 1,476 | 1,332 | 1,222 | 1,175 | 1,282 | 1,205 | 1,056 | 918 | 780 | 610 | 536 | 499 | 402 | 282 | 16,962 |

Grafiku 9: Popullsia e Dragashit sipas gjinisë dhe grupimit moshor 5 vjeçar⁵³

Emigrimi

Papunësia e lartë dhe mungesa e mundësive, bashkë me ngjarjet e të 90-ve dhe konflikti i 1999, i janë shtuar mostrave tradicionale të lëvizjeve, duke nxjerrë në pah se Kosova ka përjetuar dhe vazhdon të përjetojë migrime të rëndësishme të popullsisë. Shumica e kësaj është vërejtur të jetë bërë në ndërrim nga zonat rurale në ato urbane kudo nëpër Kosovë, si dhe emigrimi jashtë vendit. Numri më i madh i emigrantëve vjen nga zonat rurale të rajonit të Prizrenit dhe Prishtinës.

Regjistrimi në Kosovë 2011 tregon se rreth gjysmë milioni i njerëzve kanë jetuar në një lokacion tjetër nga ai ku ata kanë banuar gjatë kohës së regjistrimit, duke treguar se gati 30% e popullsisë vendore ka ndërmarrë një formë të migrimit. Nga këta, 66% e emigrantëve janë femra, ndërsa 34% janë meshkuj. Proporcioni më i lartë i këtij migrimi (70%) është për qëllime të “familjes”; në fakt, në tërë vendin, 166,000 më shumë femra sesa meshkuj kanë emigruar - me gjasë për shkak të martesave - duke llogaritur për 73% e të gjitha migrimeve për këtë shkak. Ndërsa 9% e migrimeve të përgjithshme është për “punësim”, 84% e këtyre të ndërmarrë nga meshkuj ndërsa vetëm 16% nga femrat. 7% e migrimeve llogaritet të jetë nga “1998-1999 war” dhe 3% për shkaqe të “shkollimit apo trajnimeve”; në të dy rastet,

rrinë në shtëpi për t'u kujdesur për familjen). Ky sektor i shoqërisë mendohet se “nuk është aktive ekonomikisht” në regjistrim, por ka potencial (nëse jo mundësinë) që të jetë fuqi punëtore produktive.

⁵¹ Tabela 4.1, Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Amvisnive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: të Dhënat Kryesore. Raporti i vartësisë është ajo pjesë e popullsisë që nuk është fuqi punëtore (në përgjithësi, personat nën 15 dhe mbi 65 vjeç, edhe pse Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë nuk i ka konstatuar parametrat e saktë për definimin e tij).

⁵² Tabela 2.7, Op. Cit.

⁵³ Ndarje e detajshme e të dhënave të siguruara për UNDP nga Kryetar i Komunës (Z. Salim Jenuzi). Burimi origjinal: Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe të Amvisnive në Kosovë 2011*

përafërsisht një e treta më shumë meshkuj se femra janë duke migruar. Një proporcion signifikant i migrimeve është për arsye “tjera” (12%).⁵⁴

Pjesa më e madhe e migrimeve duket se paraqitet brenda në Kosovë, duke llogaritur rreth 22.5% të lëvizjeve. Një pjesë tjetër prej 7.5% kanë shkuar jashtë vendit, ndërsa 70% janë jo-migrues.⁵⁵ Sidoqoftë, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka pohuar se 30% e familjeve në Kosovë kanë së paku një anëtar të familjes që jeton jashtë vendit, me rreth 20% të familjeve që marrin remitancë.⁵⁶ Në përgjithësi kuptohet se statistika të sakta lidhur me emigrimin në vende tjera është vështirë të sigurohen, sepse si migrima ashtu edhe transferi i remitancave mund të ndodhin nëpërmjet kanaleve joformale, dhe mund të mos jenë publike për grumbulluesit e të dhënave. Numri i shtëpive të zbrazëta në Dragash mund të jep një ide të mirë së paku lidhur me lëvizjet e popullsisë në komunë gjatë vitit, që gjithashtu mund të lidhet me shkallën e migrimit. Mesatarisht 37.5% e të gjitha shtëpive konvencionale ishin të pabanuara në kohën e Regjistrimit në Kosovë 2011. Rreth 12% janë haptazi të deklaruara si banesa të pushimit apo sezonale, ndërsa pjesa tjetër janë në shitje, me qira apo në pronësi të personave/familjeve që jetojnë përherë jashtë vendit.⁵⁷

Gati 9.5% e popullsisë nacionale konsiderohen si “udhëtarë”, që shkojnë në shkollë apo punojnë jashtë vendbanimit të tyre ku ata jetojnë. Vetëm mbi një të katërtën e këtyre udhëtarëve udhëtojnë rregullisht në vendet fqinje, nga të cilët shumica janë të rinj të moshës ndërmjet 16 dhe 22 vjeç, me gjasë si studentë. Moshë kulmore për udhëtim është 19-20. Udhëtarët në Dragash llogaritet të jenë 10.1 – 20% të lëvizjeve të tilla.

Komuna Dragash, si komunë periferike, rurale është një zonë që veçanërisht është karakterizuar me migrim gjatë shekullit 20. Ky trend ka vazhduar nga viti 2000 dhe besohet të jetë kryesisht për shkaqe socio-ekonomike. Në bazë të Regjistrimit të Kosovës 2011, ekzistojnë një total prej 4,461 persona me punësim të përhershëm që jetojnë përherë në komunë. Nga këta, 50% punojnë në vendbanimin ku jetojnë, ndërsa 16% udhëtojnë në vendbanime tjera në Dragash. Prejt tyre, 17% udhëtojnë në komuna tjera në Kosovë për të punuar dhe 13% e popullatës së komunës punojnë jashtë vendit (556 persona; nga të cilët 362 persona punojnë nëpër vende, të cilat nuk kufizohen drejtpërdrejtë me Kosovën).⁵⁸ Pastaj, Dragashi ka përjetuar një “humbje të moderuar” prej -99.9 deri -10% të banorëve të përhershëm për shkak të migrimit intern brenda Kosovës.⁵⁹

Përveç këtyre të dhënave zyrtare, të dhënat e grumbulluara nga terreni në vitin 2007 në Opojë sugjerojnë se ky rajon i Dragashit ka një numër shumë të lartë të emigrantëve që jetojnë jashtë vendit. Sipas këtyre rezultateve, gjithsej 1443 familje jetojnë jashtë ose kanë anëtarë të familjes që jetojnë

⁵⁴ Table 3.7, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore; gjithashtu “Njerëzit në livizje: një analizë e lëvizshmërisë ndërkombëtare, nacionale dhe locale të njerëzve të Kosovës”,* Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrim i Kosovës 2011

⁵⁵ Table 3.8, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore, dhe “Njerëzit në livizje: një analizë e lëvizshmërisë ndërkombëtare, nacionale dhe locale të njerëzve të Kosovës”,* Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrim i Kosovës 2011

⁵⁶ Strategjia Nacionale e Republikës së Kosovës mbi Migrimin: Plani i Veprimit 2009-2012, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, shtator 2012.

⁵⁷ Ka dyfishime, sidoqoftë, me këto definicione dhe duket se me gjasë shtëpitë e zbrazëta pronarët e të cilëve jetojnë jashtë vendit gjithashtu përdoren gjatë verës.

⁵⁸ Table 5.14, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore.*

⁵⁹ “Njerëzit në livizje: një analizë e lëvizshmërisë ndërkombëtare, nacionale dhe locale të njerëzve të Kosovës”, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrim i Kosovës 2011

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

jashtë vendit. Kjo jep një shifër prej rreth 6609 persona që jetojnë jashtë vendit. Duke e krahasuar këtë me popullsinë e përgjithshme⁶⁰, këto të dhëna sugjerojnë se një shtesë prej 25.84% e popullsisë së Opjës jeton jashtë vendit⁶¹.

Përveç kësaj, shënimet nga Bashkësia sugjerojnë masën e emigrimit nga fshatrat e Gorës:

| Fshati | Banorë të regjistruar (2007) | Banorë të përhershëm (2007) |
|---------------|------------------------------|-----------------------------|
| Baçkë | 715 | 36 |
| Brod | 2.544 | 1.250 |
| Dikanc | 912 | 133 |
| Dragaš | 1.479 | 470 |
| Glloboçicë | 1.538 | 625 |
| Kërstec | 1.241 | 242 |
| Krushevë | 1.000 | 630 |
| Kukulanë | 1.540 | 285 |
| Leshtan | 1.427 | 190 |
| Lubovishtë | 1.200 | 355 |
| Mlikë | 1.254 | 100 |
| Orçushë | 777 | 53 |
| Radeshë | 2.084 | 950 |
| Rapçë | 2.483 | 823 |
| Restelicë | 5.800 | 4.250 |
| Vranisht | 2.100 | 290 |
| Zlipotok | 925 | 325 |
| totali | 29,019 | 11,007 |

Tabela 6: Popullsia e fshatrave të rajonit të Gorës 2007⁶²

Në bazë të këtyre të dhënave rreth 62% e popullsisë së regjistruar nga rajoni i Gorës të komunës së Dragashit kanë jetuar jashtë vendit në vitin 2007, duke i lënë përreth 38% të cilët do të konsideroheshin si banorë të përhershëm. Për shkak të lidhjeve tradicionalisht të afërta familjare në rajon në përgjithësi dhe praktika kulturore e familjeve që ndërtojnë shtëpi në trollin e origjinës së familjes - pa marrë parasysh se a do të jetojnë apo jo si banorë të përhershëm – numri i madh i banesave të pabanuara si dhe ardhja e madhe e familjeve nga diaspora gjatë verës dëshmon një lidhje të vazhdueshme kolektive me “shtëpinë” në Kosovë dhe në Dragash.

Çështja e migrimit është ngushtë e lidhur me planifikimin hapësinor të Dragashit. Diaspora tanimë ka bërë një kontribut të madh në ndërtimin e ndërtesave të reja nëpër tërë komunën, duke ndërtuar ndërtesa dhe duke kërkuar një nivel të duhur të infrastrukturës ose të sigurimit të shërbimeve për të

⁶⁰ Dana, H. “Punim Diplome – Opoja në migrimet e jashtme: Arsyet, humbjet dhe përfitimet”, Prishtinë 2007.

⁶¹ Sqarim: Këto të dhëna janë marrë përmes regjistrimit të emigrantëve dhe është kryer nga 20.05.2007 deri 08.07.2007. Kjo analizë merr mostër prej 10% të atyre të përfshirë në pyetësor (145 persona). Nga Raporti i UNDP mbi Projektionet e Popullsisë për Dragash, Gollopeni, B., qershor 2012.

⁶² Të dhënat janë siguruar nga imami Uzair Hamza, korrik 2012

plotësuar nevojat e tyre. Ky popullim i luhatshëm i komunës është me rëndësi, për shembull, kur planifikohet furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike si dhe për zgjerim të vendbanimeve dhe për zhvillim ekonomik lokal.

Popullsia gjatë verës dhe dimrit

Numri i shtëpive të zbrazëta në kohën e regjistrimit mund të shfrytëzohet si udhëzues për numrin e personave apo të familjeve që jetojnë jashtë vendit, pasi që ky është një fakti shpesh i përmendur se popullsia e vendbanimeve të Dragashit rritet në mënyrë dramatike gjatë verës me familjet që kthehen për pushime dhe se gjatë pjesës tjetër të vitit, një proporcion signifikant i ndërtesave nuk shfrytëzohen. Regjistrimi në Kosovë 2011 tregon se derisa 61.3% e banesave konvencionale të Dragashit janë të banuara përherë, pjesa tjetër (38.7% apo 3856 njësi) janë të zbrazëta.

Ekziston një disparitet i qartë ndërmjet situatës aktuale të migrimit në komunë dhe asaj që zyrtarisht është regjistruar. Informatat e marra nëpërmjet grumbullimit të të dhënave në terren, për këtë arsye është e rëndësishme për të ndihmuar në definimin e nivelit të migrimit për Dragashin, dhe ndërrimeve në banim gjatë tërë vitit që është me pasojë për planifikimin hapësinor.

Përkundër mospërputhjeve në këto statistika të ndryshme shtetërore, zyrtare dhe lokale mbi migrimin dhe nxënien dhe duke marrë parasysh shkallën dhe të dhënat nga terreni lidhur me nxënien, supozohet se popullata e komunës shtohet me rreth një të katërtën dhe një të tretën në kohë të caktuara të vitit.

Shpopullzimi⁶³

Lëvizja e një numri të madh të banorëve të vendbanimit shkakton ulje të përgjithshme në popullsi për atë fshat, me ndikim në perspektivën dhe strategjitë që duhen planifikuar për zhvillim. Kjo shkaktohet nga një numër faktorësh, duke përfshirë kushtet natyrore, zhvillimin ekonomik, faktorët social, nivelin e shërbimeve etj. Pasojat për shpopullzimin e vendbanimit përfshijnë zvogëlimin e tokave të punueshme si rezultat i mungesës së forcës punëtore apo mundësive të tregut, emigrimit të fuqisë së re punëtore dhe personave të arsimuar, ulje së numrit të martesave dhe lindjeve, si dhe vjetërsimit të popullsisë. Me vazhdimin e shpopullimit, kushtet për banorët e rinj sa vijnë dhe vështirësohen (siç është qasja në arsim, punësim dhe shërbime që mund të jenë mbyllur), duke i shtuar kështu gjasat për emigrim të mëtejshëm nga vendbanimi. Mungesa e popullimit ka gjithashtu efekt negative në infrastrukturë dhe aspektin fizik të vendbanimit, me rrugë dhe shtigje që mbulohen nga vegetacioni si rezultat i mospërdorimit dhe mirëmbajtjes, braktisjes së pronave dhe infrastrukturës, dhe në disa raste, shtimit të raportuar të vjedhjeve.⁶⁴

Përgjithësisht, nëpër Komunë të Dragashit, një numër mjaft i barabartë i vendbanimeve janë rritur për nga popullsia, kanë rënë apo kanë mbetur stabile (respektivisht 11, 12 dhe 13). Nga ato që janë rritur, vetëm 3 gjenden në rajonin e Gorës (Restelica, Krusheva dhe Lubovishta); 5 vendbanime të Gorës kanë mbetur stabile për nga popullsia (Brodi, Zlipotoku, Radesha, Leshtani dhe Gllloboçica); dhe 8 kanë rënë për nga popullsia. Anasjelltas, 9 fshatra në rajonin e Opojës janë rritur për nga popullsia, 7 janë stabile

⁶³ Instituti për Planifikim Hapësinor, Analizë Hapësinore – Komuna e Dragashit, nëntor 2006. Nga Raporti i UNDP-së mbi Projektionet e Popullsisë për Dragash, Gollopeni, B., qershor 2012.

⁶⁴ Anketa në terren e muajit maj 2012 raportoi për vjedhje të kohëve të fundit në Mlikë dhe Baçkë të cilat banorët ia atribuuan mungesës së banorëve të përhershëm në këto fshatra të largëta.

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

dhe 5 kanë rënë. Variacionet në ndryshimet e popullsisë mund të shpjegohen për nga faktorët gjeografik, si dhe ndryshimi i normave shoqërore. Vendbanimet në zonat malore qendrore dhe jugore të komunës janë më të largëta dhe më vështirë arrihen, posaçërisht gjatë dimrit. Kjo shkakton kufizime të qasjes në mundësitë për arsim dhe punësim, vështirësi në kultivim, prodhim dhe tregëti, si dhe kufizon mundësitë e biznesit dhe të komunikacionit. Pastaj, qasja në internet dhe në mediat tjera bashkëhore shpesh i inkurajon të rinjtë të zgjedhin arsimin, ambiciet dhe punësimin në vende më të urbanizuara dhe larg nga aktivitetet tradicionale rurale dhe jetesës që konsiderohet si e “prapambetur” apo jashtë modës. Shpopullzimi, posaçërisht nga gjeneratat më të reja nga vendet rurale gjithashtu priret të vetë gjenerojë p.sh. braktisjen e një popullate të madhe të pleqve apo të atyre që janë duke u plakur. Ky migrim nga pjesë rurale në ato urbane është karakteristikë e përbashkët e shumë rajoneve nëpër botë në ditët e sotme, por duket veçanërisht e theksuar në Dragash dhe posaçërisht në ato fshatra të kategorizuara si fshatra të largëta.

Cështjet e etnive dhe minoriteve

Kosova është shtëpi e një përzierje komplekse të grupeve etnike – shqiptarëve, serbëve, romëve, ashkalive, egjiptianëve, boshnjakëve, turqve, kroatëve dhe malazezëve – ku secili luan rol të rëndësishëm në historinë dhe zhvillimin e rajonit. Statistikat e sakta mbi popullsinë sipas etnisë vështirë mund të sigurohen dhe janë kontroverze për t’u raportuar, posaçërisht për shkak se një numër i madh i serbëve të Kosovës (duke përfshirë shumicën e tri komunave veriore) e kanë bojkotuar Regjistrimin në Kosovë 2011 dhe për shkak të definicioneve individuale dhe kolektive të etnisë dhe të sfondeve kulturore që priren të jenë më të paqëndrueshme. Burimet në përgjithësi pajtohen se shqiptarët e Kosovës formojnë komunitetin shumicë në Kosovë (rreth 90% e popullsisë), 5% të popullsisë serbë të Kosovës dhe pjesa e mbetur që përbëhet nga grupet tjera etnike⁶⁵. Regjistrimi në Kosovë 2011 në nivel kombëtar konfirmon këtë në një shkallë më të gjerë, përveç me gjasë të raportimit të pamjaftueshëm mbi popullatën serbe të Kosovës.

| | SFONDI ETNIK APO KULTUROR | | | | | | | | | | | TOTALI |
|-----------------|---------------------------|-----------|-------|------|----------|------|---------|----------|--------|-------|-----------------------------|--------|
| | Nuk ka | Shqiptarë | Serbë | Turq | Boshnjak | Romë | Ashkali | Egjiptas | Goranë | Tjerë | Preferojnë mos ë përgjigjen | |
| [A] NACIONALE % | 0.11 | 92.93 | 1.47 | 1.08 | 1.58 | 0.51 | 0.89 | 0.66 | 0.59 | 0.14 | 0.05 | 99.89 |
| Dragash Nr. | 22 | 20,287 | 7 | 202 | 4,100 | 3 | 4 | 3 | 8,957 | 283 | 129 | 33,997 |
| [B] DRAGASH % | 0.06 | 59.67 | 0.02 | 0.59 | 12.06 | 0.01 | 0.01 | 0.01 | 26.35 | 0.83 | 0.38 | 100.00 |

Grafiku 10: Popullsia sipas sfondit etnik/kulturor për [A] Kosovë, dhe [B] komunën e Dragashit

Përkundër faktit se pyetjet mbi etninë dhe religjionin nuk ishin të obligueshme në Regjistrimin e Kosovës 2011, diversiteti i grupeve etnike në komunë duket të jetë në vazhdimësi me të dhënat e llogaritura nga QEÇM dhe OSBE. Popullata shqiptare e Kosovës është rreth 60%, me 12% boshnjakë, 26% goranë dhe një numër të vogël të grupeve të tjera etnike që jetojnë në komunë. Ky proporcion gjithashtu përafërsisht korrespondon me dallimin ndërmjet popullatës së fshatit të dy rajoneve gjeografike të Gorës (kryesisht goranë/boshnjakë) dhe Opojës (kryesisht shqiptarë të Kosovës).

⁶⁵ Sipas Raportit të Bankës Botërore 2007, cituar në Profilin e Kosovës të ECMI, në dispozicion në: <http://www.ecmikosovo.org/index.php/kosovo-profile/communities> [qasur më 13.06.12]

Në nivel nacional, sipas Raportit të 'Human Rights Watch' për vitin 2011, grupet joshumicë në Kosovë mbesin të rrezikuara nga diskriminimi, marginalizimi dhe ngacmimi, veçanërisht serbët e Kosovës dhe romët, ashkallitë, dhe egjiptianët.⁶⁶ Niveli i punësimit i komuniteteve joshumicë në shërbimin civil dhe struktura komunale në Kosovë gjykohet si i pakënaqshëm dhe ka respektim të dobët të kërkesave ligjore për përdorim të gjuhëve zyrtare të Kosovës. Ka ndërveprim të dobët ndërmjet nxënësve dhe studentëve nga grupe të ndryshme etnike në shkollat e Kosovës dhe mungesë e mundësive për t'i studiuar të dy gjuhët zyrtare. Edhe trashëgimia kulturore e komuniteteve joshumicë është e rrezikuar.⁶⁷

Ka pasur një shtim të kthimit vullnetar në Kosovë në vitin 2010, ndonëse shifrat e përgjithshme mbeten të ulëta, duke numëruar rreth 1036 persona. Kthimi i detyrueshëm i kosovarëve nga vendet e Evropës perëndimore ka vazhduar (1694 persona në nëntë muajt e parë të 2010). Shkalla e kthimeve me forcë në Kosovë ka gjasë të rritet në nivel nacional, për shkak të marrëveshjeve për ripranim të nënshkuara nga autoritetet e Kosovës me Gjermaninë, Shqipërinë, Belgjikën, Francën dhe Zvicrën.⁶⁸

Në krahasim me situatën nacionale, niveli i mirë i tolerancës dhe bashkëjetesës paqësore i grupeve të ndryshme etnike në Komunën e Dragashit është një përparësi domethënëse. Ai është burim i pasurisë në jetën kulturore të zonës dhe siguron jo vetëm bazë të fuqishme për ardhmërinë e komunës por gjithashtu jep apo vendos një shembull të mirë brenda Kosovës.

Përbërja etnike e komunës së Dragashit lidhet me dy rajonet e Gorës dhe Opojës. E para gjendet në qendër dhe jug të komunës përfshin 16 fshatra të banuara kryesisht nga komunitetet shumicë të goranëve dhe boshnjakëve. Rajoni i Opojës gjendet në veri të komunës dhe numëron 19 fshatra, me popullsi shumicë shqiptare.

Raportet nga OSBE dhe ECMI theksojnë traditën multikulturore dhe paqësore të përbashkët të komunës së Dragashit, si në frontin social ashtu dhe në atë kulturor që është një përparësi e vërtetë në vizionin e saj për zhvillim.

Siguria dhe liria e lëvizjes është vlerësuar lartë si nga OSBE ashtu edhe nga ECMI dhe nuk janë raportuar incidente lidhur me të kthyerit që janë kthyer në Dragash gjatë 1999 dhe 2009. Nga këta, boshnjakët që janë kthyer vullnetarisht në Dragash para 2008 përbëjnë numrin më të madh (1277). 171 boshnjakë tjerë janë kthyer në 2008-2009. Vlerësohet që ka pasur 4000 boshnjakë të zhvendosur nga komuna; nga këta, pak më shumë se gjysma ende jeton jashtë. Një numër prej 228 individëve të tjerë iu nënshtruan procesit të kthimit me forcë në vitin 2007 (goranë). Një numër organizatash ndërkombëtare kanë kryer projekte për kthim, riintegrim, ndërtim të komunitetit, dialogut ndëretnik dhe zhvillimit lokal, duke përfshirë këtu ISMC-në, IOM-in, 'Swiss Caritas', GTZ-në dhe ARC-në.

Shifrat nga ECMI për 2010 zbulojnë një nivel të mirë punësimit të minoritetit në sektorët publik (administratë, shëndetësi, arsim) në Dragash dhe respektim të duhur të gjuhëve zyrtare të Kosovës pa probleme të komunikimit ndërmjet komuniteteve. Boshnjakët/Goranët përbëjnë afërsisht 36% të popullsisë totale të Dragashit, ku 27-35% e stafit të sektorit publik është nga ky komunitet. Përfaqësimi zyrtar në pozitat publike për këtë arsye është në proporcion me etninë.

⁶⁶ 'Human Rights Watch', *Raporti Botëror 2011 - Kosovë*, 24 janar 2011, në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4d48283b2.html>. [Qasur më 13 qershor 2012]

⁶⁷ Raport i OSBE Vlerësimi i të drejtave të komuniteteve, Botimi i dytë, dhjetor 2010

⁶⁸ Human Rights Watch, *Raporti Botëror 2011, Kosovë*, 24 janar 2011, në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4d48283b2.html>. [Qasur më 13 qershor 2012]

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Lidhur me gjuhët amtare, 59% e popullatës së Dragashit flasin gjuhën shqipe, 6% gjuhën serbe, 14% gjuhën boshnjake dhe 0.3% gjuhën turke, me 21% që flasin gjuhë “tjera” (me siguri llogaritet për gjuhën gorane që thonë se është më e ngjajshme me maqedonishten). Përveç kësaj, shumë njerëz në Dragash flasin edhe disa gjuhë tjera, përfshirë ato gjuhë tjera që janë autoktone të komunës si dhe gjuhët e vendeve ku ata kanë emigruar.

Në aspekt të përkatësisë fetare, shumica – mbi 99% e popullatës së Dragashit janë myslimanë me një numër të vogël të ortodoksëve dhe me besime tjera.

| | Mysliman | Ortodoks | Katolik | Tjerë | Pa religjion | Preferojnë të mos përgjigjen | Nuk ka të dhëna |
|--------------|----------|----------|---------|-------|--------------|------------------------------|-----------------|
| Numri | 33,806 | 9 | 0 | 141 | 5 | 12 | 24 |
| % | 99.44 | 0.03 | 0.00 | 0.41 | 0.01 | 0.04 | 0.07 |

Grafiku 11: Popullsia e Dragashit sipas religjioni⁶⁹

Cështjet gjinore

Në nivelin kombëtar, dallimi ndërmjet gjinive në kuptim të shfrave të popullsisë është shumë i vogël, me afërsisht 0.68% më shumë meshkuj sesa femra. 62.8% e popullsisë së Kosovës e moshës 6-29 vjeç aktualisht gjendet në një formë të arsimimit, nga të cilët 52.6% janë meshkuj dhe 47.4% janë femra. Kjo tregon se përafërsisht 5% më shumë meshkuj sesa femra janë në arsim, përkundër demografisë gjinore që gati është e barabartë. Femrat në Kosovë llogariten të jenë rreth 3% nga 8.2% e popullsisë që kanë diplomuar në univetsitet; 30% nga ata që kanë kryer shkollën e mesme të lartë, vetëm 10% janë femra. Deri sa 95% e popullsisë së obliguar për shkollim (5-15 vjeç) vijojnë shkollimin, Regjistrimi i Kosovës 2011 nxjerr në shesh se shumica e femrave e ndërpresin shkollimin e tyre në fund të shkollimit të obligueshëm (ku përfundojnë shkollën e mesme të ulët në moshën 15 vjeç), ndërsa meshkujt vazhdojnë në shkollën e mesme të lartë dhe më tej.⁷⁰ Në përgjithësi ndjekja e shkollimit kulmon rreth moshës 14 vjeç, ku pastaj fillon të bie deri në moshën 18-19 vjeç, ku ka rënie të mëtejme pasi që njerëzit e ndërpresin shkollimin dhe nuk vazhdojnë në univeristet.

Regjistrimi i femrave në skolla të mesme dhe në shkollim të lartë nëpër zonat rurale në Kosovë është mesatarisht 20% më e ulët sesa për meshkujt e moshës së shkollës së mesme. Posaçërisht lidhur me shkollimin e femrave, Kosova është shumë prapa Evropës dhe shumicës së fqinjëve në rajon.⁷¹

Grafikoni tregon dallimet ndërmjet nivelit arsimor të meshkujve dhe të femrave në Dragash. Është e qartë se përkundër një proporcioni gati të barabartë të meshkujve dhe të femrave në komunë si tërësi, gratë kanë një arritje më të ulët arsimore sesa meshkujt, që mbarojnë vetëm shollën e mesme të lartë që është e obligueshme. Një pjesë e madhe e femrave gjithashtu nuk kanë mbaruar asnjë nivel arsimor. Derisa braktisja e shkollës gjithashtu është e madhe edhe për meshkujt pas shkollës së mesme të ultë, megjithatë më shumë meshkuj sesa femra vazhdojnë shkollimin e tyre të mesëm të lartë dhe në


⁶⁹ Tabela 5.5, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore*

⁷⁰ Tabelat 2.2 dhe 3.21, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore*

⁷¹ Getting to Lisbon. Assessing vocational training needs and job creation opportunities for rural women. UNICEF 2008. Burimi: http://www.unicef.org/kosovo/Getting_To_Lisbon_-_English.pdf. Vlerësuar më 13 June 2012

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

universitet/skollimi terciar. Shkolla e mesme në qytetin e Dragashit shënon se vetëm 33% e popullsisë më të vjetër shkollore është femra, që është në mënyrë signifikante nën mesataren kombëtare.



Grafiku 12: Proporcioni i popullatës së Dragashit sipas gjinisë dhe nivelit më të lartë të arritur arsimor

Në përgjithësi në Kosovë, pjesa më e madhe e personave “ekonomikisht joaktiv” (49%) janë të angazhuar me “kujdesin ndaj shtëpisë/familjes”.⁷² Në Dragash, 63% e popullsisë mb moshën 15 vjeç konsiderohen ekonomikisht aktiv; të atyre që kanë mbetur 37% që konsiderohen ekonomikisht joaktiv, 26% janë meshkuj dhe 74% janë gra. Për dallim me definicionin e “popullsia e moshës së punës” që është dhënë në paragrafin më lartë, Regjistrimi i Kosovës 2011 e dallon këtë grup produktive të punës në “ekonomikisht aktive” dhe “ekonomikisht joaktive”, ku personat e angazhuar si “*nxënësit me orar të plotë, studentët, amviset, pensionistët, shërbyesit e shërbimit ushtarak të obligueshëm*” nuk pritet të punojnë. Kjo nënkupton se të dënat për popullatën “ekonomikisht aktive” të Dragashit mund të mos përfshijnë femrat që janë në gjendje të krijojnë të hyra por nuk e bëjnë këtë për shkak të normave socio-kulturore dhe traditave që kërkojnë nga ato të angazhohen në aktivitetet shtëpiake. Deri sa ky është një përfaqësim i duhur i potencialit të vërtetë ekonomik, kjo gjithashtu tregon se pritet apo mundësitë për gratë në tërësi në Kosovë dhe veçanërisht në Dragash si zonë rurale, shpesh janë të limituara në rolin tradicional të amvisnisë. Kjo gjithashtu mund të vlejë edhe për nivelin e ultë të arritjeve arsimore për femrat sesa për meshkujt.

⁷² Table 5.15, Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat kryesore

Një numër shumë i vogël i grave në Dragash janë aktualisht të punësuar - me numër 302, nga 1275 që konsiderohen "ekonomikisht aktiv" (24%), dhe nga totali i moshës së punës të popullatës femërore⁷³ prej vetëm nën 10,500 (3%).

76.5% e populates totale femërore në Kosovë klasifikohet si "ekonomikisht joaktive". Rreth 12% të grave të moshës punuese (15-59) janë të punësuar në Kosovë, krahasuar me mesataren e BE prej 64%, edhe pse kjo është në mënyrë drastike e shtermbëruar drejt atyre me arsim të nivelit terciar dhe nuk përfaqëson pjesëmarrjen në profesionet teknike dhe tradicionalisht të dominuara nga meshkujt përkundër mungesës në treg.

Sidoqoftë, sektori më i rëndësishëm për punësimin e femrave në Kosovë është arsimiti (21%) e pasuar nga tregëtia me shumicë dhe pakicë (18%), shëndetësia dhe puna sociale (15%) administrata publike (13%).⁷⁴ Stereotipat gjinore, qëndrimet dhe traditat kulturore gjithashtu luajnë rol të madh në pabarazinë ndërmjet mundësive për meshkujt dhe femrat në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale ku ofrohen mjaft pak mundësi për arsim dhe punësim. Lidhur me këtë, kryefamiljaret femra janë veçanërisht të cenuara të jetojnë nën kufirin e varfërisë.⁷⁵ Nga 890 vende pune në sektorin publik, në 67 pozita janë femra (7.5%), me 6 në pozita vendimmarrëse. Papunësia është prevalente posaçërisht në mesin e femrave të reja në tërë Kosovën.

Regjistrimi nxjerr në shesh se punësimi i femrave në Dragash llogarit më pak se 7% e vendeve të punës, kryesisht në fushën e prodhimit dhe të arsimit. Administrata publike dhe kujdesi shëndetësor gjithashtu përfshijnë pjesën më të madhe të punësimit të femrave, me vetëm 0.45% të punëve të deklaruara që janë në bujqësi. Sidoqoftë, këto të dhëna duket se nuk marrin parasysh gjenerimin e të hyrave nëpërmjet mënyrave tjera më joformale (p.sh. nëpërmjet bujqësisë, tregëtisë, zejtarisë, etj), sesa me punë formale. Në fakt, aktivitetet e femrave llogariten rreth 26% të fitimit kryesor për jetesë të fituar nga "Puna (përfshirë punën në tokën e vetë, punën në biznes të vetin apo në biznesin familjar)" në Dragash.

Kjo është vërtetuar nga një anketë e shumicës së NVM-ve të regjistruara në komunën e Dragashit që tregon se nga gjithsej 705 persona të punësuar, 142 janë femra (20%)⁷⁶. Shpërndarja më e barabartë e punonjësve femra dhe meshkuj është në biznesin e blektorisë, që tregon se femrat ende lidhen me detyrat tradicionale të ekonomisë bujqësore dhe blektorale se sa të industrisë së prodhimit, përpunimit apo shërbimit.

Një numër i OJQ-ve që veprojnë në Dragash merren me çështjet gjinore (OJQ *Flaka, Iniciativa e Gruas, Sara dhe Dora e Shpresës*), veçanërisht në zhvillimin e aftësive dhe formimit profesional⁷⁷. Në përgjithësi shumë pak shoqata të grave janë të pranishme në Dragash dhe shërbimet mund vetëm të ofrohen në baza ad-hoc kur fondet janë në dispozicion. Ekziston nevoja për të fuqizuar Zyrën Komunale për Barazi Gjinore për forcimin e organizatave të grave dhe nismat ekzistuese në Dragash në mënyrë që të arrihet

⁷³ Afërsisht 15-59 vjeç

⁷⁴ Kita, L., *HRD analizë e vendit – Kosovë*, ETF, punim, maj 2008. Burimi:

[http://www.etf.europa.eu/pubmgmt.nsf/\(getAttachment\)/82184CC7164F60E2C12574B9005788F6/\\$File/NOTE7J5LJP.pdf](http://www.etf.europa.eu/pubmgmt.nsf/(getAttachment)/82184CC7164F60E2C12574B9005788F6/$File/NOTE7J5LJP.pdf). Qasur më: 17.03.2012

⁷⁵ Vlerësimi i varfërisë në Kosovë, Raporti i Bankës Botërore No. 39737-XK, tetor 2007

<http://www.skmbalcani.cooperazione.esteri.it/utlskmbalcani/IT/Documenti/Pdf/KosovoPAvol1.pdf>. Qasur më: 17.03.2012.

⁷⁶ Rezultatet e Anketimit të NVM në Dragash, UNDP, mars 2012

⁷⁷ Po aty.

ofrimi i shërbimeve më të gjera për gratë dhe për të krijuar mundësitë alternative arsimore dhe trajnime për gratë.

Rinia

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, me 47% të popullatës së përgjithshme nën moshën 25 vjeç. Nga këta, 19% konsiderohen "rini" (që janë nën moshën ndërmjet 15 dhe 24 vjeç), dhe dy të tretat e të cilëve jetojnë në zonat rurale. Shkollimi i detyruar mbaron në moshën rreth 15 vjeç; aktualisht 55% e kësaj grupe me moshë të re ende gjenet në arsimim, që tregon se nivelet më të larta të kualifikimeve janë duke u kërkuar nga mbi gjysma e popullsisë së re të Kosovës. Megjithatë, kjo lë 45% që kanë lënë shkollën vetëm me arsim të mesëm të ulët. Kërkesa për punëtorë tani më është e ultë në tërë Kosovën, me mungesë të arsimit dhe me përvojë pune që i kontribuon 81.8% të rinisë që kanë kërkuar punë për më shumë se 12 muaj. Për këtë, migrimi është një opsion atraktiv për të përmirësuar jetesën e tyre.⁷⁸

Kjo është veçanërisht e vërtetë në zonat rurale dhe shumë të largëta si Dragashi, ku problemet madje edhe me infrastrukturën bazë dhe shërbimet nuk përputhen me pritjet e të rinjve, si dhe për të cilën izolimi i një jetese tradicionale, bujqësore është në kundërshtim me aspiratat e shekullit të 21-të. 15 nga 36 fshatrat në komunë të Dragashit nuk posedojnë një fushë sportive, dhe 28 nuk kanë një shesh lojërash; megjithatë, objekte të internetit janë të vendosura në 7 fshatra, të cilat mund të ofrojnë forume të tjera për shoqërim për të rinjtë. Shërbimet dhe disponueshmëria e dobët e artikujve popullor apo e dyqaneve në fshatrat krahas vështirësive në transport (sidomos në dimër dhe për shkak të kostos) bashkojnë këtë ndjenjë të izolimit dhe mungesës së mundësive për të rinjtë. Këta faktorë kontribuojnë gjithashtu në standarde të ulëta dhe qasje të ultë në arsimim përtej nivelit fillor. Ka vetëm një qendër rinore-OJQ, e vendosur në qytetin e Dragashit që u shërben të gjitha fshatrave. Objektet rajonale rinore përfshijnë katër OJQ rinore në qytetin e Prizrenit, një Këshill lokal për veprim rinor, dy këshilla studentore dhe një klub shoqëror. Ekziston edhe një Qendër për Arsim, Ndërmjetësim dhe Ekologji me fokus tek të rinjtë që gjendet në fshatin Sredskë afër Prizrenit.

Në përgjithësi në Kosovë, përfshirja e të rinjve në jetën publike është shumë e kufizuar. Gjetjet nga Anketa e opinionit publik e të rinjve e UNICEF-it, 2010, tregojnë se shumica e njerëzve të rinj e shohin veten si "pak" ose "aspak" pjesëmarrës në proceset vendimmarrëse. Së pari, mekanizmat e nivelit lokal (Këshillat rinore për veprim, Departamentet Komunale për Rinisë, etj) ose mungojnë krejtësisht ose nuk funksionojnë siç duhet. Së dyti, të dyja institucionet qendrore dhe lokale ende nuk e konsiderojnë zhvillimin e të rinjve si një prioritet. Kjo reflektohet nga alokimet buxhetore tejet të vogla për aktivitete rinore në të dy nivelet, qendror dhe lokal.

Rinia e Kosovës është një pjesëmarrëse thelbësore e institucioneve dhe shoqërisë civile, për t'u angazhuar aktivisht në politikat zhvillimore dhe në hartimin dhe sigurimin e avokimit të bazuar në dëshmi për një fokus më institucional dhe publik mbi çështjet rinore. Kjo mund të arrihet në veçanti duke ndërtuar mbi arritjet e bëra përmes Këshillave qendrorë dhe lokalë të veprimit rinor, si dhe zhvillimit dhe zbatimit të planeve për veprime rinore komunale.

Përpjekjet për mobilizimin e komunitetit të të rinjve që të avokojnë dhe të ngrenë zërin e tyre për të qenë pjesë e jetës publike do të duhet të vazhdojnë dhe të forcohen. UNICEF-i dëshiron të përqendrohet

⁷⁸ Burimi: UNICEF/IKS Raport: Ndryshimi i Zgjidhur: Zërat e Rinisë së Kosovës 2010
http://www.unicef.org/kosovo/iks_unleashing_change_eng.pdf, shikuar më 17 mars 2012

në vazhdimin e mbështetjes së nismave të ndryshimit të sjelljes tek të rinjtë, me qëllim uljen e sjelljeve të rrezikshme dhe promovimin e jetesës së shëndetshme. Ndiurma financiare dhe teknike është planifikuar për t'i synuar të rinjtë në moshë të re.

Aktivitetet që janë më të nevojshme janë pjesëmarrja e rinisë dhe fuqizimi nëpërmjet lidhjes së aktiviteteve të vazhdueshme dhe të reja rinore me Qendrën Rinore në Dragash, në mënyrë që t'i mobilizojë të rinjtë më shumë dhe të marrin pjesë në disa aktivitete për të mirën e tyre dhe komuniteteve të tyre.

Një tjetër objektivi që është po aq i rëndësishëm është ndërtimi i kapaciteteve për rininë në lëndë të ndryshme, si dhe ngritjen e vetëdijes lidhur me sjelljet e rrezikshme dhe HIV.

Ekzistojnë 5854 individë të kësaj grupmoshe që aktualisht jetojnë në Dragash, që është rreth 17% e popullsisë së përgjithshme e komunës. Nga këta, 2360 janë në shkollim (40%).⁷⁹ Derisa një pjesë e madhe e regjistrimit është përqendruar në banorët e moshës 15 apo më lartë, në regjistrimin kombëtar nuk ka informata specifike të siguruar mbi grupmoshën e “rinisë”.

Grupet tjera të cenueshme

Ka vetëm disa statistika të besueshme për të dhënë një pasqyrë të saktë të situatës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, por sipas OJQ-së Asociacioni për Persona me Nevoja dhe Aftësi të Kufizuara, numri i tyre është 18,760. Pothuajse të gjithë kanë përjetuar diskriminim në arsimim, punësim dhe sigurimin e shërbimeve mjekësore. Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe ata me nevoja të veçanta janë veçanërisht në rrezik nga përjashtimi që nga moshja e re për shkak të paragjyqimeve, si dhe mungesës së burimeve për të siguruar kujdes të duhur dhe përkrahje. Gjetja e një pune në tregun e punës kur ka papunësi prej 70% është një tjetër problem i madh dhe shumë prej tyre mbeten gjithmonë të papunë.

Regjistrimi i Kosovës 2011 shënon se afërsisht 4.5% e popullsisë së përgjithshme kanë ndërmjet një dhe tri “vështirësi”, nga të cilët 47% janë meshkuj dhe 53% janë femra. Përveç grupmoshës 0-14 që duket të ketë një numër jashtëzakonisht të lartë të vështirësive të regjistruara, numri i vështirësive të regjistruara afatgjata rritet me grupmoshën, që kulmon ndërmjet moshave prej 55 deri 70 vjeç, para se të ulen lehtësisht. Kjo mund të lidhet me kategoritë e “vështirësive” që janë vlerësuar dhe rënia natyrale në lëvizshmëri dhe sensi që shoqëron moshën rritëse: shurdhësia/dëmtim i rëndë i dëgjimit, verbëria/dëmtim i rëndë vizual, paaftësi fizike, paaftësi në të mësuar/intelektuale, vështirësi kronike psikologjike/emocionale apo sëmundje tjera kronike. Nga këto, më të rëndomëta janë sëmundjet tjera kronike dhe paaftësitë fizike, të përcjella nga dëmtimet e dëgjimit dhe të shikimit.⁸⁰

3.5% e popullsisë së Dragashit është mbi 75 vjeç, që është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 2.2%. Nga popullsia e komunës 8% janë të pensionuar dhe marrin pension, derisa 3% marrin asistencë sociale.

Sikurse edhe me rininë, nuk ka informata mbi situatën e pleqve apo të njerëzve me aftësi të kufizuara në Dragash.

⁷⁹ Table 3, *Popullsia e moshes 6-29 vjecare, neper vendbanime Dragash qe vazhdojn shkollimin*: të dhëna shtesë për secilin fshat janë siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës; siguruar nga *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011*

⁸⁰ Tabela 3.30, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet finale: Të Dhënat kryesore*

3.1.5 Administrimi komunal

Dragashi daton si një entitet administrativ që nga 1935 dhe ka funksionuar si i tillë deri në vitin 1960, kur kufijtë komunalë që ekzistojnë sot u krijuan. Nga viti 1992 deri në vitin 1999, komuna ishte e ndarë në dy rajone: komunën e Gorës, ku rajoni i Opojës iu bashkëngjiti më vonë komunës së Prizrenit. Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, nën qeverisjen e përkohshme administrative të UNMIK-ut, rajonet e Gorës dhe Opojës iu bashkuan përsëri komunës së Dragashit në vitin 2000. Kuvendi i parë i Komunës së Dragashit është themeluar më 21 nëntor 2000. Kjo zëvendësoi strukturën e vet-caktuar të PDK-së që ishte ngritur menjëherë pas konfliktit.⁸¹

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, komuna që ka më shumë se 10 për qind të banorëve që i përkasin komuniteteve joshumicë duhet të caktojë një zëvendëskryetar të Kuvendit të Komunës për Komunitete. Që nga 2011, kjo pozitë është mbajtur nga Šerif Aga (VAKAT), boshnjak i Kosovës.⁸²

Ndërmjet 2007 dhe 2011, investimet e komunës llogariten rreth 4.8 milion euro. Prej tyre, rreth 3.5 milion euro u shpenzuan për përmirësimin e rrugëve, kanalizimit/ ujërave të zeza, ujit, kujdesit shëndetësor dhe shkollat në rajonin Opoje , afërsisht 2.7 herë shuma e shpenzuar në rajonin e Gorës (1.3 milionë euro). Sektori më i madh për investim ishte në rrjetin rrugor, që përbëjnë rreth 60 për qind të buxhetit gjatë këtyre pesë viteve. 11% u shpenzuar për përmirësime në furnizimin me ujë dhe 8% për përmirësime në shkolla. 6% e buxhetit të përgjithshëm për 2007-2011 është shpenzuar në kanalizim/përmirësime në ujërat e zeza, ndërsa në shërbimin e kujdesit shëndetësor është shpenzuar vetëm 4%.⁸³

⁸¹ Profilet Komunale OSCE 2006

⁸² Profilet Komunale OSCE 2011

⁸³ Listë e Projekteve të investimeve komunale në Komunën e Dragashit, 2007-2011.


Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 7: Përfaqësuesit e administratës komunale 2012

| POZITA | EMRI I PLOTË | TEL. | e-mail |
|--------------------------------------|---------------------|---------------------------|--|
| Kryetari i Komunës | Salim Jenuzi | 044 200 998 / 029 281 543 | Salim.Jenuzi@rks-gov.net |
| Zv. Kryetari i Komunës | Shehadin Tërshnjaku | 044 547-568 | shehadin.tershnjaku@ks-gov.net |
| Zv. Kryetar i Komunës për Komunitete | Qasip Kushi | 044 257 482 | qasip.kushi@ks-gov.net |

| DREJTORITË KOMUNALE (si në qershor 2012) | | | |
|--|---------------------------------|----------------------------|--|
| POZITA | EMRI I PLOTË | TEL. | e-mail |
| Drejtoria e Administratës dhe Personelit | Avni Nebiu | 044 203 177 029 281 005 | avni.nebiu@rks-gov.net |
| Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim | Ahmet Batjari | 044 203 334 | ahmet.batjari@ks-gov.net |
| Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike | Tafil Krasniqi | 044 309 071 | tafil.krasniqi@ks-gov.net |
| Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Reshit Qafleshi | 044203501 | reshit.qafleshi@rks-gov.net |
| Drejtoria për Arsim | Hajri Ramadani | 044 410 124 029 281 646 | hajri.ramadani@rks-gov.net |
| Drejtoria për Bujqesi, Turizëm, Inspektim dhe Zhvillim Rural | Bajram Hoxha | 044 494 141 | bairampasa@gmail.com |
| Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit | Bean Haxhiasan | 044 757 770 | beanadziasan@yahoo.com |
| Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Kamber Kamberi | 044 604 965 | kamberkamberi@yahoo.com |
| Zyra për Komunitete | Mehmed Hamza | 044 354 629 029 281 729 | mehmed.hamza@ks-gov.net |
| Zyra për Kthim | Vezaip Kajakush Fitim Spahiu | 044 716 848 044 318 308 | vkajkus@yahoo.com fitim.spahiu@hotmail.com |
| Kryesuesi i Kuvendit Komunal | Lulzim Rifaj Shaban Shabani | 044 354 686 029 281 113 | lulzim_rifaj@hotmail.com shaban.shabani@rks-gov.net |
| Zv. Kryesuesi i Kuv. Komunal | Sherif Aga | 044 913 907 | serifaga@yahoo.com |
| Pika e Kontaktit për Sekretariatit e Kuvendit Komunal | Hazbi Halili | 044 228 861 | azbi_halili@hotmail.com |

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 13: Skema organizative e administratës komunale Dragash

Pozitë për Zyrtar për Energji dhe Efikasitetin e Energjisë ende nuk është krijuar në komunën e Dragashit dhe, për shkak të kufizimeve financiare dhe një kornize të paqartë nacionale, nuk ka të ngjarë të ndodhë së shpejti. Komunitat duhet të planifikojnë për nevojat e furnizimit me energji përmes dokumenteve të tyre të zhvillimit, në harmoni me planet komunale të efikasitetit të energjisë që duhet të krijohen nga Agjencia e Kosovës për Efikasitet të Energjisë. Një person teknik i kontaktit për çështje të energjisë në komunën e Dragashit është caktuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.

Prania e Organeve të Sigurisë

Stacioni policor i Kosovës në Dragash ka 54 oficerë policie, duke përfshirë edhe tetë policë në nën-stacionin policor në Krushevë; 36 janë shqiptarë të Kosovës, 14 janë goranë të Kosovës dhe pesë janë boshnjak të Kosovës, ku një është femër.

KFOR-i Turk siguron prani ushtarake ndërkombëtare.⁸⁴

Drejtësia⁸⁵

Zyra për ndihmë juridike në Dragash është themeluar në dhjetor të vitit 2009 dhe përbëhet nga tre punonjës: dy zyrtarë ligjorë dhe një asistent administrativ. Zyra vepron në përputhje me Rregulloren 2006/36 mbi Ndhimën Ligjore, duke ofruar ndihmë ligjore për të gjithë qytetarët në komunë, pavarësisht përkatësisë etnike, racës dhe gjinisë, në raste civile, penale dhe administrative. Zyra i raporton Komisionit të Zyrës për Koordinim të Ndhimës Ligjore në Prishtinë në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Në vitin 2010 Zyra për ndihmë juridike ka pranuar 169 raste, nga të cilat 88 ishin raste civile, 8 ishin raste penale dhe 73 raste administrative. Kjo përfaqëson 33 gra dhe 136 burra. 125 ishin shqiptarë dhe 44 ishin goranë. Në vitin 2011, janë pranuar gjithsej 190 raste, ku 91 ishin raste civile, 18 raste penale dhe 81 raste administrative. Kjo përfaqëson 29 gra dhe 161 burra. 136 ishin shqiptarë, dhe 54 ishin goranë. Në tremujorin e parë të vitit 2012, janë pranuar 46 raste: 20 raste civile, 9 raste penale dhe 17 raste administrative, që përfaqësojnë 12 gra, 35 burra, nga të cilat 43 ishin shqiptarë dhe 13 ishin goranë.

Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar

"Bashkëpunimi ndër-komunal" (BNK) i referohet dy ose më shumë komunave fqinje që punojnë së bashku për të kryer detyra administrative komunale, ofruar shërbime publike për qytetarët dhe për të nxitur zhvillimin lokal në një mënyrë më efikase dhe efektive se sa përmes veprimit të izoluar.⁸⁶

Komuna e Dragashit nuk ka asnjë marrëveshje ndërkomunale bashkëpunimi me komunat fqinje. Megjithatë, ekziston një marrëveshje dhe projekt në nivelin e Agjencisë Kosovare për Zhvillim Rajonal-Jug, e cila përfshin komunat e Prizrenit, Dragashit, Suharekë, Mamushë, Rahovec dhe Malishevës.

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare

Komuna e Dragashit nuk ka qenë vend ku janë zhvilluar shumë punë aktive nga organizatat joqeveritare. Ka 30 OJQ të regjistruara, por vetëm 16 nga këto janë aktive aktualisht.

⁸⁴ Burimi: Policia e Kosovës, cituar në Profilet Komunale, OSBE 2011

⁸⁵ Raport nga Agim Kamberi, Zyrtar Ligjor, Dragash, maj 2012

⁸⁶ Përkufizimi nga Udhëzuesi i UNDP Guide, burimi: http://www.municipal-cooperation.org/index.php?title=Main_Page. Qasur më 14.06.12

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 8: Listë e OJQ-ve të regjistruara në Dragash

| Emri | Lokacioni | Përfaqësuesi/ja | Hollësitë për kontaktim | Fokusi |
|---|---------------------|----------------------------|---|--|
| Kryqi i Kuq i Kosovës | Dragash | Muamer Rexhepi | 044 310 993 029 281 425 | Shpërndarje e ndihmave humanitare dhe bashkërendim i çështjeve humanitare |
| Handikos | Dragash | | | Përkrahje për personat me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre në shoqëri |
| Flaka | Dragash | Fitim Kurtishi | fitimkurtishi@yahoo.com 044 203 301 | Aktivitete të grave, arsimim |
| Mështekna | Dragash dhe Bresanë | | | Mikro kredi, biznese të vogla dhe bashkërendim i bujqëve dhe prodhuesve të tjerë |
| Memlecet | Dragash (Zlipotok) | Gazmend Tairovci | 044 203 214 | Zhvillim kulturor dhe arsimor |
| Dora e Shpresës | Dragash | Senavere Spahiu | 029 81 876 | Aktivitete të gruas |
| Forumi Rinor i Shkollës së Mesme "Ruzhdi Berisha" | Dragash | Mësimdhënës Selim Kryeziu | selikryeziu@hotmail.com selikryeziu@yahoo.com 044 201 097 | Aktivitete kulturore dhe sportive |
| Organizata e Veteranëve të UCK-së | Dragash | Galip Skeraj | 029 81 113 | Përkrahje për veteranët |
| Sara | Dragash/ (Bresanë) | Dashurije Sahiti | ojq_sara@hotmail.com 044 244 967 | Aktivitete të gruas |
| SHEA | Dragash (Bresanë) | Reshat Reshiti | Shea47@hotmail.com 044 323 533 | Ekologji, arsim |
| NVO Krusevo | | Elvir Ilijazi | nvokrusevo@yahoo.com 044 203 296 | Zhvillim i shoqërisë civile |
| Renesansa | Dragash (Rapçë) | Orhan Tosuni | Renesansa2004@yahoo.com m 044 203 702 | Aktivitete Kulturore, mjedisore, rinore, edukative |
| 'WIB' Bordi për Iniciativa të Grave | Dragash | Gjejrane Lokaj | Xhejrane_55@hotmail.com m 044 327 922 | Aktivitete të gruas |
| Yjet | Dragash (Radeshë) | Eldina Redzhepi | Stars_nvo@yahoo.com 049 199 653 | |
| Alternativa e Ardhshme | Dragash | Albert Spahiu | fitim.spahiu@hotmail.com | |
| QRD (Qendra Rinore e Dragashit) | Dragash | Sead Nuhiu Jeton Qengaj | dragashyc2002@yahoo.com m 045 645 077 044 244 948 | Aktivitete rinore |

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Organizatrat Joqeveritare në vijim janë të regjistruara në komunën e Dragashit, por aktualisht nuk janë aktive.

| Emri | Lokacioni | Përfaqësuesi/ja | Hollësitë për kontaktim | Fokusi |
|------------------------------|---------------------|------------------|---|---|
| Nëna Tereze | Dragash | Fadil Reshiti | 044 201 052 | Shpërndarje e asistencës humanitare |
| Dora e ndihmës | Dragash | Selami Beluli | 044 200 919 | Asistencë Humanitare, Ekologji, mini ferma |
| Vatan | Dragash (Krushevë) | Arif Kuşi | 044 365 390 | Asistencë humanitare, edukim, praktika të avancuara demokratike |
| Guri i Zi | Dragash | Jeton Ramadani | 044 200 920 | Bjeshkatari, Ekologji, Shpellëtari |
| Dragash Ekologji Njerëzore | Dragash | Murselj Haljilji | 044 435 679 | Ekologji |
| Asociacioni Sportistëve | Dragash | Mitat Bojaxhiu | 044 203 695 | Aktivitetet sportive |
| Këshilli i Prind-Mësimdhënës | Dragash | Masar Shabani | masarkpa@hotmail.com | Arsim |
| Orfe | Dragash | Selim Kryeziu | selikryeziu@hotmail.com selikryeziu@yahoo.com 044 201 097 | Kulturë, çështje gjinore |
| Qeni Ilir i Sharrit | Dragash (Kuk) | Serafedin Osmani | 044 604 522 | Kultivim i qenve të Sharrit |
| Biser | Restelicë | Murat Muska | Korap_1@hotmail.com 044 498 568 | Kulturë |
| Lepota Sara | Dragash (Restelice) | Nail Muska | 044 845 986 | Mjedis, agrikulturë, blegtori |
| Koritnik | Kërstec | Rasmin Hamza | Nvo.koritnik@gmail.com 044 466 875 | Ekologji, edukim rinor, mjedis |
| Flores | Dragash | Arafat Bajrami | 044 760 782 | Mjedis |
| Qarku Rinor | Dragash (Radeshë) | Turkes Dalifi | 044 573 954 | |
| Natyra-Dragash | Dragash | Azi Rifaj | 044 203 800 | Mbrojtje e biodiversitetit |

3.1.6 Sfondi kulturor dhe historik

Thuhet se vendbanimi në Dragash daton nga kohët e lashta, ngjashëm si në vende të tjera në rajonin e Prizrenit, ku janë gjetur dëshmi banimi të kohës së neolitit dhe të hekurit, si dhe të dhëna të rëndësishme nga periudha Romake dhe Otomane. Si një zonë e lartë malore rurale, kushtet topografike dhe klimatike kanë pasur një ndikim të madh në qasshmërinë e cila ka qenë e rëndësishme për historinë sociale-kulturore të zonës dhe zhvillimin e saj.

Gjatë sundimit Osman nga 1445-1912, zona e komunës së Dragashit ishte pjesë formuese e Sanxhakut dhe, më vonë, e Vilajetit të Prizrenit (1871), një qark i gjerë administrativ që përfshinte hapësira në IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Serbinë e sotme dhe përfshinte pjesën më të madhe të hapësirës që sot është Kosovë. Duke e përfshirë Elbasanin, Gucinë, Pejën, Tetovën, Dibërën, Gostivarin

dhe Nishin, ky territor u bë i njohur si Vilajeti i Kosovës në vitin 1877. Prizreni ishte i njohur për lidhjet tregtare të fuqishme, si udhëkryq si për rrugët ushtarake dhe komerciale. Prandaj, ishte një qendër shumë e rëndësishme me të cilën komunitetet në zonën e Dragashit kanë pasur lidhje të forta, siç kanë edhe sot.

Fjala 'Gora' do të thotë 'mal/bjeshkë' në gjuhët sllave. Prandaj njerëzit goranë janë 'bjeshkatarët'. Gjuha e folur nga goranët ('Našinski', afërsisht përkthyer si 'E jona') është një përzierje e gjuhës maqedonase, serbe, boshnjake dhe turke. Në aspektin gjuhësor, gjuhët sllave zakonisht janë folur nëpër rajonin e malit Sharr, ku udhëtarët e shekullit të nëntëmbëdhjetë kanë raportuar për 'maqedonishten' dhe 'bullgarishten' e hasur përgjatë territorit. Meqë komunitetet në Dragash kanë qenë të lidhura gjatë me ato në IRJ të Maqedonisë përmes maleve gjatë migrimit blegtoral dhe shtigjeve bujqësore, Dragashi ka formuar një urë në mes komuniteteve shqiptare dhe sllave përtej kufijve bashkëkohor nacionalë. Një mendim i mbështetur gjerësisht është se goranët vijnë nga popujt sllav ortodoks me origjinë nga Bullgaria, të cilët në shekullin e 13 kaluan përmes Dragashit në rrugën e tyre drejt asaj që sot quhet Bosnjë dhe Hercegovinë, gjë që mbështet observimet e mëvonshme gjuhësore. Gjatë periudhës Osmane popullsia u konvertua në Islam, ku grupet e goranëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve në Dragash kishin të njëjtin besim - faktor që është shkak për integrimin e fortë ndërkomunitar dhe tolerancë.

Pasuri thelbësore e Dragashit është se ai gërsheton trashëgiminë e tij të traditave kulturore dhe të veçorive natyrore ngushtësisht në një tregim të vazhdueshëm. Ai përshkruan kulturat rurale malore dhe mënyrat e jetesës që i janë përgjigjur dhe zhvilluar në këtë peizazh të largët malor gjatë shekujve dhe krijojnë një ndjenjë autentike të vendit përmes gjurmëve, shtigjeve, ndërtesave dhe modeleve bujqësore, rriteve, festivaleve dhe traditave.

3.1.7 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese

Pozita e Dragashit është mu në jug, lart në male që do të thotë se konsiderohet si një "rrugë qorre".

- Si mund të tejkalohet largësia gjeografike?
- Cilat lidhje të reja mund të krijohen and cilat lidhje ekzistuese duhet të focohen?

Topografia dhe klima në Dragash shkaktojnë dimra të fortë me të reshura të mëdha të dëborës.

- Si mundet Komuna të sigurojë qasje të sigurt për fshatrat?
- Cilat kushte mund të përmirësohen për të siguruar jetesë të mirë edhe gjatë dimrit?

Popullsia e Dragashit është mjaft e re dhe aktive për punë; por në anën tjetër shkalla e papunësisë është mjaft e lartë.

- Si mundet Komuna të krijojë mundësi të mira të jetesës për të rinjtë?
- Si mundet të krijohen punë dhe të hyra për të rinjtë për të evituar humbjen e gjeneratave të reja nëpërmjet emigrimit?

Emancipimi i femrës dhe pjesëmarrja në ekonomi dhe në proceset e vendimmarrjes nuk është e barabartë me meshkujt.

- Si mundet Komuna t'i mbështesë gratë?

Administratorët komunalë duhet të ballafaqohen me disa çështje me qëllim të veprimit si lidhje ndërmjet nivelit qendror (ministritë) dhe nivelit komunal (fshatrat).

- Si mundet PZhK të kontribuojë në përmirësimin e proceseve administrative?

Dragashi është një komunë ku janë të përziera komuniteti dhe tradita sllave dhe shqiptare.

- Si mundet kultura dhe tradita e posaçme e Dragashit të ruhen?
- Si mundet Dragashi të përfitojë nga e kaluara e saj kulturore dhe historike?
- Si mundet në mënyrë të barabartë të sigurohet nëpër tërë Komunën dhe në çdo hapësirë?

3.2 VENDBANIMET

3.2.1 Fondi i njësive banesore dhe kushtet e jetesës

Niveli shumë i ulët i sipërfaqeve artificiale⁸⁷ (rrugëve, vendbanime etj) - 1.21% e sipërfaqes së territorit - tregon se Dragashi është një zonë shumë rurale e cila nuk i nënshtrohet zhvillimit të rëndësishëm urban. Kjo është veçanërisht e vërtetë në jug të komunës, ku gjeografia malore kufizon zonat e arritshme dhe ku mund të ndërtohet, duke çuar në grupe të ngushta të shtëpive dhe shtigjeve në fshatra. Qasja në infrastrukturën bazë gjithashtu e kufizon se ku mund të ketë ndërtimi, edhe pse ka tendencë të një niveli më të lartë të vetë ndërtimit apo me vetë-financimit në këtë drejtim që mundëson shtrirjen e shërbimeve në shtëpitë e reja në mënyrë ad-hoc. Më shumë urbanizim dhe rritje është vërejtur në pjesën veriore të komunës, sidomos rreth qytetit të Dragashit dhe përgjatë rrugës kryesore drejt Prizrenit, ku gjithashtu mund të vërehet shtrirje përgjatë rrugës kryesore dhe ndërlidhje e vendbanimeve kryesore, në hap me trendët urbane si në pjesën tjetër të vendit. Kjo zonë, që përbën gati 9 për qind të territorit, është dukshëm më e rrafshët. Përafërsisht 36% e peizazhit është pak apo mesatarisht i pjerrët dhe është i lidhur me këto zona të rrafshëta.

Shtëpitë tradicionale në zonat rurale si Dragashi janë ndërtuar me gurë për katin e parë apo për ngritjen e bazamentit, me kornizë të drurit mbushur me tulla qerpiçi në nivelet më të larta, deri në dy kate. Për shkak të vështirësive në mirëmbajtjen e strukturave prej qerpiçi, shumë prej këtyre objekteve janë në gjendje shumë të dobët dhe kryesisht të braktisura, pabanuara, apo janë konvertuar në objekte magazinimi. Përdorimi i gurit për ndërtimin e shtëpive në 2-4 kate ka vazhduar edhe në shekullin e 20-të. Një numër i madh i këtyre ndërtesave ekzistojnë ende dhe vazhdojnë të jenë të banuara, duke iu nënshtruar rinovimeve dhe përmirësimeve nga banorët. Trendët aktuale të ndërtimit përdorin materiale më të lira, të gatshme në dispozicion dhe teknikave të shpejta të ndërtimit si korniza betoni mbushur me beton të (ajruar) vibruar/blloqe terakote. Kjo ka mundësuar rritje në madhësi dhe shkallë të njësisë së banimit.

Ashtu si shumica e zonave në Kosovë, Dragashi përmban një numër të madh të shtëpive të ndërtuara rishtazi, ndonëse ka edhe një numër të madh të ndërtesave të vjetra. Sipas regjistrimit të vitit 2011, rreth 38% të banesave në Dragash janë të pabanuara. Megjithatë, ka të ngjarë që shumica e tyre janë të banuara gjatë muajve të verës kur kthehet diaspora. Këto shtëpi të banueshme, por të pabanuara, përbëjnë një kapital dhe fond të rëndësishëm pasiv për akomodim potencial turistik.⁸⁸

⁸⁷ Termi "sipërfaqe artificiale" shfrytëzohet në nomenklaturën CORINE mbi Sipërfaqen e Tokës dhe i referohet zonës së shtëpive, zonës industriale, komerciale dhe të njësive të transportit, rrugëve dhe rrjeteve të hekurudhës, deponive dhe minierave, por gjithashtu edhe zonave të gjelbërta urbane" – kjo kryesisht nënkupton sipërfaqe ndërtimore

⁸⁸ Nga Drafti i UN-Habitat për PZhK, shtator 2010


Shfrytëzimi i energjisë nga shtëpitë⁸⁹

Një pyetësorë është përdorur si vegël për të grumbulluar të dhëna nga banorët, në 200 shtëpi dhe mbi shtatë vendbanime. Rezultatet janë të përmbledhura në dokumentin “Bazat e Energjisë për Komunën e Dragashit”.

Vlerësimet e të intervistuarve për kushtet e tyre të jetesës, në krahasim me shtëpitë tjera, tregoi se 70% mendonin se kushtet e tyre të jetesës ishin të kënaqshme, ku grupi i dytë më i madh (18.5%) e konsiderojnë gjendjen e tyre mirë, dhe 3.5% i konsiderojnë kushtet e tyre jetësore si shumë të mira. 8% e të intervistuarve mendonin se kushtet e jetesës ishin të këqija ose shumë të këqija. Qëllimi i këtij anketimi ishte që të vlerësohej nëse masat e efikasitetit të energjisë mund të integroheshin brenda shtëpive dhe nëse mungesa e mjeteve financiare apo e informacionit do të ishte problem i hasur gjatë këtij veprimi.

Të dhëna mbi amvisnitë

- Sipërfaqja mesatare e një shtëpie: $S = 136.5m^2$
- Mesatarja vjetore e shpenzimit të energjisë elektrike për një shtëpi: 330.44 €
- Vetëm 1% e shtëpive kanë sistem qendror të ngrohjes të instaluar për ngrohje.
- Sipërfaqja mesatare që ngrohet në shtëpi: $35.4m^2$
- Numri mesatar i dhomave të ngrohura për shtëpi: 2
- Druri është burimi më i rëndomtë i energjisë për shtëpitë.
- Në përgjithësi, në Komunën e Dragashit ndërprerjet e energjisë elektrike janë të shkurta.
- Problemi kryesor i përballur është cilësia e furnizimit me energji elektrike meqë është me tension (voltazh) të ulët.



Grafiku 14: Burimi i energjisë për ngrohje të hapësirës sipas përdorimit në përqindje

Të dhëna mbi burimet e energjisë

- Mesatarja vjetore e vëllimit të druve të shpenzuar për shtëpi: $8.89m^3$
- Mesatarja vjetore e vëllimit të bajgave të shpenzuar për shtëpi: $6.28m^3$

⁸⁹ “Bazat e Energjisë për Komunën e Dragashit”, Naumann, E.; Pireci, M, 2011

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

- Shumica (64%) e druve për zjarr blihet në treg; 22% e drurit për zjarr pritet nga banorët në pyjet publike; 14% e drurit për zjarr prehet nga pyjet private.
- Burimi kryesor për ngrohjen e ujit është energjia elektrike (77%). Një numër familjesh përdorin energjinë elektrike në kombinim me burime tjera të energjisë, si p.sh. gasi apo dru zjarri.

| | |
|--|------------------------|
| Çmimi mesatar final i drurit për zjarr, i blerë në treg | 40.39 €/m ³ |
| Çmimi mesatar i drurit për zjarr i prerë në pyje publike | 19.16 €/m ³ |


Tabela 6: Çmimi i drurit për zjarr sipas burimit

Masat për efikasitet në përdorimin e energjisë nëpër shtëpi

- Vetëm 12% e shtëpive kanë mure të izoluar nga jashtë; 18% kanë mure të suvatuara nga jashtë; 70% e shtëpive nuk kanë fare izolim termik.
- 28% e shtëpive kanë kulme të izoluar.
- 80% e shtëpive kanë dritare me xhama të dyfishtë.


Konsumi i energjisë

Shtëpitë përfaqësojnë konsumatorët më të mëdhënjë të energjisë elektrike në Komunën e Dragashit, kryesisht për shkak të faktit që ka relativisht pak ndërmarrje komerciale apo industriale të vendosura në lokacion.



Grafiku 15: Energjia e faturuar për sektorë të ndryshëm për vitin 2010 (%)

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Grafiku 16: Energjia elektrike e faturuar në fshatra të Komunës Dragash (2010)

3.2.2 Krahasimi i fshatrave⁹⁰

Popullsitë

Sipas Regjistrimit të popullsisë të Kosovës 2011, ekzistojnë 12 vendbanime nga 36 vendbanimet e Kosovës që kanë mbi 1000 banorë të përhershëm. Fshatrat më të populluara janë Restelica, Bresana, dhe Brezna me mbi 1900 banorë; Restelica është shumë më e madhe me 1,5 herë më shumë se numri i banorëve të fshatit tjetër më të madh, Bresana dhe mbi 4 herë sesa popullata e qendrës komunale, Dragashi. Mesatarisht 40% e popullsisë totale të komunës jetojnë në vendbanimet e Gorës dhe 60% jetojnë në Opojë që duket se është konform me të dhënat demografike sipas etnisë.

Dendësia e popullsisë në Komunën e Dragashit është rreth 78 banorë për km².⁹¹ Në përgjithësi, vendbanimet ndodhen mbi 1000m lartësi mbidetare, me një dendësi prej 9 vendbanimeve për 100km². Megjithatë, ka dallime të konsiderueshme në dendësi nëpër komunë.

⁹⁰ Nga Punëtorja e Vizionit, Afishet Karakterizuese të Fshatit, DB Fshati Dragash, Rezultatet e anketimit të fshatit

⁹¹ Sipas shifrave të popullsisë për 2008.

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

Tabela 7: Numri dhe dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve - 2008 [renditur sipas dendësisë më të ulët e tutje]⁹²

| ID i fshatit | Vendbanimi | Nr. i banorëve 2011 | Sipërfaqja km ² | Dendësia | ID i fshatit | Vendbanimi | Nr. i banorëve 2011 | Sipërfaqja km ² | Dendësia |
|--------------|---------------------------|---------------------|----------------------------|----------|--------------|------------|---------------------|----------------------------|----------|
| 22 | Mlikë | 92 | 9.44 | 9.7 | 18 | Kuklibeg | 852 | 8.27 | 103.0 |
| 23 | Orçushë | 60 | 4.41 | 13.6 | 30 | Shajne | 1069 | 9.57 | 111.7 |
| 1 | Baçkë | 52 | 3.74 | 13.9 | 7 | Brrut | 1164 | 8.42 | 138.2 |
| 10 | Dikanc | 124 | 6.04 | 20.5 | 14 | Kosavë | 905 | 6.54 | 138.4 |
| 35 | Zlipotok | 610 | 27.07 | 22.5 | 8 | Buçe | 645 | 4.58 | 140.8 |
| 19 | Kukulanë | 235 | 9.65 | 24.4 | 13 | Kapre | 452 | 3.19 | 141.7 |
| 6 | Brod | 1544 | 48.14 | 32.1 | 25 | Pllavë | 1000 | 6.78 | 147.5 |
| 15 | Kërstec | 420 | 13.03 | 32.2 | 3 | Blaç | 1455 | 9.68 | 150.3 |
| 12 | Gllloboçicë | 960 | 23.37 | 41.1 | 20 | Leshtan | 783 | 5.03 | 155.7 |
| 27 | Rapçë | 853 | 20.56 | 41.5 | 29 | Rrenc | 581 | 3.5 | 166.0 |
| 31 | Vranisht | 352 | 7.77 | 45.3 | 4 | Bresanë | 2839 | 14.34 | 198.0 |
| 16 | Krushevë | 857 | 18.91 | 45.3 | 34 | Zgatar | 885 | 4.26 | 207.7 |
| 28 | Restelicë | 4698 | 84.7 | 55.5 | 36 | Zym | 585 | 2.73 | 214.3 |
| 32 | Xërxe | 236 | 3.54 | 66.7 | 2 | Bellobrad | 948 | 4.36 | 217.4 |
| 24 | Pllajnik | 405 | 5.96 | 68.0 | 5 | Brezne | 1990 | 9.12 | 218.2 |
| 26 | Radeshë | 1224 | 15.3 | 80.0 | 17 | Kuk | 1658 | 6.62 | 250.5 |
| 21 | Lubovishtë | 773 | 8.35 | 92.6 | 9 | Buzez | 320 | 1.27 | 252.0 |
| 33 | Zaplluxhe | 1273 | 13.14 | 96.9 | 11 | Dragash | 1098 | 3.6 | 305.0 |
| | Komuna e Dragashit | 33997 | 434.98 | 78.2 | | | | | |

Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Dragashit, ku jetojnë mesatarisht rreth 305 banorë për km², edhe pse zona e tij kadastrale është gjithashtu e gjashta më e vogla. Dendësia dhe distanca mesatare ndërmjet vendbanimeve nëpër komunë tregojnë se rajoni i Opojës dendësinë e banorëve e ka gati tre herë më të madhe se rajoni i Gorës, me largësi ndërmjet vendbanimeve afërsisht 1.6 herë më të shkurtra.⁹³

Tabela 8: Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve të komunës⁹⁴

| Rajoni | Mesatarja T (dendësia) | Mesatarja D (distanca) |
|--------|------------------------|------------------------|
| Opoja | 167 | 2.57 |
| Gora | 61 | 4.32 |

Trembëdhjetë vendbanimet më pak të dendura janë të gjitha të vendosura në Gorë, nga totali i 16 vendbanimeve në rajonin qendror dhe jugor në përgjithësi. Zonat e sipërfaqeve të mëdha të territoreve

⁹² Analiza e dendësisë së popullsisë bazohet në parashikimet e popullsisë për 2008. Sic ishte në qershor 2012, Regjistrimi i vitit 2011 aktualisht nuk ka informacione mbi popullsinë në fshatra individuale. Ka mundësi që dendësia e tanishme të jetë më e ultë se ajo e paraqitur këtu. Raporti i UNDP-së për Projektionet e Popullsisë për Dragash, Gollopeni, B., qershor 2012.

⁹³ Raporti i UNDP-së për Projektionet e Popullsisë për Dragash, Gollopeni, B., qershor 2012.

⁹⁴ Meleqi, H. Analizë e historisë dhe gjeografisë komplekse të Opojës, Prishtinë, 2009.

të vendbanimeve përkatëse mund të kenë parasysh këtë, posaçërisht në zonat malore, dhe mban pak lidhje me popullsinë e përhershme. Restelica, për shembull, ka numrin më të madh të banorëve në komunë por gjithashtu edhe zonën më të madhe territoriale; zona kryesore urbane ku paraqiten shumica e vendbanimeve njerëzore, sidoqoftë, është mjaft e dendur derisa pjesa tjetër e territorit është e pa banuar.

Ka dallime të mëdha në madhësinë e popullsisë në vendbanime të ndryshme gjatë gjithë vitit; siç është përmendë më herët, ka gjasa se popullsia është rreth një të tretën më e madhe gjatë verës sesa gjatë dimrit.⁹⁵ Prandaj, edhe fshatrat që duken të braktisura kryesisht gjatë tërë vitit bëhen vende shumë aktivë në verë. Regjistrimi i Kosovës i 2011 tregoi se 37.5% e vendbanimeve në Dragash janë të pabanuara, nga të cilat rreth 12% shërbejnë për t'i shfrytëzuar si banesa të përkohëshme gjatë pushimeve dhe punës sezonale⁹⁶.

Klasifikimi i vendbanimeve

Të dhënat e popullsisë nga Regjistrimi i Kosovës 2011 janë përdorur në klasifikimin vijues të vendbanimeve. Të gjitha të dhënat aktuale të popullsisë në përshkrimin e mëposhtëm të vendbanimeve, përfshirë edhe ndarjet fshat më fshat për arsim dhe banesa tradicionale, janë marrë nga Regjistrimi i Kosovës 2011 zyrtar.

Vendbanime Parësore: popullsia mbi 1700 banorë

Vendbanime Dytësore: popullsia në mes 800 dhe 1700 banorë

Vendbanime Tretësore: popullsia nën 800 banorë

Veç kësaj, disa vendbanime terciare klasifikohen gjithashtu edhe si **Fshatra të Largëta**, kjo për shkak se vazhdimisht ka rënie të numrit të popullsisë dhe ndodhen në vende jashtëzakonisht të largëta.

Vendbanimet parësore

Tre vendbanimet që konsiderohen si qendra kryesore janë Brezne, Restelica dhe Bresana. Përveç Breznes, ato ofrojnë një numër të madh të lehtësirash/shërbimesh, mes 53 dhe 71 dyqane, në krahasim me Vendbanimet Dytësore, të cilat kanë shumë më pak shërbime (me 1 deri 14 dyqane).⁹⁷ Më e ulët se mesatarja për vendbanimet tjera në komunë (39%), rreth 30% e banesave tradicionale të vendbanimeve parësore të Dragashit janë të pabanuara apo të zbrazëta. Kjo sugjeron se emigrimi nga këto vendbanime gjithashtu ka gjasa të jetë më i ultë dhe se dallimi ndërmjet popullatës së verës dhe të dimrit krahasimisht është më stabile (edhe pse ende është signifikante).

Bresanë

Është nën-qendër biznesi, me gjithsej 89 biznese që punësojnë 33 punonjës përveç pronarëve të biznesit. Është gjithashtu qendër e tregut pastoral bujqësor, me aranzhim piktoresk dhe qasje në zonat e egra. Vendbanimi është shumë mirë i lidhur me fshatrat përreth, gjë për të cilën ka rol të qendrës (duke

⁹⁵ Raport i UNDP-së për Projektionet e Popullsisë për Dragash, Gollopeni, B., qershor 2012.

⁹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Amvisive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të dhënat Kryesore*, ndarja e marrë nga fshatrat.

⁹⁷ Baza e të dhënave e UNDP-së për Biznese

pasur parasysh objektet dhe shërbimet siç janë dyqanet, shollat, objektet shëndetësore dhe xhamitë) dhe me rrugët kryesore nga komuna për në Prizren (nëpër Zaplluxhe apo nëpër Buzez dhe Pllavë). Bresana gjithashtu ka një karakter të fuqishëm trashëgimor dhe është lokacion i një numri festivalesh, prandaj dhe mund të shërbejë si bazë turistike në të ardhmen. Popullsia e saj ka shfaqur ngritje të qëndrueshme që nga viti 1021, edhe pse popullsia e saj aktuale e banorëve të përhershëm (2839) është vetëm pak më e lartë se që ishte në vitin 1981. Aktualisht, ajo ka një rën prej popullsisë më të mëdha në komunë. Në krahasim me pjesën tjetër të vendeve në komunë, më pak se 50% e popullsisë punon jashtë komunës dhe një pjesë e madhe e banorëve jeton vetëm nga shërbimet e ofruara lokalisht. Infrastruktura (uji, kanalizimi, rrugët) konsiderohet e mirë dhe ka rrjete të mira të komunitikimit (telefoni mobile, internet, telefoni fike). Shumica e territorit (61%) është e mbuluar nga pyjet dhe zona gjysmë-natyrore, të përshtatshme për kullotjen e një numri të madh të bagëtisë (lopë, dele) dhe ushqim të shpendëve që kultivohen në këtë territor, ndërsa 33% e territorit është tokë bujqësore.



Fotografia 17: Fotografi nga ajri e Bresanës

Bresana është një vendbanim i konsiderueshëm me përhapje përgjatë rrugëve kryesore dhe e mbushur për të krijuar një vendbanim mjaft të dendur. Zhvillimi kufizohet në skajet e veriut dhe verilindjes nga pyjet dhe topografia. Ndërtimi apo rrugët e ndërtuara duket se ndjekin shtigjet bujqësore (sidomos në lindje), duke u zgjeruar ashtu siç zgjerohen vendbanimet. Ka një mori ndërtesash tradicionale në pjesën lindore të vendbanimit, me interes për trashëgiminë kulturore. Në Bresanë, 36% e banesave tradicionale janë të pabanuara. 7% përdoren herë pas here gjatë pushimeve dhe punës sezonale. Të tjerat 29% klasifikohen si të “zbrazëta”. Një model mjaft i zakonshëm i shtrirjes urbane është vërejtur përgjatë akseve rrugore kryesore në dalje të fshatit në drejtim të Zgatarit, Kukit, Buzezit dhe Blaçit. Ka afërsi dhe rritje edhe drejt Kuklibegut dhe në të ardhmen inkorporim, lidhje ose formim potencial i “periferive” me mundësi të zgjerimit të pëртејmë, deri në Kuk. Modelet e fushave të kultivuara janë gjithashtu një tipar i terrenit natyror.

Restelica

Është vendbanimi më jugor i Komunës së Dragashit, dhe zona kadastrale e dyta më e madhe. Largësia e tij prej Dragashit dhe qendrave tjera në Kosovë, megjithatë, nuk e kanë penguar atë të zhvillohet në një qendër kryesore dhe nën-qendër biznesi, me fokus produktet natyrore dhe kultivimin (qumështi/djathi, fruta të egra, bletari/ mjaltë dhe barishte). Si qendër e kulturës gorane, Restelica ka potencial të madh turistik, sidomos lidhur me turizmin e natyrës në malet dhe luginat e lumenjve. Karakteristika të tjera që mund të ngjallin interesim të mundshëm janë qentë e Sharrit, zejtaria, festivalet dhe ritualet e dasmave që e karakterizojnë apo ndërlidhen me këtë rajon.

Restelica ka popullsinë më të madhe të përhershme në komunë, dhe i cili është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 1921. Gjithashtu është shënuar të ketë popullsi më stabile ndërmjet verës dhe dimrit. Ka varësi të ulët nga burimet lokale (10%) dhe shërbimet lokale (15%) edhe pse kjo shifër është mesatare në krahasim me pjesën tjetër të fshatrave të Dragashit. Gjithashtu, gratë kontribuojë me përqindje relativisht të lartë në të ardhurat familjare. Megjithatë, në krahasim me madhësinë dhe vendndodhjen e saj, ka shërbime të kufizuara: nuk ka qendër shëndetësore, zyra postare, banka (ose shërbimi bankar mobil), stacion policor, shkollë të mesme, farmaci, hotel, linja fikse apo stacion karburanti. Infrastruktura themelore është gjithashtu problematike. 25% e dyqaneve janë bare (kafene) dhe restorante në vend të ndërmarrjeve produktive. Megjithatë, ka një prodhim shumë të lartë të qumështit të deleve dhe lopës, vezëve. Megjithatë, ka më pak mbledhje të bimëve ose bujqësi ndoshta edhe për shkak të terrenit më të rrëpirë dhe lartësisë më të madhe.

Restelica është vendbanim i madhësisë të konsiderueshme që është zhvilluar me shpejtësi. Në proporcion me popullsinë e vet, ka numrin më të madh të banesave tradicionale në komunë; sidoqoftë, rreth 36% të këtyre janë të pabanuara (9% shfrytëzohen për qëllime të pushimit). Vendbanimi është shumë i izoluar, por në të njëjtën kohë është portë apo hyrje për të arritur në vargun malor që shpie në IRJ të Maqedonisë dhe në Parkun Nacional të Mavrovës në jug. Ka dy pjesë të hapura në vendbanim; në veri dhe jug të vijës së luginës. Pjesa veriore ka një rrjet të rrugëve gjarpëruese dhe një model të dendur urban që formon karakterin historik. Në dekadën e fundit, Restelica është zgjeruar gati dyfishin e madhësisë së saj të mëparshme. Hapja apo shtrirja vërehet në veriu dhe lindje të vendbanimit, me rrugë të reja që janë krijuar nga zgjatjet në drejtim të zonave të banuara. Zhvillime të reja gjithashtu vërehen në jug të vijës së luginës përgjatë rrugës kryesore në drejtim të jugut. Për dallim nga vendet tjera, nuk vërehet ndërtime të shtëpive që ndjekin vijën rrugore kryesore. Relievi i ngushtë e ka kufizuar zhvillimin, kështu që duket se kanë filluar të krijohen grupe të dendura të gjysmë-vendbanime nëpër luginë. Fatkeqësisht, zhvillimi i shpejtë dhe jo i koordinuar i vendbanimit ka shkaktuar disa probleme. Gjatë këtij zgjerimi nuk janë ndërtuar rrjete adekuate rrugore e as infrastruktura publike. Shtëpitë janë ndërtuar shumë afër rrugës së vetme dhe shumë të ngushtë, duke e bërë qarkullimin në dy drejtime të pamundur. Ka raste kur qarkullimi në trafik ndalet plotësisht kur ka më shumë automjete në rrugë. Automjetet e shpëtimit apo të zjarrfikësit nuk do të mund të arrijnë aty në rast të ndonjë emergjence. Gjithashtu, ka rrezik të lartë nga ortekët e borës apo rrëshqitja e tokës/gurëve në këtë terren të thepisur. Zgjerimi i vendbanimit në zonat e rrezikuara sjell rreziqe që nuk mund të mënjanohen.



Fotografia 18: Fotografi nga ajri e Restelicës

Brezne

Ky vendbanim gjendet në rëzë të Malit Koritnik, ku lugina e gjërë hapet në drejtim të veriut. Në shpat jeton një vendbanim me dendësi të popullsisë të konsiderueshme, por ka edhe zgjerim në drejtim të luginës. Vendbanimi aktualisht përfshin një numër vendbanimesh më të vogla, me lagje të mëdha, të mesme dhe të vogla. Në lindje, në drejtim të rrugë Prizren-Dragash, ekzitojnë vende më të mëdha anash rrugës së gjerë dhe të shtruar. Kjo rrugë gjithashtu kalon edhe nëpër pjesën e vjetër të fshatit. Ka disa shitore dhe kafiteri përkrah rrugës. Në dalje të rrugës kryesore brenda fshatit shtrihet një rrjet i rrugëve shumë të pjerrta dhe shtigjeve bujqësore.

Popullsia ngadalë është rritur gjatë kohës (përkundër të dhënave anormale të larta për 2008 dhe 2010), edhe pse popullsia aktuale (1.990) është shumë afër nivelit të popullsisë në vitin 1981. Për dallim nga shumë vendbanie tjera në Dragash, Brezna shenon një nivel të lartë të banimit të përhershëm të shtëpive të saja tradicionale. Vetëm 18% e ndërtesave janë të lira (krahasuar me mesataren e komunës prej 39%), nga e cila rreth 54% janë për shfrytëzim gjatë pushimeve apo punës sezonale.

Brezne identifikohet si vend me potencial kyç turistik, për shkak të afërsisë së tij me liqenin Brezne që nga rëndësia është liqeni i vetëm në komunë dhe i cili mund të qaset nga rruga kryesore rajonale Prizren-Dragash krahas shtigjeve bujqësore të cilësisë së ultë. Disa elemente infrastrukturore, gjegjësisht shkallë dhe pjesë të shtruara me gurë, janë ndërtuar buzë liqenit për qëllime turistike por nuk mirëmbahen dhe ka problem me mbeturinat. Gërmime janë parë afër kthesës për t'iu qasur liqenit nga rruga rajonale dhe duket se një rrugë tjetër është duke u ndërtuar për në liqen nga ky lokacion. Krahasuar me shumicën e komunës, vendbanimi është në lartësi më të ulët mbidetare (900 -1570m), ndonëse vargu brenda vet territorit të vendbanimit është i rëndësishëm.

Megjithëse është vendbanim primar, ka numër më të vogël të shitoreve, shërbimeve dhe bizneseve të regjistruara se sa pritet të kishte, (me rreth 22 të tilla), edhe pse, kjo e bënë Breznën qendër mesatare biznesi. Nga këto ndërmarrje, shtatë janë punëdhënës, me nga një deri në pesë punonjës. Ka kultivim mesatar të bagëtisë (dele dhe lopë), me prodhim mjaft të lartë të qumshit në komunë, ndonëse nuk ka pikë grumbullimi. Megjithatë, mbikullotja është një problem i veçantë. Si në shumicën e vendbanimeve, kultivimi individual dhe privat i bimëve, frutave dhe perimeve është një tipar i dalluar. Pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga pyjet dhe zonat gjysëm-natyrore (484ha) me numër gati të njëjtë të hapësirave bujqësore (382ha). Anketat e fshatrave japin vlerësim të mirë të drurit për zjarr, e ndonëse nuk ka ndonjë biznes të prerjes së druve të regjistruar në vendbanim, është e qartë se pylltaria luan një rol domethënës në aktivitetet e vendbanimit.

Ka shërbime të kufizuara shëndetësore, me vetëm një klinikë. Megjithatë, krahasuar me shumë vendbanime tjera, ka lidhje të lehta rrugore si me Prizrenin ashtu dhe me Dragashin që siguron një sërë mundësishë për shërbime. Fshati raporton të ketë infrastrukturë të dobët, me probleme të ujit dhe kanalizimit, si dhe me shumë zjarre dhe rrezik nga vërshimet.



Fotografia 19: Fotografi nga ajri i Breznës/Brezna

Vendbanimet dytësore

16 nga 36 vendbanimet e Komunës së Dragashit klasifikohen si Vendbanime dytësore, me popullsi mes 800 dhe 1700 banorë. Përveç qytetit të Dragashit, këto janë Bellobradi, Blaçi, Brruti, Kosava, Kuki, Kuklibegi, Pllava, Shajnja, Zaplluxhja dhe Zgatari në Opojë dhe Brodi, Glloboçica, Krusheva, Radesha dhe Rapça në Gorë.

Shumë nga këto fshatra gjithashtu përbëhen nga një numër vendbanimesh më të vogla, të shpërndara, apo grupimeve të lagjeve të shoqëruara me zhvillim të ulët të dendësisë përgjatë rrugës. Ato karakterizohen me qasje të moderuar në infrastrukturë dhe komunikim, posaçërisht në lidhjet e tyre me rrugët kryesore për në qytet të Dragashit dhe në Prizren. Mesatarisht, rreth një e treta e shtëpive tradicionale në këto vendbanime dytësore janë të lira apo të zbrazëta; në përgjithësi kjo është pak më e ulët sesa mesatarja e komunës (edhe pse më e lartë se shkalla e nxënies në vendbanimet parësore) por Projekti i UNDP: Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës në Dragash

akoma nënkupton se ka gjasa të jetë një dallim signifikant ndërmjet popullsisë së verës dhe të dimrit në këto vendbanime.

Disa nga fshatrat janë të rëndësishme për karakterin e tyre rural dhe qasjen për mundësi të mira për shëtitje malore, peizazhe piktoreske dhe vecori natyrore, prandaj, ato kanë potencial të mirë për turizëm. Disa janë me interes përkitazi me trashëgiminë kulturore: për festivale, rite dhe tradita, si dhe ndërtesa tradicionale dhe monumente. Veçoritë e trashëgimisë kulturore shtjellohen në hollësi në Pjesën 8 të Profilit.

Qyteti i Dragashit është qendra kryesore administrative dhe komerciale e Komunës së Dragashit/Dragas, si dhe qyteti me tregun kryesor. Ka 229 biznese që punësojnë 533 njerëz (përveç pronarëve). Prandaj, ai luan rolin më të rëndësishëm për punësim në komunë, nëpërmjet administratës lokale, sigurim të shërbimeve (shkollat, kujdesi shëndetësor, bankat, shërbimi postar, etj.) dhe nëpërmjet një numri të madh të kafeneve, bareve dhe restoranteve, ndonëse nuk ka objekte turistike. Brenda zonës së tij kadastrale nuk ka vendbanime të vogla. Ai është zona kadastrale gjashtë më e vogël në kuptim të sipërfaqes së tokës.

Sikurse me shumicën e vendbanimeve të mëdha në komunë, popullsia e përhershme për vitin 2011 është shumë e afërt me atë të vitit 1981. Në qytetin e Dragashit ekziston një numër jashtëzakonisht i lartë i shtëpive tradicionale që janë të pabanuara apo të zbrazëta: 52% krahasuar me mesataren e komunës prej 39%. Vetëm gjashtë fshatra të tjera në tërë komunën kanë një numër më të lartë të banesave të lira, pjesa me e madhe e të cilave klasifikohen si fshatra të largëta dhe kanë përjetuar një shpopullzim të madh. Nga një popullsi prej 1098 banorë të përhershëm në qytetin e Dragashit, rreth një e katërta janë të moshës 6-19 vjeç, nga të cilët 84% gjenden në një formë të shkollimit. Të gjithë fëmijët e moshës 6-15 vjeç vijnë arsimin e obligueshëm, me një shkallë të vijimit nga më të lartit (82%) të shkollës së lartë të mesme në komunë, me gjasë për shkak të qasjes së lehtë pasi që shkolla e mesme gjendet në qytet. Për dallim nga vendbanimet tjera në komunë (që përbëhen kryesisht nga një grup etnik primar: shiptarët e Kosovës në rajonin e Opojës dhe goranët/boshnjakët në rajonin e Gorës). Qyteti i Dragashit është shumë i përzier në aspekt të gupeve etnike që banojnë, me 52% goranë, 45% shqiptarë të Kosovës dhe 1,6% boshnjakë dhe një numër i vogël i komuniteteve tjera.

Qyteti i Dragashit ka të gjitha shërbimet publike të nevojshme për komunë (siç është spitali), duke përfshirë edhe shkollën kryesore të mesme dhe një ndërtesë të re të shkollës së mesme që është në ndërtim. Me siguri për shkak të lidhjes më të mirë që gëzon me qendrat tjera më të mëdha në Kosovë (veçanërisht me Prizrenin), të lokacionit që lidhet me rrugët që çojnë në shumicën e vendbanimeve kryesore në komunë (që inkurajon lëvizshmëri në qytet, për shembull në ditën e pazarit) dhe të sipërfaqes së tij të vogël. Shumë pak amvisni jetojnë nga burimet lokale dhe ka pak kultivim bujqësor apo blegtoral, me përjashtim të kultivimit kopshtar në shkallë të vogël të frutave dhe perimeve, bletarisë, prodhimit të mjaltit dhe prodhimit të shpendëve/vezëve të tyre. Edhe kjo ka gjasë të jetë për shkak të urbanizimit të lartë të territorit (9.4% përdorim të tokës), si dhe mungesës së konsiderueshme të tokave bujqësore dhe blegtorale. Megjithatë, ai ka numrin më të madhë të shtëpive që jetojnë vetëm nga bizneset lokale dhe shërbimet (50%), ku një pjesë e ultë e tyre fiton të ardhura pjesërisht apo plotësisht jashtë komunës (gjegjësisht, 10% dhe 20%). Ka pritje më pozitive për mundësi të ardhshme në mesin e banorëve të Dragashit.

Vendndodhja e Dragashit është kyçe për zhvillimin e tij, i vendosur në një ndarje në rrugën fryesore që të shpien në Restelicë dhe Brod. Ai gjithashtu është edhe nyje për rrugët që shpiejnë në Radeshë dhe

Rapçë. Gjendet shumë afër vendbanimit të Lubovishtës në juglindje dhe ka gjasë që plotësimi dhe shtrirja urbane ti bashkojë këto dy vendbanime për të formuar një lloj periferie. Një model i ngjashëm i shtrirjes (me shtëpi të një thellësie të njëtrajtshme që renditen gjatë rrugës kryesore) është vërejtur përgjatë rrugës kryesore drejt Shajnes, ndoëse topografia dhe pyjet e kufizojnë këtë zhvillim. Një rrugë e re është shtruar ndërmjet veriut të qytetit të Dragashit dhe Shajnes, krahas së cilës është duke u ndërtuar shkolla e re e mesme dhe është pastruar një pjesë mjaft e madhe e tokës, ku komuna planifikon të krijojë një qendër biznesi. Zhvillimet në 'Industrinë e lehtë' janë të pranishme në rrugën jugperendimore që çon në Restelicë. Ndërmarrja më e madhe komerciale në komunë, fabrika e leshit Remateks, ndodhet këtu. Brenda qytetit, ka një rrjet mjaft të dendur të rrugëve/shtigjeve që shkojnë pingul me rrugën kryesore dhe lidhen me shtigje bujqësore që çojnë në zona natyrore. Kjo është duke krijuar një numër lagjeve të grupuara që me gjasë do të mbushen me objekte apo ndërtesa të tjera. Qendra e qytetit përmban një numër të objekteve të mëdha dhe shërbimeve institucionale dhe është kulmi dhe pika kryesore e të gjitha rrugëve nëpër komunë. Stacioni ndërkomunal i autobusëve gjendet afër qendrës së qytetit.

Bellobrad

Për shkak të pozitës brenda livadheve të lumit, terreni është relativisht i sheshtë. Rruga rajonale, përgjatë të cilës është zhvilluar ca biznes, kalon direkt përmes fshatit. Rrjeti rrugor për në jug është kryesisht i mirë. Modelet e ndërtimit të dendur kanë filluar të përhapen në pjesët veriore të fshatit. Kanë mbetur vetëm disa banesa tradicionale, ndonëse një "valavicë" është një veçori që bie në sy. Fshati ka pasur një popullsi që është rritur qëndrueshëm që nga viti 1921. Bellobradi gjithashtu është e pesta për nga dendësia e popullsisë në territorin e tij. Një numër më i ultë nga mesatarja e banesave tradicionale janë të lira (26%, krahasuar me mesataren e komunës prej 39%), nga të cilat vetëm më pak se gjysma përdoren për pushim apo shfrytëzim sezonal.

Blaç

I ndarë në tri pjesë, Blaçi është i lidhur me rrugën rajonale me Bresanën në perëndim dhe Zaplluxhe në lindje. Rrugët e pashtuara shpiejnë përmes vendbanimeve e shpërndara rurale që ndodhen përgjatë rrjedhave të ujit. Ndërmjet këtyre zonave janë zhvilluar vende më të mëdha me shtëpi të vetme. Zhvillimin e pengojnë zonat e rëpirra në veri të lumit të Blaçit. Pikë me interes kulturorë janë një krua me gurë të gdhendur dhe varrezat. Vendbanimi ka pasur një rritje të qëndrueshme të popullsisë (aktualisht me 1455 banorë të përhershëm), dhe territory është me një densitet mjaft të madhe. Gati një e katërta e banesave tradicionale në Blaç janë të lira, edhe pse kjo shifër është më e ultë se mesatarja e komunës. Pjesa më e madhe janë të zbrazëta dhe shfrytëzohen për pushim dhe shfrytëzim sezonal.

Brodi

Një rrugë e vetme shpie në këtë fshat që gjendet në një luginë të vogël, thellë në male. Rruga vazhdon në një strukturë të rrugëve të ngushta me shtëpive të vjetra dhe atyre të reja. Nuk ka shtrirje apo hapje të reja për shkak të mungesës së hapësirës. Tre lumenj rrjedhin nëpër këtë vendbanim të dendur, me kryesore luginën e lumit Brod që shtrihet në veri dhe jug. Ka pasur pak ndërtim në rrafshinat e përmbytura të lumit, kështu që ka mbetur pak hapësirë publike. Rruga në jug çon tek Hotel Arxhena. Ka disa ndërtesa banimi tradicionale të mirëmbajtura. Për dallim nga vendbanimet tjera në komunën e Dragashit, Brodi ka osciluar në popullsi që nga viti 1921 në përgjithësi me një trend në rënie. Gjithashtu, për dallim me pjesën tjetër të komunës, demografia më e madhe është ndërmjet 34 dhe 59 (jo 10 dhe 29), që tregon një popullsi në plakje dhe me gjasë një rënie të shkallës së lindjeve në të ardhmen. Derisa rreth një e katërta e popullsisë së përgjithshme të fshatit të shumicës së vendbanimeve tjera janë popullsi e re me moshë 6-19, në Brod kjo llogaritet të jetë vetëm 19% e popullsisë së përgjithshme. 86%

e banorëve me moshë prej 6-15 vijnë shkollimin e obliguar (duke përcjellur proporcionet me vendbanimet tjera), por vetëm 35% të personave me moshë 15-19 janë banorë të përhershëm dhe duke u arsimuar. Migrimi jashtë vendbanimit, apo edhe jashtë komunës, për arsye të shkollimit apo të punësimit mund të jenë faktor i rëndësishëm për këtë. 36% e të gjitha banesave tradicionale janë të lira, që është pak më e ulët sesa mesatarja e komunës (39%). Në përgjithësi vetëm 6% e këtyre shfrytëzohen për pushim dhe shfrytëzim sezonal.



Fotografi 20: Fotografi nga ajri e Brodit

Brruti

I vendosur në skajin verior të luginës së Opojës, peizazhi rreth vendbanimit është malor dhe shumica e zonës së ndërtuar është mjaft e pjerrët. Vendbanimi mjaft i dendur zgjerohet në të dy anët e rrugës rajonale për Bellobrad në përnendim dhe Zgatar në lindje. Zgjerimi i zonës urbane ka filluar të ndodh përmes përhapjes përgjatë rrugëve më të vogla në veri dhe rrugës për Zgatar. Ka një hapësirë të hapur në mes të vendbanimit me një kodër të vogël të mbuluar me drunj që e ndanë zonën e ndërtesave në dy pjesë. Brruti ka përjetuar një ngritje të qëndrueshme të popullsisë që nga viti 1921. Ekziston një numër më i vogël sesa mesatarja e shtëpive të lira (22%), nga të cilat shumica shfrytëzohen për pushim dhe shfrytëzim sezonal. (76%) që tregon se ekziston një numër shumë më i lartë i popullsisë së verës sesa në dimër.

Gllboçicë

Fshati shtrihet përgjatë rrugës për Restelicë. Një rrugë e pjerrët degëzohet nga rruga kryesore për në vendbanimin mjaft të dendur. Rruga e fshatit është përgjithsisht në gjendje shumë të dobët, ndonëse është shtruar në qendër të fshatit. Fshati karakterizohet nga terreni i pjerrët shpator, me shumë pak hapësirë për zhvillim të mëtejshëm, ndonëse në vendet ekzistuese është duke u mbushur me banorë, ku ndërtesat e vjetra zëvendësohen me ndërtime të reja. Një varg i vetëm i shtëpive rreshtohet përgjatë rrugës kryesore, me pamje kah lugina, por terreni është shumë i pjerrët duke mos lejuar zhvillim të metejmë në drejtimin veri-jug të fshatit apo në perëndim në drejtim të luginës. Rrugët përgjatë fshatit

janë të ngushta, por me sa duket në to ka shumë qarkullim. Edhe pse është regjistruar një rënie signifikante e popullsisë pas vitit 1981, sipas regjistrimit 2011, popullsia që nga atëherë është shtuar. Krahasuar me vendbanimet tjera, ekziston një grupmoshë më e vogël e rinisë, me vetëm 19% të banorëve të moshës 6-19. Në vendbanim janë të lira rreth 30% e banesave.

Kosavë

Fshati gjendet në skajin jugor të luginës së Opojës me një faqe mali të rrëpirë në perendim të tij. Zgjerimi i vendbanimit drejtohet kah lumi Pllajnik dhe rruga kryesore. Një rrugë më e vogël të shpie në pjesën e dytë të fshatit që është më lartë në drejtim të lindjes. Kanë mbetur shumë pak ndërtesa të vjetra, por ka ndërtime të reja të dendura në shumicën e fshatit. Një zonë e madhe e pjesës së sipërme të faqes së malit përtej fshatit është duke iu nënshtruar një erozioni të rëndë dhe ka gjasë të ketë rëshqitje të dheut (rënie të gurëve). Kjo zonë është gjithashtu vend për hudhje të plehut të kafshëve, përgjatë shtegut bujqësor. Ka edhe gjermime përgjatë pjesës së sipërme të rrugës mes Xërxës dhe Kosavës. Popullsia e fshatit ka përjetuar një ngritje të qëndrueshme gjatë kohës, me një popullsi aktualisht pak më të ultë të ngjajshëm me nivelin e vitit 1981. Gati 38% e banesave tradicionale në Kosavë janë të lira, me një proporcion të ulët të përdorimit si shtëpi për pushim apo shtëpi sezonale.

Krushevë

Gjendet afër Restelicës dhe kthesës për në Zlipotok. Krusheva është një fshat që është zgjeruar në mënyrë signifikante përgjatë rrugës për shkak të anëve të rrëpirëta të luginës ku gjendet. Lumi rrjedhë drejtpërdrejtë nëpër vendbanim, gati paralelisht me rrugën kryesore, përgjatë të cilit një thellësi e ngushtë e shtëpive është krijuar. Ekziston një numër i shtëpive dhe ndërtesave bujqësore që i japin fshatit një karakter historik dhe një rrjet i shtigjeve historike të tregëtisë dhe bujqësisë që çojnë nga vendbanimi për në Zlipotokun fqinj dhe në Restelicë, Baçkë dhe Brod dhe përtej kufirit në Shqipëri. Për dallim nga shumë vendbanime tjera, Krusheva duket të ketë përjetuar rritje të qëndrueshme të popullsisë, pa luhajtje të vërejtura në llogaritjet e vitit 2008 apo trendi në rënie në vitin 2011. Afërsia e saj me vendbanimin më të madh Restelicën mund të ndikojë në këtë stabilitet, pasi që ka qasje të lehtë në shërbime dhe në objekte përreth. Pastaj, vetëm 15% e shtëpive janë të lira në vendbanim (e treta shkallë më e ultë në komunë), që tregon se emigrimi mund të mos jetë aq i zakonshëm sikurse në shumicën e vendbanimeve tjera. Kanë deklaruar se nga këto, asnjë shtëpi nuk shfrytëzohet për pushim apo punë sezonale.

Kuk

Për shkak të pozitës së tij në luginën e Opojës, vendbanimi është mjaft i rrafshet dhe përhapet në rrafshet në veri. Në mes të shtëpive ka hapësira të gjelbra dhe fusha. Jugu i zonës është më malor me disa pyje buzë lumit. Kjo vazhdon deri në skaj të Kukit në lindje. Duket se popullsia ka kaluar nëpër një rritje të lehtë që nga viti 1981, duke shfaqur strukturë të ngjajshme të popullsisë me pjesën tjetër të komunës, me një grup të madh të gjeneratave më të reja, posaçërisht në grupmoshat nga 10-19. Kuki gjithashtu ka numër më të vogël se mesatarja e shtëpive të lira (33%), nga të cilat një numër i vogël përdoren për pushim/shfrytëzim sezonal.

Kuklibeg

Ky është një fshat i vogël në jug të Bresanës me afërsi dhe zhvillim në drejtim të fshatit më të madh. Fshati shfrytëzon (i ka të përbashkta) xhamitë e Bresanës (të vjetrën dhe të renë) dhe ka një monument fontanë/burim që gjendet në fshat. Ka tashmë përhapje në vendbanimet e izoluar në drejtim të Kukit dhe ka gjasë që të ketë konsolidim të banimeve përgjatë kësaj rruge që e ndjek një shteg të vjetër bujqësor. Ka lagje më të vogla të vendbanimit brenda zonës kadastrale Hasanaj, Islamaj, Sherifajt, dhe

Hamitaj). Kuklibegi është e pesat për nga numri më i vogël i banesave të lira në komunë (22%), në të cilat gati një e katërta kthehen për pushim apo punë sezonale. Popullsia shfaq një strukturë karakteristike për komunën e Dragashit, me një bazë të gjerë (32% e popullsisë së përgjithshme janë të moshës 6-19). Por është një numër dramatikisht më i ultë i personave ndërmjet moshës 25 dhe 34, që sugjeron për një shkallë të lartë të emigrimit për qëllime punësimi apo shkollimi. Kjo mund të sugjerojë se deri sa adultët e rinj shpërngulen për punë apo shkollim, familjet kanë mbetur në trevë.

Plavë

I pozicionuar në terren më të rrafshët (ndonëse më i pjerrët në drejtim të perëndimit), fshati gjendet afër rrugës rajonale mes Prizrenit dhe Dragashit. Ka një numër objektesh rurale tradicionale dhe objekte bujqësore, që përfshijnë fusha dhe pemishte, si dhe shtëpi më të mëdha me oborre para dhe pas tyre. Dy rrugë të shtruara çojnë përmes fshatit. Ky vendbanim mjaft i dendur përhapet në jug dhe lindje. Dy varre janë me interes trashëgimor. Popullsia në përgjithësi ka filluar të rritet me një shkallë më të shpejtë pas vitit 1971, struktura e popullsisë tregon një shkallë positive të lindjes për të ardhmen. Rreth 36% e shtëpive janë të lira në fshat, me rreth një të tretën e tyre, në të cilat kthehen gjatë vitit.

Radeshë

Përkundër terrenit malor, Radesha është bërë një fshat i madh që ndahet në pjesë të poshtme dhe të epërme, e pozicionuar në një luginë të vogël në lindje të Dragashit. Ka pak hapësirë dhe terreni është shumë i pjerrët, kështu që lagjet janë shumë të dendura dhe shumica e rrugëve janë të ngushta dhe gjarpëruese. Lumi rrjedh nëpër vendbanimin e poshtëm, mes ndërtesave të vjetra dhe të reja. Në përgjithësi, popullsia është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 1921, dhe ekziston një trend që ka vazhduar në vitin 2011. Ekziston një numër krahasimisht i ulët i shtëpive të lira (28%), nga të cilat, asnjëra nuk shfrytëzohet si shtëpi e përhershme.

Rapçë

Fshati gjendet në rrëzë të Malit Koritnik në luginë që çon në juglindje. Ka dy pjesë të vendbanimit, të cilat janë në distancë 500m largë njëra-tjetrës. Pjesa e epërme është vendbanim i dendur kryesisht i përbër nga shtëpi rezidenciale. Pjesa e poshtme është më e vogël por përmban objekte publike dhe ruan më shumë nga aspekti tradicional urban në rrugë dhe ndërtesa. Popullsia është përgjysmuar ndërmjet viteve 1981 dhe 2011, prandaj popullsia aktuale është e ngjajshme me nivelin e vitit 1961. Popullsia është duke u plakur dhe shkalla e lindjeve ka gjasa të bie në të ardhmen. Ekziston gjithashtu një numër i madh i shtëpive të lira (45%) nga të cilat vetëm një numër i vogël (17%) banohen në mënyrë sezonale.

Shajne

Vendbanimi gjendet shumë afër qytetit të Dragashit, në verilindje. Prurja dhe përhapja urbane mund të bëjë që vendbanimi të formojë një periferi. Përhapja e shtuar (me shtëpi të njëtrajtshme të reshtuara përgjatë rrugës kryesore) është vërejtur në rrugën kryesore drejt Dragashit, ndonëse zhvillimi kufizohet nga topografia dhe pyjet. Shajne përbëhet kryesisht nga ngastra dhe fusha rurale, ndonëse ka shtim në zhvillimin 'suburban'. Rreth 32% e shtëpive të vendbanimit janë të lira, rreth një e tretë e të cilave shfrytëzohen përkohësisht gjatë vitit.

Zaplluxhe

Ky vendbanim gjendet në skajin më lindor të luginës së Opojës, gjegjësisht në fund të rrugës rajonale. Vendbanimi është i ndarë të dy pjesë, me vendndodhje përgjatë dy burimeve lumore që çojnë në lumin Blaç. Rrjeti i rrugëve është relativisht i mirë, vecanërisht në pjesën jugore, ku janë ndërtuar shumë

shtëpi të reja. Rreth 11% e banesave të Zaplluxhes janë në shfrytëzim pushimi/sezonal dhe 22% tjera janë të zbrazëta. Ka disa ndërtesa tradicionale në Zaplluxhe.

Zgatar

Gjendet në skaj të luginës së Opojës. Ky fshat është i vendosur në shpate të pjerrta me pak hapësirë. Prandaj, pjesa e vjetër e fshatit është e dendur. Ka disa shtëpi të vjetra brenda fshatit. Zgjerimi i fshatit bëhet kryesisht në drejtim të rrugës rajonale për në Blaç, por në fund të faqës së malit zgjerohet në drejtim të rafshinës/fushës. Në anën tjetër të fshatit ka zgjerim në drejtim të Brrutit. Deri sa struktura e përgjithshme e popullsisë është konforme me mostrat nëpër tërë komunën – me një numër të madh të gjeneratave të reja – është një rënie e dukshme në popullsi për grupmoshat ndërmjet 15 dhe 34, që sugjeron për një emigrim. Ekziston një numër mesatar i shtëpive të lira (38%), dhe një e treta e tyre thuhet se shfrytëzohen për puhsim dhe punë sezonale.

Vendbanimet tretësore

Nga 36 vendbanime të Dragashit, 17 konsiderohen qendra terciare, me një popullsi më pak se 800 banorë. 7 fshatra gjenden në rajonin e Opojës me 10 tjera të mbetura në Gorë. Shumica nga këto fshatra janë duke përjetuar rënie të numrit të popullsisë, me fshatra që duket të braktisura gjatë shumicës së vitit. Ka probleme serioze përkitazi me rrjetin rrugor dhe atë të komunikimit, posacërisht në menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Gjashtë nga këto fshatra janë gjithashtu të klasifikuara si fshatra të largëta, me popullsi në rënie dhe vendodhje të largët që e bën qasjen edhe më të vështirë.

Vendbanimet tericare në Gorë janë ato që e ndjekin rrugën që shpie në fshatra më të mëdha si Brodi dhe Retelica. Ka shumë pak ndërlidhje ndërmjet këtyre fshatrave, përveç përmes rrugës kryesore apo përmes terrenit më të vështirë për kalim ose shtegjeve bujqësore. Vendbanimet terciare që gjenden në Opojë shpesh kanë tendencë të jenë më afër qendrave më të mëdha, ndërmjet Dragashit dhe Bresanës dhe janë mirë të lidhura me fshatrat tjera përmes rrugës. Afërsia më e madhe dhe lehtësia për qasje mes fshatrave në pjesën veriore të komunës mund të jetë arsye për nivelin e ulët të shërbimeve në këto fshatra, meqë qasja në shërbime alternative është më e lehtë.

Ka dallim të madh në numrin e popullsisë gjatë periudhës dimërore dhe asaj vereore në këto fshatra dhe numër të madh të shtëpive të lira. Gjithashtu, ka mbështetje të ultë në prodhimet apo shërbimet lokale dhe prodhim të ulët apo mesatar nga blegtoria ose bujqësia. Shumica e këtyre fshatrave shpesh karakterizohen me popullsi të vogël, stabile apo në rënie (nganjëher janë të tilla në mënyrë dramatike), me mungesë të gjeneratave të reja dhe një numër të madh të gjeneratave të reja që sugjeron për një popullatë në plakje dhe shkallë të vogël të lindjeve.

Pavarësisht nga parashikimet negative ekonomike dhe të prodhimit në mesin e popullsisë, ka një ndjenjë të fortë të pronësisë dhe vlerësim të madh përkitazi me vecoritë natyrore dhe aspektin trashëgimor të këtyre fshatrave.

Baçkë [Fshat i largët]

Ky është një fshat i vogël i rrethuar me kullosa me shkurre dhe me pyje, me një rrugë për qasje që e përshkon tërë fshatin dhe që shpie në rrugën kryesore mes Brodit dhe qytetit të Dragashit. Vendbanime të banuara përhapen pingul nga rruga kryesore poshtë faqës malore, duke formuar një grup të vogël që gjarpëron rreht konturave të rrëpira të faqës së malit. Fshati përfundon me shtigje bujqësore. Rrugët janë të ndërtuara me gurë tradicional por të mbuluara me barishte. Ka përqendrim të lartë të shtëpive

të vjetra prej guri dhe shtallave, por ato janë në gjendje të mjerueshme për shkak të mungesës së banorëve. Infrastruktura është e dobët. Ky është një fshat kryesisht e pabanuar, me probleme të sigurisë (vjedhje) për shkak të mungesës së banorëve dhe faktit se 86% e ndërtesave janë të pabanuara, nga të cilat 5% mund të jenë të banuara përkohësisht për pushim apo punë sezonale. Nga një kulmim i popullsisë në vitin 1981, popullata e fshatit ka rënë në mënyrë dramatike, prandaj janë vetëm 52 persona aktualisht që banojnë në fshat.

Buçe

Vendbanimi ndodhet në rrëzë të Malit Koritnik, ku rrafshina e gjërë hapet në drejtim të luginës së Opojës. Përrenj malor rrjedhin nga veriu i fshatit në drejtim të lindjes. Ndërmjet këtyre rrjedhave fshati i vogël është shumë i dendur, por ka gjithashtu edhe disa hapësira të hapura dhe zona të gjelbra. Rruga kryesore (e shtruar) që hyn në fshat përfundon në zonën e “sheshit të fshatit”. Rrugët dytësore janë të cilësisë tejet të dobët. Një zonë tjetër vendbanimi gjendet pas në drejtim të rrugës kryesore për në lindje, në pjesët më të pjerrta të shpateve. Kjo zonë e dytë ka një numër shtëpishë gurri të braktisura, në gjendje të mjerë. Buçe ka përjetuar një rritje graduale të popullsisë nga 1921 deri në vitin 1981, por tani duket të jetë në trajektore në rënie, me rënie signifikante të popullsisë së vlerësuar në një nivel të ngjajshëm me shënimet nga 1971. Ka një numër mesatar të shtëpive tradicionale që janë të lira në raport me vendbanimet tjera në komunë, nga të cilat gati gjysma përsëri banohen gjatë sezonit apo për pushim. Kështu, ekziston një luhatje signifikante në popullsi gjatë vitit.

Buzez

Fshati është i lidhur me Bellobradin, Kapren, Kosavën, Kukin dhe Bresanën, gjendet afër udhëkryqit të disa rrugëve të asfaltuara në mes të luginës së Opojës. Nuk është fshat i madh, ndonëse ka një industri të lehtë. Shtëpitë janë të përhapura rreth fabrikës së qumshtit në njërin anë, ku pjesa e vjetër e vendbanimit (rreth xhamisë së re) gjendet në anën tjetër të rrugës. Ka një monument të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në varreza që gjenden menjëherë pas pjesës kryesore të vendbanimit. Struktura e popullsisë tregon një proporcion të lartë të të rinjve në fshat, që krahasonet me shumicën e vendbanimeve tjera në komunë. 30% e banesave janë të lira, nga të cilat një e treta janë lënë për pushim/shfrytëzim sezonal.



Figure 21: Fotografi ajrore të Buzezit

Dikanc [Fshat i largët]

Ky është një fshat i largët që shtrihet në dalje të rrugës së Brodit, në fundin e luginës së lumit Brod. Dikanca është një fshat i vogël i rrethuar me tokë të kultivuar dhe kulloso ekstenzive. Infrastruktura është e dobët. Ka një rënie shumë të pjerrët në luginë menjëherë pas qendrës së fshatit. Qendra e fshatit është zonë mjaft e madhe, me drunj dhe vende për pushim. Ndërtesat e vjetra përgjithësisht në gjendje shumë të dobët. Dikanca ka strukturë të popullsisë të ngjajshme me atë të Baçkës. Kulmimi i popullsisë për fshatin si tërësi ishte ndërmjet viteve 1961-1971, ku pastaj ishte shënuar një rënie dramatike e popullsisë në 124 në vitin 2011. 53% e banesave janë të lira, që është shkalla më e ulët e gjashta në komunë për zbrazëti. Nga këto, 12% janë në shfrytëzim të përkohshëm/sezonal.

Kapre

Ky fshat i vogël gjendet afër udhëkryqit të disa rrugëve të asfaltuar në mes të luginës së Opojës. Prandaj, është mirë i lidhur me Buzezin, Bellobradin dhe Kosavën. Fshati është i rrethuar me rrafsh/fusha të gjëra të hapura që shfrytëzohen për kullasje të bagëtisë. Fshati ka vetëm disa ndërtesa tradicionale, të cilat janë zëvendësuar kryesisht me ndërtime të reja bashkëkohore. Ka një hapsirë të gjërë të hapur afër xhamisë, që për nga forma duket si “shesh i fshatit”. Gjithashtu, ekziston edhe një zonë e rëndësishme për nga aspekti trashëgimor/fetar, gjegjësisht një varrezë në qendër të fshatit. Popullsia ka përjetuar një ngritje të ngadaltë gjatë viteve, por duket se është ndalur dhe është në proces të rënies. 34% e banesave janë të lira, nga të cilat një numër relativisht i lartë shfrytëzohen për pushim apo punë sezonale.

Kërstec

Ky fshat i vogël është i ndarë në dy pjesë – i poshtëm dhe i epërm – në distancë 500 metra larg njëra-tjetrës. Gjendet në rrëzë të Malit Koritnik afër kufirit me Shqipërinë. Qendra e pjesë së epërme të fshatit (në perendim) qëndron mbi një rrafshnaltë të vogël, me faqe mali të rrëpira sipër dhe poshtë vendbanimit. Kjo pjerrësi është pak më e sheshtë në pjesën e ultë, me pak hapësirë ndërmjet shpateve. Ka një tërësi atraktive ndërtesash tradicionale në pjesën e epërme të fshatit, me mundësi të mira për shëtitje/ecje përgjatë shtigjeve të numërta bujqësore që çojnë në drejtim të Shqipërisë dhe Rapçës. Për dallim nga mostra komunale që ka proporcion të lartë të të rinjve si banorë të përhershëm, grupmosha prej 55-59 vjeç është grupmi demografik më i populluar. Në përgjithësi, struktura e popullsisë së fshatit indikon një grup të gjerë të grupmoshës së mesme sesa një popullatë të re. Kjo sugjeron se deri vonë shkalla e lindjeve ka qenë në rënie dhe/ose ka pasur një emigrim të madh, faktorë që mund të lidhen. Trendi i popullsisë nga viti 1921 deri 2011 indikon një rritje të përgjithshme të popullsisë, por kjo ka qenë e përcjellë me një rënie dramatike në popullsi që nga atëherë. Kjo duket të jetë vlerësuar nga numri i madh i banesave të lira në vendbanim (48%), në mënyrë signifikante mbi mesataren e komunës dhe e nënta më e larta në komunë. Pjesa dërmuese e këtyre banesave janë për shfrytëzim sezonal/pushim, që indikon një dallim të madh në popullatën e verës dhe të dimrit të vendbanimit.

Kukulanë

Ky vendbanim i dendur është ndërtuar në një rrafshnaltë të vogël, me përjashtim të një grupi shtëpishë më të reja në anën veriore. Fshati gjendet në të dy anët e rrugës nga Dragashi për në Broad në një shpat mali të pjerrët. Popullsia e këtij fshati ka kulmuar në vitin 1981, pas të cilit ka përjetuar një rënie dramatike në një të tretën e popullatës së kaluar. 70% e të gjitha banesave janë të lira, por gati të gjitha shfrytëzohen si banesa të përkohshme për pushime apo punë sezonale. Kjo tregon se Kukulani ka përjetuar një shkallë të madhe të emigrimit dhe se popullsia e tij verore është në mënyrë signifikante më e madhe sesa popullsia e dimrit.

Leshtan [Fshat i largët]

Ky është një fshat i vogël dhe i largët në malet në juglindë të Dragashit. Është një vendbanim i dendur dhe i koncentruar që shtrihet në mes të një vendi gjeografik malor të rëndësishëm në rrugën mes Lubovishtës dhe Radeshës; rruga nga Dragashi është e shtruar dhe në gjendje të mirë, ndonëse rruga për në Radeshë nga Leshtani është e pashtuar dhe vështirë për qarkullim. Vendosur rreth një sheshi kryesor, me një xhami që duket të jetë rindërtuar rishtazi, gjenden tërësi ndërtesash autoktone në gjendje të ndryshme fizike që janë shumë të rëndësishme për trashëgiminë kulturore. Shtigjet bujqësore çojnë në thellësi të zonës së grykës/luginës. Ky fshat shfaqë një trend të ngadalhtë në rritje, edhe pse kjo ka gjasa ende të ngadalësohet madje edhe të bie për shkak të shkallës së ultë të lindjeve. Pak mbi një të tretën e banesave në fshat janë të lira, me një numër të neglizhuar të përdorimit për qëllime të pushimit/sezonale.

Lubovishtë

Fshati ndodhet shumë afër qytetit të Dragashit në veriperendim dhe ka gjasë që prurja dhe përhapja urbane do ta shëndrojnë vendbanimin në periferi të qytetit kryesor. Ka shumë shtëpi me oborre përpara dhe pas, por shumë pak biznes për shkak të afërsisë së tij me Dragashin. Qendra e Lubovishtës gjendet jashtë rrugës rajonale për në Brod, por ka disa shtëpi të ndërtuara përgjatë kësaj rruge shumë të frekuentuar. Lubovishta ka një strukturë të çrregulluar të popullsisë me një numër më të madh të adultëve të rinj dhe grupeve të moshës së mesme të kombinuara. Gjatë kohës popullsia është rritur ngadalë, edhe pse ajo është nivelizuar në vitin 2011. Fshati ka një numër të madh të banesave të lira (49%), nga të cilat 41% mund të përdoren përkohësisht gjatë vitit.

Mlikë

Ky është një fshat i vogël, kompakt me një koleksion objektësh të vjetra dhe shtëpi të reja, si dhe disa artefakte të trashëgimisë kulturore në gure të varreve dhe pllaka të gdhendura (punuara). Gjendet në malet e poshtme të rajonit të Gorës, ku shkalla e pjerrësisë nuk është shumë e madhe. Vendbanimi i dendur ka filluar të përhapet në veri. Në fund të fshatit, vendbanimi përfundon në një hapësirë më të gjërë afër xhamisë. Rrugët nga këtu lidhen me shtigjet bujqësore ekzistuese përgjatë dhe përtej lumit nëpër tokave pyjore. Shtigjet bujqësore lidhen me rrugën që shpie në Brod. Kufizohet me skajin e një zone shumë të madhe të pyllëzuar. Në dalje të vendbanimit ekzistojnë disa shtëpi të shpërndara. Zona sociale kryesore e fshatit duket të jetë një fontanë buzë rrugës, në skaj të oborrit të shkollës. Edhe pse Mlike gjithmonë ka qenë një fshat i vogël, ka kaluar nëpër një rënie të qëndrueshme në popullsi gjatë shekullit 20, me një rënie më signifikante gjatë viteve të fundit. Aktualisht është i treti fshat më i vogël në aspekt të popullsisë, me një popullsi në plakje, e indikuar nga një strukturë e ndërruar e popullsisë që nuk ka asnjë banorë të moshës 20-24 vjeç dhe disa herë mbi moshën prej 65. Mlikë ka numrin e tretë më të madh të shtëpive të lira (79%), por vetëm 16% nga këto përdoren përkohësisht për pushim apo për punë.


Orçushë [Fshat i largët]

Ky është një fshat i largët në malet afër kufirit me Shqipërinë. Nuk ka lidhje ndërkufitare përmes rrugës, por një shteg shpien përtej kufirit. Fshati i vogël qëndron në një shpat të pjerrët të ekspozuar nga jugu-perendimi, i grupuar rreth fundit të një rruge të pashtuar me cilësi dhe gjendje shumë të dobët. Një koleksion interesant i objekteve më të vjetra është i vendosur në bazën e fshatit. Ngajshëm me Mlikën, Orçusha ka një popullsi në plakje me një numër shumë të vogël të njerëzve të moshës 20-34 dhe më shumë të moshës mbi 79 vjeç. Kulmimi i fshatit në aspekt të popullsisë ishte ndërmjet viteve 1971 dhe

1981, para se të përjetonte një rënie dramatike në popullsi në 60 në ditët e sotme. 81% e banesave janë të lira por duket se rreth një e treta e këtyre pronarëve që mungojnë, kthehen gjatë vitit.

Pllajnik

Ky është një fshat i vogël e i dendur në lartësi të madhe mbidetare në jug të luginës së Opojës. Gjetet ndërmjet lumit Pllajnik e një rrjedhë që shpie në fshat në faqen e pjerrët të shpatit. Fshati është i lidhur me Xërxën përmes një rruge gjarpëruese lokale, si dhe me Kosavën. Rrugët kryesore janë të shtruara, por rrugët dytësore mbeten të pashtruara. Skaji i rrugës lëshohet me pjerrtësi të madhe në luginë, ku janë duke u ndërtuar vetëm një rend i vetëm shtëpishë. Ka një numër ndërtesash tradicionale prej guri dhe qendra e fshatit është atraktive me veçori natyrore prej guri dhe me kroin. Vendbanime të vogla gjenden brenda zonës kadastrale (lagjet Çengaj, Berisha, Çusaj dhe Domazet). Pllajniki ka pasur pak banorë të përhershëm që ka ndryshuar pak gjatë kohës (duke injoruar vlerësimet ekstreme nga viti 2008). Pak mbi një e treta e tërë banesave në fshat janë të lira, rreth një e treta e këtyre janë të banuara gjatë kohëve të ndryshme të vitit.



Grafiku 22: Fotografi nga ajri e Radeshës

Rrenc

Ky është një fshat i vogël përgjatë rrugës kryesore për Prizren - Dragash, ndonëse gjendet lartë një rruge gjarpëruese, të shtruar. Vendbanimi nuk është shumë i dendur, me oborre dhe fusha mes shtëpive, Shumica e shtëpive janë rishtaz të ndërtuara, ndonëse ka gjurmë të vendbanimit të vjetër në nivelet më të ulta të malit. Ekziston një shkallë e banimit më e madhe se mesatarja e banesave tradicionale, me rreth 22% që janë të zbrazëta dhe 9% shfrytëzohen përkohësisht gjatë vitit. Rrugët/shtigjet janë të pashtruara, me përjashtim të rrugës kryesore. Zhvillime të reja janë duke ndodhur në zonat e rrafshta përgjatë rrugës kryesore në hyrje të fshatit. Përkundër një popullsi më të vogël të regjistruar në 2011, fshati ka kaluar nëpër një ngritje të qëndrueshme të popullsisë që nga viti 1921. Ekziston një dominim mjaft i theksuar i grupeve të moshave të reja në fshat, me 30% të popullsisë së përgjithshme të moshës 6-19 dhe një numër të vogël të gjeneratave më të vjetra. Për këtë arsye, struktura e popullsisë tregon

një shkallë të lartë të lindjeve dhe rritje të qëndrueshme të popullsisë. Ekziston një numër më i vogël i personave me moshë prej 30-34 sesa që mostra sugjeron, duke indikuar se migrimi për punë apo familje është një aspekt signifikant në fshat.

Vranisht

Ky fshat i vogël ka një koleksion të objekteve të vjetra dhe të reja, i pozicionuar në pjesë kodrinore të rajonit të Gorës, ku shkalla e pjerrësisë nuk është aq e madhe. Një rrugë e asfaltuar çon përmes fshatit, që hapet për të krijuar një hapësirë qendrore publike (për shembull, vend ku presin taksitë zakonisht). Në disa pjesë, vendbanimet janë të dendura, por zgjerohet dhe hapet në të dy anët e rrugës. Ka disa ndërtesa tradicionale, por ato janë në gjendje shumë të dobët. Një rritje shumë e ngadaltë në popullsi është regjistruar deri në vitin 1981, pas të cilit fshati ka përjetuar një rënie të banorëve të përhershëm. Përkundër ca shifrave më të larta të banorëve të grupmoshave prej 0-9 dhe 35-39, në përgjithësi në Vranishtë, struktura e popullsisë tregon për një popullsi në plakje, me shumicën e banorëve të moshës 50-64. Fshati ka vendin e katërt për nga numri i banesave tradicional të lira në komunë (74%), nga të cilat 21% shfrytëzohen gjatë sezonës.

Xërxe [Fshat i largët]

Rruga për në Xërxe është pjesërisht e shtruar, ndonëse ky nuk është rasti edhe në hapësirat e epërme të fshatit; këto rrugë janë në gjendje shumë dobët. Është një fshat i vogël dhe i largët në malet në verilindje të Dragashit. Shtëpitë janë të shpërndara në hapësirë prej 20ha dhe ka pak ndërlidhje apo lidhje mes tyre. Përgjatë rrugës ka shenja të punëve gërmuese. Xërxa ka qenë një fshat i vogël gjatë historisë së tij, që ka kaluar nëpër një rritje të popullsisë, me një rënie të vogël të vërejtur në shënimet e vitit 2011. Një mesatare e banesave tradicionale janë të lira, nga të cilat thuhet se asnjë nuk shfrytëzohet gjatë sezonës.

Zlipotok

Ky është një fshat i largët, i pozicionuar në malet në veri të Restelicës në një shpat kodre të pjerrët. Një rrugë e shtruar me zhavorr shpie nga Zlipotoku në Krushevë dhe në Gllaboçicë, i pozicionuar në rrugën Dragash - Restelicë. Përveç qendrës së dendur të fshatit ka edhe ca troje më të mëdha në veriperendim të fshatit. Ka ende disa ndërtesa të vjetra, si dhe një vend ku gjendet xhamia e vjetër dhe një pllakë e gdhendur. Mbeturinat hudhen në lumin që rrjedh përmes fshatit. Zlipotoku ka përjetuar një rritje të ngadaltë por të qëndrueshme të popullsisë deri në vitin 1981 dhe më vonë një stagnim në popullsi. Zlipotoku ka numrin më të madh të banesave të banuara në komunë, vetëm 3% nga të cilat janë të zbrazëta dhe 5% shfrytëzohen gjatë sezonës. Kjo mund të sugjerojë se Zlipotoku ka më pak emigrim sesa vendbanimet tjera në Dragash.



Grafiku 23: Fotografi nga ajri e Zlipotokut

Zym

Ky është fshati i parë në rrugën që përshkon luginën e Opojës. Fshati është i ndarë në dy pjesë: njëra në veri të rrugës kryesore dhe tjetra në jug të saj. Ka disa shtëpi tradicionale në pjesën veriore të fshatit që formojnë një tërësi. Topografia është shumë e pjerrët. Ka disa shtëpi të ndërtuara të ngjeshura dhe ca të shpërndara me fusha dhe oborre të vogla. Një zonë e madhe e hapur (e përqendruar rreth një druri të vjetër e të madh) rrugës për në dalje të fshatit përreth shkollës që shërben si vend për festivale dhe kremtime. Zymi shfaqë një strukturë standarde të popullsisë për Dragashin, me një bazë të gjerë të gjeneratave më të reja dhe një numër të vogël të banorve më të vjetër. Popullsia është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 1921. Zymi ka shkallën e dytë më të lartë të banueshmërisë në komunë, me vetëm 4% të banesave tradicionale dhe 6% shfrytëzohen si banesa të përkoshme apo sezonale.

3.2.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të vendbanimeve

Toka produktive dhe natyra e paprekur janë resurse të rëndësishme, por i janë të ekspozuara dëmtimit për shkak të zhvillimeve aktuale.

- Si mundet toka bujqësore të ruhet dhe të mos degradohet nga zhvillimet aktuale dhe si të parandalohet kjo?
- Si duhet amvisnia të orientohet me qëllim që të minimizojë humbjet në tokën bujqësore, por gjithashtu të ruhet tipologjia tradicionale e amvisnisë?

Zhvillimi hapësinor në komunë është i konceptuara keq, ndërsa ndërtimet mbikëqyren.

- Si duhet të trajtohen këto vendbanime? Çfarë kushtesh mund të formulohen nga PZhK për të arritur rregullore mirë të menduara të zgjerimit të vendbanimeve e që do të respektohej nga qytetarët?

Disa vendbanime janë gati të shpopulluara.

- Si duhet këto vendbanime të trajtohen? Çfarë kushtesh duhet t'u sigurohen banorëve të fshatrave të vogla, me qëllim që ata të kthehen në vendbanimet e tyre?

Shfrytëzimi i energjisë dhe ngrohja e shtëpive është në gjendje të vështirë.

- Çfarë lloj modernizimi mund të arrihet?
- Si mundet eficiency e energjisë të përmirësohet në amvisnitë dhe në ndërtesat publike të Dragashit?

3.2.4 Vendbanimet joformale

Definicioni

Definicioni i pranuar ndërkombëtarisht mbi vendbanimet joformale i karakterizon ato si “vendbanime njerëzore ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e nevojshme sipas standardit jetësor, posaçërisht ato për banim adekuat”.⁹⁸ Në vitin 2005, Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Vienës mbi Vendbanimet Joformale, e cila thërret si për parandalim të vendbanimeve të reja joformale ashtu edhe për formalizimin e atyre ekzistuese. Parandalimi dhe formalizimi i vendbanimeve joformale gjithashtu ishte përfshirë edhe në Planin e Implementimit të Standardeve të Kosovës (PISK) dhe në pasardhësin e tij, Plani i Veprimtimit të Partneritetit Evropian (PVPE). Çështja e vendbanimeve joformale gjithashtu është një pjesë e rëndësishme e progresit të Kosovës drejt plotësimit të Synimeve Zhvillimore të Mileniumit⁹⁹.

Definicioni valid për vendbanimet joformale është dhënë në Ligjin e ndryshuar mbi Planifikimin Hapësinor (Ligji Nr.03/L-106): “Vendbanime joformale” janë vendbanimet të cilat janë të banuara nga individë dhe të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë standarde jetësore të duhura, respektivisht akomodim të duhur. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat në vijim:

- a) Pronësi joformale të pronës,
- b) Privim nga shërbimet elementare apo joadekuate,
- c) Pjesëmarrje joadekuate apo mos pjesëmarrje në qeverisje, dhe
- d) Rrezikshmëri të lartë.

Situata në Dragash

Në vitin 2005, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë një përcaktim të vendbanimeve joformale në Kosovë. Ministria ka definuar tri zona në Dragash si joformale:

- Dragash: një pjesë e qytetit në jug nga qendra, madhësia prej 7 ha,
- Vranisht: tërë fshati, madhësia 40 ha,
- Pllajnik: tërë fshati, madhësia 50 ha,

MMPH ia ka dhënë UNDP-së një komplet të dhënash me sistem GIS lidhur me këto vendbanime¹⁰⁰.

Profili i Komunës nga PZhK mbi situatën ekzistuese tregon të dhënat në vijim mbi këto vendbanime:

⁹⁸ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: “Udhëzime mbi hartimin e Planeve Zhvillimore Lokale “

⁹⁹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Asociacioni i Komunave të Kosovës, UN-HABITAT, OSCE: Së bashku t’i bëjmë qytetet më të bukura – Vendbanimet joformale, 2007

¹⁰⁰ Të dhënat e dërguara nga MMPH, Vjollca Puka për UNDP, 10 maj 2013

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK



Pllajniku është fshat në rajonin e Opojës, që gjendet në një lartësi prej 1400 m. Edhe pse janë vetëm 5 km largësi ajrore deri në Dragash, largësia gjeografike dhe qasja e vështirë kanë çuar deri në një humbje të rëndë të popullsisë për shkak të migrimit. Mbi dy të tretat e shtëpive janë të pabanuara, për afërsisht një e treta e këtyre janë të banuara në kohë të ndryshme gjatë vitit.



Vranisht është gjithashtu një fshat në rajonin e Gorës në një lartësi prej 1000 m. Gjendet afër rrugës rajonale Dragash–Restelicë dhe kështu është gjeografikisht më mirë i lidhur. Si në të gjitha fshatrat në rajon të Gorës, ka ndodhur një ndikim i madh nga emigrimi gjatë dekadës së fundit. Fshati ka numrin e katërt më të madh të shtëpive të pabanuara në komunë (74%), nga të cilat 21% shfrytëzohen gjatë sezonit.



Në qytetin e **Dragashit** pjesa që është shënuar të jetë vendbanim joformal gjendet në jug nga qendra me rreth 200 - 300 m distancë deri te tregu qendror. Përbëhet nga shtëpi banimi me një mostër të vendbanimit që nuk dallohet shumë nga të tjerët.

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

| Vendbanimi | Nr. i banorëve 1948 | 1981 | 2011 | Evolucioni 1981 – 2011 | Nr. i shtëpive 2011 | Sfondi kryesor etnik apo kulturor (Nr. i banorëve) |
|------------------|---------------------|------|------|------------------------|---------------------|--|
| Pllajnik | 322 | 576 | 405 | -30% | 51 | Shqiptarë (405) |
| Vranisht | 755 | 731 | 352 | - 52% | 93 | Goranë (334) Boshnjakë (3) |
| Dragash (totali) | 408 | 1114 | 1098 | +/- 0% | 235 | Goranë (567) Shqiptarë (498) Boshnjakë (18) |

| Vendbanimi | Arsimi | Kujdesi shëndetësor | Qasja në rrugë | Furnizimi me ujë |
|------------|---|---|--|---|
| Pllajnik | Shkolla fillore “Samedin Emini” (Shkolla satelite) Klasët 1-5 | E lidhur me Qendrën Mjekësore Kryesore në Dragash | Rrugë lokale, e shtruar 2012 | Sistem lokal i ujësjellësit, kualiteti i ujit në pajtim me standardet mikrobiologjike dhe kimike |
| Vranisht | Shkolla fillore “25 maji” (Shkollë qendrore) Klasët 1-8 | Ambulantë në Vranisht | Rrugë lokale, e shtruar | Sistem lokal i ujësjellësit, kualiteti i ujit në pajtim me standardet mikrobiologjike dhe kimike |
| Dragash | Shkolla fillore “Fetah Sylejmani” (Shkollë qendrore), Klasët 1-9 Shkollë e mesme “Ruzhdi Berisha” Klasët 10-13 | Qendra Mjekësore Kryesore në Dragash | Rrugë rajonale dhe rrjet i rrugëve lokale, të shtruara | Sistem lokal i ujësjellësit, kualiteti i ujit nuk është në pajtim me standardet mikrobiologjike, por është në pajtim me standardet kimike |

Lidhur me indikatorët **“Privim nga shërbimet elementare apo joadekuate”**, nuk dallime signifikante ndërmjet këtyre tri vendbanimeve dhe fshatrave tjerë në Dragash apo diku tjetër në zonat rurale të Kosovës që do të tregonin për mungesë të shërbimeve publike apo qeverisje.

“Pjesëmarrje joadekuate apo mos pjesëmarrje në qeverisje” ky rast nuk është në asnjërin nga këto tri vendbanime. Banorët gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të njëjtën pjesëmarrje sikurse banorët e të gjitha fshatrave tjera.

Lidhur me indikatorin **“Rrezikshmëri e lartë”** hartat “A 4 Vlerësimi i rreziqeve natyrore” të krijuara për Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm mund të shfrytëzohen për të vlerësuar rreziqet ekzistuese në pika të caktuara. Hartat A 4.1 dhe A 4.2 tregojnë se ekziston rrezik i lartë nga erozioni dhe rrezik i mesëm nga ortekët në rrethinë të Pllajnikut. Duke pasur parasysh se fshati gjendet pas një bjeshke, vetë fshati është kryesisht i mbrojtur nga këto rreziqe. Vranishta dhe Dragashi aspak nuk janë të rrezikuara nga këto rreziqe.

Projekti i UNDP: Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës në Dragash

Lidhur me indikatorin **“Pronësi joformale e pronës”** të dhënat kadastrale për këto fshatra janë kontrolluar nga UNDP. Në bazë të të dhënave të marra nga Agjencia Kadastrale në të tri rastet nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme mbi pronësinë e tokës.

Në komunën e Dragashit të ashtuquajturat **“tokat shoqërore”** mbulojnë një pjesë të madhe të sipërfaqes së komunës. Lidhur me Pllajnikin dhe Vranishtën nuk ka indikatorë se tokat mund të kenë qenë në pronësi shoqërore. Në bazë të të dhënave kadastrale, pjesa e qytetit të Dragashit për të cilën bëhet fjalë si një vendbanim joformal nuk gjendet larg nga toka që ka qenë në pronësi shoqërore. Kjo tregon për një mundësi se një pjesë e vendbanimit ka mundur të jetë e ndërtuar në tokë publike.

Konkluzion:

Me gjasë të dhënat që mungojnë apo që nuk përputhen mbi pronësinë e tokës ka shkaktuar klasifikimin e tri fshatrave të Dragashit si vendbanime joformale. Urgjentisht është e nevojshme të qartësohet statusi i pronësisë së tokës për këto vendbanime. Në rast se rezultatet vërtetë tregojnë mungesën e pronësisë së tokës, këto tri fshatra duhet të trajtohen siç është paraparë në **“Udhëzuesin për planifikim hapësinor mbi vendbanimet joformale”**¹⁰¹.

3.3 SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE DHERAT

3.3.1 Shkëmbijtë, Mineralet dhe Dherat¹⁰²

Komuna e Dragashit është pjesë e Maleve të Sharrit që formojnë kufirin ndërmjet Kosovës dhe IRJ të Maqedonisë. Malet e Sharrit janë formuar në të njëjtën fazë gjeologjike me Alpet dhe Dinariket.

Gjysma e territorit të Komunës së Dragashit formohet nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve metamorfik. Dy zona janë të dominuara nga lloje të ndryshme të gurëve gëlqeror që i janë nështruar proceseve metamorfike. Këto zona janë Mali Koritnik dhe pjesë të maleve rreth Brodit dhe Restelicës. Ndërhyre të magmatiteve gjenden kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Dragashit ndërmjet Kërstecit, Dragashit, Pllajnikut, Brodit, Zlipotokut dhe Krushevës. Zona më të mëdha të gurit ranor mund të gjenden në jugperendim të largët të maleve (Kësula e Priftit), derisa zona më të vogla janë të shpërndara kudo nëpër zonë. Afërsisht 20% e territorit të komunës formohet nga sedimente kuaternare të origjinës fluviale ose glaciale. Zonan e mëdha janë në veri mes Breznës dhe Bresanës, rreth Dragashit, si dhe përgjatë luginave në mallet e larta në jug të komunës.

7ha të pellgut të lumit Plavë janë aktualisht duke u gërmuar.


Brenda kufijve të komunës, Harta gjeologjike tregon 8 vende me depozita minerare:

- 3 depozita të xeheve së hekurit mund të gjenden rreth Zlipotokut
- 1 depozitë me bakër dhe merkur gjendet afër Mlikës
- 1 depozitë me bakër, plumb dhe kallaj gjendet afër Dikancës
- 1 depozitë me bakër, plumb dhe kallaj, molidben, volfram dhe arsenik afër and /Backës
- 2 zona gërmimi afër Restelicës and Lubovishtës, të dyja gjenden në shistë të gurëve të sedimentuar. Shpella mund të gjenden në zonat me gurë gëlqeror.


¹⁰¹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **“Udhëzuesi për planifikim hapësinor të vendbanimeve joformale”**

¹⁰² Atlasi për Zhvillim të Qendrushëm: Vëllim 2 (Draft) *Bazat*, UNDP, qershor 2012. Informacione të hollësishme shtesë gjenden në Atlasin për Zhvillim të Qendrushëm: Vëllimi 3 *Vlerësimi*, UNDP

Klasat e shkëmbinjve në Dragash



Grafiku 24: Klasat e gurëve në Dragash



Grafiku 25: Klasat e dheut në Dragash

Varieteti i gjerë e dherave në Dragash mund të përmbledhet në 8 klase:

- Shkëmb i zhveshur me shumë pak ose aspak zhvillim të mbulimit me dhe, afërsisht 1% e sipërfaqes, posaqërisht në mallet e larta dhe të rrëpira në jug;
- Litosole të reja, pak të zhvilluara në të gjithë llojet e shkëmbinjve dominojnë në zonat e rrëpira përgjatë luginave dhe maleve dhe e mbulojnë afërsisht 95 % të territorit;
- Faza e ardhshme e zhvillimit të dherave përfaqësohet nga ‘Rankerët’ në shkëmbitë acidik ose neutral dhe ‘Rendzinat’ në gurët gëlqeror. Këto dhera janë zakonisht të zhvilluar vetëm në sipërfaqe dhe mbulojnë rreth 70% të Dragashit– ‘Rankerët’ në male përgjatë kufirit lindor dhe jugor dhe ‘Rendzinat’ në masivin e Malit Koritnik në veri.

3.3.2 Shfrytëzimi i tokës¹⁰³

70% e territorit të of Dragashit karakterizohet me bar natyror – dhe toka me shkurre të shpërndara aty-këtu me zona shkëmbore apo zona me vegetacion të rrallë, ligatina dhe pyje.

Zonat me mundësi kultivim (kullotat, tokat bujqësore, dhe zonat heterogjene) përbëjnë rreth 26.6% të hapësirës komunale (11603ha). Për shkak të lartësisë së madhe, tokat barishtore apo kullotat dominojnë mbi tokat e lërueshme dhe kulturat e përhershme (18% kundrejt 9%). Zonat bujqësore me toka të lërueshme, kulturat e përhershme dhe toka me shfrytëzim kompleks të përbëra me kultura (të korra) vjetore dhe të përhershme me mur të gjallë janë të koncentruara në rajonin e Opojës. Nën-pellgjet e lumejve të Plavës dhe Prizrenit përbëjnë 86% të llojit të kësaj toke të shkrytëzuar. Në rajonin e Gorës, mund të gjenden zona të mëdha bujqësore rreth Gllaboçicës, Krushevës dhe Restelicës. Kullosat dhe

¹⁰³ Atlasi për Zhvillim të Qendrueshëm: Vëllimi 2, (draft) Bazat, UNDP, qershor 2012

fushat mund të gjenden kryesisht në një shirrit në lindje të fshatrave në rrëzë të maleve të larta. Nën-pellgjet e lumit të Plavës, Brodit dhe Restelicës përbëjnë 96% të këtyre llojeve të tokave të shfrytëzuara.

Një zonë shumë e ultë – 1% e territorit të komunës – është zënë nga sipërfaqet artificiale (rrugëtm ndertesat, vendbanimet, etj).

Pyjet përbëjnë 22% të territorit, të koncentruara jashtë Malit Sharr posaqërisht në luginat e lumejve Plavë, Brod dhe Restelicë dhe në Malin Koritnik ku ka një sasi të madhe të pyjeve me korrije. Pikat në lartësi të Malit Sharr janë gati pa pyje.

Malet e Sharrit karakterizohen me toka barishtore dhe shkurre natyrore dhe gjysëm-natyrore, të shoqëruara ligatina përgjat rrjedhave të lumejve dhe në rënie, zona me pak vegetacion dhe me shkëmbij. Këto lloje të tokave përbëjnë 50% të territorit të komunës.

3.3.3 Rreziqet natyrore¹⁰⁴

Zjarri

Sipas anketimeve të fshatrave, zjarret vërehen shpesh. Shumica e këtyre zjarreve ndodhin në pjesën qendrore dhe atë jugore të komunës, kryesisht në zonat malore, rurale. Zjarret mund të ndodhin nga shkaqe natyrore, kur vegetacioni ose mbeturinat fillojnë të digjen, por ato mund të nisen edhe nga faktori njeri dhe të shfrytëzohen për t'i pastruar kullotat nga shkurret. Për shkak të incidencës së lartë të zjarreve të krijuara nga njeriu, është me rëndësi të zgjidhet ky problem.

Ortekët

Zonat me rrezik të lartë për orteqe përkohë me zonat malore me anë të pjerrta të luginës, vecanërisht përgjatë luginave që cojnë në Brod dhe Restelicë, si dhe në zonat në perendim afër fshatrave Orçushë dhe Rapçë. Rreziku mesatar nga orteku ekziston afër fshatrave në veri dhe verilindje të komunës. Zonat në rrezik gjithashtu përkohë me ato që kanë pak zona pyjore, mbulesë kurore ose shkurre, që në njëfarë nënyre do të ofronin pak ndihmë. Rajoni i Gorës dhe pjesa perendimore e Opojës është shumë më e prirur për ortekë se sa zonat e urbanizuara më të dendura në verilindje Dragashit.

Më 4 shkurt 2012, një ortek bore e goditi fshatin Restelicë duke shkatërruar disa shtëpi pas një periudhe të gjatë me rreshje bore në një dimër jashtzakonisht të ftohtë. Dy nga këto shtëpi ishin të banuara në atë kohë dhe 10 persona vdiqën në këtë aksident, për të cilin thuhet të ketë qenë rasti më katastrofik që ka përjetuar komuna. Vendi është në pjesën më jugore të fshatit, gati jashtë vendbanimit.

Një grup prej 15 shtëpive që janë ndërtuar rishtas ndodhen në këtë pikë. Tre apo katër prej tyre janë shkatërruar tërësisht në ortek, ndërsa disa të tjera janë të dëmtura rëndë e disa pjesërisht. Vendi është ende i mbuluar me copa dhe mbetje inerte.


Orteku erdhi nga drejtimi juglindor Ka një kodër që është afërsisht 300m mbi vendbanimin, shpati i së cilës nuk është shumë i pjerrët, por është i gjatë dhe vazhdimisht i lakuar. Nuk ka fare drunj dhe vetëm disa shkurre që rriten, sigurisht për shkak të kullotjes tradicionale e madje me gjasë edhe djegies.

¹⁰⁴Informacione të hollësishme shtesë përmban Atlasi për Zhvillim të Qendrueshëm: Vëllimi 3, *Vlerësim*, UNDP, qershor 2012

Banorët më të vjetër të fshatit raportuan se vendi në fjalë quhet “vendi ortekut” tradicionalisht, meqë atë janë parë ortek më të vegjël herë pas here.

Tregjedia e fundit në Restelicë ka shtuar frikën nga katastrofat e tjera të mundshme në mesin e banorëve. Gjithashtu, ekziston edhe frika nga rreziku që vjen nga shembja e gurëve ose rrëshqitja e dheut në një pjesë tjetër të Restelicë, ku rreth dyqindë shtëpi gjenden nën disa skëmbinj guri. Raportohet që këta shkëmbinj i janë nënshtruar erozionit dhe që e kanë humbur në masë të madhe bazamentin e tyre. Kështu, ka mundësi që të fillojnë të lëvizin, qoftë nga vetë lëvizja e tyre apo si rezultat i ndonjë tërmeti të vogël.

Grafiku 26: Ortofotografi e Restelicës me tregues të qendrës historike dhe përhapjes së vendbanimit gjatë dekadës së fundit. Shigjeta e kuqe tregon rrugën e ortekut, rrethi i zezë i tregon shtëpitë e prekura.



Erozioni

Për shkak të terrenit malor dhe të rrëpirë, lartësive të mëdha, tokës së brishtë, sasive së madhe të ujrave, shfrytëzimit joadekuat të tokës dhe prerjës së tepër të vegjetacionit/pyjeve, ka rrezik të konsiderueshëm për erozion kudo në komunë. Pjesët veriore dhe verilindore të komunës (kryesisht rajoni i Opojës) janë kullota më të rrafshta, me rrezik të ultë apo mesatar të erozionit. Përjashtim këtu përbën pjesa në veri të Blaçit, në lindje të Kukit dhe përgjatë rrugës mes Xërxës dhe Rrencit, ku ka rrezik të lartë erozioni. Zonat rreth vendbanimeve të mëdha të Bresanës dhe Dragashit janë në rrezik të ultë-mesatar.

Zonat me rrezik të lartë të erozionit janë vecanërisht të theksuara në zonat jugoro-qendrore përgjatë luginave që shpiejnë në Brod dhe Restelicë dhe në perendim, rreth Malit Koritnik. Kjo është kryesisht rajoni i Gorës. Në rrëzë të Malit Koritnik ka rrezik shumë të lartë në perendim të fshatrave Rapçë dhe Kërstec. Gjithashtu, ka rrezik të lartë rreth fshatit Radeshë në skaj të vargut të Malit Sharr. Zona tjera me rrezik të lartë erozioni janë përgjatë rrugës për në Brod, me ku ka një zonë të konsiderueshme të rrezikuar rreth fshatit Baçkë. Rrezik të lartë për erozion ka edhe në perendim të fshatit Mlikë dhe në juglindje të fshatit Restelicës, ku zona para hyrjes në fshat përgjatë rrugës është gjithashtu në rrezik të lartë. Zlipotoku, gjithashtu, ndodhet në një zonë me rrezikshmëri të lartë të erozionit.

Vërshimet, rrëshqitjet e dheut dhe shembja e shkëmbinjve

Përderisa komuna e Dragashit posedon afërsisht rreth 3ha të rezervave (akumulime) ujore, ligatinat përbëjnë rreth 1889ha (4.3% e territorit) nga të cilat shumica (335ha) janë ligatina bregore përgjatë kufijve dhe brigjeve lumore. Ka edhe hapësira të vogla të moqaleve (pellgjeve) torfore dhe kënetave.¹⁰⁵

Vërshimet ndodhin pas rreshjeve të mëdha të shiut apo shkrirjes së borës. Zonat më të rrezikuara janë Bresanë, Bellobrad, dy zona rreth Brodit, dhe menjëherë në lindje të liqenit Brezne.

Rreziku i shembjes së gurëve rritet me rritjen e lartësisë, ku zonat më të prekura janë ato që ndodhen në lartësi të pjesës lindore të malit Sharr në rajonin e Opojës. Fshatrat që mund të përjetojnë shembje të gurëve për shkak të afërsisë me zonat e rrezikuara janë Rapça, Kërsteci, Mlika, Plava, Blaçi, Kuki, Brodi, Restelica dhe Zlipotoku. Megjithatë, asnjë nga këto fshatra nuk shfaqin rrezik të lartë të shembjes së gurëve. Në Restelicë ka frik serioze nga shembja e gurëve, posaçërisht tani kur popullsia është me e vetëdijësuar për rreziqet natyrore pas katastrofës me ortekun e borës në shkurt 2012.

Tërmetet

Kosova gjendet në zonën e tokës me seizmicitet aktiv, me vija të shkarjes që kalojnë përgjatë bregdetit të Adriatikut dhe luginës së Vardarit duke e bërë të prirur për tërmete.¹⁰⁶ Niveli i seizmicitetit është vlerësuar të jetë VII – VIII, që tregon për rrezik mesatar të dëmtimit të ndërtesave në rast të ndonjë tërmeti. Nuk ka pasur termite të regjistruara gjatë kohëve të fundit në rajonet që rrethojnë Dragashin¹⁰⁷, dhe ato që kanë ndodhur në ose afër Kosovës kanë qenë afërsisht të shkallës 2.7 – 4.8. Megjithatë, këto termite kanë qenë vazhdimisht me hipoqendër të cektë (në thellësi prej 2km nën

¹⁰⁵ Nga Baza e të dhënave e UNDP-së: Dragashi_balanci i shfrytëzimit të tokës 2011.xlsx

¹⁰⁶ Raport për Vlerësim të Kapaciteteve të Kosovës në Uljen e Rrezikut nga Katastrofat, UNDP Zyra për Prandalim të Krizave dhe Shpëtim, Ekipi për Ulje të Rrezikut nga Katastrofa dhe Shpëtim, Kapaciteti për Iniciativa të Uljes së Katastrofave, prill 2011. <http://www.gripweb.org/gripweb/sites/default/files/Kosovo%20DRR%20Cap%20Ass%20Report.pdf>, Qasur 26.03.2012

¹⁰⁷ Të dhëna nga Qendra Seizmike për Evropë- Mesdhe. Kërkimi varion nga 1.10.2004 deri 3.04.2012; thellësia 0-200km; shkalla 1-10. Për më shumë informacion, burimi: <http://www.emsc-csem.org> Qasur më 26.03.12.

sipërfaqe të tokës), që shton rrezikun nga dëmet në ndërtesa, rrëshqitjet e dheut, shembje të shkëmbinjve dhe rreziqeve tjera tokësore. Duhet të theksohet se shumica e dëmeve dhe lëndimeve nga tërmetet vjen nga konstruksioni dhe ndërtimi i dobët i ndërtesave se sa nga vet lëvizja e tokës.

3.3.4 Burimet e ujit¹⁰⁸

Në bazë të topografisë nuk ka ndonjë lidhje natyrale të lumit nga Dragashi në Prizren. Andaj, Dragashi nuk ka qasje të lehtë në zonën e Dukagjinit, një zonë e madhe pjellore që shtrihet në rajonin e Kosovës Perëndimore dhe që lidh në jug Prizrenin me qytetin e Gjakovës dhe të Pejës. Ky është një faktor tjetër i izolimit të Dragashit.

Uji është një burim i fuqishëm natyral në Dragash, me burime të shumta të ujit nga altitudat më të ulta e deri në zonat më të larta mbi 2500m, dhe në mesatare ka 1130mm/m² të reshura në vit. Densiteti mesatar për komunën është 2.1km të rrjedhave të ujit për një km² të sipërfaqës tokësore, me 0.4km të rrjedhave të mëdha permanente të ujit dhe 1.7km të atyre më të vogla apo të përkohshme. Përafërsisht 76% (700km) të rrjedhave të ujit të komunës së Dragashit gjenden në malet e rajonit të Gorës, ku luginat e lumit dhe liqenet e formuara nga shkrirjet e akullit kontribuojnë në numrin e madh të kanaleve të ujit. Rreth 24% të kanaleve ujore të Dragashit gjenden në Opojë (215km). Shumica e këtyre rrjedhave të ujit janë të vogla apo të përkohshme, me një gjatësi të përgjithshme prej gati 740km në tërë komunën. Rrjedhat e mëdha të ujit në Dragash janë përafërsisht 170km. Dy liqenet kryesore janë liqeni Shutman dhe liqeni Brezne.

Pellgu i Pllavës është zona e ujëmbledhjes së sasisë më të madhe të ujit në komunën e Dragashit, e cila grumbullon katër herë më shumë të reshura se lumenjtë e Lepencit apo të Restelicës, dhe gjendet në veri të komunës. Pjesa më e madhe e jugperëndimit të territorit të komunës i takon derdhjes së pellgut të lumit të Lepencit në detin Egje (6.761ha = 16% të territorit). Nën-pellgu i vetëm është ai i lumit të Lepencit.

Tabela 9: Të reshurat vjetore në m³ për pellgun ujëmbledhës

| Pellgu | Nën-pellgu | Sipërfaqja në ha | Të reshurat vjetore në m ³ |
|---------------------------------|--------------------|------------------|---------------------------------------|
| Lepenci | Lumi i Gurit të Zi | 6.761 | 80.950.634 |
| Lepeni gjithsej | | 6.761 | 80.950.634 |
| Drini i Bardhë | Lumi Brod | 9.118 | 107.711.462 |
| | Lumi i Pllavës | 17.573 | 191.584.988 |
| | Lumi i Restelicës | 7.090 | 81.590.998 |
| | Lumi Sotka | 603 | 6.075.304 |
| | Lumi i Prizrenit | 2.435 | 24.161.538 |
| Drini i Bardhë gjithsej | | 36.820 | 411.124.290 |
| Gjithsej në Komunën e Dragashit | | 43.581 | 492.074.923 |

¹⁰⁸ Nga Atlasi për Zhvillim të Qëndrueshëm: Volumi 3 i Vlerësimit, UNDP, qershor 2012.

Madhësia e pellgut të lumit të Pllavës është 29,730ha, me rrjedhë vjetore minimale prej 1.43m³/s dhe maksimale prej 14.4m³/s, duke dhënë kështu një mesatare prej 5.74m³/s. Sezona e rrjedhës së lartë varet nga shkrija e borës dhe zgjat nga shkurti deri në qershor.

Pllavë është burimi më i rëndësishëm i ujit në Dragash. Ajo formon një nën-pellg si pjesë e Drinit të Bardhë, pellgut më të madh të lumit në Kosovë që mbulon shumicën e pjesës perëndimore të vendit (84% të territorit) dhe që lidh qytetet kryesore të Kosovës. Drini i Bardhë në Dragash përbëhet nga nën-pellgjet e lumit të Restelicës, Lumit Brod, Lumit Sotka, Lumit të Pllavës dhe Lumit të Prizrenit.

Lumenjtë më të vegjël të Gurit të Zi dhe të Restelicës janë 9118ha, respektivisht 7090ha. Rrjedha vjetore mesatare e ujit të të parit është 2.31m³/s (minimumi 0.84m³/s, maksimumi 6.48m³/s) ndërsa e të fundit është 1.92 m³/s (minimumi 1.01m³/s, maksimumi 4.73m³/s). Lumenjtë e Restelicës, Klekut, Sopotnicës, Zlipotokut, Gurit të Zi, Cajlanskës, Serupskës dhe Suvës derdhen në nën-pellgun e Restelicës. Sezona e rrjedhës së lartë fillon në Prill për shkak të altitudës më të lartë të ujëmbledhësve.

Niveli i rrjedhave të ujit për të tre lumenjtë arrin majën në muajin maj, më së shumti për lumin e Pllavës, e cila gjithashtu ka një majë në muajin nëntor. Niveli më i ulët i rrjedhave të ujit arrihet prej muajit gusht deri në tetor për shkak të reshjeve të pakta, ndonëse kjo periudhë është më e shkurtër për lumin e Pllavës se për lumin Brod dhe lumin e Restelicës. Reshjet më të shpeshta nga shtatori deri në dhjetor rezultojnë në nivel më të lartë të rrjedhave.¹⁰⁹

Pyjet dhe lagunat janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në komunë. Kjo u hapi rrugë shkarkimeve të shpejta të të reshurave dhe shkrires së borës, dhe për këtë janë të rëndësishme në kontrollin dhe rregullimin e ekosistemeve në Dragash. Për shkak të terreneve malore, zonat më jugore të komunës (nën-pellgu i Gurit të Zi) kanë pak pyll dhe janë në mënyrë të konsiderueshme më pak rigjeneruese se zonat në veri, që përbëjnë më pak se 20% të zonës. Megjithatë, kjo mungesë mbulohet nga zonat e mëdha të lagunave (841ha) – gati 71% e tërë zonës së lagunave në komunë. Për dallim, pyjet e larta dhe pyjet e korive në pjesët veriore të komunës përbëjnë përqindje të larta të zonave ujore rigjeneruese, posaçërisht rreth Malit Koritnik dhe nën-pellgut të lumit Sotke.

Cilësia e ujit

Sa i përket cilësisë së ujit, 45 mostra për testim janë marrë nga 24 lumenjë të fshatrave përreth komunës në lokacione të ndryshme, në lartësi prej 910m deri në 1402 metra mbi nivelin e detit. Nga këto, 15 rezultuan me cilësi të shkëlqyeshme të ujit, kryesisht në lokacione që kanë një largësi nga rrugët kryesore dhe në vendbanimet në malet e Sharrit, përgjatë kufirit lindor të komunës që dërgon në fshatrat në jug. 14 nga mostrat u vlerësuan si shumë mirë dhe mirë (me gjasë ka ndotje organike) dhe këto kryesisht janë mostrat e marra nga zonat më rurale në jug dhe në perëndim. Dy lumenjë treguan cilësi të kënaqshme dhe relativisht të kënaqshme; 14 territoret që rezultuan me cilësi të dobët dhe shumë të dobët të ujit (ndotje e konsiderueshme dhe e rëndë) gjenden në zonat më të zhvilluara dhe në vendbanime të pjesës verilindore të komunës, afër rrugës kryesore për në Prizren.¹¹⁰

¹⁰⁹ Nga të dhënat e mbledhura prej 1954-1985, siç paraqiten në Atlasin për Zhvillim të Qëndrueshëm: Volumi 3 i vlerësimit, UNDP, qershor 2012.

¹¹⁰ Nga Vlerësimi i UNDP-së për Ujin.

3.3.5 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të zhfrytëzimit të tokës dhe dheu

70% e territorit të Dragashit karakterizohet nga kullosa natyrale dhe shkurre të larmuara me pjesë shkëmbore apo me vegetacion të rrallë, toka të lagura dhe pyje.

- Si mund të përmirësohet menaxhimi i shfrytëzimit të tokës, duke pasur parasysh konservimin e natyrës?

Reziquet natyrore, poasçërisht ortekët, erozionet dhe zjarret, janë rreziqet që duhet të merren parasysh seriozisht.

- Si mund të parandalohen humbjet e jetërave dhe të të mirave? Ku duhet të paraqiten intervenimet urgjente?

Uji është një resurs i fortë natyror në Dragash; ai kryesisht përballet me ndotjen organike.

- Si mund të mbrohen resurset e ujit nga humbjet dhe nga ndotja?
- Si mund të përmirësohet kualiteti i ujit?

3.4 Arsimi, Shëndetësia Dhe Mirëqenia Sociale

3.4.1 Arsimi

Përgjegjësit komunale dhe shtetërore lidhur me arsimin janë të përcaktuara me Ligjin për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 dhe me Ligjin për Arsimin Parauniversitar nr. 04/L-032. Komunitetet kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive në ofrimin e arsimit publik parashkollor, arsimit primar dhe arsimit sekondar, përfshirë licencimin e institucioneve të arsimit, rekrutimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve edukativ.¹¹¹ Roli i komunitetëve të Dragashit në arsimin lokal përfshinë ndërtimin e bashkëpunimit ndërmjet personelit të arsimit, nxënësve dhe prindërve, nxjerrjen e rregullave disiplinore, kodin e sjelljes dhe disiplinës, përzgjedhjen e drejtorëve dhe mësimitdhënësve, dhe mirëmbajtjen e riparimit të objekteve/ndërtesave shkollore përmes fondeve publike.¹¹²

SHËNIM: të dhënat në komunitetin e Dragashit i referohen notave 5-9 si 'Primare e Lartë'. Kjo terminologji do të përdoret në këtë Profil të PZhK-së, ndonëse shprehja standarde vendore (siç përkufizohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) është 'Sekondare e Ulët'.

Në bazë të statistikave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), janë gjithsej 444,029 nxënës/fëmijë të moshave 6-18 vjet në sistemin parauniversitar të Kosovës. Ka përqindje të lartë të regjistrimit në shkollimin primar (mbi 97%), përveç ndër komunitetet RAE në Kosovë, por qasja në shkollimin sekondar është më e ulët në rajonin e Evropës Juglindore. Gjithashtu ka edhe mungesë në qasjen në parashkollor; vetëm rreth 10% e fëmijëve në Kosovë marrin pjesë në programe të edukimit të hershëm. Përkundër rritjes në regjistrimin absolut dhe relativ të vajzave në shkollë, kjo është e kufizuar vetëm në shkollim primar dhe ka ende pabarazi, poasçërisht në nivel sekondar. Një grup tjetër në pozitë të disfavorshme janë fëmijët me nevoja të veçanta, 10% e të cilëve marrin pjesë në sistemin e përgjithshëm të arsimit dhe gati gjysma e të cilëve janë analfabetë.¹¹³ Deri më tani, nuk ka pasur asnjë

¹¹¹ Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

¹¹² Lista e përgjegjësive të Administratës Komunale sipas departamenteve, e siguruar nga UNDP në maj të vitit 2012.

¹¹³ Profili i Edukimit në Kosovë 2010, UNICEF, http://www.unicef.org/ceecis/Kosovo_2010.pdf. Qasur më 18.03.2012.

trajnim mbi arsimimin gjithpërfshirës për mësimdhënës, duke kontribuar kështu në mungesën e aftësive për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në mësim të rregullta. Me mbështetjen e organeve komunale të arsimit dhe të OJQ-ve që kanë programe të specializuara dhe të akredituara të trajnimit, trajnimet e tilla do të ofroheshin dhe gjendja do të përmirësohej për sa i përket regjistrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në mësim të rregullta.

Rëndësia e arsimit të vazhdueshëm dhe të cilësisë së lartë është e qartë kur merren parasysh mundësitë që ofron në të ardhmen. Nga numri i përgjithshëm i të papunëve në Kosovë, dy të tretat (përafërsisht 230,000 punëkërkues) konsiderohen 'pa aftësi', dhe gjysma e një të tretës tjetër (përafërsisht 60,000 njerëz) konsiderohen 'gjysëm të aftësuar' apo me 'aftësi të vjetëruara' (që kanë mungesë të mëdha në aftësi dhe mospërputhje të aftësive). Problemi i papunësisë që ndërlidhet arsimim të dobët është më i përhapur në zona rurale se në ato urbane.¹¹⁴

Një sondazh mbi familjet agrare i bërë në vitin 2008 në rajonin e Prizrenit tregon se vetëm rreth 3% e popullsisë së zonave agrare të moshës 15-49 vjet kanë përfunduar shkollimin sekondar, ndonëse 75% nga po e njëjta demografi kanë përfunduar shkollimin e lartë primar. Përafërsisht 6% e kësaj popullsie kanë përfunduar shkollimin e lartë.¹¹⁵ Nga këta, përafërsisht 3% e meshkujve kanë përfunduar shkollimin sekondar, në krahasim me 1% të femrave, dhe 46% e meshkujve (në krahasim me 23% të femrave) kanë përfunduar shkollimin e lartë primar.

Posaçërisht në zona rurale, femrat ballafaqohen me përjashtim të gjerë nga shkollimi dhe mundësitë e mësimi të përhershëm. Femrat luajnë rol të rëndësishëm në shoqëri si edukatore dhe shembuj, duke rritur zhvillimin kognitiv të fëmijëve; andaj, përjashtimi i femrave nga shkollimi dëmton shoqërinë kosovare në shumë drejtime. Shkollimi gjithashtu iu ndihmon femrave fermere që të adoptojnë teknologji për rritjen e produktivitetit, të kenë qasje në mundësitë bujqësore, marrjen e kredive bujqësore dhe investimin në aktivitete që gjenerojnë të ardhura. Pasi që familjet e udhëhequra nga femrat janë kryesisht të prekura nga varfëria e skajshme dhe privimi, shkollimi i femrave është një mbrojtës kundër varfërisë së skajshme. Shkollimi gjithashtu i fuqizon femrat duke i bërë më pak të varura financiarisht dhe më pak të ndjeshme në shoqëri. Gjithashtu u mundëson femrave që të marrin pjesë në mënyrë aktive si qytetare dhe votuese, gjë që rezulton në stabilitet më të madh dhe në kohezion shoqëror.¹¹⁶

Në Dragash, ekzistojnë 8929 të rinj banorë të përhershëm ndërmjet moshave 6 dhe 19. Kjo reflekton ata që duhet të vijojnë shkollimin e obligueshëm deri në moshën 15 vjeç dhe ata që mund të vazhdojnë për të mbaruar shkollën e mesme. Nga këta, rreth 94% të nxënësve vijojnë shkollimin e obliguar, ndërsa vetëm 62% vazhdojnë të kryejnë shkollën e mesme. Vendbanimet me më pak se 40% vijim në shkollën e mesme të gjithë gjenden në zonat më të largëta malore (Restelicë, Brod, Zlipotok dhe Rapçë). Pesë vendbanime tjera në rajonin e Gorës kanë shkallë të pjesëmarrjes në shkollë të mesme më pak se 60% (Orçushë, Kukulane, Radeshë, Krushevë dhe Vranisht). Përveç Xërxës dhe Pllajnikut (me 45% dhe 49%), të gjitha vendbanimet e Opojës kanë mbi 60% të të regjistruarve në shkollë të mesme. Për Vendbanimet Primare, si Restelica ashtu edhe Bresana shfaqin vijueshmëri të ulët në shkollë të mesme, njëra me 28%

¹¹⁴ Plani Strategjik Arsimit i Kosovës 2011-2016, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

¹¹⁵ Sondazhi mbi Familjet Agrare 2008, Zyra e Statistikave të Kosovës. SHËNIM: në shifrat, shkollimi i lartë primar quhet 'shkollë sekondare', dhe shkolla sekondare quhet 'shkollë e mesme'.

¹¹⁶ Rruga për në Lisbonë. Vlerësimi i nevojave të trajnimit profesional dhe krijimi i mundësive të vendeve të punës për gratë rurale, UNICEF 2008. Burimi: http://www.unicef.org/kosovo/Getting_To_Lisbon_-_English.pdf

dhe tjetra me 66%. Dragashi dhe Shajnja kanë numrin më të lartë të nxënësve të shkollës së mesme, me gjasë për shkak se shkolla e mesme gjendet në qendrën kryesore komunale në këtë zonë. Mesatarisht, shkalla e vijueshmërisë në shkollë të mesme në rajonin e Opojës është rreth 70.4% ndërsa në Gorë është 55.2%. Një numër i arsyeve mund të merren parasysh lidhur me këtë dallim. Së pari, transporti dhe qasja qoftë në Dragash apo në “shkollën paralele” në Mlikë është e gjatë, kushton dhe është e vështirë, posaçërisht gjatë dimrit dhe për vendet që janë të largëta. Pastaj, këto vendbanime rurale kanë një mbështetje më të vështirë (dhe me gjasë traditë më të thellë) në bujqësi dhe posaçërisht në blegtori. Nga një moshë e re, nga të rinjtë pritet të kontribuojnë dhe të ndihmojnë në këto aktivitete rurale që shpesh u lë pak kohë (apo mudësi) për studim apo punësim alternativ. Shkalla e ulët e vijueshmërisë mundet gjithashtu të jetë e shkaktuar për shkak të numrit të vogël të femrave që vazhdojnë shkollimin; familjet mund ta konsiderojnë më të rëndësishme për djemtë të shkollohen, ndërsa vajzat tradicionalisht kërkohet të mbështesin aktivitetet e amvisnisë qoftë në familjen e tyre apo të burrit.

| Fshati | Emri shkollës | Qendror / Satelitë (C/S) | Sistem (Kosovë/ Serbi) | Klasat parashkollore / Nr. i fëmijëve | Nota | Gjithsej m2 | Nr. I klasave | Nr nxënësve | Mashkull | Femër | Nr. mësimdhënësve | Kushtet e objekteve |
|------------|-----------------|--------------------------|------------------------|---------------------------------------|-----------|-------------|---------------|-------------|----------|-------|-----------------------------|---------------------|
| Baçkë | Zenuni | S | Kosovë | - | '1-4 | 91 | 2 | 4 | n/a | n/a | 3 | Keq |
| Bellobrad | Sezai Surroi | C | Kosovë | 1 klasë/ 12 | '1-5 | 708 | 10 | 95 | 50 | 45 | 15 | Keq |
| | | | | | '6-9 | | | 201 | 99 | 102 | | |
| Blaç | Ilmi Bahtijari | C | Kosovë | 1 klasë / 18 | '1-5 | 1962 | 22 | 108 | 57 | 51 | 39 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 286 | 160 | 126 | | |
| Brezne | Shaban Shabani | S | Kosovë | 1 klasë /20 | '1-5 | 830 | 19 | 168 | 91 | 77 | 11 | Mirë |
| Brod | Zenuni | C | Kosovë | 1/8 | '1-5 | 1750 | 12 | 122 | n/a | n/a | 20 | Mirë |
| | | | Serbi | | '1-8 | | | 70 | n/a | n/a | | |
| Bresanë | 28 Nentori | C | Kosovë | 3/20 (60 gjithsej) | '1-5 | 2013 | 22 | 317 | 174 | 143 | 40 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 281 | 150 | 131 | | |
| Brrut | Sezai Surroi | S | Kosovë | 1/18 | '1-5 | 790 | 5 | 100 | 49 | 51 | 6 | Mirë |
| Buçe | Shaban Shabani | S | Kosovë | 1/12 | '1-5 | 250 | 3 | 58 | 31 | 27 | 6 | Keq |
| Buzez | No school | n/a | Kosovë | - | n/a | n/a | n/a | n/a | n/a | n/a | - | n/a |
| Dikanc | Zenuni | S | Serbi | - | '1-4 | 250 | 3 | 15 | n/a | n/a | 5 | Keq |
| Dragash | Fetah Sylejmani | C | Kosovë | 2 (1 Shqip, 1 Boshnj.) | '1-5 | 1724 | 13 | 128 | 68 | 60 | 124 (me shkollën sekondare) | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 287 | 152 | 135 | | |
| Gllaboçicë | Svetlost | S | Kosovë | - | '1-5 | 164 | 2 | 70 | n/a | n/a | 5 | Mirë |
| Kapre | Sezai Surroi | S | Kosovë | - | '1-5 | 1100 | 12 | 35 | 14 | 21 | 3 | Mirë |
| Kosavë | Ulina | C | Kosovë | 1/12 | '1-5 | 370 | 5 | 76 | 43 | 33 | 15 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 97 | 57 | 40 | | |
| Kërstec | 9 Maj | S | Serbi | - | '1-4 | 116 | 2 | 10 | n/a | n/a | 5 | Mirë |
| Krushevë | Svetlost | C | Kosovë | 1/10 | '1-5 | 1140 | 8 | 51 | n/a | n/a | 18 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 42 | n/a | n/a | | |
| Kuk | Samedin Emini | C | Kosovë | 1/20 | '1-5 | 1080 | 16 | 122 | 60 | 62 | 23 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 164 | 77 | 87 | | |
| Kuklibeg | No school | n/a | Kosovë | - | n/a | n/a | n/a | n/a | n/a | n/a | - | n/a |
| Kukulanë | Fetah Sylejmani | S | Serbi | - | '1-4 | 324 | 3 | 10 | n/a | n/a | 5 | Mirë |
| Leshtan | Fetah Sylejmani | S | Serbi | - | '1-4 | 165 | 3 | 10 | n/a | n/a | 5 | Mirë |
| Lubovishtë | Fetah Sylejmani | S | S/(Ks) | - | '1-4(1-5) | 168 | 3 | 21 (4) | 11 | 10 | 5 | Mirë |
| Mlikë | 25 Maj | Shkollë e mesme(C) | Serbi | - | '9-12 | 141 | 2 | 150 | n/a | n/a | 5 | Keq |

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2013-2023 Profili Komunal i Dragashit për PZhK

| | | | | | | | | | | | | |
|--------------------------|-----------------|--------------------------|-----------------------------------|-------------------------------|------------|-----------------------------|----|-----------|------|------|---------------------------|----------------------|
| Orçushë | 25 Maj | S | Serbi | - | n/a | 144 | 2 | n/a | n/a | n/a | - | Keq |
| Pllavë | Shaban Shabani | S | Kosovë | 1/21 | '1-5 | 360 | 4 | 88 | 38 | 49 | 6 | Mirë |
| Pllajnik | Samedin Emini | S | Kosovë | - | '1-5 | 176 | 3 | 39 | 19 | 20 | 4 | Mirë |
| Radeshë | Fetah Sylejmani | S | Serbi | - | '1-4 | 144 | 3 | 16 | n/a | n/a | 5 | Mirë |
| Rapçë | 9 Maj | C | Ks/(Srb) | 1/10 | '1-5 (1-8) | 990 | 9 | 3 (100) | n/a | n/a | 14 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 11 | n/a | n/a | | |
| Restelicë | Restelica | C | Ks/(Srb) | 2/20 (40) | '1-5 (1-8) | 2200 | 25 | 122 (150) | n/a | n/a | 42 | Mirë |
| | | | | | '6-9 | | | 105 | n/a | n/a | | |
| Rrenc | Fetah Sylejmani | S | Kosovë | - | '1-5 | 210 | 3 | 61 | 31 | 30 | 5 | Mirë |
| Shajne | Fetah Sylejmani | S | Kosovë | - | '1-5 | 640 | 5 | 56 | 30 | 26 | 5 | Mirë |
| Vranisht | 25 Maj | C | Serbi | - | '1-8 | 286 | 4 | 35 | n/a | n/a | 5 | Keq |
| Xërxe | Fetah Sylejmani | S | Kosovë | - | '1-5 | 91 | 2 | 21 | 6 | 15 | 4 | Keq |
| Zaplluxhe | Ilmi Bahtijari | S | Kosovë | 1/20 | '1-5 | 320 | 3 | 112 | 57 | 55 | 6 | Mirë |
| Zgatar | Ilmi Bahtijari | S | Kosovë | 1/12 | '1-5 | 400 | 6 | 67 | 35 | 32 | 6 | Mirë |
| Zlipotok | Svetlost | S | Kosovë | 1/8 | '1-5 | 164 | 2 | 62 | 21 | 41 | 6 | Mirë |
| Zym | Sezai Surroi | S | Kosovë | - | '1-5 | 320 | 4 | 15 | n/a | n/a | 6 | Mirë |
| Llapushnik | Shaban Shabani | C | Kosovë | - | '6-9 | 830 | 7 | 226 | 125 | 101 | - | Mirë |
| Dragash/ shkollë e mesme | Ruzhdi Berisha | C për të gjitha fshatrat | Kosovë | - | '10-13 | 3590 | 22 | 965 | 609 | 356 | 124 (me shkollën primare) | Mirë |
| GJIHSEJ | | C = 14 S = 22 | Ks = 27 Srb = 9 Përzier = 3 | 301 minus shifrat e Dragashit | | Mesatarja 702m ² | | | 2314 | 1926 | 471 | Keq = 8 Mirë = 28 |

Tabela 103: Përmbledhje e shkollave të arsimit sipas fshatrave në komunën e Dragashit

Sistemi paralel

I ashtuquajtur "sistem paralel" do të thotë që Serbia, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, është duke financuar sistemin e shkollimit në rajonin e Gorës. Andaj, pagat e mësimdhënësve janë duke u paguar nga Qeveria e Serbisë, në vend që të jenë punonjës të Komunës së Dragashit. Mirëpo, mirëmbajtja e ndërtesave shkollore bëhet nga mjetet e Komunës së Dragashit. Në sistemin paralel, shkollimi i ulët primar përfshinë klasën 1-4 dhe shkollimi i lartë primar përfshinë klasën 5-8. Kjo është një vit më pak se në sistemin kosovar. Sistemi paralel gjithashtu ka program mësimorë të ndryshëm nga sistemi kosovar. Komuna nuk ka ndërhyrë në sistemin paralel, pasi që ka bërë kontribute të mëdha financiare për sistemin e edukimit, por është duke bërë përpjekje për të zvogëluar ndikimin e Serbisë, ashtu që nxënësit, për shembull, të mund të zgjedhin gjuhën dhe kurrikulën e shkollimit të tyre. 27 nga 39 shkollat në Komunën e Dragashit financohen nga institucionet e Kosovës, 9 financohen nga institucionet e Serbisë dhe 3 financohen pjesërisht nga Kosova dhe Serbia.

Qasja në arsim

Ka përafërsisht 5800 fëmijë të moshave shkollore (6 – 15) në Komunën e Dragashit. Përafërsisht 22% e këyre nxënësve janë aktualisht në shkollën sekondare në Dragash apo në Mlikë.

Densiteti i ulët i Dragashit në zona të vogla të vendbanimit do të thotë që parimi i "edukimit në pikën më të afërt" nuk mund të ndiqet pa përjashtime. Fshatrat Buzez dhe Kuklibeg nuk kanë fare objekte shkollore. Fëmijët nga këto fshatra shkojnë në shkollën e fshatit fqinj të Bresanës/Brodosavce. Në fshatrat e largëta e të papopulluara ka disa shkolla shumë të vogla, me të ardhme të paqartë: në Baçkë raportohet se janë vetëm 4 nxënës, derisa në fshatin Orçushë ka një ndërtesë shkollore me dy klasa dhe sipërfaqe prej 144m², por aktualisht nuk ka asnjë nxënës. Sidoqoftë, është e qartë se të jetosh afër një shkolle (siç është qyteti i Dragashit, Shajnja dhe vendbanimet e afërta) inkurajon pjesëmarrjen në shkollim. Për këtë arsye, qasja e lehtë është një aktor shumë i rëndësishëm në mbështetjen e arsimit të rinjve – dhe posaçërisht të femrave – në nivele më të larta. Kjo është e një rëndësie të veçantë në qendrat e mëdha siç është Restelica ku shkollimi përtej moshës 15 vjeç është shumë i ultë.

29 nga 36 fshatrat kanë shkollë të ulët primare (shkollat satelite, klasat 1-4/5). Katër vendbanime ofrojnë shkollim të ulët primar dhe shkollim të lartë primar (klasat 1-8): Vranisht, Restelicë, Brod dhe Rapçë. 10 fshatra kanë shkolla të larta primare (klasat 6-9) të ndara nga shkolla e ulët primare: Restelicë, Rapçë, Kuk/, Dragash, Bresanë, Blaç, Bellobrad, Zym, Krushevë dhe Llapushnik. Qyteti i Dragashit ka shkollë të ulët dhe të lartë primare si dhe shkollën kryesore sekondare në komunë. Në Mlikë është shkolla sekondare (sistemi paralel) për klasat 9-12. Fshati Mlikë ka shkollën sekondare që funksionin nën "sistemin paralel" për klasat 9-12, në të cilin ndjekin mësimet fëmijët e fshatrave të Gorës. 17 fshatra ofrojnë parashkollor, pesë nga të cilat gjenden në rajonin e Gorës.

Për dallim nga niveli i lartë i ofrimit të shkollimit të ulët primar për nxënës në pothuajse të gjitha vendbanimet, vetëm rreth gjysma e vendbanimeve kanë kapacitet për ofrimin e arsimit deri në minimumin e detyrueshëm prej 15 vjet (klasa 9) për largimin nga shkolla. Shtatë nga këto plotësojnë nevojat e rajonit të Opojës, derisa pesë shkolla shërbejnë për rajonin e Gorës, në secilën rrugëve degëzuese që shpjen në jug të qytetit të Dragashit (Brod, Restelicë, Vranisht dhe Krushevë), dhe në fshatrat përreth Malit Koritnik (Rapçë). Andaj, udhëtimi ndërmjet vendbanimeve për ndjekjen e mësimave në shkollën e lartë primare është i shpeshtë.

Raportet e kaluara kanë paraqitur shkallë të lartë të braktisjes së shkollës pas nivelit të shkollimit të ulët fillor (pas klasës së 4/5) në moshën rreth 11 vjeçare. Gjithashtu është raportuar se nxënësit e gjinisë mashkullore kanë qenë më të prirur se ato të gjinisë femërore për të vijuar shkollimin e mesëm dhe shkollimin e lartë. Të dhënat aktuale të mbledhura në vitin 2012 tregojnë se ka pasur përmirësime. Nga ata që vijnë në mësimet në klasat 6-9 të shkollimit të lartë fillor, 53% janë meshkuj dhe 47% femra. Në shkollën sekondare në Dragash, gjinitë tregojnë mosbaraspeshim, ku 63% të nxënësve janë të gjinisë mashkullore dhe 37% janë të gjinisë femërore. Kjo ndoshta tregon se shkollimi i meshkujve ende mund të ketë prioritet mbi shkollimin e femrave kur bëhet fjalë për sistemin formal të arsimit të lartë në Dragash. Përveç kësaj, të dhënat mbi gjinitë që vijnë në shkollimin nuk janë të disponueshme në 14 shkolla në komunë; shtatë nga këto janë shkolla të sistemit paralel, katër janë shkolla të financuara nga Kosova dhe tri janë shkolla me financim të përzier (Brod, Restelicë dhe Rapçë).

Kjo është në pajtim me trendet vendore, ku qasja e dobët në objektet arsimore pas moshës 10 vjeçare ndikon posaçërisht në shkollimin e vajzave. Kësaj i kontribuojnë edhe mungesa e burimeve financiare, vështirësitë e transportit dhe qasjes, si dhe qëndrimet tradicionale që inkurajojnë femrat për të qëndruar në shtëpi. Kjo është posaçërisht prevalente në zona rurale.¹¹⁷

Në bazë të Drejtorit për Arsim, pritet që vijimi i shkollimit sekondar të bëhet me ligj i detyrueshëm në Kosovë. Kjo do t'i jepte fund diskutimeve për nivelin e ulët të shkollimit sekondar dhe pabarazisë gjinore në shkollim në zona rurale. Përveç kësaj, një shkollë e re dhe e madhe sekondare është duke u ndërtuar në Dragash, afër fshatit Shajne, nën kompetencën e Ministrisë së Arsimit.

Shumica e femrave që mbarojnë shkollën e mesme kanë të mbaruar shkollën e mesme të mjekësisë¹¹⁸ dhe aktualisht janë të papuna, e që është në mospërputhje me mungesën aktuale të stafit mjekësor (shih më poshtë).

Stafi mësimdhënës

Ka gati 500 persona që punojnë në fushën e arsimit, të punësuar nga komuna. Andaj, sektori i arsimit është një nga punëdhënësit më të mëdhenj në Dragash, i mbikëqyrur nga Drejtori i Arsimit. Organizimi i brendshëm i Drejtorisë së Arsimit funksionon mirë; për shembull, ka vlerësime të brendshme të përgatitjeve të mësimdhënësve në baza të rregullta, si dhe bëhet monitorimi i kushteve fizike të ndërtesave shkollore. Kodi i Etikës për mësimdhënës ndalon ushtrimin e aktiviteteve politike në shkollë, sjelljen e dhunshme të mësimdhënësve, dhe synon shmangjen e diskriminimit kundër gjinisë, fesë dhe përkatësisë etnike.

Shkalla e proporcionit nxënës/ mësues

Në bazë të kërkesave shtetërore, duhet të ketë së paku 10 dhe më së shumti 35 nxënës për një mësimdhënës. Shkalla e proporcionit kombëtar nxënës/mësimdhënës aktualisht është mesatarisht rreth 32.3 nxënës për klasë në shkollat sekondare të Kosovës (që kryesisht ndodhen në zonat urbane) në krahasim me 23.3 nxënës për klasë në shkollat e ulëta fillore dhe shkollat e larta fillore.

¹¹⁷ Profili i Edukimit në Kosovë 2010, UNICEF, http://www.unicef.org/ceecis/Kosovo_2010.pdf. Qasur më 18.03.2012

¹¹⁸ Sipas përfaqësuesve të fshatrave Blaç, Brrut dhe Bellobrad gjatë një takimi me UNKT të mbajtur gjatë vitit 2011

Ky proporcion në vendet e BE-së sillet prej 10 deri në 19 nxënës për mësimdhënës. Numri mesatar i nxënësve për mësimdhënës në Dragash është 12.09 në 33 fshatrat që ofrojnë shërbime arsimore, që mund të duket e ngjashme me shkallën e proporcionit në Suedi dhe Belgjikë dhe gati përgjysmë më pak se proporcioni në vendin fqinj të FYROM (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), por kjo mund të shpjegohet me numrin shumë të ulët të popullsisë në disa nga fshatrat, gjë që shtrembëron rezultatet. Megjithatë, janë 7 fshatra me shkallë më të lartë të proporcionit nxënës / mësimdhënës (mbi 20). Vetëm 2 fshatra në Opojë kanë proporcion shumë të ulët nxënës / mësimdhënës prej më pak se 10 nxënës për mësimdhënës (Xërxe dhe Zym), derisa e njëjta gjë është edhe me 10 fshatra të Gorës (Baçkë, Kërstec, Krushevë, Kukulane, Leshtan, Lubovishtë, Radeshë, Rapçë, Restelicë, Vranisht). 70% e fshatrave (8 nga 12) me shkallë të ulëta të proporcionit gjenden në territoret që po kanë zvogëlim të popullsisë, e që nuk po reflektohet në numrat e të punësuarve. Dy fshatra kanë numër stabil të popullsisë, mirëpo përkundër kësaj kanë shkallë të ulët të proporcionit nxënës/mësues.

Objektet shkollore

Numri në rritje i nxënësve në Kosovë nuk është përcjellur me ndërtimin e objekteve të tjera shkollore, apo me mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese për të përballuar shfrytëzimin e madh.

Me standarde vendore kërkohet që të ketë 2.5m² për nxënës. Të gjitha shkollat në Dragash e tejkalojnë këtë kusht, kryesisht për shkak se ka numër të ulët të fëmijëve në fshatra në krahasim me madhësinë e objekteve ekzistuese shkollore. Përjashtim nga kjo bëjnë fshatrat: Bellobrad/Belobrad (2.4m²/nxënës), Gllloboçicë (2.3m²/nxënës), Kosavë (2.1 m²/nxënës), dhe Mlikë (0.9m²/nxënës). Shkolla sekondare (sistemi paralel) në Mlikë ka vetëm dy klasa për 150 nxënës. Sidoqoftë, objektet tjera shkollore ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për nxënës: në tërë komunën, sipërfaqja mesatare për nxënës është 8.7m², gati 3.5 herë më shumë se kërkesa vendore.

8 nga shkollat (në fshatrat Baçkë, Bellobrad, Dikanc, Orçushë, Mlikë, Xërxe dhe Vranisht) janë vlerësuar në sondazhet e UNDP-së në terren se kanë kushte të dobëta kur është vlerësuar gjendja e ndërtesës dhe pajisjet. Kjo përbëhet nga sondazhe të strukturës së ndërtesës (muret, dyshemetë, dritaret, dyert) dhe të orendive (tavolinat, karriget, dërrasat e zeza etj).

Nga viti 2007 deri në vitin 2011, ka pasur 23 projekte të financuara nga komuna për përmirësimin e shkollave, kryesisht në përmirësimin e kushteve ekzistuese (p.sh. vënia e dritareve të reja, kulmeve, shtruarja e dyshemeve etj). Investimi i komunës ka qenë përafërsisht 360,000 €, që i bie rreth 8% të buxhetit të përgjithshëm për pesë vitet.

Zbatimi i masave për energji efiçente për kursimin e derivateve dhe zvogëlimin e shpenzimeve të ngrohjes është një alternativë e mundshme për objektet shkollore (p.sh. për sistemet solare të ngrohjes së ujit).

Dhuna në shkolla

Ndonëse nuk është raportuar për ndonjë incident të madh në Komunën e Dragashit për raste të dhunës në shkolla, ka raste të dhunës më pak të rëndë ndërmjet vet nxënësve dhe ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve. Dëri më tani, Komuna e Dragashit nuk ka qenë e përfshirë në projektin e UNICEF-it për "Parandalimin e Dhunës në Shkolla" (zbatuar nga Qendra Kosovare për Arsim), por planifikohet që kjo

komunë të përfshihet në projekt gjatë vitit 2012. Strukturat përgjegjëse për qasjen e përgjithshme kundrejt dhunës në shkolla janë të formuara dhe përfshijnë Drejtorinë Komunale të Arsimit, Departamentin Rajonal të Inspeksionit Arsimor, Komisionet shkollore prind-mësimdhënës-nxënës, etj., duke formuar kështu të ashtuquajturat “Rrjete Mbrojtëse” të brendshme dhe të jashtme. Kjo, sikurse në shumë komuna (15) në tërë Kosovën, do të ketë ndikim në adresimin dhe kuptimin e çështjes së dhunës në shkolla, ku rezultati final pritet që të jetë krijimi i Shkollave të Dashura për Fëmijë, të lira nga çfarëdo forme e dhunës.

Transporti për në shkollë

Fëmijët shpesh ecin për në shkollë, përfshirë edhe deri në fshatrat fqinje. Kjo distancë është shumë e largët në tri fshatra, andaj komuna paguan minifurgonë për transportin e fëmijëve për në shkollë. Kjo nuk është e mundur në nivel të shkollimit sekondar për shkak të lokacioneve në Dragash dhe Mlikë. Ka 7 autobusë me të cilët transportohen nxënësit për në shkolla: 5 autobusa privat dhe 2 autobusa të komunës. Shpenzimet për këtë transport duhet të mbulohen nga familjet.

Shkrim leximi

Kosova ka një shkallë prej 92% të atyre që dinë shkrim lexim, nga 55,000 njerëz në Kosovë që janë analfabetë, gati 80% janë femra. Sidoqoftë, numri më i lartë i njerëzve analfabet janë të moshës mbi 75 vjeç¹¹⁹. Trajnimi nga UNICEF-i në Komunën e Dragashit është bërë në bazë të programit “Hap pas Hapi”. Sidoqoftë, me përfshirjen e OJQ-ve të grave lokale, programet e shkrim leximit do të vazhdojnë të ndihmojnë në rritjen e shkallës së shkrim leximit ndër femra.

Cilësia e arsimit

Ka përafërsisht 20,000 mësimdhënës që japin mësim në të gjitha nivelet e shkollimit parauniversitar në Kosovë, prej të cilëve rreth 30% janë të patrajnuar për të ligjruar programin e ri mësimor gjithpërfshirës në disa lëndë, pasi që ata i janë nënshtruar një trajnimi të bazuar në një lëndë në institucionet ekzistuese për trajnimin e mësimdhënësve.¹²⁰ Në Dragash janë 944 mësimdhënës të çertifikuar. Gjithashtu janë edhe 44 mësimdhënës të gjuhës angleze.

Niveli i trajnimit profesional i mësimdhënësve është i mbikëqyrur mirë nga komuna.

Trajnimet profesionale, zhvillimi i aftësive dhe mësimi i përhershëm

Trajnimi për Arsimin Profesional (TAP) në Kosovës shërben për një përqindje të lartë (56%) të popullsisë së nxënësve të nivelit sekondar. Ndonëse kjo nuk është e përfaqësuar në mënyrë të duhur në buxhetin publik, për të janë ndarë mbi një e treta (38%) e mjeteve të përgjithshme për zhvillim nga partnerët në fushën e arsimit. Shkollat profesionale në Kosovë gjithashtu veprojnë edhe si qendra për shkollimin e të rriturve për të plotësuar nevojat e të rinjëve në ‘klasa të ngelura’ dhe si programe për shkollimin e të

¹¹⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet Finale: Të Dhënat kryesore*; ndarja e siguruar sipas fshatrave.

¹²⁰ Profili i Edukimit në Kosovë 2010, UNICEF, burimi: http://www.unicef.org/ceecis/Kosovo_2010.pdf. Qasur më: 18.03.2012

rriturve që u ofrohen të rinjëve mbi moshën 15 vjeçare. Gjatë vitit 2008/09, janë organizuar programe në dyzet e katër shkolla dhe janë certifikuar më shumë se 3000 të trajnuar.¹²¹

3.4.2 Shëndetësia

Gjendja në vend

Në nivel të vendit në Kosovë ka ndarje të pamjaftueshme të mjeteve buxhetore për sektorin e shëndetësisë. Kjo vazhdon të pengojë përbushjen e nevojave themelore për nënat, shëndetin e fëmijëve, shëndetin publik dhe ushqimin. Së paku 80% (përafërsisht 45 milion euro) e tregut farmaceutik të Kosovës financohet nga pagesat prej xhepit të qytetarëve. Kjo shpeshherë, në mënyrë disproporcionale, bie mbi supet e qytetarëve nga komunitetet joshumicë (posaçërisht komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas), të cilët kanë të ardhura më të vogla dhe të cilët gjithashtu mund të ballafaqohen me stigmatizim nga personeli shëndetësor.

Statusi shëndetësor i nënave dhe i fëmijëve në Kosovë cilësohet si më i dobëti në rajon. Shkalla e mortalitetit të të posalindurve vlerësohet të jetë ndërmjet 35 deri 49 për 1,000 lindje (44 për 1000).¹²² Shkalla e mortalitetit perinatal në vitin 2010 ishte 19.1 për 1,000 lindje. Në vitin 2010 janë raportuar dy vdekje të nënave.¹²³ Kujdesi gjatë shtatzënisë konsiderohet i dobët në tërë vendin, me një mesatare prej katër vizitave gjatë shtatzënisë. Ky shërbim shëndetësor ofrohet kryesisht nga gjinekologët (98% të rasteve) dhe vetëm rreth 2% e grave shtatzënë vizitojnë mjekun familjar.¹²⁴

Studimet në tërë vendin tregojnë se në Kosovë ka përhapje të anemisë ndër fëmijët e moshave shkollore dhe gratë shtatzëna, ku 15.7% e të parëve dhe 23% e këtyre të fundit tregojnë probleme të lehta dhe mesatare të shëndetit publik në vend. Ngecjet në zhvillim gjithashtu janë identifikuar në 15.5% të fëmijëve të moshave shkollore, prej të cilëve 4.7% kanë përjetuar ngecje të mëdha në zhvillim.¹²⁵

Në bazë të Institutit Kombëtar për Shëndet Publik, mbulimi i vaksinimit në Kosovë është mbi 95%. Mbulimi i vaksinimit është më i ulët ndër komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Komuna e Dragashit ka një Qendër Kryesore për Mjekësi Familjare (në qytetin e Dragashit, që ofron ndihmë 24 orëshe), pesë qendra të mjeksësisë familjare dhe tetë ambulante shëndetësore.

Kriteret vendore për themelimin dhe punësimin e personelit në Qendër të Mjekësisë Familjare apo në Ambulante Shëndetësore janë:

- 1 Ambulante Shëndetësore për 6000 banorë
- 1 Qendër të Mjekësisë Familjare për 10,000 banorë

¹²¹ Plani Strategjik Arsimit në Kosovë 2011-2016, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, burimi: http://www.masht.gov.net/advCms/documents/KESP_2011_2016.pdf. Qasur më: 18.03.2012

¹²² Sondazhi për Kujdesin Shëndetësor Demografik, Kontributi nga UNICEF-i për Profilin e Planit Zhvillimor Komunal.

¹²³ Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000-2010, Ministria e Shëndetësisë, Kontributi nga UNICEF-i për Profilin e Planit Zhvillimor Komunal.

¹²⁴ Kujdesi gjatë Shtatzënisë në Kosovë: Cilësia dhe Qasja, UNICEF, 2009.

¹²⁵ Raporti i UNICEF-it 2010

- 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë për 100,000 banorë

- 1 mjek dhe 2 infermiere për 2,000 banorë

Për shkak të kufizimeve buxhetore nuk ka qendra shëndetësore në të gjitha fshatrat. Pavarësisht nga kjo, është bërë një hulumtim nëpër zona për të verifikuar ofrimin e shërbimeve mjekësore. Në bazë të këtij sistemi hierarkik, çdo objekt shëndetësor ka një zonë periferike (zonë të thellë) apo fshatrat përreth për t'u ofruar qytetarëve qasje në kujdesin shëndetësor. Zonat përreth të ambulanteve ofrojnë shërbim bazik mjekësor në nivel fshati, ndërsa zona përreth e Qendrës për Mjekësi Familjare ofron qasje shtesë në shërbimet specialistike shëndetësore për vendbanimin ku ata janë të vendosur si dhe për zonën që mbulohet nga ambulatat. Qendra Kryesore Mjekësore, e cila i shërben të gjithë komunës dhe ka standardin më të lartë të shërbimeve mjekësore, është e vendosur në qytetin e Dragashit. Lista e mëposhtme paraqet objektet aktuale mjekësore dhe zonat e tyre në nivel të shërbimeve bazike mjekësore:

Tabela 11: Përmbledhje e zonave që kanë objekte të kujdesit shëndetësor në Dragash

| Fshati | Lloji i qendrës shëndetësore | Fshatrat që mbulohen |
|--|------------------------------|----------------------|
| Dragash / | Qendra Kryesore Mjekësore | Shajne |
| | | Rrenc |
| | | Xerxe |
| | | Pllajnik |
| | | Lubovishtë |
| | | Kukulanë |
| Vranisht | Ambulante shëndetësore | Mlikë |
| | | Orçushë |
| Radeshë | Ambulante shëndetësore | Leshtanë |
| Bresanë | Qendra e Mjekësisë Familjare | Kulkibeg |
| Kuk | Ambulantë shëndetësore | - |
| Kosavë | Ambulantëshëndetësore | Buzez |
| Blaç | Ambulantë shëndetësore | Zapluxhe |
| | | Zgatar |
| Bellobrad | Qendra e Mjekësisë Familjare | Kapre |
| | | Brrut |
| | | Zym |
| Llopushnik * | Qendra e Mjekësisë Familjare | Buce |
| | | Brezne |
| | | Pllavë |
| Rapçë | Qendra e Mjekësisë Familjare | Kërstec |
| Brod | Ambulantë shëndetësore | Dikancë |
| | | Baçkë |
| Krushevë | Qendra e Mjekësisë Familjare | Zlipotok |
| Gllboçicë | Ambulantë shëndetësore | - |
| Restelicë | Ambulantë shëndetësore | - |
| *Nuk është në territor të fshatit (i është caktuar fshatit Brezne) | | |

Kjo strukturë e shpërndarjes së shërbimeve shëndetësore mbetet një mangësi. Në Restelicë, ku banojnë mbi 4,200 banorë, nuk ka Qendër të Mjekësisë Familjare andaj banorët duhet të shkojnë në Krushevë.

Komuna konsideron se ndërtimin e objekteve mjekësore ka përfunduar. Megjithatë, përmirësimet e mëtejme të pajisjeve fizike dhe teknike për të realizuar standarde moderne do të jenë të nevojshme në të ardhmen.

Kushtet e transportit janë një tjetër fushë ku nevojitet të bëhen përmirësime. Për shembull: pacientët të cilët kanë nevojë për dializë të rregullt të gjakut duhet të transportohen në Prizren tri herë në javë. Për këtë transport nevojiten më shumë automjete dhe ngasës.

Në vitin 2010, në bazë të Zyrës Statistike të Kosovës, ka pasur 86,179 vizita në objektet e kujdesit shëndetësor në Dragash.

Tabela 12: Krahasimi i vizitave në objektet shëndetësore të Dragashit me mesataren e vendit¹²⁶

| Vendndodhja | Numri i vizitave në Dragash | % e vizitave të përgjithshme në Dragash | Mesatarja kombëtare e % së vizitave të përgjithshme |
|--|-----------------------------|---|---|
| Mjekësia familjare | 34577 | 40.12% | 43.4% |
| Departamenti për nëna dhe fëmijë | 5775 | 6.70% | 3.4% |
| Departamenti i gjinekologjisë dhe maternitetit | 2450 | 2.84% | 1.2% |
| Kirurgjia e vogël | 15266 | 17.71% | 23.7% |
| Laboratori | 8207 | 9.52% | 6.9% |
| Emergjencia | 6832 | 7.93% | 3.8% |
| Shërbimet e tjera të specializuara | 6548 | 7.61% | 12.6% |
| Stomatologjia | 6522 | 7.57% | 5.0% |
| GJITHSEJ | 86177 | 100% | 100% |

Në bazë të këtyre të dhënave, Dragashi përbën 2.3% të të gjitha vizitave në objekte shëndetësore në Kosovë, duke qëndruar pakëz mbi mesataren e vendit prej 1.9%. Pasi që Komuna e Dragashit përbën përafërsisht 1.9% të popullsisë së përgjithshme, frekuenca e vizitave në institucionet e shërbimeve shëndetësore është pakëz më e lartë se mesatarja. Për çdi vit, mesatarja e numrit të vizitave për person në institucionet e shërbimeve shëndetësore në Dragash është 2.5, ndërsa mesatarja e vendit është 2.2.

Shumica e vizitave ishin në Qendrat e mjekësisë familjare (40.12%), ndërsa për nga frekuentimi pason klinika e kirurgjisë së vogël (17.71%). Ka dukshëm më pak vizita në klinikat e gjinekologjisë dhe

¹²⁶ Bazuar në të dhënat nga Zyra Statistike e Kosovës, 2010

maternitetit se në shërbimet tjera në Dragash, kryesisht për shkak se ka vetëm 1 gjinekolog dhe 4 mami në tërë komunën, përkundër faktit se kërkohet që të jenë 3.4, respektivisht 6.8. Në vitin 2011, materniteti në Dragash ka raportuar për 124 lindje. Rastet më të komplikuaa dërgohen në repartin e maternitetit në Prizren; ka gjithashtu edhe raste që vet shkojnë në Prizren. Sidoqoftë, shfrytëzimi i klinikës së maternitetit është dyfish më shumë se shkalla në nivel vendi. Ka shfrytëzim më të lartë të të gjitha klinikave në krahasim me mesataren e vendit, me përjashtim të mjekësisë familjare, intervenimeve dhe shërbimeve të tjera të specializuara, ndonëse këto mbeten në linjë me trendet në tërë vendin si shërbimet më të frekuentuara. Për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme, nuk janë të disponueshme shifra më të sakta.

Stafi mjekësor

Tabela 13: Lista e stafit mjekësor në Komunën e Dragashit (2012)¹²⁷

| Fusha | Numri i punëtorëve në Dragash | Kërkesat vendore për staf: 1 për numrin e banorëve | Kërkesa minimale për staf në Dragash (popullsia 34000) |
|---|-------------------------------|--|--|
| Mjek (1 mjek për Vesh, Hundë dhe Fyt; 9 mjekë pa specializim) | 14 | 2000 | 17 |
| Infermiere | 31 | 1000 | 34 |
| Pediatër | 1 | | |
| Gjinekolog | 1 | 10000 | 3 |
| Mami | 5 | 5000 | 7 |
| Radiolog | 1 | | |
| Stomatolog | 5 | 5000 | 7 |
| Teknik i stomatologjisë | 4 | | |
| Teknik i laboratorit | 6 | | |
| Farmacist | 4 | | |
| GJITHESEJT | 72 | | |

40% e pozitive në institucionet shëndetësore në Dragash mbahen nga persona të përkatësisë Gorane-Boshnjake, ndërsa të tjerët janë shqiptar të Kosovës, që tregon një nivel të mirë të përfaqësimit të komunitetit joshumicë në poste të sektorit publik në fushën e shëndetësisë dhe kjo është në proporcion me përfaqësimin e popullit.

Numri i stafit që mund të punojnë në sistemin shëndetësor të komunës është i kufizuar nga Ministria në bazë të numrit të popullsisë. Në bazë të informacioneve të dhëna nga Drejtori për Shëndetësi, numri i fundit i të punësuarve në shërbimet shëndetësore të Dragashit është 103 punonjës në përgjithësi. Por

¹²⁷ Shifrat e marra nga Drejtori për Shëndetësi, Maj 2012 dhe të adaptuara në bazë të punës në terren.

numri i stafit nuk plotëson minimumin e numrit standard të mjekëve, infermierëve, stomatologëve, gjinekologëve apo të mamive sipas rregullave kombëtare për staf për numër të banorëve në Dragash. Komuna ka vështirësi në gjetjen e specialistëve siç janë gjinekologët, pasi që ata preferojnë të punojnë në zona urbane.

Cilësia e objekteve mjekësore

Prej vitit 2007 deri më 2011, përafërsisht 200,000€ të buxhetit investues të komunës janë shpenzuar në sektorin e shëndetësisë. Kjo përbën rreth 4% të buxhetit të përgjithshëm.

Kushtet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash janë përmirësuar pas instalimit të sistemit solar të ujit dhe revitalizimit të rrjetit të ujit të ngrohtë me nxemjen qendrore të ujit. Qendra e Mjekësisë Familjare në Bresanë gjithashtu është përmirësuar pas instalimit të sistemit të ngrohjes solare të ujit dhe të rrjetit të ujit të ngrohtë me nxemjen qendrore të ujit.

3.4.3 Mirëqenia Sociale

Gjendia shtetërore

Mandati i Qendrave për Mirëqenie Sociale shërben për mbrojtjen e qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë, duke iu mundësuar shërbime sociale dhe familjare, përfshirë shërbime për mbrojtje të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Punon në bashkëpunim me komunitetet, OJQ-të dhe organizatat e tjera. Ofruesit e shërbimeve sociale në Qendrën për Punë Sociale janë të detyruar të kryejnë vlerësim profesional mbi nevojat e shërbimeve sociale për fëmijë dhe familje të cilat kërkojnë ndihmë apo të cilat përmes mënyrave tjera dallohen si në nevojë ose që duket të jenë në nevojë për Shërbime Sociale ose Familjare. Ofron kujdes social, këshillim familjar, dhe në rrethana të veçanta, ndihmë materiale ndaj fëmijëve dhe familjeve të tyre. Ata janë gjithashtu të detyruar që të vendosin fëmijën në një objekt jashtë atij familjar kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se ka një rrezik të menjëhershëm për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës.

Në përgjithësi, sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve në Kosovë është i pamjaftueshëm dhe i fragmentuar, me shërbime të kufizuara për fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e neglizhuar, fëmijët pa përkujdesje prindërore, viktimat e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, fëmijët që punojnë si dhe fëmijët që kanë rënë ndesh me ligjin.

Ka nevojë për të rritur vetëdijesimin e komuniteteve, institucioneve publike (shkollave, qendrave rinore, shërbimeve shëndetësore etj.) dhe organizatave mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Ka nevojë edhe për rritjen e njohurive të palëve të interesuara të cilat punojnë me fëmijë me anë të trajnimeve shumësektoriale mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilat për shkak të mandatit të kujdesit kundrejt fëmijëve janë ligjërisht të detyruara që të raportojnë rastet e mbrojtjes së fëmijëve në Qendrën për Punë Sociale kur dyshojnë ose kanë dëshmi se një fëmijë po vuan nga abuzimi fizik, seksual apo psikik nga prindi apo kujdestari.¹²⁸ Për të rritur detyrimin ligjor, ka nevojë urgjente për të hartuar forma të veçanta të referimit të rasteve të dhunës dhe të abuzimit, në të gjitha institucionet të cilat për shkak të mandatit apo rolit të tyre kanë përgjegjësi për kujdesin ndaj fëmijëve. Më saktësisht, format unike

¹²⁸ Neni 10 i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare (No. 02/L-17).

apo standarde ose referimet duhet të jenë të hartuara për mësuesit apo stafin mbështetës në shkolla, mjekët, infermierët dhe ndihmësit mjekësor, zyrtarët e shërbimeve sociale, zyrtarët policor, prokurorët,

gjyqtarët dhe avokatët mbrojtës për të rritur identifikimin, referimin dhe trajtimin e mëtutjeshëm të këtyre rasteve.⁸¹ Për të përforcuar referimin dhe menaxhimin e rasteve për mbrojtjen e fëmijëve në Dragash, duhet të zhvillohet një mekanizëm koordinues me palët e interesuara relevante që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve. Synimi i mekanizmit të koordinimit për mbrojtjen e fëmijëve është për t'i referuar, menaxhuar dhe monitoruar rastet e fëmijëve në rrezik mesatar apo të lartë të kriminalitetit, neglizhencës, abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit gjatë takimeve mujore të profesionistëve.⁸²

Gjendja në Dragash

Komuna e Dragashit i ofron këto shërbime: mbrojtjen e fëmijëve, kujdesin ndaj të moshuarve, mbështetje për pacientë me sëmundje kronike, mbështetje për ish-shkelësit e ligjit, strehim social, këshillim psikosocial, terapi të ndryshme, adoptim, koordinim me shkolla, bashkëpunim me gjykata dhe organizata të tjera. Ka një Qendër kryesore për Mirëqenie Sociale në qytetin e Dragashit, e cila ofron dhe koordinon shërbimet për të gjitha fshatrat e komunës.

Asociacioni i Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar vepron në Dragash, ku trajtohen persona me aftësi të kufizuara dhe kujdeset për 420 anëtarë të moshave të ndryshme në një objekt të specializuar.

Tabela 14: Mirëqenia sociale e ofruar në vitin 2011 sipas muajve

| Muaji | Nr i përgjithshëm i familjeve të përfshira | Nr i anëtarëve të familjes | Shuma e përgjithshme € |
|----------|--|----------------------------|------------------------|
| Janar | 412 | 1495 | 25,775 |
| Shkurt | 432 | 1568 | 27,510 |
| Mars | 433 | 1587 | 27,320 |
| Prill | 429 | 1559 | 27,040 |
| Maj | 394 | 1397 | 24,560 |
| Qershor | 405 | 1436 | 25,450 |
| Korrik | 398 | 1415 | 24,735 |
| Gusht | 397 | 1407 | 25,225 |
| Shtator | 411 | 1476 | 26,095 |
| Tetor | 422 | 1509 | 27,190 |
| Nëntor | 427 | 1524 | 26,850 |
| Dhjetor | 450 | 1619 | 28,915 |
| Gjithsej | | | 316,745 € |

⁸¹ Raporti Përmbledhës për Hartimin dhe Vlerësimin e Sistemit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë. Konsultimi DeLegibus 2011.

⁸² Rrjeti i Sigurisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Terre des Hommes 2012. Burimi: <http://tdh.ch/en/countries/kosovo>

Tabela 15: Mirëqenia sociale e ofruar në vitin 2011 sipas kategorisë

| Lloji i mirëqenies | 2011 | Gjithsej |
|---|------|----------|
| Fëmijët pa përkujdesje prindërore | | |
| Jetimët | 2 | 31 |
| Jetimët nën përkujdesjen e familjes | 2 | 15 |
| Fëmijë të braktisur | 2 | 6 |
| Prindër të paaftë ⁸³ | 0 | 7 |
| | | |
| Fëmijë në rrezik | | |
| Fëmijë të neglizhuar / fëmijë të abuzuar | 4 | 12 |
| Fëmijë të prindërve të pamartuar | 8 | 18 |
| Fëmijë të prindërve të shkurorëzuar | 3 | 69 |
| | | |
| Delikuencë / të rinjtë | | |
| Fëmijët nën përkujdesje sociale nën moshën 14 vjeçare | 12 | 53 |
| Delikuenca e të miturve (14-16 vjet) | 0 | 62 |
| Delikuenca e të miturve (16-18 vjet) | 3 | 95 |
| | | |
| Fëmijë dhe të rritur me nevoja të veçanta | | |
| Psikologjike | 0 | 21 |
| Fizike | 4 | 26 |
| Të kombinuara | 3 | 43 |
| | | |
| Fëmijë/Viktima të trafikimit | 0 | 0 |
| Fëmijë | 0 | 0 |
| Të rritur | | |
| | | |
| Të rritur me nevoja të veçanta | | |
| Psikologjike | 0 | 156 |
| Fizike | 0 | 196 |
| Të kombinuara | 0 | 61 |
| | | |
| Të rritur në rrezik | | |
| Të rritur jashtë statusit normal martesor | 8 | 29 |
| Dhunë në familje | 5 | 46 |
| Persona në proces të shkurorëzimit | 8 | 38 |
| | | |
| Të rritur me sjellje anti-sociale | | |
| Persona të pastrehë | 0 | 6 |
| | | |
| Të moshuar me nevoja për mirëqenie sociale | | |
| Pa mbështetje familjare | 1 | 133 |
| Të moshuar me nevoja të veçanta | 0 | 27 |

⁸³ Përkufizuar si “Prindër ose prind, ose kujdestar tjetër, të cilët qoftë për shkak të mënyrës së jetesës, paaftësive fizike apo mendore ose sëmundjeve, problemeve psiko-sociale, varshmërive apo arsyeve tjera, kanë vështirësi për të ofruar nivele adekuate të kujdesit apo mbikëqyrjes për të”, në Nenin 7, 9 dhe 10 të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare (Nr. 02/L-17).

Tabela 16: Ofrimi i shërbimeve

| Lloji i shërbimit | 2011 | Gjithsej |
|--|------|----------|
| Adoptim | 0 | 3 |
| Kujdestar | 2 | 20 |
| Kujdestar i familjes | 0 | 3 |
| Shtëpi e sigurt | 0 | 6 |
| Trajtim për integrim social | 20 | 125 |
| Kujdes për të rritur | 1 | 10 |
| Mbështetje për martesë nën moshën e lejuar | 8 | 44 |
| Objekte për kujdes ndaj të moshuarve | 1 | 4 |

Qendra për punë sociale gjithashtu ofron shërbime për të mbijetuarit dhe dëshmitarët e dhunës në familje. Aktualisht në Dragash nuk ka mekanizëm për koordinim komunal për dhunë në baza gjinore apo dhunë në familje.

“UN Women” (Gratë e KB) është gati për të filluar mbështetjen e krijimit të një Mekanizmi Koordinues në Dragash. Në koordinimin dhe drejtimin e Zyrtarit Komunal për Barazi Gjinore, ky mekanizëm duhet të vendosë struktura të rregullta të koordinimit dhe komunikimit në mes palëve të interesuara nga sektorët përkatës, siç janë shërbimet sociale, policia, shëndetësia, drejtësia dhe arsimit, me qëllim që të mundësojnë shërbime më të mira për të mbijetuarit e dhunës në bazë gjinore apo dhunës në familje dhe për të siguruar shërbime cilësore për ta. Ka mungesë edhe të vetëdijesimit tek fëmijët dhe tek të rinjtë për të raportuar/paraqitur dhunën, abuzimin dhe moskujdesin. Aktualisht ka shërbime shumë të kufizuara për të mbijetuarit dhe dëshmitarët e dhunës në Dragash, dhe të mbijetuarit me fëmijët e tyre varen nga strehimi në Prizren. Ka nevojë për të mbështetur themelimin e shërbimeve adekuate për të mbijetuarit, dëshmitarët dhe kryesit e dhunës në familje. Në përgjithësi ka nevojë për zhvillimin e një politike të qartë sociale në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, në mënyrë që të sigurohet një kornizë gjithëpërfshirëse dhe multisektoriale për zhvillimin e shërbimeve të specializuara në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe riintegrit të fëmijëve viktime të të gjitha formave të dhunës, moskujdesit dhe abuzimit.

Për të rritur vetëdijësimin për çështje që kanë të bëjnë me dhunë dhe të drejtat e fëmijëve, Zyra Komunale për Barazi Gjinore në Dragash, me mbështetje të komunës, agjencive dhe organizatave që punojnë në fushën e dhunës në familje ose dhunës në bazë gjinore, gjatë 16 ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës në bazë gjinore organizon aktivitete kundër dhunës për grupe të ndryshme. Në vitin 2011 kjo është organizuar me mbështetjen e OSBE-së. Zyra gjithashtu organizon aktivitete që kanë të bëjnë me mandatin e zyrës, por për shkak të fondeve të kufizuara aktivitetet mund të organizohen vetëm ad hoc.

3.4.4 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale
Ekziston një sistem paralel shkollor në rajonin e Gorës që do të thotë se ekziston mungesë e koordinimit dhe e mbikëqyrjes së shërbimeve të arsimit; kjo zvogëlon koherencën e komunës si njësi hapësinore dhe nuk kontribuon pozitivisht në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve si dhe në ndërtimin e tolerancës.

- Si mund të zgjidhen dallimet ndërmjet sistemit shkollor serb (paralel) dhe atij kosovar në komunën e Dragashit?

Dragashi ka një strukturë specifike të vendbanimeve me 36 vendbanime të vogla dhe të rralla; madje çdo fshat ka shkollë, nga kjo del se raporti nxënës : mësues në disa fshatra është mjaft i ulët.

- Si mund të sigurohet parimi kombëtar i “Arsimit në pikën më të afërt”?
- Si duhet shkollat konsiderohen shkollat që kanë numër të vogël të nxënësve?

Edhe pse ka pasur një përmirësim disa nxënës (posaçërisht vajzat) megjithatë nuk mbarojnë shkollën e mesme.

- Si mund të lehtësohet qasja në arsimin e mesëm, posaçërisht për vajzat?
- Si mund të mbështeten burrat dhe gratë e pakualifikuar?

Edhe pse sistemi shëndetësor i Dragashit realizon standardet kombëtare, ekziston një mungesë e stafit mjekësor në disa pjesë të komunës.

- Si mundet mungesa e specialistëve dhe e pajisjeve të zgjidhet nëpër fshatrat e vogla dhe në zonat e thella?

Qendra për Punë Sociale është e vendosur në qytetin e Dragashit, e cila siguron dhe koordinon shërbimet për të gjitha vendbanimet në komunë.

- Si mundet PZhK të kontribuojë në përmirësimin e situatës sociale dhe në mirëqenie të qytetarëve të Dragashit?

3.5. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI

3.5.1 Zhvillimi Ekonomik

Mes viteve 2004 dhe 2009, numri i kompanive të regjistruara në Dragash është rritur me 54%.⁸⁴ Rritja në të gjithë Kosovën për të njëjtën periudhë kohore është 82%. Vetëm Novobërda (44%) dhe Leposaviqi (52%) kanë shkallë më të ulët të rritjes.

Ndërmarrjet e regjistruara janë kryesisht biznese shumë të vogla, që shpeshherë mundësojnë punësim vetëm për pronarin. Numri i përgjithshëm i vendeve formale të punës në komunën e Dragashit konsiderohet të jetë rreth 2500.

Spektori më i madh për biznes në Dragash është tregtia dhe shpërndarja, pasuar ngushtë nga prodhimi. Shumica e tregtisë ndodh përmes dyqaneve lokale: dyqaneve ushqimore, punishteve ndërtimore, depove dhe pompave të derivateve. Ofrohet një numër shumë i vogël i komoditeteve tjera, siç janë shitja e ngjyrës, stolive, lëkurës, tekstilit dhe veglave. Katër barnatore gjenden në qytetin e Dragashit dhe një në Bellobrad, një në Blaç dhe dy në Bresanë.

Përsa i përket prodhimit, vetëm gjashtë biznese janë të regjistruara, shumica me vetëm një të punësuar që përpunon lëndën e parë (siç është druri). Kontribut i madh në tregun e punësimit vjen nga fabrika e tekstilit Remateks në qytetin e Dragashit, e cila ofron 380 vende pune kryesisht në prodhimin e

⁸⁴ Zyra Statistikore e Kosovës, Raporti Statistikor i Ndërmarrjeve në Kosovë, Ç4 – 2009.

pëlhurave sintetike, me një sasi të vogël të prodhimit të leshit, si dhe është punëdhënësi më i madh në komunën e Dragashit. Tregu kryesor për këto produkte është jashtë vendit. Stafi administrativ vjen gjithashtu nga Prizreni, por kompania ofron transport falas për punëtorët nga Dragashi. Kompania ishte themeluar më 1982, para konfliktit të vitit 1999 fabrika ka grumbullar lesh.

Një tjetër pjesë e rëndësishme e tregut të punës gjenerohet nga ndërmarrjet e shërbimeve dhe ato ushqimore; kjo kryesisht lidhet me kafenetë, baret dhe restorantet të cilat ekzistojnë në shumicën e fshatrave, e jo me hotele pasi që industria e turizmit është ende e pazhvilluar dhe ka vetëm një hotel të regjistruar. Punëdhënësi më i madh brenda këtyre sektorëve është qyteti i Dragashit, me 35 biznese të regjistruara, pasuar nga Restelicë me 23. Një numër relativisht i madh i bizneseve të regjistruara ka qenë e pamundur të identifikohen apo nuk kanë ekzistuar (10%).⁸⁶ Kjo mund të jetë për shkak se ato mund të jenë mbyllur që prej regjistrimit apo të kenë ndryshuar vendndodhjen apo organizimin në ndonjë mënyrë tjetër.




Figura 27: Bizneset e regjistruara në Dragash sipas sektorit

Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria paraqesin vetëm 1% të bizneseve të regjistruara në komunë, që do të thotë se ka shfrytëzim të pakët të burimeve natyrore të disponueshme për gjenerimin e të ardhurave. Megjithatë, shumica e aktiviteteve bujqësore që bëhen në Dragash janë joformale dhe për sigurimin e ekzistencës, duke ofruar ushqim për familje private, ku në disa raste teprica shitet në treg. Sondazhet në fshatra kanë konfirmuar se në çdo fshat zë vend një nivel i lartë i kultivimit të frutave dhe perimeve, krahas rritjes së pulave dhe bletëve për vezë dhe mjaltë. Kjo bujqësi e shkallës së ulët lejon një ulje të përgjithshme në shpenzimet shtëpiake, si dhe një mënyrë jetese të vetëmjaftueshme dhe të qëndrueshme e cila duhet të çmohet dhe të inkurajohet, edhe pse një trend i përgjithshëm i vënë re në mbarë Kosovën është se familjet që marrin para të dërguara nga vendet e jashtme shpenzojnë më shumë në artikuj të përditshëm siç janë ushqimi dhe veshmbathjet.

⁸⁶ Databaza e UNDP-së për fshatrat e Dragashit, 2011

Qendra ekonomike dhe biznesore është qyteti i Dragashit, me 228 biznese të regjistruara nga 856 sa janë gjithsej në tërë komunën dhe përbën shumicën e sektorëve të shërbimit. Bresana dhe Restelicë janë dy nënqendra biznesore (88, respektivisht 95 biznese). Ka më pak se 50 biznese në 33 vendbanimet tjera, me 13 vendbanime që kanë më pak se dhjetë biznese e të cilat gjenden në dy grupime vendbanimesh – nga Buçëja deri në Pllajnik dhe nga Kërsteci në Zlipotok.

Tabela 17: Numri i bizneseve të regjistruara dhe punëtorëve në Dragash sipas fshatrave

| FSHATI | Numri i Bizneseve | Numri punëtorëve (pa pronar) | Numri i punëtorëve (me 1 pronar) |
|-----------------|-------------------|------------------------------|----------------------------------|
| Zonat Natyrore | 1 | 0 | 1 |
| Baçkë | 2 | 0 | 2 |
| Bellobrad | 26 | 13 | 39 |
| Blaç | 20 | 10 | 30 |
| Bresanë | 88 | 28 | 116 |
| Brezne | 29 | 8 | 37 |
| Brod | 30 | 2 | 32 |
| Brrut | 18 | 4 | 22 |
| Buçe | 9 | 2 | 11 |
| Buzez | 12 | 18 | 30 |
| Dikanc | 2 | 0 | 2 |
| Dragash | 228 | 603 | 831 |
| Gllaboçicë | 22 | 7 | 29 |
| Kapre | 6 | 6 | 12 |
| Kosavë | 6 | 0 | 6 |
| Kërstec | 5 | 0 | 5 |
| Krushevë | 24 | 3 | 27 |
| Kuk | 25 | 17 | 42 |
| Kuklibeg | 9 | 6 | 15 |
| Kukulanë | 8 | 0 | 8 |
| Leshtan | 5 | 0 | 5 |
| Lubovishtë | 17 | 1 | 18 |
| Mlikë | 4 | 0 | 4 |
| Orçushë | 3 | 0 | 3 |
| Pllajnik | 4 | 0 | 4 |
| Pllavë | 25 | 50 | 75 |
| Radeshë | 16 | 0 | 16 |
| Rapçë | 20 | 4 | 24 |
| Restelicë | 95 | 12 | 107 |
| Rrenc | 5 | 0 | 5 |
| Shajne | 23 | 0 | 23 |
| Vranisht | 15 | 3 | 18 |
| Xërxe | 3 | 0 | 3 |
| Zaplluxhe | 17 | 6 | 23 |
| Zgatar | 10 | 9 | 19 |
| Zlipotok | 8 | 0 | 8 |
| Zym | 8 | 4 | 12 |
| GJITHSEJ | 848 | 816 | 1664 |




Figura 28: Numri i bizneseve dhe punëtorëve (me përjashtim të pronarëve) në Dragash sipas vendbanimeve

Bizneset më të mëdha me më shumë se 10 punëtorë janë në Dragash (4), Pllavë (1) dhe Buzë (1), të cilat janë në zonën veriore të komunës (Opojë) dhe me lidhje shumë më të mirë me Prizrenin dhe tregjet tjera përmes rrugëve kryesore. Në këto lokacione, numri i punëtorëve e tejkalon numrin e përgjithshëm të bizneseve, duke treguar një kontribut pozitiv në punësimin e banorëve të Dragashit. Këto biznese janë të përfshira në sektorin e përpunimit të leshit, mishit, ndërtimtarisë dhe punimit të metalit, me një të regjistruar si kompani aksionare.

Megjithatë, në 33 vendbanimet e mbetura, numri i bizneseve është shumë më i lartë sesa numri i të punësuarave të listuar. Shumë ndërmarrje merren me tregti të vogël e të bazuar në shkathësi, që mbështeten vetëm në aftësitë e pronarit, ku disa nga to ndoshta kanë një ose dy ndihmës. Shumica e bizneseve të regjistruara nuk kanë ndonjë punëtor shtesë përveç pronarit (665 (92.6%) nga 718 bizneset që mundën të identifikohen). Kjo kryesisht është e theksuar në 15 fshatra (9 në Gorë; 6 në Opojë) të cilat kanë numrat më të ulët të bizneseve në komunë. 114 biznese punësojnë vetëm 1 person. Të ardhurat nga këto biznese të vogla, ngjashëm me prodhimin nga bujqësia për sigurimin e konsumit familjar, kanë ndikim të vogël në ekonominë e përgjithshme apo në zhvillimin e komunës, por i ndihmojnë familjet individuale.

Fshatrat Kosovë, Pllajnik dhe Rrenc në rajonin e Opojës janë veçanërisht të dallueshme si komunitete të vogla me shumë pak shërbime apo ndërmarrje dhe me një shkallë të ulët të punësimit lokal. Megjithatë, këto fshatra ndodhen afër Pllavës dhe Buzës, të cilat kanë një kompani të madhe me 40, respektivisht 12 punëtorë. Kështu ka lëvizje për punësim ndërmjet fshatrave, veçanërisht në pjesën veriore të komunës e cila është e lidhur relativisht mirë, gjë që mund të jetë një faktor i rëndësishëm. Megjithatë, Brodi është shembull i një fshati me një komunitet relativisht të madh dhe një numër të dyqaneve dhe shërbimeve që nuk krijojnë punësim shtesë në fshat, me përjashtim të pronarëve të bizneseve.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të)

Janë 67 NVM të regjistruara në komunën e Dragashit, prej të cilave 57 janë anketuar.⁸⁷ Shumica e tyre janë aktive në produktet që prodhohen nga burimet natyrore të Dragashit, duke përfshirë agrikulturën dhe bujqësinë. Nga këto, shumica janë të përfshira në blegtori (lëndë të papërpunuara), ndonëse një numër pothuajse i barabartë janë të angazhuar në produktin përfundimtar (bagëtinë dhe industrinë ushqimore). Bagëtia është fusha më aktive për NVM në Dragash, duke angazhuar 96 njerëz në 30 ndërmarrje. Pas punëdhënësit më të madh, Remateksit, industria ushqimore që prodhon produkte të gatshme për konsum është punëdhënësi i dytë më i madh me 8 ndërmarrje që gjenerojnë 116 vende pune. Zejtaria është punëdhënësi i katërt më i madh. Femrat përbëjnë 20% të fuqisë punëtore të NVM-ve, në linjë me mesataret vendore, ndonëse sektorët e përfshirjes janë kryesisht në bagëti dhe në mbledhjen e frutave/perimeve; pjesëmarrja e femrave në industrinë ushqimore dhe atë të tekstitit është më e ulët sesa mesatarja, pavarësisht se këta sektorë kanë në përgjithësi numra më të lartë të punëtorëve.

Tabela 18: Degët e NVM-ve në Dragash (2011)⁸⁸

| Dega | Niveli i prodhimit | | | | Tregtia / | |
|--|-----------------------|-----------------------|------------------------------------|----------|-----------|-----------|
| | Prodhimi përfundimtar | Prodhimi papërfunduar | i Prodhimi i lëndës së papërpunuar | Shërbimi | Shitja | Gjithsej |
| Akomodim dhe Gastronomi | | | 1 | 1 | | 2 |
| Bujqësi | | | 3 | | | 3 |
| Zejtari | 1 | | | | | 1 |
| Industri Ushqimore (përcakto (bulmet, mish etj.) | 8 | | | | | 8 |
| Mbledhje Frutash / Bimësh | | | 1 | | | 1 |
| Bagëti | 9 | 1 | 20 | | | 30 |
| Të Tjera | 3 | | | 1 | | 4 |
| Shpeztari | 1 | | | | | 1 |
| Dyqane / Tregti | | | | | 2 | 2 |
| Industri Tekstili | | 1 | | | | 1 |
| Industri Druri | 3 | | 1 | | | 4 |
| Gjithsej | 25 | 2 | 26 | 2 | 2 | 57 |

⁸⁷ Draft raporti i UNDP-së: Raporti i misionit për vlerësimin e LED, Agostinucci, A., Janar 2012.

⁸⁸ Rezultatet e Anketimit të NVM-ve, UNDP, Mars 2012.

Tabela 19: Numri i punëtorëve sipas degës në NVM⁸⁹

| Dega | Numri i punëtorëve meshkuj | Numri i punëtorëve femra | Numri i punëtorëve për gjithë vitin |
|---|----------------------------|--------------------------|-------------------------------------|
| Akomodim dhe Gastronomi | 7 | 3 | 6 |
| Agrikulturë | 6 | 3 | 5 |
| Zejtari | 81 | 4 | 85 |
| Industri Ushqimore (përcakto) (bulmet, mish etj.) | 113 | 21 | 116 |
| Mbledhje Frutash / Bimësh | 30 | 10 | 10 |
| Bagëti | 91 | 42 | 96 |
| Të Tjera | 18 | 5 | 17 |
| Shpezëtari | 1 | 1 | 2 |
| Dyqane / Tregti | 6 | 0 | 6 |
| Industri Tekstili | 300 | 50 | 350 |
| Industri Druri | 13 | 3 | 12 |
| Gjithsej | 666 | 142 | 705 |




Figura 29: Vlerësimi i relevancës së faktorëve të ndryshëm për suksesin apo dështimin e NVM-ve⁹⁰

⁸⁹ Rezultatet e Anketës së NVM, UNDP, Mars 2012

⁹⁰ Rezultatet e Anketës së NVM, UNDP, Mars 2012

Faktorët që kanë ndikim pozitiv në zhvillimin dhe suksesin e NVM-ve janë:

- Disponueshmëria dhe cilësia e ofruesve lokalë të shërbimeve
- Telekomunikacioni
- Disponueshmëria e shërbimeve të qëndrueshme energjetike (rrymë elektrike dhe ngrohje) të standardeve të cilësisë ndërkombëtare
- Disponueshmëria e tokës për zgjerim
- Disponueshmëria e fuqisë punëtore dhe forcës së aftë për punë (gjithashtu cilësia e fuqisë lokale të aftë për punë)
- Disponueshmëria dhe cilësia e lëndëve të para
- Mbështetja nga administrata lokale si dhe proceset dhe rregullat administrative

Anketimi i NVM-ve tregoi se faktorët që parandalojnë zhvillimin apo suksesin e NVM-ve në Dragash janë:

- Qasja në financim
- Rrugët, qasja
- Qasja në njohuri dhe teknologji
- Mungesa e kapaciteteve deponuese
- Menaxhimi i tepricave ujore
- Cilësia e furnizimit me rrymë elektrike (Dragashi ka gati furnizim të rregullt të rrymës elektrike, por cilësia e rrymës në të shumtën e rasteve është e dobtë, për shkak të tensionit të ulët të rrymës)
- Cilësia e pajisjeve dhe vendit të punës
- Menaxhimi i mbeturinave të forta

Tregjet

Para krijimit të ndërmarrjes në pronësi shoqërore Sharrprodhimi, bujqësia ka qenë mirë e organizuar në Kosovë. Megjithatë, pas shpërbërjes së kësaj ndërmarrjeje në pronësi shoqërore nuk ka më treg të gjerë për prodhime apo bagëti. Kjo ka rezultuar me një ulje të theksuar të bagëtisë në Dragash. Rruga që çon në jug nga Restelicë për në IRJ të Maqedonisë më parë ka qenë një rrugë e rëndësishme për qasje në tregjet bujqësore jashtë Kosovës, por kjo nuk funksionon më për shkak se nuk është një vendkalim kufitar zyrtar. Remateksi është ndërmarrja kryesore me tregje përtej Kosovës.

Ndikimi i migrimit

Remitencat nga migrantët kosovarë që jetojnë jashtë shtetit (disapora) janë përgjegjës për 13% të GDP-së së Kosovës dhe vazhdon të jetë burimi më i rëndësishëm i financimit të jashtëm për vendin. 70% të familjeve me migrantë ndërkombëtarë jetojnë në zona rurale. Përqindja e popullatës që pranon para nga jashtë është dukshëm më e lartë sesa e atyre që marrin ndihmë sociale, me një mesatare prej 2800 eurosh të pranuar në vit nga familjarët ruralë (1500 euro në zonat urbane), e cila është rreth tri herë më e lartë sesa mbështetja financiare mesatare nga skemat e mbrojtjes sociale. Në rajonin e Prizrenit 23.3% të familjeve pranojnë para nga jashtë.⁹¹

⁹¹ Figurat e UNDP-së 2010, të cituara në Vlerësimin e Varfërisë në Kosovë, Raporti i Bankës Botërore Nr. 39737-XK, tetor 2007. Qasur më: 17.03.2012

<http://www.skmbalcani.cooperazione.esteri.it/utliskmbalcani/IT/Documenti/Pdf/KosovoPAvol1.pdf>

Emigrimi mund të shihet si tregues i fuqisë së një komuniteti të aftë për rritjen dhe dërgimin e individëve dinamikë “nëpër botë”. Përmes diasporës, komuniteti është drejtpërdrejt i lidhur me faktorë të jashtëm, si pozitivë, ashtu dhe negativë. Pjesëtarët e diasporës janë ambasadorët më të mirë dhe ndërlihdhësit e komuniteteve të origjinës së tyre. Në ambientet e tyre profesionale dhe private, ata mund të stimulojnë interes për mundësitë që Dragashi ka për të ofruar për investitorët e huaj dhe klientët. Pjesëtarët e diasporës janë vëzhgues të trendeve dhe agentë të ndryshimeve. Në ambientet e tyre respektive në vende dhe kapacitete të ndryshme, ata mësojnë për trendet e reja në tregje, teknikat e prodhimit dhe konceptet e biznesit. Ata mund të sjellin këtë informacion në Dragash dhe t’i ndihmojnë akterët lokalë për të sjellë risi dhe për të punuar më mirë.

Emigrimi në masë të konsiderueshme gjithashtu zbulon dhe vë në pah dobësitë e komuniteteve të origjinës: përderisa kapaciteti për të dërguar të rinj në botë është fuqi, paaftësia për t’iu ofruar atyre mundësi për fazat vijuese të projekteve të tyre personale dhe familjare është dobësi për ta. Fakti se diaspora investon fuqishëm në patundshmëritë lokale tregon se diaspora vazhdon të mbajë një lidhje të fuqishme me vendin e tyre të origjinës. Dobësia qëndron në paaftësinë e komunitetit të origjinës që t’iu ofrojë atyre mundësi për përfshirje të fuqishme në zhvillimin e komunitetit lokal.

Për shkak të emigrimit, anëtarët produktivë të komunitetit mungojnë në institucionet lokale, bizneset dhe familjet të cilat, si rezultat, mund të mos i kenë burimet e nevojshme shoqërore për t’iu përgjigjur mundësive që pjesëtarët e diasporës mund t’ua tregojnë. Rreziqet përfshijnë faktin se imazhi i një emigranti të suksesshëm sjell një kulturë të emigrimit dhe mungesë të vizionit për komunitetin amë. Pjesëtarët e diasporës mund të kthehen me sjellje që janë në konflikt me nevojat dhe projektet lokale e rrjedhimisht të krijojë më shumë një pengesë sesa një kontribut në zhvillimin lokal. Por, rreziku më i madh është se lidhja mes diasporës dhe komunitetit amë është i rënduar dhe kthimi i burimeve njerëzore ose financiare në komunitetin amë është ndërprerë.⁹²

Biznesi/punësimi joformal

Banka Botërore vlerëson se përafërsisht 40% e punësimit në Kosovë është joformal, të cilat janë aktivitete që gjenerojnë të ardhura të ulëta, por që nuk e përballojnë çmimin e legalitetit. Kjo dallon nga ato aktivitete të cilat pavarësisht se janë fitimprurëse, fshihen qëllimisht nga organi publik me qëllim të shmangies së taksave dhe nga ekonomia e nëntokës dhe aktivitetet e paligjshme të cilat janë të ndaluara me Kod Penal (p.sh. trafikimi i drogës).⁹³

Sipas informacionit nga Agjenda e Zhvillimit Komunal 2004-2006, tradita e përpunimit të qumështit dhe mbledhjes së frutave vazhdon të jetë një biznes joformal, por së fundmi zejtarët lokalë (siç janë dyqanet elektronike, parukierët, punëtorët e ndërtimtarisë) vazhdojnë aktivitetet e tyre biznesore pa i regjistruar..

⁹² Nga Draft MDP e Habitatit të KB, Shtator 2010

⁹³ Nga Ekonomia Joformale në Kosovë: Çfarë Roli për Unionet Tregtare, Raporti nga Bashkimi i Unioneve të Tregtisë së Pavarur të Kosovës (2005) dhe Studimi i Tregut të Punës në Kosovës: Ndryshimet e Politikave të Punësimit Formal dhe Joformal, Raporti i Bankës Botërore Nr. 25990, 2003.

3.5.2 Punësimi

Kosova është një ndër vendet më të varfëra në Evropë, me më shumë se një të tretën e popullsisë që jeton nën nivelin e varfërisë prej 1.55€ në ditë dhe 12% nën nivelin e varfërisë së skajshme prej nën 1.02€ në ditë.⁹⁴ Shkalla e përgjithshme e varfërisë në Kosovë është pothuajse 45%; në krahasim, shkalla e varfërisë në BE është 10-23%, përderisa në vendet fqinje është 12.4% të popullsisë në Shqipëri dhe 19% në IRJ të Maqedonisë.

Problemi është i lidhur ngushtë me nivelet e larta të papunësisë, të cilat aktualisht janë në 45.4% për mbarë Kosovën.⁹⁵ Grupe të caktuara përballen me sfida edhe më të mëdha: 74% të rinjve janë të papunësuar, përderisa vetëm 11% e femrave të moshës për punë janë të punësuar. Në veçanti, varfëria rurale vlerësohet të jetë më e rënda dhe më e përhapura për grupet vijuese, veçanërisht në rajonet qendrore dhe lindore të Evropës: bujqit në zona të larta dhe malore, pagëmarrësit ruralë, femrat rurale, të moshuarit, minoritetet etnike, personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët.⁹⁶ Përderisa 37.4% të popullsisë urbane të Kosovës jetojnë në nivelin e varfërisë, 49.2% jetojnë në varfëri në zonat rurale. Trendët e vëzhguara ndërmjet viteve 2003 dhe 2005 tregojnë se përderisa varfëria urbane po ulet, varfëria rurale po rritet.⁹⁷

Në përgjithësi në Kosovë, pjesa më e madhe e personave “ekonomikisht joaktive” (49%) janë të angazhuar në “kujdesin për familjen”. Në Dragash, 32% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç konsiderohet ekonomikisht aktive.¹²⁹ Femrat përbëjnë 67% të popullsisë ekonomikisht joaktive në Dragash.

Sidoqoftë, përkundër kësaj situate të vështirë, numri i familjeve që marrin asistencë sociale ka rënë nga mesatarisht 592 në vitin 2005 deri në 360 në vitin.¹³⁰

Spektori publik në Dragash është punëdhënës i madh, pothuajse i barabartë me ata të përfshirë në aktivitetet e sektorit privat.

Tabela 20: Numri i punëtorëve në sektorin publik në komunën e Dragashit

| SEKTORI | NUMRI I PUNËTORËVE |
|---------------------------|--------------------|
| Administrata komunale | 127 |
| Arsimi | 507 |
| Shëndetësia | 98 |
| Brigada e zjarrfikësve | 18 |
| (TMK) | 43 |
| (SHPK) | 39 |
| Gjykata | 44 |
| Ujësjetësi | 15 |
| Pastrimi | 15 |
| Ekonomia pyjore | 29 |
| Qendra për punë sociale | 12 |
| Zyra komunale për punësim | 3 |
| GJITHSEJTE | 950 |

⁹⁴ Burimi: Vështrim i Programit të Partneritetit të Bankës Botërore dhe Kosovës, Shtator 2011

http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/Kosovo_Snapshot.pdf. Qasur më 16.03.2012

⁹⁵ Nga Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2011-2016, në bazë të të cilit 345,000 persona në Kosovë janë të regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

⁹⁶ Burimi: Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor 2002, http://www.ifad.org/poverty/region/pn/PN_e_1.pdf. Qasur më: 16.03.2012

⁹⁷ Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, Raporti i Bankës Botërore Nr. 39737-XK, Tetor 2007

<http://www.skmbalcani.cooperazione.esteri.it/utlskmbalcani/IT/Documenti/Pdf/KosovoPAvol1.pdf>. Qasur më: 17.03.2012.

¹²⁹ Të dhënat e siguruar nga Qendra për Punë Sociale, Dragash. Nga UN-Habitat Draft Profili i PZhK, shtator 2010

¹³⁰ Të dhënat e siguruar nga Qendra për Punë Sociale, Dragash. Nga UN-Habitat Draft Profili i PZhK, shtator 2010

3.5.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese ekonomike

Numri i ndërmarrjeve në Dragash është duke u rritur ngadalë. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve janë të vogla, të cilat sigurojnë punësim vetëm për pronarin.

- Çfarë kushtesh mund të ofrohen për të ngritur numrin e njerëzve të punësuar?
- Si mundet PZhK të kontribuojë në përmirësimin e tregut të biznesit në Dragash?
- Si mundet niveli arsimor i punëtorëve dhe konkurrencësia e bizneseve të përmirësohen?

3.6 PYLLTARIA DHE BUJQËSIA

3.6.1 Pylltaria & dhe zonat gjysmë natyrore¹³¹

Territori i komunës së Dragashit karakterizohet me barë natyral dhe shkurre të ndërprera nga zona gurore me vegjetacion të rallë dhe pellgje ujore dhe pyje. Këto lloje kryesore të tokës e mbulojnë përmbi 70% të sipërfaqes së komunës. Vetëm 27% e tokës përdoret për qëllime bujqësore. Për shkak të lartësisë së madhe mbidetare, tokat e lëvruara dominohen nga fushat me bar dhe kulturat permanente (18% me 9%). Vetëm 1% e sipërfaqes mbulohet me vendbanime apo infrastrukturë.

Table 21: Llojet e tokave të shfrytëzuara në Komunë të Dragashit në ha dhe përqindje

| | Vendbanimet | Zonat bujqësore | Kullosat & Livadhet | Pyjet | Barë natyror - & Shkurre | Zona me vegjetacion të rallë | Shkëmbij të zhveshur | Pellgje ujore | Ujë i akumuluar | Gjithsej në ha |
|-------------------|-------------|-----------------|---------------------|--------------|--------------------------|------------------------------|----------------------|---------------|-----------------|----------------|
| Nën pellgjet | | | | | | | | | | |
| Lumi Guri i Zi | | 8 0% | 3 0% | 1 0% | 5.140 76% | 557 8% | 212 3% | 841 12% | | 6.761 |
| Lumi i Brodit | 40 0% | 146 2% | 1.490 16% | 1.666 18% | 4.061 45% | 985 11% | 291 3% | 439 5% | | 9.118 |
| Lumi i Plavës | 361 2% | 2.620 15% | 4.234 24% | 5.240 30% | 3.535 20% | 1.199 7% | 102 1% | 283 2% | | 17.573 |
| Lumi i Prizrenit | 56 2% | 640 26% | 217 9% | 1.202 49% | 232 10% | 70 3% | | 15 1% | 3 0% | 2.435 |
| Lumi i Restelicës | 67 1% | 385 5% | 1.784 25% | 958 14% | 2.829 40% | 562 8% | 195 3% | 311 4% | | 7.090 |
| Lumi i Sotkes | 3 1% | | 77 13% | 522 87% | | 1 0% | | | | 603 |
| Komuna Dragash | 527 1% | 3.798 9% | 7.806 18% | 9.588 22% | 15.797 36% | 3.373 8% | 800 2% | 1.889 4% | 3 0% | 43.581 |

Zonat gjysme-natyrore

Malet e Sharrit karakterizohen me livadhe natyrore, barishte, shkurre dhe kaçuba dhe ato llogariten që mbulojnë diku 50% të sipërfaqes së përgjithshme të përdorueshme në komunë. Ato gjithashtu karakterizohen me pellgje ujore të rrjedhshme dhe në rënie, me vegjetacion të rallë dhe zona shkëmbore. Zonat më të mëdha të tyre gjenden në jug dhe lindje të komunës së Dragashit, në jug të Restelicës dhe në veri drejt Brodit, përgjatë skajit të maleve të Sharrit, dhenë pikat më të larta të Malit Koritnik.

¹³¹ Informata të detajuara mund të gjenden në Atlasin për Zhvillim të Qëndrueshëm të UNDP-së: Vëllimi 2 *Baz* dhe Vëllimi 3 *Vlerësimi*

Pyjet

Qindra vjet të kullotjes së kullosave në zonat dikur të pyllëzuara kanë mbetur rreth 17.1% (8,124 ha) të pyjeve në Dragash kryesisht në pjesën veri-perëndimore të komunës. 5199 ha të tërë zonës pyjore janë publike (64%), duke përfshirë rrobullin e shquar të vjetër në Koritnik, i cili është rreth 70 vjet i vjetër. 1160 ha e këtij pylli në Malin Koritnik janë pjesë e Parkut Kombëtar dhe një nga pikat kryesore të biodiversitetit në komunë.

- Pyjet private (2925 ha) kryesisht janë cungishte (2814 ha) dhe një burim i rëndësishëm i druve të zjarrit për komunitetin. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve cungishte është 4048 ha.
- Plantacionet përfshijnë 211 ha (përafërsisht 3% të pyjeve në përgjithësi), vetëm në një zonë të vogël në veri të Dragashit.
- Pjesa prej 2462 ha e pyjeve në dhe të hollë kanë nevojë për kujdes të veçantë gjatë menaxhimit të pyjeve, me qëllim të parandalimit të erozionit dhe për të mirëbajtur kapacitetin e tyre për ruajtjen e ujit.
- 18 ha të pyjeve janë degraduar për shkak të vjeljeve (prerjeve) ilegale, zjarreve apo arsyeve tjera të paspecifikuara¹³².
- Pyjet e përziara, pyjet rreth 70 vite të vjetra dhe tranzicioni alpik i kullosave-pyjeve në nivel të drunjve janë habitate për ariun dhe rrëqebullin dhe formojnë pjesë të korridorit të tyre regjional ekologjik.

¹³² Në krahasim me sipërfaqen e Njesise menaxhuese "Koritniku II" prej 2843 ha sipërfaqja prej 18 ha është me pak se 1% (0,6%) që perputhet me komentin e APK faqe 2

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2012 Profili Komunal i Dragashit për PZhK-Drafti final

Tabela22: të hyrat nga vjeljet në pyje në të dy sektorët publik/privat

| Njësia menaxhuese | Të hyrat nga vjeljet në Euro | Harxhimet e vjeljeve dhe nxjerrja | Të hyrat vjetore neto në Euro | Vëllimi potencial vjetor i vjelur / m ³ |
|----------------------|------------------------------|-----------------------------------|-------------------------------|--|
| Koritniku II | 229 858 | 83 067 | 146 791 | 5 358 |
| Opoja | 184 685 | 55 085 | 129 600 | 4 879 |
| Bredhiku | 260 717 | 80 553 | 126 164 | 7 104 |
| Shuma publike | 675 260 | 218 705 | 402 555 | 17 341 |
| Pyjet private | 92 925 | 35 407.74 | 57 517.3 | 4425.97 |
| Totali | 768 185 | 254 112.74 | 514 072.3 | 21 766.97 |

Figura 30: Situata pronësore në pyjet e Dragashit (në ha)





Figura 31: Moshja e klasave në pyjet e Dragashit (në ha)



3.6.2 Bujqësia dhe shfrytëzimi i posaçëm i tokës

Zonat bujqësore me tokë të punueshme, të mbjellat e përhershme dhe përdorimi i ndërlikuar i tokës që përbëhet prej të mbjellave vjetore dhe të përhershme me gardhe janë të koncentruara në rajonin e Opojës ku terreni është më i rrafshët se sa në rajonin e Gorës. 86% të këtyre tokave të shfrytëzuara janë brenda nën-pellgjeve të lumenjve Pllava dhe Prizren. Në rajonin e Gorës, zonat kryesore të bujqësisë mund të gjenden rreth fshatrave Gllloboçicë, Krushevë dhe Restelicë. Kullotat dhe livadhet gjenden kryesisht në rripin në lindje të fshatrave në këmbën e maleve të larta.¹³³

Bujqësia sot në Dragash ofron një profesion plotësues dhe joformal dhe të ardhura për një numër të madh të ekonomive familjare që nuk janë në gjendje që t'i ndërtojnë fermat e tyre në ekonominë formale, dhe përbënë një pjesë të madhe të aktiviteteve të ekonomive familjare. Ekzistojnë gjithsej 3500 ferma në Dragash, nga të cilat 95% janë ferma për mbijetesë të familjes, 3.5% e tyre prodhojnë si për nevojat familjare ashtu edhe për shitje në treg, dhe vetëm 1.5% të fermave janë komerciale. Kjo tregon që i tërë sektori i bujqësisë ka mungesë të mjeteve mekanike.¹³⁴

Procesimi i produkteve bujqësore në komunë mungon pothuajse plotësisht (me përjashtim të dukshëm të thertores Meka e cila punëson 40 persona në fshatin Pllavë).¹³⁵ Ekzistojnë katër pika të grumbullimit të qumështit: Kuk, Buzez, Kosavë, dhe Bresanë. Përveç kësaj, sasi të konsiderueshme të qumështit shiten në mënyrë joformale. Në komunën e Dragashit ekzistojnë tri thertore dhe tri fabrika të procedimit të produkteve të qumështit.¹³⁶

Llojet kryesore të drithërave që kultivohen në komunë janë:

Gruri (96.5ha të kultivuara në vjeshtë të vitit 2009)

Tërshërë (45ha në pranverë të vitit 2010)

Elb (40ha në pranverë të vitit 2010)

Thekër (45ha në vjeshtë të vitit 2009)¹³⁷

Në anketën vjetore të ekonomive familjare bujqësore, janë intervistuar rreth 130 ekonomi familjare nga Dragashi. Kur janë pyetur për arsyet e lënies së tokës prodhuese, *mungesa e përfitimit* nga prodhimi bujqësor është përmendur si faktori kryesor (37%), përcjellë nga "*mungesa e të hyrave*" (29%). Mungesa e përfitimit, p.sh. zbrazëtira ndërmjet ofertës dhe kërkesës ka shkaqe të ndryshme. Qasja e vështirë në treg shpesh citohet si faktorë kritik, Këtu përfshihet distanca fizike në fazat e ndryshme të zinxhirit të logjistikës (nga fushat/livadhet në ferma, nga fermat në pikat grumbulluese të prodhimit, nga pikat e grumbullimit në fabrikat e procesimit, etj.), po aq sa edhe mungesa e certifikimit dhe e marketingut adekuat të prodhimeve të Dragashit të cilësisë së lartë që do të mundësonte qasje në segmente të vlerave më të larta të tregut të konsumatorëve.

Përdorimi i posaçëm i tokës

Kjo përfshinë prerjen e druve të zjarrit, mbledhjen e kërpudhave, bimëve mjekësore, frutave të egra dhe mbajtjen e bletëve. Prerja e drunjëve të zjarrit ndodhë kryesisht në zonat rurale rreth Malit Koritnik, ndërmjet fshatrave Orçushë dhe Vranisht. Një proces i madh i mbledhjes së kërpudhave ndodhë në pikat rreth pjesës perëndimore të komunës, në terrenin në secilën anë të rrugës për në Restelicë, veçanërisht ndërmjet Restelicës dhe Gllloboçicës me lokacione të shpërndara ndërmjet fshatrave Mlikë,

¹³³ UNDP Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm, Vëllimi 2: *Baza*, qershor 2012

¹³⁴ UNDP Udhëzime Komunale Dragash 2010

¹³⁵ UN-Habitat Draft PZhK, shtator 2010

¹³⁶ UNDP Udhëzime për Zhvillim Komunal të Dragashit, 2010

¹³⁷ UNDP Udhëzime për Zhvillim Komunal të Dragashit, 2010

Orçushë dhe Vranisht. Ekziston gjithashtu një zonë e konsiderueshme për mbledhjen e kërpudhave përreth fshatrave Kukulanë dhe Radeshë, me zona më të vogla dhe të shpërndara të mbledhjes përreth fshatrave Rapçë, jug të Bresanës dhe veri të Bellobradit. Mbledhja e bimëve mjekësore ndodhë në lartësi më të mëdha të komunës, përreth Malit Koritnik dhe në zonën e Malit Sharr, veçanërisht përreth fshatrave Restelicë, Brod dhe ndërmjet fshatrave Gllloboçicë dhe Krushevë. Zona më të vogla dhe të

shpërndara ku bëhet mbledhja e bimëve mjekësore gjenden në pjesën tjetër të komunës, përreth vendbanimeve në kodrinat e Malit Koritnik si dhe rreth Opojës përgjatë rrugës në Zaplluxhe. Mbledhja e frutave të egra bëhet kryesisht në pjesët veriore të komunës – ndërmjet fshatrave Shajne, Pllavë, Buçe dhe Brezne, dhe në zonat më të vogla afër fshatrave përgjatë rrugës në Zaplluxhe. Mbajtja e bletëve është tipar i vërejtur në shumicën e fshatrave në tërë komunën dhe ka një shpërndarje kryesisht të barabartë.

3.6.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të pyjeve dhe të bujqësisë

Pyjet numërojnë rreth 22% të territorit, pjesa më e madhe pyje me gjethe të gjera, me proporcione më të ulëta të pyjeve të përziera dhe halore, dhe pyje cungishte.

- Si mundet pylltaria në Dragash të përmirësohet në aspektin e kuantitetit dhe kualitetit?

Ekziston një sasi e vogël e tokës e përshtatshme për të korra në Dragash; përveç kësaj, toka pjellore pjesërisht është e pakultivuar. I tërë sektori bujqësor ka pak meakizim.

- Si mundet sektori i bujqësisë të përmirësohet?

3.7 BIODIVERSITETI DHE MBROJTJA E NATYRËS

3.7.1 Flora dhe fauna¹³⁸

Komuna e Dragashit shfaq një larmi të madhe të llojeve të bimëve dhe të kafshëve si dhe të habitateve, kjo në pjesë të madhe për shkak të lartësive të ndryshme mbidetare (ndërmjet 730 m deri mbi 2660 m lartësi mbidetare), një varietet të gurinave dhe dheut, si dhe ndikimi nga klima mesdhetare dhe kontinentale. Shumica e zonave nën zonën e kufirit drunor (afërsisht 2000 – 2100m) duhet të jetë e mbuluar me pyje, por intervenimi njerëzor dhe zhvillimi i bujqësisë nëpër shekuj e ka shkaktuar shpyllëzimin. Zonat përmbi kufirin e drunjëve janë të mbuluara me formacione natyrore të gurëve, bari alpinë dhe shkurre me botina siç janë moçalet me torfë dhe kënetat e cekëta me torfë.

Dragashi mburret me trashëgimi të pasur të kafshëve të egra, me 1500 specie të bimëve vaskulare me 150 specie endemike. Kjo përbënë rreth 20% të florës në Ballkan. Ekzistojnë rreth 730 specie vaskulare në lartësi përmbi 1500 metra. Në tërë Malin e Sharrit kombinimi i mikroklimave alpine dhe mesdhetare rezulton në një larmi të elementeve floristike, me 40 elemente anktartiko-alpin të florës që kanë mbetur si relikte kryesisht nga periudha e akullnajave. Ekzistojnë 92 elemente boreale dhe nënboreale të florës, 57 nga Evropa e Mesme (Nordiko-Alpikë), 67 Euroaziatike (Karpato-Ballkanike), dhe 151 nga Evropa Jugore (Ballkaniko-Apenine). Elemente të florës nënmesdhetare dhe mesdhetare gjenden në zonat e

¹³⁸ Atlasi i UNDP-së për zhvillim të qëndrueshëm, Vëllimi 2: Baza, qershor 2012

lumenjve Drini i Bardhë, Lumbardhi në Prizren dhe lumit në Kaçanik.¹³⁹ 38 komunitete të bimëve janë identifikuar në zonat kryesore, me 438 specie të identifikuara; nga të cilat 37 janë identifikuar si bimë të rëndësishme të lartë dhe të rrezikuara.¹⁴⁰ Mirëpo, nuk ka studime sistematike apo shkencore në dispozicion për faunën në Dragash, ndonëse të dhënat e mbledhura nga OJQ-të, komunitetet e fshatrave, literatura dhe vështrimet nga ekspertët e UNDP-së kanë siguruar një pasqyrë. OJQ-ja "Finches" i ka numëruar 11 lokacione kryesore në komunë për mjedise të banimit të shpezëve, dhe nga viti 2004 – 2010 janë vërejtur gjithsej 152 specie, nga të cilat një e treta janë numëruar në shtojcat e Direktivës së BE-së për shpezët. Janë identifikuar 40 specie të fluturave, nga të cilat rreth një e treta janë numëruar në shtojcat II dhe IV të Direktivës së BE-së për Habitatet apo janë vlerësuar si "të rrezikuara" nga IUCN.¹⁴¹

Peizazhe të shumta alpine, livadhe malore dhe pyje, përfshirë trungje të lashta të pishës endemike Maqedone dhe Boshnjake, kontribuojnë në pasurinë natyrore të zonës me një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve natyrore dhe specieve të rralla të florës dhe faunës, përfshirë specie të rëndësishme të përbashkët evropiane si ariu ngjyrë kafe, ujku dhe Rrëqebulli Ballkanik. Shumica e emrave shkenëcor për speciet endemike të rajonit të Sharrit janë marrë nga referenca e tyre si 'Scardus' në hartat e lashta të Ptolemisë (Claudius Ptolomaeus, 100-178 AD). Shembujt përfshijnë *Anthyllis scardica*, *Crocus scardicus*, *Narthecium scardicum*, *Onobrychis Montana*, *Sideritis scardica*, *Stachys scardica*, *Verbascum scardicum*, dhe *Viola schariensis*. Historia e hulumtimit shkenëcor në botanikë të kësaj zone daton nga viti 1836.¹⁴²

3.7.2 Parku Nacional i Sharrit

Parku Nacional i Sharrit në Kosovë u krijua në vitin 1986. Në dhjetor të vitit 2012 ligji i ri për Parkun Nacional Sharri ka definuar zgjerimin e kufinjëve në komunën e Dragashit gjithashtu. Në IRJM Malet e Sharrit janë pjesë e Parkut Nacional të Mavrovës dhe janë lokacion i qendrës së popullarizuar të sporteve të dimrit Popova Šapka.

Pjerrtësitë veriperëndimore të zonës së malit të Sharrit si Park Nacional janë themeluar nga Kuvendi Krahinor i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nën Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ajo mbulon një zonë prej 230km² në pesë komuna (Suharekë, Prizren, Kaçanik dhe Shtërpçë), dhe mbetet i vetmi park nacional zyrtar në Kosovë.¹⁴³ Mirëpo për kah hapësira ai i ofrohet tri zonave tjera të mbrojtura në rajon: Parku Nacional i Mavrovës (73088ha; i themeluar më 1949) dhe Parku i Planifikuar Šar Planina në IRJ të Maqedonisë dhe Peisazhi i Planifikuar i Mbrojtur i Korabit në Shqipëri.

Sipas Unionit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN) kategorizimi i Parkut Nacional të Sharrit është klasifikuar si zonë e mbrojtur e Kategorisë II.¹⁴⁴ Gjithashtu është njohur edhe nga OJQ-të ndërkombëtare si një zonë e rëndësishme për zogjtë (IBA. OJQ-ja Bird Life International, 1999) dhe zonë

¹³⁹ Bexhet, M. Profilet Ekologjike të specieve bimore/Asociacionet dhe Hartat e shpërndarjes të komuniteteve specifike të bimëve dhe llojet interesante të vendbanimeve në Komunën e Dragashit, 2011.

¹⁴⁰ Për informata më të detajuara, shih vëllimin. 5 Të dhënat e Atlasit për Zhvillim të Qëndrueshëm.

¹⁴¹ Atlasi i UNDP-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, Vëllimi 2: *Baza*, qershor 2012

¹⁴² Nga Studimi I fisibilitetit për themelimin e Zonës tejkufitare të mbrojtur Mali i Sharrit -Korab- Deshat, I prodhuar nga UNEP (Programi I OKB-së për Mjedis), ISCC Vienë, 2010

¹⁴³ Matjet e mëparshme të madhësisë së Parkut Nacional kanë paraqitur një zonë prej 390 km, matjet e fundit nga MMPH, kanë zbuluar që zona në terren nuk i tejkalon 230 km².

¹⁴⁴ IUCN Lista e Kombeve të Bashkuara e Parqeve Nacionale dhe Zonave të Mbrojtura, 1990. "Parqet Nacionale janë zona të mëdha natyrore apo gati natyrore të veçuara me qëllim të mbrojtjes së proceseve të mëdha ekologjike, së bashku me gamën e specieve dhe ekosistemeve që janë karakteristike për atë zonë, e cila gjithashtu ofron bazament për mundësi që janë të përputhshme me mjedisin, kulturën, anën shpirtërore, shkenëcore arsimore rekreative dhe të mundësinë e vizitorëve."

e rëndësishme për bimët (IPA, OJQ-ja Planta Europa, Plantlife, 2005) si dhe në listën e Zonave kryesore të fluturave. Mirëpo, Ndikimi njerëzor dhe presionet për biodiversitetin e rajonit janë shtuar veçanërisht në dy dekadat e fundit. Kërcënimet përfshijnë trajtimin e dobët të ujërave të zeza, dhe menaxhimi urban i mbeturinave, fragmentimi dhe humbja e habitateve dhe pyllit, zjarret e shkaktuara nga vetë njeriu, mungesa e kontrollit dhe inspektimit, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm, prerja e paligjshme e druve dhe zhvillimi i pakontrolluar i tokës. Mund të ketë edhe rrezik të përdorimit të tepruar të burimeve natyrore (si mbledhja e bimëve të egra) dhe kullotja e tepërt apo e pakët. 32 specie të bimëve të pranishme në malet e Sharrit/ gjenden në listën e kuqe të IUCN-së për bimët e kërcënuara, derisa 26 specie janë të përfshira në listën e kuqe evropiane.¹⁴⁵ Konfliktet e armatosura në fund të viteve 90 deri në vitin 2001 në këtë rajon tejkuftar nuk e kanë dëmtuar infrastrukturën, trashëgiminë kulturore apo burimet natyrore. Mirëpo, ndryshimet pasuese administrative dhe sfidat (si mungesa e vetëdijes, ekspertizës dhe kapaciteteve), shfrytëzimi i pakujdesshëm dhe i parregulluar i burimeve natyrore, si dhe depopullimi, migrimi nga zonat rurale në atë urbane dhe popullata e moshuar, janë faktorë që mund të kontribuojnë në problemet në mjediset natyrore, peizazhet kulturore dhe kontekstin socio-ekonomik.¹⁴⁶

Shtetet e përfshira në procesin a para anëtarësimit në Bashkimin Evropian kërkojnë që t'i harmonizojnë standardet e tyre të mbrojtjes së natyrës me ato të BE-së. Kjo nënkupton caktimin e zonave të posaçme të konservimit (përmes rrjetit Natyra 2000, siç është theksuar në Direktivën e Këshillit 92/43/EEC "Direktiva e vendbanimeve të egra") dhe speciet e shpezëve (shtojca I e Direktivës së Këshillit 79/409/EEC, 1979 – "Direktiva e Shpezëve") brenda zonës së malit të Sharrit.

Zona më e madhe e tokës së komunës së Dragashit (67.67%) është e mbuluar me pyje dhe dhe vegjetacion tjetër gjysmënatyror, që tregon nivel të lartë burimeve natyrore dhe pjesërisht të kultivuara, me rreth 4% të botinave gjysmë natyrore, 26.75% e zonës iu është dhënë bujqësisë. Në përgjithësi, Dragashi ka një larmi të gjërë të vendbanimeve natyrore, ekosistemeve, florës dhe faunës që e bëjnë atë zonë shumë të rëndësishme të biodiversitetit në rajonin e Evropës Juglindore.

Një pjesë e madhe e terrenit të komunës (55.5%) përfshihet brenda Parkut Nacional të Sharrit. Termi "Park Nacional" shpesh stigmatizohet nga perceptimi i kufizimeve dhe frika sociale që zhvillimi ekonomik do të kufizohet, që aktivitetet kulturore përfshirë pylltarinë do të kontrollohen në mënyrë strikte, dhe që turizmi, ndërtimi dhe aktivitetet tjera do të kufizohen. Mirëpo, kjo nuk është kështu. Sipas ligjit, aktivitetet që nuk e dëmtojnë ndërveprimin harmonik të njeriut me natyrën dhe zhvillimi dhe konservimi i vetë natyrës lejohen brenda parkut Nacional dhe në afërsi të tij. Shpesh ka aktivitete që janë praktikuar me shekuj dhe që formojnë pjesë të vlefshme të kontekstit të Parkut Nacional, dhe si të tilla do të promovohen. Shumica e territorit është tokë shoqërore, dhe zonat e banuara nuk janë përfshirë në kufijtë e Parkut Nacional. Përqindja e tokave private brenda kufijve të Parkut Nacional Sharri në Dragash është përafërsisht 3100 ha ose 12.6%. Zonimi i territorit do të definojë aktivitetet e lejuara.

Ndarja në zona e Parkut Nacional bëhet në pajtim me Ligjin për Parkun Nacional dhe është rezultat i një procesi të konsultimit ndërmjet qeverisë, komuniteteve lokale dhe akterëve:

¹⁴⁵ Nga Studimi I fisibilitetit për themelimin e Zonës tejkuftare të mbrojtur Mali i Sharrit -Korab- Deshat, I prodhuar nga UNEP (Programi I OKB-së për Mjedis), ISCC Vienë, 2010

¹⁴⁶ Informata të detajuara për rajonin e Sharrit kanë ardhur nga Studimi I fisibilitetit për themelimin e Zonës tejkuftare të mbrojtur Mali i Sharrit -Korab- Deshat, I prodhuar nga UNEP (Programi I OKB-së për Mjedis), ISCC Vienë, 2010

Zona 1 – zona e mbrojtur – përfshinë zonat me tipare të veçanta natyrore, me specie të rralla, bimë dhe kafshë të rrezikuara dhe disa lloje të natyrës së egër. Kjo zonë i përket regjimit të mbrojtjes së rreptë. Në zonën 1, nuk lejohet ndërtimi, eksploatimi i natyrës, peshkimi, aktivitetet ekonomike apo ndonjë aktivitet tjetër përpos punës shkencore, ecjes dhe kullotja (me kontroll të madh).

Zona 2 – Zona aktive e menaxhimit – përfshinë zonat e karakterizuara me ekosisteme, vlera të peizazheve dhe tjera. Këtu aktivitetet me bazë në natyrë që nuk bien në kundërshtim me mbrojtjen e natyrës – si kullotja e menaxhuar, mbledhja e kontrolluar e produkteve të malit dhe bimëve mjekësore – mund të praktikohet.

Zona 3 – Zona e zhvillimit – përfshinë zona për ndërtim të ndërtesave për pushim, rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Parkut Nacional, me përdorim të kufizuar dhe të përzgjedhur të burimeve natyrore.

Më shumë informata për tiparet specifike dhe karakteristikat e burimeve natyrore të komunës së Dragashit gjenden në Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

3.7.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të biodiversitetit

Dragashi është një nga pikat e nxehta të Ballkanit lidhur me biodiversitetin e tij të jashtëzakonshëm që përmban një numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe të rralla.

- Si mundet zhvillimi komunal dhe mbrojtja e natyrës të bashkëjetojnë?

Një proporcion i lartë i terrenit të komunës (55.5%) është propozuar të përfshihet në kuadër të Parkut të Mbrojtur Kombëtar Sharri.

- Si mundet Dragashi të përfitojë nga zgjerimi i Parkut Kombëtar në territorin e vetë?

3. 8. TURIZMI DHE KULTURA

3.8.1 Kultura

Objektet kulturore

Një numër i grupeve, asociacioneve dhe organizatave kontribuojnë në aktivitete dhe burime moderne kulturore dhe sociale në Dragash.¹⁴⁷

Ekzistojnë dy asociacione kulturore artistike që janë aktualisht aktive: “Bresana” (nga fshati Bresanë) dhe “Biseri” (në Restelicë).

Në komunë ekzistojnë katër shtëpi kulturore si në vijim:

1. Shtëpia e kulturës në qytetin e Dragashit i ka disa dhoma dhe sallën kryesore që shërben për projektimin e filmave dhe performancave, por nuk ka sistem adekuat të ngrohjes apo pajisje për projektim kinematografik.
2. Shtëpia e kulturës në fshatin Bresanë ka një bibliotekë dhe një sallë teatrale.
3. Shtëpia e kulturës në fshatin Bellobrad ka një bibliotekë, sallën teatrale dhe këndin për internet që kryesisht përdoret nga të rinjtë.

Një objekt tjetër publik që do të mund ta kryente funksionin e Shtëpisë së Kulturës është zyra e Bashkësisë Lokale dhe Rinisë në fshatin Krushevë. Biblioteka dhe dhomat që do të përdreshin nga komuniteti janë aktualisht në dispozicion këtu, ndonëse nuk ka sallë kryesore teatrale për performanca më të mëdha. Më përjashtim të objektit në Krushevë, Shtëpitë ekzistuese të kulturës gjenden në verilindje të komunës (Opoja), në fshatrat përgjatë rrugës kryesore për Prizren.

Ekzistojnë 6 biblioteka në komunën e Dragashit, 4 nga të cilat gjenden në rajonin e Opojës me nga një bibliotekë në secilën rrugë kryesore që shpijnë në jug të qytetit të Dragashit (në Krushevë, rrugës për Restelicë dhe në Brod). Ekziston edhe një bibliotekë rajonale që gjendet në qytetin e Prizrenit. Mirëpo biblioteka në Krushevë është një objekt i kombinuar me shtëpi të kulturës. Prandaj, shumica e burimeve moderne kulturore gjenden në pjesën verilindore të komunës dhe janë më pak të qasshme për fshatrat në jug.

Një përmbledhje e objekteve të bibliotekave në komunën e Dragashit është si në vijim:

1. Biblioteka qendrore në qytetin e Dragashit është objekt i ri që përmban rreth 21, 000 libra, nga të cilat gjysma janë në gjuhën boshnjake-serbe. Biblioteka e ka një sallë leximi me disa kompjuter që mund të përdoren lirshëm nga nxënës të shkollës fillore dhe të mesme.
2. Biblioteka në fshatin Brezne gjendet në shkollën fillore, dhe përmbanë rreth 10,000 libra.
3. Biblioteka në fshatin Bresanë i ka rreth 7,300 libra.
4. Biblioteka në fshatin Krushevë ka libra në gjuhën boshnjake-serbe që numërojnë diku 5,200.
5. Biblioteka në fshatin Bellobrad ka rreth 4,700 libra.
6. Biblioteka në fshatin Brod është në objektin e shkollës fillore dhe i ka rreth 3,500 libra.

Në pajtim me trendet e përgjithshme Evropiane, numri përdoruesve të bibliotekave thuhet që është duke rënë për çdo vit ndonëse dëshmitë e 20 viteve të fundit në Evropën qendrore dhe lindore tregojnë

¹⁴⁷ Informata nga Kamberi, K., Drejtor për kulturë, rini dhe sport, Komuna e Dragashit, Mars 2012

që shkalla e rënies është më e ulët se sa në shtetet e BE-së. Anketat nga fillimi i viteve 2000 në shtetet e BE-së kanë treguar një trend të dukshëm të rënies në numrin e pikave shërbyese të bibliotekave, por një rritje e përgjithshme në stoqet e librave veçanërisht në bibliotekat nacionale dhe ato të arsimit terciar (të lartë) , që sugjeron se ka një centralizim të përgjithshëm të objekteve dhe grumbullim të burimeve. Trendi për mbylljen e objekteve të bibliotekave të arsimit terciar ka qenë më pak i shfaqur në shtetet e Evropës lindore; mirëpo këto zona janë karakterizuar me zvogëlim më të madh të bibliotekave publike.

148

Një faktor i rëndësishëm që kontribuon në ndryshimin në përdorimin e bibliotekave është arritja a botimeve digjitale dhe elektronike dhe rritja e përdoruesve të kompjuterit, veçanërisht për qëllim të referimit. Në të gjithë komunën e Dragashit, në vitin 2011 kanë qenë të regjistruar rreth 4000 përdorues, të cilët kanë lexuar gjithsej 7000 libra.

Muzetë etnografik janë tipar i shpeshtë i qyteteve në tërë Evropën juglindore, dhe ato kryesisht përqendrohen në karakterin e kulturës dhe traditave lokale më tepër se sa në kontekstin nacional apo rajonal. Si të tilla ato janë shpesh burim i dobishëm për informata që i përkasin interesit, kulturës dhe portreteve lokale të jetës së përditshme në afërsi, dhe funksionojnë si muze për vizitorë ashtu edhe si dyqane apo arkiva për komunitetet lokale. Mirëpo, përkundër traditave të pasura që janë të veçanta për këtë rajon, aktualisht nuk ka asnjë objekt që e kryen këtë funksion në komunën e Dragashit

Sportet

Klubet dhe asociacionet sportive në komunë përfshijnë:

1. Klubin e futbollit 'Pllava' në Pllavë
2. Klubin e futbollit 'Liqeni' në Brezne
3. Klubin e futbollit 'Opoja' nga një pjesë e Opojës
4. Asociacionin e ecjes 'Guri i Zi' në Dragash
5. Klubi i Skijimit 'Arxhena'
6. Klubi i skijimit 'Sharri'
7. Klubi i mundjes 'Sharri'
8. Klubi i qitjes i shkollës së mesme
9. Shkolla e futbollit nga Gllloboçicë për talent të rinj

Komuna e Dragashit ka këto objekte sportive:

1. Fusha të madhësisë së plotë të futbollit gjenden në qytetin e Dragashit toën dhe në fshatrat Brezne dhe Blaç, por ato janë aktualisht të pashfrytëzuara dhe nuk përmbajnë vendet për spektator.
2. Dy fusha me të vogla private të mbuluara me 'balon' gjenden në Mejdan.
3. Fushat komerciale të madhësisë mesatare të lojërave në Dragash, Brezne dhe Gllloboçicë.

¹⁴⁸ Nuk ka burim qëndror për statistika të bibliotekave të tërë Evropës, dhe nuk është publikuar asnjë e dhënë cilësore apo sasiore për përdorimin e bibliotekave apo burimet në Kosovë. Mirëpo, projekti Libecon që është nga viti 2002 ka filluar të zhvillojë metoda të reja për krahasim. Duhet të përmendet që përdorimi i mediave digjitale dhe elektronike është shtuar në masë të madhe që nga fillimii viteve 2000, prandaj, trendet aktuale për zvogëlim mund të jenë më të theksuara në Kosovë. <http://www.libecon.org/newsletters/2/default.asp>. E qasur më 09.04.2012.

4. Një palestër sportive gjendet në shkollën e mesme në qytetin e Dragashit.

Shkollat në 13 fshatra të Dragashit nuk kanë as objekte sportive e as fusha të lojërave. Nuk janë ofruar më shumë informata për lokacionet tjera që mund të përdoren për rekreacion nga fëmijët e fshatrave, ndonëse zonat joformale që përdoren për rekreacion janë të zakonshme.

Pistat e skijimit janë kryesisht të pazhviluara për turizëm por ofrojnë një burim për rekreacion nga popullata lokale, ndonëse interesimi për skijim dhe rrugica të ecjes mbetet i ulët. Ato ndodhen në:

- Në hotelin 'Arxhena' përtej fshatit Brod.
- Në afërsi të fshatit Radeshë.
- Përtej fshatit Zaplluxhe.

Ngjarjet e rëndësishme sportive përfshijnë turnirë të futbollit në nderim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe kampionati nacional i skijimit afër hotelit "Arxhena". Para konfliktit të vitit 1999,

është mbajtur një traditë e veçantë e lojërave të mundjes së 'pelivanëve' për çdo vit më datën 1 Maj në Dragash, me vizitorë dhe pjesëmarrës që vijnë nga e gjithë Kosova, Shqipëria, IRJM-ja, Mali i Zi dhe Turqia. Kjo ngjarje tradicionale sportive nuk është organizuar vitet e fundit, për shkak të kryesisht mungesës së fondeve.

3.8.2 Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Trashëgimia kulturore dhe natyrore bie nën ombrellën e burimeve kulturore të rajonit, që ndërlidhet për të krijuar një përmbledhje të integruar të sistemit të marrëdhënieve ndërmjet njerëzimit dhe mjedisit që i rrethon. Kjo është trashëguar dhe transmetuar tek banorët modern dhe përfshinë identitetin e gjere të komunitetit dhe shënjesit e tij si burim i përbashkët kulturor. Kjo është e një rëndësie të veçantë në Dragash duke e pasur para sysh potencialin për zhvillim ekonomik përmes turizmit.

Trashëgimia Kulturore¹⁴⁹

Në nivelin qendror, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) janë përgjegjëse për bashkërendimin dhe mbrojtjen nacionale të trashëgimisë kulturore, në veçanti përmes integritetit në mekanizmat dhe legjislacionin e planifikimit hapësinor. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është i ngarkuar me vlerësimin dhe caktimin e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme, duke bërë ndërlidhje ndërmjet 7 qendrave të Kosovës për trashëgimi kulturore (QTK) të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen, konservimin dhe integrimin e trashëgimisë kulturore në planet hapësinore lokale. QTK punon për së afërmi me strukturat komunale, duke bashkëpunuar veçanërisht me departamentet e urbanizimit dhe kulturës (ndonëse jo ekskluzivisht) dhe duke bërë bashkërendimin ndërmjet nivelit lokal dhe atij nacional. Trashëgimia kulturore në Kosovë është përligjur përmes Ligjit për Trashëgiminë Kulturore 02/L-88, Ligjin

¹⁴⁹ Informata më të detajshme mund të gjenden në *Hulumtimi i Pasurive të Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Dragashit*, Whitaker, C., UNDP shtator 2012

për Planifikim Hapësinor 2003/14, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura 2008/03-L039 dhe shtatë rregullore.

Komuna e Dragashit bie nën rajonin e Prizrenit, me Zyrën Qendrore për Trashëgimi Kulturorë – Zyra Qendrore e Prizrenit që ndodhet në qytetin e Prizrenit.

Përmbledhje e trashëgimisë kulturore

Në Jugosllavi, Dragashi (nën rajonin e Prizrenit) ka pasur tri monumente të numëruara që kanë qenë të mbrojtura në nivel nacional:

Tabela 23: Lista e Monumenteve të Mbrojtura, Jugosllavia 1967

| Emri i Monumentit | Periudha | Lokacioni | Data e futjes në listë | Kodi |
|---------------------------------------|----------------|-----------|------------------------|-------------------|
| Gërmadhat e Kalasë, "Kodra Hisar" | Shekulli 2 – 4 | Krushevë | 1967 | nr.v. E.K. 924/67 |
| Xhamia e Kukli Beut | Shekulli 16 | Bresanë | 1967 | nr.v. E.K. 925/67 |
| Gërmadhat e objektit/artefaktit fetar | Shekulli 16 | Bresanë | 1967 | nr.v. E.K. 926/67 |

Aktualisht, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është duke e bërë një inventar të trashëgimisë kulturore në tërë Kosovën. Këtu përfshihet një listë e gjere prej 12 objekteve, monumenteve dhe artefakteve që aktualisht janë nën mbrojtje të përkohshme, përfshirë tri monumente që më parë janë mbrojtur me ligjin Jugosllav. Kjo listë e zgjeruar përmban 2 zona arkeologjike, 8 objekte fetare dhe 2 ndërtesa bujqësore.

Pas konsultimeve gjatë Punëtorive për vizionin me komunitetet lokale, si dhe me kontributin e specialistëve të turizmit dhe Drejtorin e Kulturës në Dragash, është zhvilluar një listë më gjithëpërfshirëse e aseteve të trashëgimisë kulturore në komunë. Këto nuk janë në nivelin e monumenteve të mbrojtura brenda Kosovës, por janë në përputhje me vlerat ndërkombëtare kulturore siç është përkufizuar në një mori kapitujsh dhe konventash të UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës. Kjo përfshinë shqyrtimin e trashëgimisë natyrore dhe peizazheve kulturore, trashëgimisë të paprekshme kulturore, arkitekturës lokale (përfshirë edhe ndërtesat bujqësore) dhe grupet e ndërtesave, si dhe një listë të gjere të objekteve potenciale arkeologjike, objekteve fetare/artefakteve dhe monumenteve tjera potenciale.

Trashëgimia natyrore dhe peisazhet kulturore

Kjo përfshinë pikëpamje të rëndësishme dhe panorama të tërë komunës si dhe objekte të legjendave dhe folklorit, dhe tipare mbresëlënëse natyrore (si liqenet, shpellat dhe shkëmbinjët). Ajo gjithashtu përfshinë, tradita bujqësore dhe të barinjve, siç është përdorimi i plehut të kafshëve për ndërtim dhe si karburant, dhe qërimi i drunjve. Ndonëse një propozim i listës me këto zona është formuluar, kërkohen më tepër hulumtim i bazuar në terren dhe i udhëhequr nga komuniteti për të regjistruar me saktësi dhe për të gjetur objektet, si dhe për të shpjeguar dhe vlerësuar karakteristikat e tyre.

Trashëgimia e paprekur kulturore

Komuna e Dragashit është e njohur për festivalet e saj të veçanta që demonstrojnë sinkronizimin e ritualeve pagane dhe fetare, të trashëguara si nga tradita Islame ashtu edhe ajo Krishtere si dhe traditat historike që janë të përbashkëta në tërë Ballkanin.

Ato janë:

1. Shën Gjergji festohet për çdo vit në disa zona të komunës nga data 5 – 15 Maj. Është festa më e madhe dhe më e famshme e tubimeve, që tërheq vizitorë nga e gjithë Shqipëria veriore dhe Kosova si dhe nga diaspora e Dragashit që vjen në Kosovë për ta festuar me familjet e tyre. Është koha e festimeve në komunitet disa vende në natyre, si në pyje, kur fshatrat i gëzohen besimit të tyre në Zotin, ceremonive shumë-fetare dhe jetës.
2. Dita e Goranëve mbahet më 6 Maj në rajonin e Gorës, një festim me muzikë dhe veshje tradicionale. Vendi kryesor i tubimit është Vlaska, afër fshatit Vranisht. Gjatë kësaj kohe, zakonisht mbahen edhe ceremoni të martesave. Pastaj më 7 maj festimet pastaj barten në në fshatin Rapçë, dhe më 10 maj në Rapçë ku festohet dita e rinisë. Gjatë kësaj kohe mbahen gara me kuaj.
3. Pelivan, festivali i mundjes tradicionale, është mbajtur për çdo vit në qytetin e Dragashit më datën 1 maj, ku pjesëmarrësit dhe spektatorët vijnë nga Kosova, IRJM, dhe Turqia. Kjo përcillej me gara me kuaj dhe një paradë të qenve të Sharrit, me muzikë folklorike. Herën e fundit ky festival u mbajt ishte në vitin 2004, dhe aktualisht nuk mbahet për shkak të mungesës së financimit.
4. Festivali i të rinjve mbahet në fund të majit në Shtëpinë e Kulturës në qytetin e Dragashit, me pjesëmarrje të të gjitha shkollave në komunë të cilat organizojnë shfaqje teatrale, muzikë, pikturim dhe recitim të poezive.
5. Festivali i Pranverës Verza mbahet më 14 Mars, për përgatitjen e fushave për sezonin e ri të mbjelljes.
6. Festalet nacionale që janë të rëndësishme në Dragash përfshijnë Ditën e Pavarësisë (17 Shkurti) dhe Dita Ndërkombëtare e Gruas (8 marsi).

Përveç festivaleve dhe festimeve, një numër i tipareve tjera të Dragashit ofrojnë burim të vlefshëm të trashëgimisë së paprekshme kulturore. Ato përfshijnë:

- Lyerja tradicionale e fytyrës së nuseve
- Traditat e gatimit të ëmbëlsirave
- Rrëfimet dhe legjendat, veçanërisht ato që ndërlidhen me peisazhin natyror
- Traditat rurale bujqësore

Ashtu si me trashëgiminë natyrore/ peizazhet kulturore është formuluar një propozim listë e këtyre zonave, kërkohet humumtim më i detajuar i bazuar në terren dhe i udhëhequr nga komuniteti për të regjistruar dhe gjetur me saktësi ato vende, dhe për t'i përshkruar dhe vlerësuar karakteristikat e tyre.

3.8.3 Turizmi¹⁵⁰

Deri më sot nuk ka pasur asnjë plan të definuar të veprimit për turizmin në komunën e Dragashit. Një strategji e zhvilluar në vitin 2002 nuk është zbatuar asnjëherë dhe vuan nga mungesa e investimeve në infrastrukturën e përgjithshme dhe në mënyrë më specifike në infrastrukturën e turizmit (përfshirë ndërtimin e kapaciteteve), në veçanti lidhur me mundësitë rurale dhe ato që janë bazuara në natyre. Decentralizmi ka nënkuptuar që komuna duhet t'i marrë përgjegjësitë kryesore për sektorin e sigurisë, dhe kështu edhe politikat e turizmit është dashur që të zhvillohen nga fillimi. Përveç kësaj, Kosova vuan nga një pozitë e dobët e turizmit në rajon, për shkak të imazhit negativ, çështjet e statusit të pazgjidhur dhe mungesa e financimit për zhvillimin dhe promovimin e turizmit. Përkundër këtyre kufizimeve,

¹⁵⁰ Shih raportet e UNDP nga Wassel, T.: *Strategjia për Turziëm në Natyrë; Malet e Dragashit: Udhërrëfytyrë për Shëtitje dhe Turizëm në Natyrë i Kosovës; Katalogu i Turizmit*

Dragashi dhe Kosova në përgjithësi ka potencial për të zhvilluar një treg të veçantë të produkteve të turizmit që mund të integrohen në burimet tashmë ekzistuese rajonale.

Aktualisht Dragashi ka objekte të kufizuara për pritjen e vizitorëve, përkundër potencialit të vet lokal si një zonë për skijim dhe aktivitete në natyrë. Ekziston një hotel funksional – hoteli Arxhena në Brod – Ndonëse hoteli Meka në Dragash është duke u rinovuar dhe pritet që të hapet në vitin 2012. Ekziston edhe një hotel në fshatin Zaplluxhe që rishtazi është kompletuar por është mbyllur pasi që nuk ka pasur sa duhet mysafir dhe pronari jetom jashtë vendit. Këto objekte, nëse funksionojnë do të ofronin deri në mesatarisht 110 shtretër. Një shtëpi private (Brod) është konvertuar në akomodim për mysafir, ndonëse ka nevojë për renovim dhe prezantim të cilësisë më të lartë. Gjithashtu, restoranti i sapo ndërtuar (dhe së shpejti edhe hotel) në fshatin Restelicë kërkon avansime të mëtutjeshme për të pasur qasje në rrugë para se kjo të bëhet një lokacion i mirë turistik. Përveç kësaj, mali ndërmjet qytetit të Dragashit dhe Prizrenit mund të jetë në gjendje që të ofrojë akomodim për personat që vijnë për kampim, ecje në natyrë dhe shetitësve.

Dragashi ka shumë potencial për të zhvilluar strategji të turizmit që bazohet në tiparet natyrore dhe kulturore. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj është origjinaliteti i vendit që paraqet një lidhje ndërmjet natyrës dhe kulturës rurale malore. Izolimi i komunës mund të jetë shkak për shumë nga problemet e saj aktuale; mirëpo, mund të konsiderohet si përparësi pasi që ka qenë në gjendje që t'i ruajë shumë nga aktivitetet e veta tradicionale të bujqësisë blegtorisë, traditave dhe mënyrave të jetesës që janë zhdukur në shumicën e Evropës, prandaj edhe mund të shërbejnë si lokacione atraktive për turistët. Tri shtyllat e turizmit në Dragash janë:

1. Bukuria natyrore (malet, biodiversiteti)
2. Kultura dhe trashëgimia (kultura Opojane dhe Gorane, mënyra e jetës tradicionale)
3. Mikpritja dhe kuzhina e pasur (ushqimi i prodhuar aty, mikpritja fshatare)

Dragashi përmbanë një pasuri të mundësive ende të pashfrytëzuara për aktivitete në natyrë dhe turizëm, përfshirë:

- Gjurmimin e kafshëve, shikimin e zogjëve, dhe svëzhgimi i natyrës (përfshirë për qëllime akademike dhe hulumtuese)
- Peshkimin
- Ecjen në natyrë dhe në kodra
- Ngasjen e biçikletave
- Vendet për piknik
- Kampimin
- Eksplorimin e trashëgimisë, arkeologjisë dhe kulturës rurale
- Skijimin
- Ecjen në borë
- Kalërimin
- Çiklizmin
- Ngasjet skenike
- Produktet natyrore lokale dhe kultivimi (bimë, mjaltë, fruta dhe perime)

Lokacionet e aseteve të veçanta natyrore janë:

- Parku Nacional i Sharrit
- Zonat e largëta dhe një nga vendet e vetme në Evropë ku entuziastët e natyrës së egër mund të shohin ari dhe ujqër

- Një sërë shtigjesh të definuara të ecjes në natyrë/çiklizmit
- Mali Koritnik
- Brodi (fshati turistik)
- Lugina e Opojës (çiklizëm, piknik, turizëm malor agro turizëm)
- Malet jugore/Rrafshnaltat me tipare të dallueshme
- Kultura Opojane dhe Gorane
- Potenciali tejkufitar (Shqipëri dhe IRJ të Maqedonisë)

Mirëpo, përkundër kufizimeve kryesore financiare dhe infrastrukturore për zhvillim të një industrie efektive të turizmit në Dragash, një numër i dobësive dhe kërcënimeve tjera paraqesin pengesa që duhet të merren para sysh njëkohësisht:

- Keqmenaxhimi dhe degradimi i burimeve natyrore
- Menaxhimi i dobët i mbeturinave, që shie në ndotje dhe hedhje vend e pavend të mbeturinave
- Njohuria e pakët për mikpritjen dhe furnizimin me ushqim tek ofruesit e shërbimit
- Njohuria e pakët e marketingut dhe brandimit
- Deri diku mungesa e besimit ndërmjet rajoneve/komuniteteve të ndryshme
- Emigrimi i fuqisë së re punëtore nga komuna në kërkim të mundësive tjera dhe punësimit
- Mungesa e një strategjie të komunikimit dhe bashkërendimit ndërmjet operatorëve të vegjël, si në nivelin rajonal ashtu edhe atë nacional.

Turizmi është mbuluar në mënyrë më të detajuar më Katalogun Turistik të Rajonit të Dragashit, Udhëzuesin turistik, Ecja dhe Natyra dhe Strategjinë e Turizmit në Dragash të Bazuar në Natyrë.

Ndikimi i Parkut Nacional

Zonat e mbrojtura, si parqet Nacionale, janë vende që mbrohen për shkak se ato posedojnë vlera shumë të mëdha, si peizazhi i bukur, janë të pasura me specie të rralla të bimëve dhe kafshëve, kanë objekte të rëndësishme arkitektonike dhe historike, tradita të rëndësishme, apo kombinim të të gjitha këtyre. Zonat dhe vendet e mbrojtura përreth janë disa nga lokacionet më të bukura në botë, që tërheqin shumë vizitorë nga Evropa dhe bota. Ato janë komponentë e rëndësishme e ekonomisë, që kontribuojnë me përmbi 15 miliardë Euro në vit në punësim, dhe shërbime tjera për popujt e Evropës.

Ka shumë mundësi për aktivitete turistike në Parkun Nacional. Sipas projekt Planit Hapësinor për Parkun Nacional të Malit të Sharrit, më tepër se 40% e të gjitha zonave të skijimit të Maleve të Sharrit (përfshirë edhe në IRJ të Maqedonisë) gjenden në komunën e Dragashit, në vendet si fshatrat Zaplluxhe, Radeshë, Brod dhe Restelicë. Këto zona me potencial për turizmin dimëror gjithashtu ofrojnë atraksione ujore, me shumë burime ujore, përronjë, vegjetacion të larmishëm dhe peisazhe piktoreske që mund të shfrytëzohen edhe për rekreacion veror. Dragashi mund të zhvillojë një ekonomi të qëndrueshme të turizmit përmes një partneriteti ndërmjet sektorit publiko, sektorit privat dhe shoqërisë civile për ta mbrojtur mjedisin, rritur punësimin dhe ofruar mundësi të ndërmarrësisë dhe përfitime sociale, ekonomike dhe të hyra të komunës. Shpallja e Parkut Nacional gjithashtu do të rrisë mundësitë për gjiro turistike të bazuar në aspektet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore në komunën e Dragashit, siç janë xhamitë dhe teqetë e vjetra, ndërtesat dhe proceset bujqësore, mbetjet arkeologjike, grupet e rralla të arkitekturës rurale tipike, dhe qasja në ritualet, traditat dhe legjendat. Kjo gjithashtu do të ndihmojë që të sigurohet mbrojtje e burimeve të vlefshme natyrore dhe të trashëgimisë kulturore në komunë.

3.8.4 Sfidat e genësishme në situatën ekzistuese të turizmit dhe kulturës

Mungesa e institucioneve publike dhe zonave publike për kulturë, sport dhe rekreacion është e evidente.

- Si munden zonat/terrenet e reja të nevojshme të identifikohen (p.sh. bibliotekë, teatër/kinema, kënde publike, kënde të lojërave, fusha sportive...) dhe si munden ato të sigurohen?

Dragashi ka një numër të aseteve kulturore, të cilat nuk janë inventarizuar dhe mbrojtur; nevojitet hulumtim i mëtejshëm.

- Si munden objektet historike dhe tradicionale të ruhen gjatë procesit të zhvillimit dhe modernizimit?

Dragashi ka potencial të lartë për turizëm por aktualisht ka objekte të limituara për t'i mbështetur vizitorët.

- Si mundet pozita e Dragashit, vlerat natyrore dhe kulturore të shfrytëzohen për të avancuar zhvillimin turistik dhe ekonomik?
- Cilat zona dhe fshatra duhet të jenë fokus për zhvillim të turizmit?

3.9 RRJETI RRUGOR DHE TRANSPORTI

3.9.1 Rrjeti rrugor

Komuna e Dragashit është e lidhur me pjesën tjetër të Kosovës përmes dy rrugëve: njëra është e asfaltuar, e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me autostradën e re ndërmjet Shqipërisë dhe Prishtinës, fillon në Zhur dhe futet afër fshatit Brezne/Brezna, dhe një rrugë tjetër e paasfaltuar që futet afër fshatit Zaplluxhe. Një rrugë e vetme e pashtuar nga Restelicë shpie tek kufiri në jug, dhe e ndërlidhë Dragashin me rajonin Gorna Reka në IRJ të Maqedonisë tek kalimi malor në Lukovo Pole (1500), ndonëse kjo është mbyllur që nga viti 2001. Shtigje tjera të ecjes në këmbë dhe shtigje bujqësore përshkrajnë vendkalimet joformale të kufirit në IRJ të Maqedonisë dhe Shqipëri.

Ekzistojnë rreth 570km të rrugëve dhe shtigjeve brenda komunës së Dragashit, nga të cilat afërsisht gjysma (278km) janë të qasshme për veturat e zakonshme. Ato kanë dallime të mëdha në cilësinë e tyre. Deri para disa viteve kushtet e këqija të rrugëve në komunë kanë luajtur rol kryesor në izolimin e komuniteteve të fshatrave të Dragashit, duke i prekur kështu një numër të aspekteve të jetës së përditshme, nga qasja në arsim gjatë dimrit deri te qasja në tregje për shitje të produkteve dhe mallrave. Në disa vitet e fundit, komuna ka ndërmarrë përpjekje të mëdha për përmirësimin e gjendjes së rrugëve lokale. Aktualisht ekzistojnë vetëm dy fshatra të largëta që nuk kanë qasje në rrugë të asfaltuar: Orçushë dhe Pllajnik. Prandaj, shumica e vendbanimeve kanë qasje në rrugë rajonale përmes rrugëve të asfaltuara, ndonëse duhet të theksohet që rrugët ndërmjet fshatrave dhe ndërmjet fshatrave janë në shumë raste ende të paasfaltuara.

Ndërmjet vitit 2011 komuna ka shpenzuar shumicën e buxhetit të saj të investimeve në përmirësimin e rrugëve. Gjithsej gati 3 milion Euro janë shpenzuar – 60% e investimeve të përgjithshme për këtë periudhë.

3.9.2 Transporti

Rrugët gjarpëruese të terrenit malor të Dragashit nënkupton që shumica e transportit bëhet me vetura (përfshirë 'taksitë' e përbashkëta), e jo me autobus apo transport tjetër publik. Një numër i ulët (ndërmjet 8 dhe 13) i fshatrave kanë theksuar që nuk kanë shërbim privat të transport që ofrohet në fshatin e tyre. Janë 7 kompani private të autobusëve të cilat i operojnë linjat e autobusëve. Ka më shumë lidhje ndërmjet Prizrenit dhe fshatrave Zaplluxhe dhe Bresanë se sa drejtpërdrejt ndërmjet Prizrenit dhe Dragashit (vetëm një linjë e autobusit). Autobusët tjerë ofrojnë shërbim nga fshatrat në qytetin e Dragashit.

Transporti me autobus është më i vështirë në fshatrat rurale malore ku udhëtimet bëhen më tepër me vetura private. Nuk ka autobus nga Prizreni në rajonin e Gorës apo nga Opoja në Gorë. Vendndalimi i fundit i autobusit për Gorën është qyteti i Dragashit, nga ku udhëtimet vazhdojnë me vetura private apo me taksi. Transportimi në disa fshatra të Gorës ofrohet vetëm për studentë gjatë vitit akademik. Janë edhe tre autobusë që në baza ditore ofrojnë udhëtim për në Beograd, Serbi.¹⁵¹

Kufijtë dhe stacionet kufitare¹⁵²

¹⁵¹ Anketa e UNDP-së, qershor 2012

¹⁵² Nga UN-Habitat Draft PZhK, shtator 2010

Zyrtarisht, Dragashi është luginë e enklavizuar që është e lidhur me pjesën tjetër të botës përmes rrugës për në Zhur e cila nga aty e lidhë atë me Prizrenin dhe Kukësin/Shqipëri. Mirëpo, në nivelin historik dhe social, secila nga luginat e komunës ka pasur dhe ende ka një apo më shumë lidhje me komunat fqinjë në Kosovë, IRJ të Maqedonisë dhe Shqipëri. Në këtë aspekt, kufijtë politik paraqesin pengesa më të mëdha për lidhjet ndërkomunale dhe ndërkombëtare se sa barrierat fizike.

Ashtu sikur lidhjet e brendshme, disa nga këto lidhje tejkufitare e kanë situatën e profilit dhe atë gjeografike që do të sugjeronte avancimin e tyre në rrugë të mirëfillta. Krusheva e ka një rrugë funksionale me zhavorr për në Shqipëri, por kufiri është i mbyllur për vetura; fshatit Orçushë i mungojnë vetëm disa qindra metra rrugë për t'u lidhur me shqipërinë; rruga përmes Parkut Nacional të Mavrovës në IRJ të Maqedonisë lidhet me territorin jugor të Restelicës, që është i qasur vetëm me veturë 4x4 gjatë periudhës kur nuk ka borë. Nga fshati Zapluzhë dy rrugë e lidhin luginën e Zhupës dhe rruga e vjetër/shtegu drejt Tetovës në IRJ të Maqedonisë është pjesërisht e riparuar, por ende mund të përshkohet vetëm me veturë 4x4 dhe vetëm gjatë sezonit kur nuk ka borë.

Dragash – Shqipëri:

Disa shtigje bujqësore, rrugë me zhavorr dhe rrugica kalojnë përtej kufirit në Shqipëri. Një numër i tyre ende përdoren si shtigje për bagëti. Ka qenë e paligjshme që të kalohet kufiri me veturë që nga viti 1999. Nga fillimi i vitit 2012 ekzistojnë tri stacione të sapo ndërtuara kufitare në anën e Shqipërisë:

- Në përfundim të fshatit Orçushë: stacioni kufitar mobil, i lidhur me rrugën lokale me zhavorr që shpie në fshatin Orgjost në anën e Shqipërisë, por ai lidhet vetëm me një shteg këmbësorësh në anën e Kosovës.
- Në veriperëndim të fshatit Glloboçicë: një kufi i vogël i këmbësorëve, i lidhur me shtigjet në të dyja anët.
- Në veriperëndim të fshatit Krushevë: stacioni kufitar mobil, i lidhur me rrugët me zhavorr shpie në fshatin Novosej në Shqipëri dhe në Krushevë.

Dragash – IRJ e Maqedonisë:

Kufiri ndërmjet komunës së Dragashit dhe IRJM-së përafërsisht e përshkon vijën më të lartë të Maleve të Sharrit. Për shkak të kësaj, ekzistojnë vetëm dy lidhje tejkufitare.

- Jug të Restelicës: Një rrugë e pashtuar nga Restelicë shpie në kufijtë jugor, dhe e lidh Dragashin me rajonin e Gorna Rekës në IRJ të Maqedonisë në kalimin malor të Lukovo Poles (1500m). Kjo lidhje ka qenë e një rëndësie të vecantë për lëvizjet sezonale të personave dhe bagëtive dhe tregtinë e produkteve bujqësore, por është i mbyllur që nga viti 2001.
- Në juglindje të fshatit Zaplluxhe: Një rrugë e pashtuar shkon lart nga fshati Zaplluxhe në male dhe arrin deri në kufi me IRJ të Maqedonisë në Malin Skarpë në një lartësi prej 2474m. Për shkak të kësaj lartësie dhe pasi që nuk ka ndjekje nga ana tjetër, kësaj nuk iu është dhënë rëndësi e madhe ende.

Kufizimet natyrore, në lidhjet rrugore përtej maleve gjithmonë kanë qenë arsye për largësinë e Dragashit. Situata politike që ka krijuar kufij të ri dhe të pakalueshëm nacional përreth Dragashit e ka rënduar edhe më shumë këtë disavantazh.

Hapja e kufijve dhe ndërtimi i rrugëve të reja tejkufitare ka gjasa që të krijojë potencial të madh për zhvillim ekonomik të Dragashit. Mirëpo, këto projekte nuk mund të diskutohen pa e marr para sysh ndikimin mjedisor, që mund të jetë veçanërisht i madh në këto ekosisteme të ndjeshme malore.

3.9.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të rrugëve dhe transportit

Rrjeti rrugor është relativisht i mirë, por kualiteti i rrugëve është i dobët dhe ende ka rrugë të pashtruara; lidhjet rrugore që çojnë jashtë komunës janë posaçërisht të dobëta.

- Ku janë të nevojshme ndërhyrjet urgjente në kompletimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor për të lehtësuar lëvizjen e banorëve dhe të vizitorëve?
- Cilat lidhje jashtë duhet të forcohen, duke marrë parasysh kriteret mjedisore dhe ekonomike?

Transporti publik nuk është i organizuar në mënyrë të duhur; në disa pjesë të komunës nuk ka fare transport publik.

- Si mundën transporti publik dhe shërbimet në rajonet e Opojës dhe të Gorës të përmirësohen?

3.10 Menaxhimi I Mbeturinave të Ngurta

3.10.1 Pasqyrim i përgjithshëm

Mbeturinat në Kosovë janë mbledhur sipas procedurave moderne të menaxhimit të mbeturinave që nga viti 1947, fillimisht me qerre me kuaj, e më vonë me traktorë dhe kamionë. Mbeturinat në Dragash janë mbledhur që nga viti 1968 nga “Kompania Komunale për Ndërtim, Ujë dhe Higjienë,” e cila i ka pasur 22 punëtorë. Në vitin 1993 kompania është ndarë në dy kompani, që merren në mënyrë të ndarë me menaxhimin e ujit dhe mbeturinave.

Nuk ka të dhëna të plota në nivel nacional për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe hedhjen e mbeturinave. Mirëpo, vlerësimet nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit tregojnë që në vitin 2008, 39% e ekonomive familjare në tërë vendin kanë pasur shërbime të mbledhjes së mbeturinave.¹⁵³ Ekziston një dallim i madh ndërmjet shërbimeve të mbledhjes së dispozitave në zonat urbane dhe rurale; ajo e para ka mbulueshmëri prej 90% derisa vetëm 10% të zonave rurale mbulohen me këtë shërbim. 40% e vendbanimeve në komunën e Dragashit (që të gjitha konsiderohen si rurale) kanë shërbime të mbledhjes së mbeturinave që është në pajtim me mesataren nacionale. Dallimi ndërmjet rajoneve veriore dhe jugore të komunës janë shumë të mëdha, mirëpo: 3 nga 16 fshatra në rajonin e Gorës, kanë qasje në shërbimet e mbledhjes së mbeturinave (rreth 19%) derisa afërsisht 95% e fshatrave në rajonin e Opojës janë të mbuluara me këtë shërbim.

Fusha e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë rregullohet me Ligjin për Mbeturinat nr. 02/L-30.

Sipas këtij ligji, llojet e mbeturinave janë:

- Mbeturinat komunale
- Mbeturinat komerciale
- Mbeturinat industriale

Një klasifikim tjetër i mbeturinave është klasifikimi i bazuar në ekspozimin dhe rrezikun që klasifikohen si:

- Mbeturina të ngurta
- Mbeturina të parrezikshme
- Mbeturina të rrezikshme

Në Dragash, shërbimi i mbledhjes së mbeturinave ofrohet për rreth 60% të fshatrave (21 nga gjithsej 36 vendbanime), me 60 kontejnerë me kapacitet 1.1m³ që janë të shpërndarë sipas nevojës, kërkesës dhe sasisë së mbeturinave. Mirëpo, përkundër donacioneve ndërkombëtare, komunës së Dragashit i mungon infrastruktura e duhur dhe strategjitë për menaxhimin e mbeturinave. Ato zona që nuk mbulohen me shërbim komunal të mbeturinave shpesh i hedhin mbeturinat në mënyra të gabuara (si djegia, apo hedhja në deponi joformale apo lumenj) gjë që përbënë kërcënim serioz për shëndetin e njeriut si dhe rrezik për ekosistemet e vlefshme dhe vendbanimet e egra të natyrës. Këto deponi të mbeturinave me pamje shumë të shëmtuar gjithashtu kanë gjasa të kenë ndikim negativ në mundësitë ekonomike për turizmin e bazuar në natyrë.¹⁵⁴

¹⁵³ *Gjendja e mbeturinave në Kosovë Raporti I vitit 2008 Report*, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, Ed. MMPPH/AKMM, 2009. Nga http://www.ammk-rks.net/repository/docs/6State_of_Ëaste.pdf. E qasur në 26.04.2012

¹⁵⁴ Përveç nëse nuk tregohet ndryshe, të gjitha informtat në këtë pjesë janë marë nga Projektraporti I UNDP-së për Menaxhimin e Mbeturinave, 2010 nga Hysni, A

Një kompani private e mbeturinave (Ekoregjioni) vepron në komunën e Dragashit, me bazën e vet kryesore në Prizren. Kompania mbledh mbeturina për çdo ditë përveç të dielave, me mbledhje javore nëpër zonat rurale që operojnë me sistemin derë më derë. Kjo njësi e mbledhjes së mbeturinave iu shërben 2694 klientëve të kategorive të ndryshme (shtëpi private, institucione, objekte, apartamente, fshatra). Mirëpo, mesatarisht vetëm 59% tëq faturave paguhen nga ekonomitë familjare, objektet dhe institucionet. Analizat në Projekt Raportin e UNDP-së për Menaxhimin e Mbeturinave (Hysni, A. 2009) demonstroi që këto të hyra janë të pamjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e larta të kompanisë së mbeturinave, dhe e ulë disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit që iu ofrohet fshatrave në Dragash. Në disa zona, ekonomitë familjare i përdorin shërbimet e mbeturinave por nuk e paguajnë tarifën e tij. Qeveria lokale në Dragash nuk është e angazhuar në përkrahjen e kësaj njësie operative për inkasimin e të hyrave. Kjo e lë një zbrazëti mesatare vjetore në të hyra prej afërsisht 70, 000€ sipas shifrave të vitit 2008.

Deponia e vetme zyrtare në komunën e Dragashit gjendet afër fshatit Brezne/Brezna, 12 kilometra nga Dragashi rrugës për Prizren, në vendin e quajtur "Trokon". Dimensionet e kësaj deponie janë 247m x 40m apo afërsisht 1.2ha, derisa kapaciteti i saj total është 50,000m³. Kapaciteti mujor i kësaj deponie është 20 tonelata. Ndonëse deponia është ndërtuar sipas standardeve të BE-së me fonde të Komisionit Evropian ajo prapëseprapë nuk është në pajtim me standardet minimale pasi që gjysma e deponisë nuk është e mbuluar me shtresë të dheut (për shkak të kufizimeve financiare) dhe ujërat e zeza nuk trajtohen fare.

3.10.2 Mbeturinat dhe riciklimi

Aktualisht mbledhja e mbeturinave nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet bëhet pa vecim fillestar, që nënkupton se nuk bëhet selektim i mbeturinave në mbeturina organike, metal, qelq, letër mbeturina të rrezikshme: bateri, barëra etj.

Mbeturinat e ekonomive familjare

Mbeturinat e ekonomive familjare janë grupi i tretë më i madh i mbeturinave të prodhuara në Kosovë, dhe përbëjnë rreth 14% (101kg/person) të mbeturinave të përgjithshme vjetore. 35.3% e mbeturinave të ekonomive familjare të grumbulluara janë mbeturina organike që janë të biodegradueshme. Një përqindje tjetër prej 21% janë qelq, 11% materie drusore, 9.4% plastikë, 9.3% metal, 8.2 tekstil dhe 4.6% letër.¹⁵⁵

Mbeturinat e rrezikshme industriale

Në tërë Kosovën, mbeturinat e rrezikshme përbëjnë afërsisht 1.2% të mbeturinave të përgjithshme. Shumë substanca, në forma të ndryshme agregate, kanë mbetur të pashfrytëzuara për një kohë të gjatë në vende të ndryshme, depo, dhe zona industriale të cilat janë degraduar me kalimin e kohës. Janë ndërmarr disa masa për zvogëlimin e rrezikut nga këto substanca me mbështetjen e donatorëve si KFOR-i dhe Trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK). Përveç kësaj, substanca tjera të rrezikshme janë të pranishme për shkak të prodhimit të industriale, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve tjera. Një Ndërmarrje me seli në Dragash e cila prodhon një lloj mbeturine industriale përfshinë Rematex në

¹⁵⁵ Gjendja e Mbeturinave në Kosovë 2008 Raport, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, Ed. MMPH/AKMM, 2009. Nga http://www.ammk-rks.net/repository/docs/6State_of_Waste.pdf. shikuar më 26.04.2012

procedimin dhe prodhimin e rrobave të lehta dhe tekstileve. Mirëpo nuk ka të dhëna të sakta për sa i përket ndikimit mjedisor të këtyre proceseve industriale.

Mbeturinat mjekësore

Mbeturinat mjekësore përbëjnë 0.12% të mbeturinave të përgjithshme vjetore në Kosovë.¹⁵⁶ Këto janë mbeturinat që gjëndërohen nga spitalet dhe repartet tjera të kujdesit shëndetësor, dhe përbënë rrezik të veçante për shëndetin njerëzor dhe mjedisin në Dragash pasi që nuk trajtohen në mënyrë të duhur. Sipas monitorimit në terren dhe të dhënave tjera, mbeturinat farmaceutike nuk mblidhen, transportohen apo shkatërrohen në pajtim me standardet e duhura. Mbeturinat e spitaleve mblidhen në kontejner të posaçëm por kjo nuk bëhet edhe për shërbimet e kujdesit shëndetësor në sektorin privat. Qendra Kryesore Familjare në qytetin e Dragashit gjeneron afërsisht 14 tonelata mbeturina në vit.

Mbeturinat ndërtimore

Mbeturinat ndërtimore përbëjnë 10% të mbeturinave të prodhuara në vit në Kosovë.¹⁵⁷ Dragashi rishtazi ka pasur një lulëzim në ndërtim, me 25 biznese të regjistruara të ndërtimit në komunë, një biznes të transportimit të materialeve ndërtimore dhe një sharrë për procedimin e drurit, që gjithsej punësojnë rreth 45 persona. 5 nga këto kompani janë të regjistruara në qytetin e Dragashit, derisa pjesa tjetër gjendet vetëm në veri dhe verilindje të rajonit të Opojës në komunë. Pjesa më e madhe e shtëpive të pabanuara në Dragash gjithashtu është dëshmitare e kësaj fryme të ndërtimit, ku 39.1% të shtëpive janë të zbrazëta. Të dhënat nuk tregojnë nëse këto ndërtesa janë në proces të ndërtimit (dhe prandaj janë ende të pabanuara) apo nëse ato janë kryer dhe qëllimisht janë lënë të zbrazëta, mundësisht për të ofruar një vend për pushime të familjeve që e vizitojnë komunën gjatë verës.

Forma tjera të mbeturinave të ngurta që paraqesin rreziqe të mundshme: përfshijnë gomat e veturave, veturat në fund të jetës së tyre dhe metali, vaji i djegur, dhe bateritë. Aktualisht nuk ka të dhëna për gjendjen e këtyre formave të mbeturinave në Dragash. Forma më e përhapur e mbeturinave të ngurta të prodhuara në Kosovë është Hiri dhe ndotja, me rreth 45% të mbeturinave të përgjithshme vjetore (331kg/person). Kjo pasohet me forma tjera të mbeturinave (paketimi, plastika, gomat, pesticidet etj) që përbëjnë 18 % të totalit (131.4kg/person në vit).¹⁵⁸

Sasia e mbeturinave të ngurta në fshatrat e Dragashit

Mbledhja e mbeturinave kryhet derë më derë dhe nga kontejnerët, që janë të shpërndarë në pika të caktuara në fshatra. Transportimit të mbeturinave nuk i bëhet kurrfarë trajtimi preliminar, kështu që vëllimi i mbledhur shkon drejt në deponi.

¹⁵⁶ Po aty

¹⁵⁷ Po aty.

¹⁵⁸ Po aty.

Tabela 24: Sasia e mbeturinave të mbledhura në vitin 2008 (tonelata)

| Fshati | Sasia vjetore (tonelata) |
|---------------------|--------------------------|
| 1. Dragash (qyteti) | 341 |
| 2. Blaç | 44 |
| 3. Bellobrad | 266 |
| 4. Kapre | 91 |
| 5. Zym | 138 |
| 6. Zaplluxhe | 301 |
| 7. Buzez | 73 |
| 8. Bresanë | 672 |
| 9. Kuk | 293 |
| 10. Kuklibeg | 168 |
| 11. Kosavë | 182 |
| 12. Brrut | 184 |
| 13. Pllavë | 236 |
| 14. Shajne | 233 |
| 15. Rrenc | 172 |
| 16. Zgatar | 163 |
| 17. Brezne | 400 |
| 19. Buçe | 172 |
| 20. Rapçë | 263 |
| 21. Lubovishtë | 194 |
| 22. Restelicë | 820 |
| TOTAL | 5406 |

Shërbimet e asgjësimit të mbeturinave nuk ofrohen për 14 nga 36 vendbanimet: përveç fshatrave Rapçë, Restelicë dhe Lubovishtë nuk ka mbledhje zyrtare të mbeturinave nga fshatrat në rajonin e Gorës, derisa Xërxa është fshati i vetëm në Opojë që nuk e ka këtë shërbim. Një faktor i rëndësishëm në këtë është mospagesa e tarifave të mbledhjes së mbeturinave, por edhe pamundësia e veturave për asgjësimin e mbeturinave që të manovrojnë në rrugët gjarpëruese që shiejnë në këto zona dhe popullata e pakët në numër që nuk prodhon shumë mbeturina gjithashtu mund të kontribuojë më shkallën e ulët të inkasimit. Deponitë joformale (nëpër lumenj apo në skaje të fshateve) janë të pranishme në këto fshatra që nuk shërbehen nga kompania e mbeturinave. 15 (afërsisht 42%) nga 36 vendbanime kanë deponi joformale nëpër fshatra, derisa ka djegje të rregullt të mbeturinave në shumicën e fshatrave.

Projektet dhe investimet

Janë bërë përpjekje për të ofruar shërbim të asgjësimit të mbeturinave në fshatrat më rurale dhe në rajonin e Gorës gjatë projektit njëvjeçar të udhëhequr nga ICS-ja italiane në katër fshatra (në Lubovishtë, Kulkanë, Vranisht dhe Radeshë në vitin 2005. Përkundër këtij investimi, projekti është

konsideruar si i dështuar pasi që popullata ka refuzuar të paguajë pagesën mujore prej 1 Euro. I tërë projekti ka kushtuar 17, 000€.

Sipas të dhënave nga Projektraporti i UNDP-së për mbeturinat, është konstatuar që përmbi 10, 000 banorë – në përmbi 2700 ekonomi familjare – nuk e kanë pranuar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Këtu nuk përfshihet numri i bizneseve dhe institucioneve në këto fshatra. Nëse gjenerimi mesatar për kokë banori në nivel të Republikës së Kosovës merret para sysh, atëherë është vlerësuar që përmbi 4000kg mbeturina hedhen nëpër fusha dhe lumenj për çdo ditë.

3.10.3 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave të ngurta

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk mbulojnë tërë komunën. Hedhja në mënyrë jo të duhur e mbeturinave në natyrë, posaçërisht nëpër lumenj, dëmton mjedisin.

- Si mund të themelohet një sistem efektiv i grumbullimit të mbeturinave për tërë komunën?
- Çka duhet të bëhet për të ngritur vetëdijen mbi hedhjen e rregull të mbeturinave në konsideratë me mjedisin natyror?
- Si duhet të trajtohen deponitë aktuale joformale?

Riciklimi dhe përdorimi i përsërishëm i mbeturinave si një resurs në përgjithësi nuk praktikohet, dhe, në kombinim me vetëdijen e ultë mjedisore, si rezultat janë deponitë joformale.

- Si mund të zhvillohen sistemet e riciklimit për mbeturinat, me qëllim që të krijohet përfitim ekonomik, për të kursyer resurset natyrore dhe për të zvogëluar sasinë e mbeturinave?

3.11 Infrastruktura dhe shërbimet Komunale

3.11.1 Furnizimi me ujë¹²⁶

Aktualisht, vetëm dy vendbanime në Komunën e Dragashit furnizohen nga sistemi qendror i furnizimit me ujë të furnizuesit lokal të licencuar Hidroregjioni Jugor: Dragashi me një popullsi prej 1098 banorë dhe Pllavë me një popullsi maksimalisht prej 1000¹⁵⁹ banorë të vlerësuara gjatë verës. Në të dyja rastet, uji i sipërfaqes nga lumi shfrytëzohet për furnizim.

Sondazhet e bëra nga UNDP tregojnë nivel të lartë të kënaqshmërisë ndër banorë me cilësinë e ujit të pijshëm dhe furnizimin e përgjithshëm me ujë.¹²⁷ Shumica e këtyre vendbanimeve furnizohen nga sistemet private që mbështeten në puseta, burime apo ujë sipërfaqësor të lumit. Shkalla e furnizimit më të ultë mund të gjendet në Brezne, Mlikë, dhe në Rapçë me vetëm 20% të banorëve që furnizohen. Në Vranishtë vetëm 30% furnizohen, në Zgatar 50% dhe në Brrut, Kapre, Kërstec, Restelicë dhe Rrenc 80%. Të gjitha fshatrat tjera arrijnë një shkallë të furnizimit me ujë prej 100%.

Ashtu sikur me shërbimet tjera komunale, mospagesa e faturave dhe lidhja e paligjshme është edhe një faktor i rëndësishëm i qasjes në furnizimin me ujë të rregullt. Sistemi i vjetër dhe të mirëmbajtura dobtë i sistemit të gypave shkakton humbjen e ujit dhe kontaminimin potencial.¹⁶⁰

Cilësia e ujit të pijshëm nuk mbikëqyret dhe burimet e ujit nuk mirëmbahen. Uji sipërfaqësor dhe uji nëntokësor nga burimi deri në vendbanim bëjnë pjesë në Kategorinë I përse i përket pastërtisë, por ndotja është e pranishme (Kategoria 2) në rrjedhat ujore përmes qytetit të Dragashit dhe rrymave që shpiejnë në drejtim të kufijve komunal, dhe këto nuk plotësojnë standardet e nevojshme për ujë të pijshëm pasi që është i ndotur nga materiet fekale.¹²⁹

Si rezultat i analizave të ujit të pijshëm, kontaminimet mikrobiologjike të ujit janë identifikuar në këto fshatra: Brrut, Bellobrad, Leshtan, Kukulanë, Kuklibeg, Kosavë dhe Dragash dhe ndotje kimike në: Bellobrad dhe Zlipotok.

Komuna e Dragashit ka investuar rreth 500,000€ prej vitit 2007 deri më 2011 në përmirësimin e furnizimit me ujë në tërë territorin. Kjo përbën rreth 11% të investimit të përgjithshëm komunal për këtë periudhë.

Tabela 25: Furnizimi me ujë në fshatrat e komunës së Dragashit

| Fshati | Furnizimi | Burimi | Banorët që furnizohen |
|-----------|-----------|---------------|-----------------------|
| Baçkë | vetë | Burim | 100% |
| Bellobrad | vetë | Burim | 100% |
| Blaç | vetë | Burim dhe lum | 100% |
| Brezne | vetë | Pusetë | 20% |
| Brod | vetë | Burim | 100% |

¹²⁶ Atlasi për Zhvillim të Qëndrueshëm i UNDP-së: Volumi 2, Qershor 2012

¹⁵⁹ Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Shtëpive në Kosovë 2011, Rezultatet finale: Të Dhënat kryesore

¹²⁷ Sondazhet e UNDP për fshatra, 2011

¹⁶⁰ UNDP Raport: Vlerësimi i Sektorit të Ujit në Komunën e Dragashit, Markaj, T., mars 2010

¹²⁹ Po aty.

| | | | |
|------------|---------|---------------|------|
| Bresanë | vetë | Burim dhe lum | 100% |
| Brrut | vetë | Burim | 80% |
| Buçe | vetë | Burim | 100% |
| Buzez | vetë | Burim dhe lum | 100% |
| Dikanc | vetë | Burim | 100% |
| Dragash | qëndror | Lum | 100% |
| Glloboçicë | vetë | Burim | 100% |
| Kapre | vetë | Pusetë | 80% |
| Kosavë | vetë | Burim | 100% |
| Kërstec | vetë | Pusetë | 80% |
| Krushevë | vetë | Burim | 100% |
| Kuk | vetë | Burim | 100% |
| Kuklibeg | vetë | Burim | 100% |
| Kukulanë | vetë | Burim | 100% |
| Leshtan | vetë | Burim | 100% |
| Lubovishtë | vetë | Burim | 100% |
| Mlikë | vetë | Burim | 20% |
| Orçushë | vetë | Burim | 100% |
| Pllavë | qëndror | Lum | 100% |
| Pllajnik | vetë | Burim | 100% |
| Radeshë | vetë | Burim | 100% |
| Rapçë | vetë | Burim | 20% |
| Restelicë | vetë | Burim | 80% |
| Rrenc | vetë | Burim | 80% |
| Shajne | vetë | Burim | 100% |
| Vranisht | vetë | Burim | 30% |
| Xërxe | vetë | Burim | 100% |
| Zaplluxhe | vetë | Burim | 100% |
| Zgatar | vetë | Pusetë | 50% |
| Zlipotok | vetë | Burim | 100% |
| Zym | vetë | Burim | 100% |

3.11.2 Ujërat e zeza

Sondazhet e fshatrave tregojnë se 14 (39%) fshatra të komunës së Dragashit janë të lidhura me kolektorin kryesor të ujërave të zeza, 14 nuk janë të kyçura dhe 8 me vetëm kyçje të pjesërishme. 31 fshatra (86%), pa marrë parasysh se a kanë kyçje të plotë, të pjesërishme apo nuk janë të kyçur në kanalizim, raportojnë për probleme.

Fshatrat që nuk janë të kyçura janë: Bellobradi, Blaçi, Bresana, Brezna, Brodi, Buçja, Buzezi, Dikanca, Dragashi, Glloboçica, Lubovishta, Mlikë, Orçusha dhe Xërxa. Numri i amvisnive pa kyçje në kanalizim për këtë arsye është 1753, rreth 33% e popullsisë së komunës (14,452 persona). Fshatrat Brrut, Kosavë,

Kërstec, Kuk, Kukulanë, Pllajnik, Pllavë dhe Rapçë shfaqin kyçje të pjesërishme. Kjo ndikon rreth 20% të popullsisë së komunës (8595 banorë; 1030 amvisni).¹⁶¹

Ndërmjet vitit 2007 dhe 2011, komuna ka investuar afërsisht 280,000€ në avancimin e sistemit të kanalizimit dhe ujërave të zeza në tërë territorin. Kjo llogaritet të jetë afërsisht 6% e të gjitha investimeve komunale për këtë periudhë.

3.11.3 Menaxhimi i ujërave të zeza

Menaxhimi i ujërave të zeza është pothuajse inekzistent në Komunën e Dragashit, gjë që po ka ndikim të madh në disa rrjedha të ujit. Ujërat e zeza po derdhen në ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore pa u trajtuar fare, gjë që po shkakton degradim të ambientit. Ndotësit përfshijnë ndotësit organik dhe inorganik, përbërësit e nitrogjenit dhe fosforit, metalet e rënda dhe bakteret e viruset patogjenike. Ndotësit organik përfshijnë tretësit organik, mënjanesit e yndyrës dhe përbërësit tjerë toksik. Monitorimi i ujërave në tërë Kosovën është i dobët dhe nuk ka të dhëna të sakta hidrologjike. Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi ndotësit specifik dhe mbi koncentrimin dhe derdhjen e ndotësve.

Për më shumë detaje, shih Vëllimin 3 Vlerësimi i Atlasit për të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Aktualisht është duke u ndërtuar një fabrikë për trajtimin e ujërave të ndotura në Lumin Kapre, në fshatin Kapre. Fshatrat Kuk dhe Kosavë do të lidhen me këtë impiant, i cili do t'iu shërbejë dy nga 27 fshatra, me një numër të përgjithshëm të banorëve prej 2563 (2011) apo përafërsisht 7.5% të popullsisë së komunës. Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura do të parandalojë ndotjen që vjen nga këto fshatra për të mos arritur Akumulimin 1 (Lumin Bellobrad) të skemës së Hidrocentralit të Zhurit, dhe do të ndihmojë në mbajtjen e cilësisë së ujit në nivele të pranueshme.

Gjatë sondazhit në terren mbi burimet ujore, të realizuar nga UNDP në pranverë të vitit 2011, janë identifikuar disa pika të pakontrolluara të derdhjes së ujërave të zeza në lumenjtë e Dragashit, disa nga të cilat u përkisnin kompanive që lironin ujërat e ndotura në ujëra sipërfaqësore. Këto lokacione janë shënuar në hartën e burimeve të ujit.

UNDP nuk ka njohuri për ndonjë plan konkret për të trajtuar problemin e ujërave të ndotura në këtë komunë.

3.11.4 Rrjeti i energjisë elektrike¹³¹

Ndonëse Kosova në të kaluarën ka qenë eksportues i energjisë elektrike, aktualisht po vuan nga probleme shumë të mëdha në sektorin e energjisë elektrike. Thëngjilli (linjiti, i cili nxirret në Kosovë) shfrytëzohet në shtëpi private, por edhe për të furnizuar dy termocentralet që furnizojnë rrjetet vendore me energji elektrike. Sidoqoftë, rrjeti vendor dëmtohet nga humbjet e mëdha teknike në sisteme të vjetëruara dhe nga prodhimi i pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e mëdha. Fikjet dhe mungesa e kapaciteteve mbështetëse gjithashtu kontribuojnë në humbjet e shpeshta të energjisë

¹⁶¹ Të dhëna nga Rezultatet e Hulumtimit në Fshatra dhe DB e Fshatrave të Dragashit, bazuar në vlerësimet zyrtare të popullsisë nga 2008.

¹³¹ Nga Plani Hapësinore i Dragashit, MMPH/UNMIK 2006.

elektrike.¹³² Për më tepër, tensioni bie në më pak se 150V (në vend të 230V), që rezulton në shpenzime shtesë për shfrytëzuesit komercial dhe privat të cilët duhet të blejnë stabilizatorë të tensionit dhe UPS (Pajisje për Furnizimin e Pandërprerë me Energji Elektrike) në mënyrë që të operojnë pajisjet moderne elektrike si televizionet digjitale, kompjuterët dhe llambat për kursimin e energjisë.

Energjia elektrike në Dragash ka arritur në vitin 1957, kur kishte filluar të operojë hidrocentrali i Dikancës. Kjo fabrikë nuk ka funksionuar që nga viti 2000 për shkak se duhet që të zëvendësohen turbinat, ndonëse objekti (me një sipërfaqe prej 300m²) është mjaft i mirëmbajtur. Kapaciteti gjenerues i instaluar në të dy gjeneratorët është 1900 kW, më saktësisht 2x950=1900 kW. Ky termocentral është në pronësi të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), por më 2009 i ishte dhënë me koncesion kompanisë Frigo Food. Rehabilitimi i kushteve të hidrocentralit ka mbaruar, ku janë zëvendësuar pajisjet dhe është rritur kapaciteti i prodhimit në 2600 kW.

Gjashtë hidrocentrale tjera janë duke u planifikuar përgjatë lumenjëve të Brodit dhe Restelicës, por këto janë nën shqyrtim lidhur me ndikimet e mundshme negative ambientale në biodiversitetin e mjediseve të lumenjve.

Rrjeti i energjisë elektrike gjithashtu është instaluar në vitin 1957 dhe është ende në funksion. Ka shumë pak të dhëna aktuale të bazuara mbi shpenzimin e energjisë elektrike, ndonëse ka informata mbi furnizimin (me përjashtim të druve të zjarrit, si biomasë).

Në tërë Kosovën, 17% e shpenzimit primar të energjisë elektrike vjen nga drutë e zjarrit. 88% e shtëpive në Kosovë shfrytëzojnë drutë për ngrohje, prej të cilave 66% shfrytëzojnë drutë edhe për gatim. Vetëm 10% e shtëpive shfrytëzojnë naftën apo benzinën për nevoja shtëpiake.¹³³

Shtëpitë në Dragash përbëjnë 78.51% të shpenzimit të energjisë elektrike, ku 21.35% shfrytëzohet nga objektet publike dhe komerciale, dhe një përqindje më e ulët (0.14%) shfrytëzohet për ndriçim publik.¹³⁴

Tabela 26: Shpenzimi i energjisë elektrike sipas burimit të energjisë në Komunën e Dragashit dhe përqindja e shpenzimit¹³⁵

| | Objektet publike dhe komerciale | Shtëpitë e banimit | Gjithsej | Gjithsej [GWh/y] | Përqindja e burimeve të energjisë |
|---------------------------------------|---------------------------------|--------------------|------------|------------------|-----------------------------------|
| Energjia elektrike [GWh/y] | 6.372 | 23.29 | 29.66 | 29.66 | 23.97 % |
| Nafta [l/y] | 125,000.00 | | 125,000.00 | 1.425 | 1.15 % |
| Drutë e zjarrit [m ³ /y] | 754.00 | 52,000.00 | 52,754.00 | 89.57 | 72.4 % |
| Thëngjilli [t/y] | 60.00 | | 60.00 | 0.486 | 0.39 % |
| Plehu i kafshëve [m ³ /vy] | | 1,500.00 | 1,500.00 | 2.55 | 2.06 % |
| Gjithsej | | | | 123.7 | |

¹³² Raporti për Zhvillim të Kapaciteteve Njerëzore i UNDP: Energjia për Zhvillim, 2007 <http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/KHDR-eng-opt.pdf>. Qasur më 25.04.2012.

¹³³ Pira, B., Cunaku, I., Hoxha, N., dhe Bajraktari, A., *Konsumi i Energjisë Elektrike në Sektorin Shtëpiak në Kosovë: Zhvillimet në të Ardhmen, Parqitur në Konferencën e 15 të Hulumtimit Ndërkombëtar/Konferencës së Ekspertëve mbi "Trendet në Zhvillimin e Makinerisë dhe Teknologjisë së Asociuar"*, TMT 2011, Pragë 12-18 Shtator 2011. <http://www.tmt.unze.ba/zbornik/TMT2011/089-TMT11-046.pdf>. Qasur më: 15.04.2012.

¹³⁴ Raporti i vlerësimit të Energjisë Elektrike për Komunën e Dragashit, UNDP, Mireci, M., Mars 2012

¹³⁵ Tabela nga Raporti i UNDP-së për vlerësimin e Energjisë Elektrike për Komunën e Dragashit, Mireci, M., Mars 2012. Të dhënat janë të përafërta marrë nga mostrat e sondazheve në terren.

22 fshatra (61%) gjithashtu shfrytëzojnë thëngjill,¹³⁶ duke shpenzuar 60 ton në vit në objekte publike dhe komerciale. Nafta shfrytëzohet shumë nga objektet komerciale dhe publike, ndonëse sondazhi tregon se nuk shfrytëzohet në shtëpitë e banimit. Shtëpitë e banimit shpenzojnë përqindjen më të lartë të energjisë elektrike nga rrjeti vendor. Fekalet e thara të deleve dhe lopëve janë një burim tjetër i energjisë për shtëpitë e banimit, dhe ndonëse kjo nuk reflektohet në sondazhet e fshatrave, qendrat rurale në Brod dhe Restelicë janë konsumatorë kryesor. Sondazhi gjithashtu tregon se gazi është një burim i rëndësishëm i energjisë për 29 nga 36 fshatra, me gjasë në formë të konejnerëve të mbyllur apo stufave.

Tabela 27: Shpenzimi mujor i energjisë në komunën e Dragashit¹³⁷

| | Janar [GËh] | Shkurt [GËh] | Mars [GËh] | Prill [GËh] | Maj [GËh] | Qershor [GËh] | Korrik [GËh] | Gusht [GËh] | Shtator [GËh] | Tetor [GËh] | Nëntor [GËh] | Dhjetor [GËh] | Gjithsej [GËh] |
|-----------------|----------------|-----------------|---------------|----------------|--------------|------------------|-----------------|----------------|------------------|----------------|-----------------|------------------|-------------------|
| Shtëpi banimi | 1.717 | 1.810 | 1.864 | 1.784 | 1.852 | 1.976 | 2.088 | 2.001 | 2.006 | 1.828 | 2.337 | 2.026 | 23.291 |
| Komerciale | 0.427 | 0.385 | 0.478 | 0.492 | 0.507 | 0.583 | 0.487 | 0.584 | 0.524 | 0.547 | 0.728 | 0.593 | 6.333 |
| Ndriçimi publik | 0.012 | 0.006 | 0.002 | 0.001 | 0.002 | 0.003 | 0.003 | 0.003 | 0.000 | 0.000 | 0.010 | 0.001 | 0.042 |
| | | | | | | | | | | | | | 29.67 |

Kulmi i shpenzimit të energjisë elektrike është në muajt e ftohtë të nëntorit dhe dhjetorit kur ngrohja shfrytëzohet më së shumti, por gjithashtu edhe në verë (korrik, gusht dhe shtator). Kjo mund të jetë për shkak të rritjes së numrit të popullsisë si rezultat i familjeve që vijnë për pushime nga vendet e jashtme për disa muaj, përcjellur nga martesat dhe festivalet ku grumbullohen shumë njerëz.

Komuna e Dragashit furnizohet me energji elektrike nga termocentralet e Kosovës A dhe B (që gjenden në Komunën e Obiliqit afër Prishtinës), përmes përçuesit të largët prej 35KV që vjen nga Prizreni. Rrjeti i shpërndarjes në Komunën e Dragashit administrohet dhe mirëmbahet nga Njësitë i Distribucionit për Prizren-Dragash. Njësitë i Dragashit gjendet afër bazës së transmetuesit, dhe administron infrastrukturën në vijim.¹³⁸

1. Stacionin kryesor të transformatorit në Dragash

TS 35/10 KV me dy transformatorë/transmetues të energjisë elektrike me fuqi instaluese Sn = 8 MVA + 4 MVA = 12 MVA, dhe me hidrocentralin Dikanca me Sn = 2.5 MVA. Fuqia e përgjithshme e instalimit është Sn = 14.5 MVA.

2. Rrjetet e tensionit të lartë 10 KV:

a) Rrjeti ajror 10 KV, gjatësia L = 86 Km, me konduktor Al - Fe

b) Rrjeti me kablo tokësore 10 KV të gjatësisë L = 1 Km

¹³⁶ Nga Rezultatet e Sondazhit në Fshatra.

¹³⁷ Po aty.

¹³⁸ Plani Hapësinor I Dragashit, MMPH/UNMIK 2006

3. Rrjeti i tensionit të ulët 04 KV

- a) Rrjeti ajror me gjatësi L = 140 Km, me konduktor Al - Fe
- b) Rrjeti me kablllo tokësore 04 KV të gjatësisë 0.5 Km
- c) Rrjeti ajror me kablllo 04 KV me gjatësi L = 2.43 Km

4. Stacionet e transformatorëve TS 10/04 KV në lokacione në qytetin dhe fshatrat e Dragashit

Gjithsej ka 88 transmetues të energjisë elektrike me fuqi instaluese $S_n = 20.02$ MVA. Nga këto:

- a) TS 10/04 KV piramida (tra), 6 transmetues të energjisë elektrike
- b) TS 10/04 KV shtylla, 11 transmetues të energjisë elektrike
- c) TS 10/04 KV pllaka të hekurta, 7 transmetues të energjisë elektrike
- d) TS 10/04 KV shtylla të çelikut, 64 transmetues të energjisë elektrike

5. 70 stacione lokale të transformatorëve TS 10/04 janë pronë e KEK-ut. 18 nga këto janë stacione private të transformatorëve TS 10/04 KV (që nuk janë në pronësi të KEK-ut, ofruerit shtetëror të energjisë elektrike).

Derisa të gjitha vendbanimet janë të kyçura në rrjetin elektrik, duket se ka probleme të theksuara në furnizimin me energji elektrike, ku 31 nga 36 fshatra kanë probleme. 18 fshatra kanë probleme specifike me tensionin e ulët (50% të vendbanimeve). Me përjashtim të Restelica/Restelicës, e cila nuk duket të ketë ndonjë problem me energji elektrike, vendbanimet tjera që nuk kanë probleme janë qendra të vogla dytësore apo terciare.¹³⁹

Numri më i madh i popullsisë në fshatra, kombinuar me mungesën e mirëmbajtjes dhe përmirësimeve përgjatë viteve, ka bërë që përveç humbjeve normale teknike në transmision, sistemet ekzistuese të transmisionit dhe distribucionit të energjisë elektrike të mbingarkohen nga numri në rritje i vendbanimeve dhe ndërtimi i shtëpive të reja. Terreni i vështirë dhe distancat e konsiderueshme për të arritur në fshatrat më rurale gjithashtu luan rol në problemet me rrjetet e energjisë elektrike, përfshirë mirëmbajtjen dhe humbjet. Humbjet joteknike janë gjithashtu një karakteristikë e përgjithshme në tërë Kosovën, dhe përbëjnë rreth 30% të të gjitha humbjeve në Dragash. Kjo shkaktohet nga (i) vjedhja e energjisë elektrike përmes kyçjeve ilegale në rrjetet e shpërndarjes dhe ndryshimi i njehësorëve; (ii)

¹³⁹ Rezultatet e Sondazhit të UNDP-së në Fshatra.

matjet e pasakta të njehësorëve dhe (në disa raste) mungesa e njehësorëve; dhe (iii) mospagesa e faturave nga konsumatorët.

Izolimi termik¹⁴⁰

Izolimi termik zvogëlon humbjen e energjisë elektrike nga impianti deri në ndërtesë, duke ruajtur kështu nxehtësinë dhe duke zvogëluar kërkesën për energji. Kjo zvogëlon shpenzimet e banorëve, si dhe zvogëlon emetimin e dioksid karbonit në prodhimin e energjisë elektrike, dhe të gazrave dhe grimcave tjera të cilat mund të jenë të dëmshme. Zvogëlimi i shfrytëzimit të drurëve për zjarr gjithashtu do të kishte ndikim të dobishëm në mbrojtjen e pyjeve natyrore.

Ligji për Eficiencën e Energjisë është miratuar në qershor të vitit 2011 në Kosovë. Ky ligj detyron komunat që të zhvillojnë një Plan Veprimi për Eficiencën e Energjisë (PVEE), i cili duhet të miratohet nga komuna. Zhvillimi i PVEE nëpër komuna do të mbikëqyret dhe drejtohet nga Agjencia Kosovare për Eficiencën e Energjisë, e cila është themeluar në fund të vitit 2011 dhe ka filluar aktivitetet e saj në maj të vitit 2012. Zbatimi i PVEE parashihet të financohet nga komunat përmes buxheteve të tyre vetanake.

UNDP ka bërë sondazhe në terren për të patur një pasqyrë të përgjithshme mbi shfrytëzimin e izolimeve termike në ndërtesa në Dragash (izolimi me lesh xhami apo polisterol). Në përgjithësi, në tërë komunën vetëm rreth 12% të ndërtesave kanë izolim termik, përfshirë ndërtesat publike, komerciale dhe të banimit.

Tabela 28: Ndërtesat publike në komunë, gjendja ekzistuese

| Gjithsej ndërtesa publike në komunë ¹⁴¹ | | | | |
|--|-------------------------|------------------|-----------------------------|---------|
| Sipërfaqja tokësore | 30775 [m ²] | Izolim termik | 3,535.00 [m ²] | 11.49 % |
| | | Pa izolim termik | 27,240.00 [m ²] | 88.51 % |

Tabela 29: Kushtet ekzistuese në ndërtesa individuale (për banim) në Komunën e Dragashit

| Të dhënat mbi ndërtesat individuale ¹⁴² | | | |
|--|---|------------------|------|
| Sipërfaqja tokësore e ndërtesës | e | Izolimi termik | 12 % |
| | | Pa izolim termik | 88 % |

Ndriçimi publik

Sipas sondazheve të bëra në terren nga UNDP-ja, Komuna e Dragashit i ka të instaluar rreth 230 njësi ndriçuese në qytetin e Dragashit dhe në 9 fshatra.

Ndriçimi aktual publik (llambat e rrugës) përdorin poça me mërkur inkandeshent prej P = 125 [W], përderisa energjia e përgjithshme e shpenzuar nga ndriçimi publik në vit është rreth 0.042 [GWh/y].¹⁴³

¹⁴⁰ Nga Raporti i UNDP-së për Vlerësimin e Energjisë Elektrike në Komunën e Dragashit, Pireci, M., Mars 2012. Të dhënat janë të përafërta të marra nga mostrat e sondazheve në terren.

¹⁴¹ Në bazë të të dhënave të sondazhit të marra nga anëtarët e stafit të Asamblesë Komonale në Dragash.

¹⁴² "Baza Energjetikë për Komunën e Dragashit", Naumann, E., Pireci, M, 2011.

¹⁴³ Të dhënat për vitin 2009, burimi: KEK. Nga Raporti i UNDP-së për Vlerësimin e Energjisë Elektrike për Komunën e Dragashit, Pireci, M., Mars 2012. Të dhënat janë të përafërta të marra nga mostrat e sondazheve në terren.

Megjithatë, rreth një e treta e llambave nuk punojnë; po të punonin të gjitha, energjia e përgjithshme e shpenzuar në vit do të ishte 0.126 [GWh/vit].

Qyteti i Dragashit i ka 55 llamba të rrugës të instaluara në rrugët kryesore. Nga një vlerësim në terren në janar të vitit 2012, rezulton se 18 janë në gjendje funksionale, ndërsa 37 sosh nuk punojnë. Komuna është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe pagesën e shpenzimit të energjisë elektrike për llambat e rrugës. Llambat e rrugës në 9 fshatra janë financuar nga kontributet e banorëve lokalë.

Sipas sondazheve të kryera për “Baza Energjetike për Komunën e Dragashit”, 72% e të anketuarve thanë se llambat e rrugëve kanë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë, përderisa 28% mendonin se ishte komoditet.

Hidrocentralet¹⁴⁴

Burimet e mjaftueshme ujore në Dragash ofrojnë potencial të madh për ndërtimin e hidrocentraleve. Përveç riparimit të propozuar të hidrocentralit të Dikancës (kapaciteti 2.6MË), aktualisht dy skema janë duke u ndjekur për të shfrytëzuar potencialin lokal të hidrocentraleve:

- a) Skema e Hidrocentralit të Zhurit: Kjo është një skemë e hidrocentralit me një kapacitet total prej 305MË. Dy impiantet do të vendosen jashtë komunës së Dragashit, afër fshatit Zhur. Përmes një sistemi të tuneleve dhe kanaleve, uji fillimisht do të transferohet nga nënpellgu i lumit Guri i Zi, nga lumi i Restelicës dhe lumi Brod, në rezervarin e parë e të vogël në luginën e lumit Pllavë, dhe prej atje tek një rezervar i dytë më i madh afër fshatit Brezne. Një tunel më pas do të çojë ujin në impiante, dhe prej atje do të shkojë tek dy impiantet tjera, me një diferencë lartësie prej 643m, respektivisht 683.5m. Rrjedhat e lumenjve Caljanë, Restelicë, Brod dhe Pllavë do të ndikohen, sikurse edhe rrjedha e ujit afër liqenit Brezna deri në “Gurra”. Vendimi ligjor për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit është marrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 24 korrik 2009.
- b) Një konsorcium ndërkombëtar po planifikon ndërtimin e gjashtë termocentraleve përgjatë lumenjve Brod dhe Restelicë. Në këtë kohë, vendi dhe data e saktë e sasisë së planifikuar për t’u nxjerrë nuk janë të disponueshme. Për më shumë informata, shih Volumnin 3 të Atlasit të Vlerësimit për Zhvillim të Qëndrueshëm.

3.11.5 Rrjetet e telekomunikacionit

PTK (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës) kanë një njësi në Dragash që ofron shërbime të telefonisë fikse dhe shërbimeve postare. Shërbimi postar apo shërbimi i telefonisë mobile mundësohet në 27 nga 36 fshatrat e Dragashit (75%). Fshatrat që nuk mbulohen nga këto shërbime janë: Buçe, Kërstec, Orçushë, Pllajnik, Radeshë, dhe Vranisht.

Telefonia fikse megjithatë mundësohet vetëm në 5 fshatra: Bellobrad, Brod, Brrut, Glloboçicë, dhe Kukulanë.

¹⁴⁴ Atlasi i UNDP-së për Zhvillim të Qëndrueshëm: Volumi 2, qershor 2012

Të gjitha fshatrat kanë sinjal të telefonisë mobile, ndonëse cilësia varion shumë përgjatë komunës. 7 fshatra raportojnë probleme: Blaç, Buçe, Dragash, Kosavë, Orçushë dhe Radeshë. Këto fshatra gjenden në zonat veriore dhe qendrore të komunës. Megjithatë, 3 fshatra raportojnë sinjal të mirë: Kërstec, Vranisht dhe Zaplluxhe, gjë që mund të ketë lidhje me lartësinë mbidetare të këtyre fshatrave në shpatet malore lindore dhe përendimore, në krahasim me fshatrat e tjera që gjenden në luginë apo zona të ulëta. Fshatrat e Orçushës dhe Radeshës kanë më së shumti probleme përse i përket komunikimit të përgjithshëm, pa shërbime postare apo telefoni fikse, si dhe me sinjal të dobët të telefonisë mobile.

Të gjitha fshatrat janë të lidhura në internet, ku 56% (20) e fshatrave kanë internet kafe të shpërndara në mënyrë të barabartë në fshatrat përgjatë komunës.

3.11.6 Sfidat e qenësishme në situatën ekzistuese të infrastrukturës teknike

Shërbimet publike (ujë, ujërat e zeza, furnizimi i energjisë, telekomunikacioni, etj.) nuk e mbulojnë tërë territorin e komunës; infrastruktura e shërbimeve ekzistuese është e pjesërishme dhe e vjetër dhe nuk funksionon mirë.

- Si mund të përmirësohen këto shërbime?
- Si mund të instalohet një sistem i mirë i ujësjellësit që do të siguronte ujë të pijshëm të kualitetit të lartë dhe ulje të humbjeve?
- Si mund të zhvillohet menaxhimi i ujërave të zeza në 36 fshatrat e shpërndara?

Furnizimi me energji dhe harxhimi dallojnë gjatë vitit për shkak të rënies së voltazhës dhe për shkak të shtëpive përkohësisht të banuara.

- Si mund të sigurohet një furnizim stabil i energjisë elektrike?
- Çfarë energji e ripërtëritshme mund të prodhohet/shfrytëzohet në Dragash?

Rrjeti postar dhe i telefonisë është parcial, por çdo fshat është i lidhur me internet.

- Si mund të modernizohet mediat moderne të ndihmojnë për të tejkaluar pengesat e 36 fshatrave të shpërndara në Dragash?

3.12 Vlerësimi i kapaciteteve të investimit

Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët, të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, nga totali i Grantit të Përgjithshëm, secila komunë do të pranojë një shumë prej 140,000 € për një vit, minus një euro për kokë banori, ose 0€ për komunat me popullsi të barabartë me apo më të madhe se 140.000. Popullsia e komunës llogaritet me 89%; numri i popullsisë pakicë matet me 3%; komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me 2% dhe përmasat gjeografike me 6%.

Popullsia e Dragashit është relativisht e vogël. Sipas Ligjit të Kosovës mbi Financat e Pushtetit Lokal komunat më të vogla sipas numrit të banorëve janë komunat e themeluara risht me një popullsi prej 4000 deri 10,000 banorë. Dragashi, sidoqoftë, ka një numër përafërsisht prej 35,000 banorësh.

Tablea mëposhtme tregon se Dragashi nuk është duke përfutur si komunë që është me shoqëri etnikisht të ndryshme, me gjysmë të popullsisë jo shumicë dhe në të njëjtën kohë është komuna e tetë më e madhe në Kosovë. Tabela tregon se në krahasim me komunën e Deçanit, Dragashi është 130 km² më e madhe me territor; krahasuar me Fushë Kosovën, Dragashi është pesë herë më e madhe me

Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës - Dragash
2012 Profili Komunal i Dragashit për PZhK-Drafti final

territor edhe pse kanë shifra të ngjajshme të popullsisë. Sidoqoftë, buxheti komunal i Dragashit është më i vogël dhe mbledhja e të hyrave vetanake është shumë e ulët krahasuar me Fushë Kosovën. Rregullsia e kësaj formule financiare duhet të vlerësohet nëpërmjet një analize serioze.

| Komuna komunale | Popullsia ¹⁶² | Minoritetet | Size ¹⁶³ | 2012 Buxheti ¹⁶⁴ | Të hyrat vetanake |
|-----------------|--------------------------|-------------|---------------------|-----------------------------|-------------------|
| Dragashi | 35,000 | 12,935 | 430 km | 5,547,372 | 400,000 |
| Deçani | 40,000 | 294 | 297 km | 6,137,529 | 531,535 |
| Fushë Kosova | 33,682 | 3,367 | 83 km | 6,091,949 | 1,370,000 |

Tabela e mëposhtme tregon buxhetin e komunës së Dragashit gjatë 5 viteve të fundit dhe shtimin në linjë me buxhetin kombëtar të Kosovës.

Tabela 30: Buxheti i komunës së Dragashit 2007-2011¹⁶⁵

| Viti | Pagat dhe medijtjet | Të mirat & shërbimet | Harxhimet komunale | subvencionet & transferet | Investimet kapitale | TOTALI |
|------|---------------------|----------------------|--------------------|---------------------------|---------------------|------------|
| 2012 | €3,333,880 | €333,564 | €100,500 | €35,000 | €1,744,427 | €5,544,372 |
| 2011 | €3,169,880 | €320,640 | €96,240 | €36,098 | €1,958,901 | €5,581,838 |
| 2010 | €2,325,122 | €320,382 | €94,500 | €35,000 | €1,505,961 | €4,280,965 |
| 2009 | €2,153,446 | €303,087 | €91,500 | €40,000 | €1,137,247 | €3,725,280 |
| 2008 | €1,837,827 | €336,763 | €88,500 | €38,000 | €388,009 | €2,689,599 |
| 2007 | €1,764,187 | €343,268 | €80,500 | €14,000 | €297,971 | €2,499,926 |

¹⁶² Ligji Nr. 03/ L- 049 PËR FINANCAT E PUSHTETI LOKAL

¹⁶³ Ligji Nr. 03/ L- 049 PËR FINANCAT E PUSHTETI LOKAL

¹⁶⁴ <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Buxheti%202012.pdf>

¹⁶⁵ Intervistë me z. Ahmet Batjari Drejtor i Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit

4. SWOT Analiza

SWOT analiza është një metodë e planifikimit strategjik e përdorur për vlerësimin e fuqive, dobësive/kufizimeve, mundësive dhe kërcënimeve të përfshira në një projekt apo në një ndërmarrje biznesi. Përfshin specifikimin e objektivit të ndërmarrjes biznesore ose projektet dhe identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që janë të favorshëm dhe të pafavorshëm për ta arritur atë objektiv. Caktimi i objektivit duhet të ndërmerret pas SWOT analizës. Kjo do të lejonte qëllimet e arritshme ose objektivat të caktohen për organizim.¹⁶⁶

Në fushën e planifikimit urban SWOT analiza është një vegël e përdorur shpesh, për t'i përshkruar karakteristika e Komunës. Në rastin e PZHK të Dragashit, përcaktimet vijuese janë përdorur:

- Fuqitë: karakteristikat e komunës që kontribuojnë në zhvillimin e jetesës dhe mundësisht i japin epërsi ndaj të tjerave
- Dobësitë (ose kufizimet): karakteristika që e vështirësojnë jetesën dhe e vendosin komunë në situatë të pafavorshme ndaj të tjerave
- Mundësitë: gjasat për të përmirësuar situatën e komunës në të ardhmen
- Kërcënimet: elementet që mund të shkaktojnë probleme për zhvillimin e ardhshëm të komunës

Në studimet e ndryshme dhe punëtoritë, fuqitë ekzistuese dhe dobësitë si edhe mundësitë dhe kërcënimet për të ardhmen e Dragashit janë pacaktuar nga ekspertët ndërkombëtar dhe qytetarët e Dragashit. Çështjet e rëndësishme janë të përmblihdura në vijim për të dhënë një pasqyrë të sfidave kryesore të Dragashit. Struktura e listës vijuese është e bazuar në temat e Kapitullit 3 dhe nuk paraqet prioritet.

4.1 FUQITË

- Vendbanimet
 - Vendbanimet paraqesin historinë e gjatë dhe jetën e pasur kulturore të Dragashit;
 - Modeli i vendbanimit kryesisht e ka ruajtur origjinën e tij me fshatrat e mishëruar në pejzazh në një mënyrë karakteristike, me një bukuri madhështore
 - Pozita e vendbanimeve ofron qasje në resurset natyrore dhe në shfrytëzimin tradicional të tokës. Në shumë raste ka pyje dhe kulloso-toka mbi fshatra, me tokë bujqësore nën to; burimet ofrojnë ujë të pijshëm të pastër;
 - Ekziston një numër i madh ndërtesash të reja nëpër vendbanime, prandaj kushtet e banimit janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme
- Shfrytëzimi i tokës
 - Burimet e ndryshme natyrore janë në cilësi të mirë, me pejzazhe të bukura që ofrojnë bazë të mirë për shfrytëzimin e tokës nga njerëzit;
 - Mënyra e shfrytëzimit tradicional të tokës është adaptuar mjaft mirë me situatën natyrore.
- Arsimimi
 - Ekziston sistemi funksional i shkollave qendrore dhe satelitore që ofrojnë qasje në shkollën fillore në pothuaj çdo fshat

¹⁶⁶ Wikipedia.org

- Vijimi në shkollën e lartë fillore (klasat 6-9/5-8) është në një nivel dukshëm më të lartë se sa në disa vite më parë,
- Shkalla e analfabetizmit është vetëm 1% (femrat dhe meshkujt)
- Situata fizike e shkollave është përmirësuar viteve të fundit.
- Shëndetësia
 - Dragashi si tërësi i përmbush standardet e kujdesit shëndetësor të raportit staf-pacient,
 - Sistemi i graduar i njësive të kujdesit shëndetësor (Qendra kryesore e mjekësisë familjare, Qendrat mjekësore familjare dhe Ambulancat mjekësore familjare) ofrojnë furnizimet efikase mjekësore;
- Ekonomia, Punësimi
 - Biznesi mund të përfitojë nga afërsia me qendrën administrative dhe mund të ndërtohet në produktet natyrore,
 - Shoqëria mund të ndërtohet në popullatë të re dhe të motivuar dhe trashëgimi të pasur. Remitanca nga diaspora dhe fondet ndërkombëtare ofrojnë një hyrje të mjeteve financiare që mund të shfrytëzohen për përmirësimin e ekonomisë.
- Bujqësia, Pylltaria
 - Resurset e pasura natyrore dhe pozita në Malet e Sharrit ofron kushte të mira për prodhimin e produkteve me kualitet të lartë, të cilat janë mirë të respektuara në tregjet rajonale;
 - Dragashi është komuna që ka zonat më të mëdha me kullosa në Kosovë,
 - Komuna nuk është në situatë të pafavorshme nga ndonjë industri ose të aktivitetit tjetër që është në mënyrë fundamentale e dëmshme për mbrojtjen e natyrës dhe bujqësinë e cilësisë së lartë,
- Biodiversiteti, Mbroja e natyrës
 - Dragashi është një nga pikat e nxehta të Ballkanit në lidhje me biodiversitetin e tij të jashtëzakonshëm që përmbanë një numër të konsiderueshëm të llojeve të rralla endemike.
 - Pjesë të mëdha të territorit të komunës mund të konsiderohen si zona me vlerë të lartë ekologjike;
 - Vargu malor i Maleve të Sharrit dhe i Malit Koritnik, mbi vijën e epërme natyrore të drunjve paraqet pothuaj kullosë natyrore alpine-dhe shkurre. Ky është tipi më prevalent i shfrytëzimit të tokës në Dragash.
 - Ariu i kaftë, rrëqebulli, ujqit, dhitë e egra, një numër i madh i zogjëve, fluturat dhe grupe të tjera të faunës kanë habitatet e tyre në Dragash dhe kontribuojnë në vlerën e lartë ekologjike.
- Turizmi
 - Qytetarët e Dragashit janë gati t'i mirëpresin mysafirët me miqësi,
 - Ka së paku disa element të infrastrukturës turistike (hotelet, restaurantet....) që punojnë ose janë në ndërtim e sipër
- Kultura
 - Ka vende të rëndësime të trashëgimisë kulturore dhe ndërtesa si xhamia më e vjetër në Kosovë, që ndodhet në fshatin Mlik,
 - Traditat janë ruajtur te popullata,
 - Bashkëpunimi mes komuniteteve i bashkon dy komunitetet gjuhësore dhe kulturore në një territor,

- Shqiptarët, Boshnjakët dhe Goranët kanë një trashëgimi kulturore të pasur dhe gjatë të ruajtur.
- Rrjeti rrugor, Transporti
 - Rrjeti rrugor local është përmirësuar mjaft gjatë viteve të fundit nga investimet komunale. Pothuaj se çdo fshat tani ka rrugë të shtruara;
 - Transporti publik, i udhëhequr nga kompani private, lidh Dragashin dhe rajonin e Opojës me Prizrenin, Prishtinën dhe Beogradin.
- Infrastruktura teknike
 - Të gjitha fshatrat kanë sistemin qendror apo lokal të furnizimit me ujë;
 - Të gjitha shtëpitë janë të lidhura në rrjetin elektrik; shpeshësia e ndërprerjeve kohëve të fundit është zvogëluar;
 - 21 fshatra janë të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

4.2 Dobësitë

- Vendbanimet
 - Kërkesat e sotme të lëvizshmërisë dhe lidhjeve në tregjet e punës krijojnë dëme të mëdha për strukturën e shpërndarë të vendbanimit me fshatrat e largëta.
 - Vendbanimet e largëta i kanë humbur banorët meqë kanë emigruar që e rrezikon ekzistencën e tyre të ardhme
 - Zgjerimi i pakontrolluar dhe korniza jo-funksionale rregulluese për ndërtim në disa vendbanime shkakton konflikte dhe ndonjëherë rreziqe të fatkeqësive natyrore,
 - Aktivitetet intensive ndërtimore kanë ndryshuar pamjen e fshatrave; ndërtesat historike janë hequr apo numri i tyre është në rënie; hapësira publike është neglizhuar.
 - Dobësia e infrastrukturës teknike (p.sh. menaxhimi i mbeturinave të ngurta, ndotja e ujit të pijshëm) vështirëson jetesën në shumë fshatra.
- Shfrytëzimi i tokës
 - Burimet natyrore dhe shfrytëzimi i tyre vuajnë nga menaxhimi i keq dhe degradimi.
- Arsimi, Shëndetësia
 - Niveli i arsimit është akoma i ulët, krahasuar me standardet ndërkombëtare;
 - Vajzat ende kanë vijim më të ultë në shkolla të mesme;
 - Ende nuk ka objekt për arsimim profesional në Dragash;
 - Shoqëria është ndikuar negativisht nga mundësitë e dobëta arsimore; posaçërisht mungesa e edukimit profesional çon në në kualitet të ultë të punës;
 - Ekzistimi i “sistemit paralel” është duke komplikuar organizimin efektiv të objekteve dhe të resurseve arsimore;
 - Struktura specifike e vendbanimit të Dragashit me 36 fshatrat e tija të vogla dhe të shpërndara është duke penguar furnizimin e infrastrukturës sociale përderisa resurset financiare janë të limituara. Për shembull, ekziston mungesë e mjekëve në shumë fshatra, madje edhe kur numri i përgjithshëm i stafit mjekësor i përmbushë standardet kombëtare;
 - Kualifikimi i stafit arsimor dhe shëndetësor nuk mjafton në shumë raste,
- Ekonomia, Punësimi
 - Papunësia është në nivel shumë të lartë,

- Biznesi dhe ekonomia lokale vuajnë nga paaftësia dhe bashkëpunimi i dobët me organet lokale, nga infrastruktura e dobët dhe arsimimi i dobët profesional.
- Bujqësia, Pylltaria
 - Puna në bujqësi ka humbur atraktivitetin e vet në ekonominë moderne;
 - Rënia e socializmit, posaçërisht fundi i ish NSh "Sharr Prodhimi" ka nënkuptuar zvogëlim të prodhimeve bujqësore dhe marketingut të tyre që ende nuk është tejkaluar.
 - Aktualisht bujqësia nuk është veprimtari përfituese shkaku i pajisjeve dhe njohurive të kufizuara, kuantitet dhe kualitet të pamjaftueshëm të prodhimit vendor dhe mungesës së mundësive ekonomike (tregjeve);
 - Krijimi i vlerës së prodhimeve bujqësore është i ulët kur lënda e parë shitet e pa përpunuar.
- Turizmi
 - Mungesa e mundësive të akomodimit, qendrave informuese turistike, identifikimi shtigjeve (shënimi)si edhe infrastruktura e dobët rrugore regjionale e frenojnë zhvillimin e turizmit;
- Kultura
 - Mungesa e mjeteve financiare që monumentet kulturore dhe historike nuk mirëmbahen dhe janë në rrezik të zhduken – kjo është e vërtetë edhe për shtëpitë tradicionale dhe ndërtesat e tjera
 - Nuk ka histori të shkruar të trashëgimisë kulturore për këtë regjion, e as dokumente të duhura.
- Rrejtji rrugor, transporti
 - Dragashi ka qasje nga Kosova përmes një rruge të vetme dhe të vështirë;
 - Lidhjet ndërkufitare me Shqipërinë dhe IRJ të Maqedonisë janë ndërprerë, gjë që e shton shumë izolimin e Dragashit;
 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale mungon; kjo e rrezikon qëndrueshmërinë ekonomike të investimeve;
 - Transporti publik, i siguruar nga sipërmarrjet private vuan nga frekuenca e ultë, mungesa e koordinimit të itinerarëve dhe orareve dhe se nuk shërbejnë në rajonin e Gorës.
- Infrastruktura teknike
 - Furnizimi me ujë të pijshëm vuan nga rrjeti i dobët ekzistues i gypave të ujit, mungesa e mirëmbajtjes dhe nga mungesa e kontrollit mbi kualitetin e ujit. Si rezultat janë humbjet e mëdha të ujit dhe kualiteti i pamjaftueshëm i ujit në një numër të fshatrave;
 - Rrjeti elektrik ende ka probleme me stabilitetin pasi që kapacitetet e tij nuk janë të mjaftueshme;
 - Efiçenca elektrike është e ultë në shumë raste për shkak të mungesës së izolimit të shtëpive apo për shkak të pajisjeve; Burimet e energjisë ripërtëritëse ende nuk janë në shfrytëzim;
 - Sistemet ekzistuese të kanalizimit shpesh janë teknikisht të dobëta; në të gjitha rastet ata i derdhen ngarkesat e tyre nëpër lumenj;
 - Mënyra e papërshtatshme e hedhjes së mbeturinave (djegia, hedhja në deponi ilegale apo nëpër lumenj) rrezikon shëndetin e njerëzve dhe ambientin. 16 fshatra ende nuk kanë qasje në mbledhjen e mbeturinave (të gjitha në rajonin e Gorës);
 - Vullneti për të bërë pagesën për ujë, rrymë elektrike apo mbledhje të mbeturinave është i ulët në shumë raste; kjo rrezikon përmirësimin e infrastrukturës teknike;

- Kompanitë private që janë përgjegjëse për infrastrukturë teknike, shpesh raportohet se nuk janë serioze dhe kanë mungesë të kapaciteteve.

4.3 MUNDËSITË

- Vendbanimet
 - Gati të gjitha fshatrat ofrojnë mundësi për zhvillim të mëtejshëm në zona të vendbanimeve të sigurta dhe shumë të përshtatshme;
 - Rregullimi i aktiviteteve të ndërtimeve private mund të çon në zhvillim të qëndrueshëm të vendbanimeve, mund të ruaj identitetin e fshatrave dhe mund të mundësojë zbatimin e duhur të infrastrukturës teknike;
 - Përmirësimi në dizajn të hapësirës publike, mirëmbajtja e objekteve historike dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbërta mund të kontribuojnë në atraktivitetin e fshatrave.
- Shfrytëzimi i tokës
 - Ka mundësi të shumta për t'i përdorur më mirë burimet natyrore dhe të përmirësohet menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme;
- Arsimimi, Shëndetësia
 - Përmirësimi i mëtejshëm i pajisjeve personale, infrastrukturore dhe teknike, do të ofrojë mundësi më të mira për arsimim dhe kujdes shëndetësor në të ardhmen.
 - Hapja e shkollës së re profesionale do të ofrojë një mundësi për përmirësim të nivelit arsimor, posaçërisht në fushën e arsimimit profesional.
- Ekonomia, Punësimi
 - Emancipimi i femrës dhe pjesëmarrja në ekonomi dhe në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimi i perspektivës për popullatën e re janë mundësitë më të rëndësishme për shoqërinë;
 - Pjesëtarët e diasporës mund të sillen si vëzhgues trendi, ambasadorë, punëtor rrjetesh dhe investues;
 - Rrjedha e të hollave që vijnë nga diaspora dhe nga fondet ndërkombëtare ofrojnë shanse për forcimin e ekonomisë lokale, nëse të hollat harxhohen në mënyrë të dobishme;
 - Burimet natyrore dhe turizmi sigurojnë mundësi të ndryshme për zhvillimin e bizneseve të reja.
 - Zgjerimi i parkut nacional "Mali Sharr" si një katalizator për turizëm ofron shanse për zhvillim ekonomik të Dragashit;
- Bujqësia, Pylltaria
 - Shkaku i territorit të saj të shumëllojshëm dhe (relativisht) mjedisit të pastër që është i përshtatshëm për një sërë kulturash të vlerës specifike dhe të cilësisë së lartë, Dragashi mund të përfitojë nga kërkesa e shtuar (globale) për produktet të shumëllojshme të cilësisë së lartë/të shëndetshme;
 - Krijimi brendit (markës) rajonal apo komunal për produktet bujqësore (p.sh. "Djathi i sharrit" apo "Djathi i Dragashit") do të ofronte mundësi për të shitur produktet me kualitet të lartë me një çmim të lartë.
 - Përmirësimi i zinxhirit të vlerës mund të çonte në gjenerimin e të hyrave më të larta nga produktet bujqësore.
- Biodiversiteti, mbrojtja natyrore

- Zgjerimi i parkut nacional të Sharrit në malet e Dragashit paraqet një rast unik për mbrojtjen e biodiversitetit.
- Përcjellja e një strategjie të integruar të zhvillimit mund të shtojë biodiversitetin duke mbështetur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës dhe duke ulur mospërputhjet me aktivitetet njerëzore;
- Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza, zgjerimi i grumbullimit të mbeturinave të ngurta dhe masat për efikasitet të energjisë mund të zvogëlojnë ndikimin njerëzor në mjedis.
- Turizmi
 - Mjedi natyral dhe shumëllojshmëria kulturore e popullatës janë vlera të mëdha të Dragashit dhe e forcojnë zhvillimin e turizmit malor të bazuar në natyrë;
 - Relievi domethënës se ekziston një potencial i rëndësishëm për një gamë të plotë të aktiviteteve verore dhe dimërore të turizmit malor,
 - Eko-turizmi është njëri nga potencialet më të mëdha për zhvillimin e komunës.
 - Pjesëtarët e diasporës që kthehen në Dragash gjatë pushimeve verore janë një grup i madh i konsumatorëve potencial për infrastrukturën turistike;
 - Zgjerimi i parkut nacional Malet e Sharrit siguron një shansë unike për promovimin e turizmit në Dragash.
- Kultura
 - Krijimi i një muzeu për dy etnitë në komunë, mund ta paraqet komunën në brendi dhe jashtë,
 - Që të mbrohet trashëgimia kulturore (ndërtesat, peizazhet, traditat, etj.) e mirëmbanë dhe fuqizojnë identitetin.
- Rrjeti rrugor, transporti
 - Rihapja e lidhjeve të kalimit kufitar krijon mundësi të reja për tregti dhe turizëm regjional;
 - Lidhjet e përmirësuara dhe të brendshme i japin klientëve dhe turistëve qasje ndaj furnizuesve dhe atraksioneve turistike.
- Infrastruktura teknike
 - Menaxhimi i mbeturinave në Dragash mund të integrohet në veprime më të mëdha të riciklimit dhe të menaxhimit të lumenjve. Një menaxhim ambicioz dhe pragmatik i mbeturinave mund të vepron si një pilot studim rasti për Kosovën rurale.

4.4 KËRCËNIMET

- Vendbanimet
 - Situata e ardhshme e migrimit do të jetë thelbësore për shumë aspekte të zhvillimit të Komunës. Emigrimi i vazhdueshëm do të rrezikonte ekzistimin e vendbanimeve të thella.
 - Dallimi i madh në mes madhësive të popullsisë gjatë verës dhe dimrit shkakton probleme serioze për planifikim urban dhe për zhvillimin e infrastrukturës teknike (trajtimi i ujit, ujërave të zeza...)
 - Zgjerimi i pakontrolluar i vendbanimeve i rritë problemet e infrastrukturës dhe mund ta shkatërrojë tokën bujqësore të cilësisë së lartë dhe mjedisin.
 - Neglizhenca e mëtejme e infrastrukturës është kërcënimi kryesor për vendbanimet
- Shfrytëzimi i tokës

- Si pasojë e mungesës së investimeve në bujqësi, burimet e rritura spontanisht (kryesisht barishtet aromatike) rrezikojnë për tej-korrje deri në pikën e rrezikimit të rigjenerimit të tyre, derisa toka bujqësore është pak e shfrytëzuar dhe i nënshtrohet rryllëzimit natyral dhe/ose erozionit,
- Shfrytëzimi joadekuat i tokës si tej-kullosja ose prerja e tepruar e drurëve, e maksimizojnë erozionin dhe rreziqet si ortekët e borës
- Arsimimi
 - Mundësi të kufizuar arsimimi në nivel më lartë rezulton me papunësi, migrim dhe zhvillim të frenuar,
 - Arsimimi i ulët ose mospasje të arsimimit të lartë për femrat e pengon barazinë gjinore dhe mundësitë për zhvillimi shoqëror dhe ekonomik
- Shëndetësia
 - Furnizimi i dobët me shërbime themelore shëndetësore e frenojnë mundësinë e popullatës që në mënyrë aktive të marrin pjesë në të gjitha sferat: shoqërore, politike dhe ekonomike.
- Ekonomia, punësimi
 - Në sektorin e biznesit humbja e potencialit intelektual dhe të fuqisë punëtore shkakoi i migrimit të vazhdueshëm dhe rritja e sektorit joformal janë kërcënimet kryesore.
- Bujqësia, pylltaria
 - Tendencat për transferimin e ekonomive të vogla në ferma të mesme dhe të mëdha komerciale me kushte të rritjes intensive dhe me bazë gjenetike të produktivitetit të lartë mund ta ripërcaktojë shfrytëzimin tradicional të tokës (humbja e traditave të bujqësisë) dhe e rrezikojnë mjedisin përmes shkalës së lartë të plehrave artificial,
 - Mungesa e investimeve në infrastrukturën bujqësore, teknologji dhe njohuri i shtyn njerëzit ta braktisin bujqësinë.
- Biodiversiteti, mbrojtja natyrore
 - Humbja e mëtejshme e burimeve natyrore dhe e biodiversiteti mund të rezultojë nga menaxhimi i vazhdueshëm i dobët, degradimi, infrastruktura e dobët teknike dhe mungesa e vetëdijesimit;
 - Kërkesa për peizazhe të paprekura dhe biodiversiteti konkurren me kërkesat për eksploatim të shtuar të vlerave specifike siç janë terrenet për ski , lidhjet e shpejta rrugore dhe (në shkallë më të madhe) hidro-energji; planifikimi i projekteve për infrastrukturë pa konsideratë ndaj mjedisit mundet seriozisht të dëmtojë natyrën.
- Turizmi
 - Zhvillimi i pakoordinuar mund të shkatërrojë resurset natyrore si bazë për turizëm.
- Kultura
 - Emigrimi i vazhdueshëm dhe humbja e trashëgimisë kulturore e kërcënojnë shoqërinë e Dragashit.
- Rrjeti rrugor, transporti
 - Financimi i dobët ose tej-financimi i projekteve rrugore mund të çojnë deri te investimet joefikase të joefektive (rrugët e lira kërkojnë më shumë mirëmbajta, rrugët e shtrenjta në vend të gabuar ose pa masa shoqëruese mund të mos japin asnjë impuls zhvillimor).
- Infrastruktura teknike
 - Mungesa e menaxhimit të mbeturinave është duke e kërcënuar shëndet publik dhe parqet një pengesë për zhvillimin e turizmit, duke krijuar ndotje të pakontrolluar nëpër lumenj dhe brenda vendbanimeve.

- Investimi në infrastrukturë teknike pa kualitet të mjaftueshëm të punës dhe mirëmbajtje të mjaftueshme do të harxhonte burimet financiare pa efekt afatgjatë.
- Mungesa e vetëdijes publike dhe vullnetit për të bërë pagesën, rrezikon instalimin e infrastrukturës teknike punuese.

4.5 PËRMBLEDHJA

Duke e analizuar situatën e tashme të Dragashit, siç është paraqitur në kapitujt 3 dhe 4.1 deri në 4.2, ka sfera, në të cilat Dragashi është i fuqishëm ose shumë i fuqishëm. Sidoqoftë, ekzistojnë gjithashtu disa dobësi esenciale me të cilat duhet përballur në komunë. Skema vijuese i ilustron këto çështje, të cilat janë përshkruar në detaje në Kapitujt më poshtë

| | Dobësitë | | | Fuqitë | |
|----------------------------------|----------|--|--|--------|--|
| Vendbanimet | | | | | |
| Shfrytëzimi i tokës | | | | | |
| Arsimimi | | | | | |
| Shëndetësia | | | | | |
| Ekonomia, Punësimi | | | | | |
| Bujqësia, Pylltaria | | | | | |
| Biodiversiteti | | | | | |
| Turizmi | | | | | |
| Kultura | | | | | |
| Rrjeti rrugor, Transporti | | | | | |
| Infrastruktura teknike | | | | | |

Ekzistojnë mundësi dhe kërcënime për zhvillimin e mëtejshëm në çdo aspekt, siç është paraqitur në kapitujt më poshtë. Me analizimin e situatës aktuale, janë disa trende që duket se po krijojnë rrezikun më të lartë për komunën. Në anën tjetër, gjithashtu ekzistojnë disa mundësi shumë të mëdha. Në tabelën në vijim këto kërcënime dhe mundësi të mëdha janë nënvizuar.

| |
|--|
| Kërëcnimet kryesore për Dragashin |
| Braktisja e bujqësisë |
| Nëse aktivitetet bujqësore qëndrojnë një fushë me rezultate të ulëta ekonomike për punën e vështirë, të rinjtë posaçërisht do të lakmojnë të braktisin bujqësinë dhe të kërkojnë punë në sektorët tjerë ekonomik. Rënia e shfrytëzimit të tokës në afat të gjatë do të ndryshonte në mënyrë dramatike karakteristikat fizike të pejzazhit dhe karakterin e Komunës. |
| Shpopullimi si rezultat i ekonomisë së dobtë |
| Nëse situata makro ekonomike e Kosovës si tërësi dhe ekonomia lokale e Dragashit qëndrojnë të dobëta për një kohë të gjatë dhe nuk ofrojnë vende pune, pa të hyra dhe pa perspektivë (posaçërisht për gjeneratën e re), duhet të dyshohet se procesi i emigrimit do të vazhdojë në të ardhmen. Kjo mund të çojë në shpopullim posaçërisht të fshatrave të thella dhe do të frenonte zhvillimin e Komunës. |
| Degradimi i biodiversitetit |
| Nëse vetëdija për mjedisin, situata e infrastrukturës teknike dhe vlerësimi i çështjeve të mjedisit në planifikimin infrastrukturor mbeten të dobëta, trendet aktuale siç janë hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe zgjerimi i pakontrolluar i vendbanimeve si dhe ndikimet e ardhshme nga projektet për rrugë, hidrocentrale, etj. mund t'i shkaktojnë degradim serioz biodiversitetit të Komunës. Kjo mund të shkatërrojë thesarin e Dragashit: resurset e tija të pasura natyrore. |
| Mundësitë kryesore për Dragashin |
| Mbrojtja e biodiversitetit |
| Resurset e pasura natyrore përfshijnë një diversitet të madh të bimëve dhe të shtazëve dhe duhet të merret parasysh si fuqia më e madhe e Komunës. Kështu, shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e biodiversitetit - kryesisht zgjerim i parkut nacional Malet e Sharrit - ofron shans për mbrojtjen e këtij thesari për të ardhmen që do të jetë një vlerë e madhe si për njerëzit ashtu edhe për natyrën. |
| Zhvillimi i turizmit |
| Bukuria e natyrës dhe trashëgimia e pasur kulturore ofrojnë shansin për të zhvilluar turizëm të bazuar në natyrë që mund të sigurojë të hyra dhe vende pune dhe kështu të fuqizojë ekonominë lokale. Numri i madh i njerëzve nga diaspora që kalojnë kohën e verës në Dragash është një faktor pozitiv në këtë; zgjerimi i parkut nacional Malet e Sharrit ofron një tjetër shansë të madhe për promovimin e Dragashit si një zonë për turizëm. |
| Përshtatja e bujqësisë dhe zhvillimi i ekonomisë lokale |
| Përmirësimi i produkteve bujqësore, kooperimi dhe marketingu ofrojnë potencial që çon në rritje të kuantitetit dhe kualitetit të produkteve dhe përmirësojnë krijimin e vlerës. Kjo mund ta stabilizojë bujqësinë dhe shfrytëzimin e tokës si bazë për zhvillim ekonomik të Dragashit. Zhvillimi shtesë i sektorit sekondar dhe posaçërisht terciar të ekonomisë (p.sh. me përmirësimin e arsimimit profesional) mund të ofrojë vende pune dhe të hyra, duke fuqizuar ekonominë lokale. Hyrja e të hollave nga fondet ndërkombëtare dhe nga diaspora ofrojnë shanse për ta arritur këtë. Kështu, këto të holla duhet të harxhohen për projekte strategjike me interes të përbashkët. |